

ABETARJA E PUSHTETIT

LIBËRTH MBI
POLITIKËN, NJERËZIT DHE
PARTITË NË KOSOVË

DHJETOR 2011





ABETARJA E PUSHTETIT

LIBËRTH MBI
POLITIKËN, NJERËZIT DHE
PARTITË NË KOSOVË

DHJETOR 2011



Ky libërth është bërë i mundshëm me përkrahjen zemërgjërë të Fondit Demokratik për Ballkan (BTD), projekt ky i Fondit German Marshall të Shteteve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	7
SHKURTESAT DHE AKRONIMET	8
HYRJE	10
NGRITJA DHE RËNIA E KOMUNIZMIT: 1945-1989	14
Sistemi i detyrueshëm	14
Trazirat e vitit 1981	18
Kthimi i Shtypjes pas vitit 1981	20
PARTI APO LËVIZJE? – LDK	23
Krijimi i LDK-së	24
LDK-ja si Lëvizje Masovike	26
Hegjemonia politike e LDK-së deri në vitin 1997	28
Fragmentimi i LDK-së	32
NGA TYTA E PUSHKËS: PDK DHE AAK	35
Strukturat Ilegale dhe UÇK-ja	35
Shou i një njeriu – PDK	39
Ambicioz dhe Finok – AAK	44
PROJEKTE TË KOTËSISË: ORA DHE FER	47
Partia e cila mbeti pa kohë – ORA	48
Jeta nuk është fer – FER	50
JASHTË ETALONEVE - AKR DHE VETËVENDOSJE!	51
Ndërtimi i Kosovës apo i vetvetes? – AKR	51
Vetëvendosje! – e ardhmja e ndritur e Kosovës?	53
GJEOGRAFIA, POLITIKA DHE VOTIMI	56
Regjionalizimi	56
Ndarja Rurale-Urbane	62
Partitë etnike	66
PËRSHKRIM I SHKURTËR I PARTIVE POLITIKE	70
SHTOJCA I. REZULTATET E ZGJEDHJEVE 2000 deri 2010	86
INDEX	88

PARATHËNIE

Askush nuk ka monopol mbi dijen, mirëpo në Kosovë, duket se askush nuk ka monopol as mbi të vërtetën. E “vërteta” gjendet në syrin e vështruesit dhe këndvështrimi i vështruesit mbi të kaluarën ndikohet nga ajo se ku gjenden ata sot.

Kosova është vend i vogël, me vetëm 11,000 km katrorë dhe me rreth 2 milion banorë. Megjithatë, kur bëhet për fjalë për skenën e saj politike lirisht mund të thuhet se ajo është një rrjetë jashtëzakonisht e ndërlikuar dhe e koklavitur. Hulumtimi mbi Peisazhin Politik të Kosovës, ka qenë përvojë e mrekullueshme dhe njëkohësisht sfiduese. Shumë ngjarje ende janë ended të mbuluara me petkun misterioz. Për shembull, ne nuk e dimë saktë se kush e themeloi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) apo kush e shkroi statutin e parë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Gjatë punës sonë, shpeshherë dëgjonim dy apo më tepër versione të këtyre ngjarjeve nga njerëz të cilit kishin qenë prezent në këto mbledhje historike. Edhe në kujtimet e shkruara të personazheve kyçe mund të hasim në tregime ngjashëm të ngatërruara.

Është e qartë që ndjenja e përgjegjësisë qytetare ndaj publikut nuk figuron lartë në agjendën e tregimtarëve apo mund të ndodhë që agjendat personale lënë në hije çdo ndjenjë të përgjegjësisë që ne si komb kemi ndaj historisë sonë dhe ndaj generatave të reja.

Përkundër këtyre problemeve, ekipi i hulumtuesve i përbërë nga Brikenë Hoxha, Milot Rexhepi, Dren Pozhegu dhe Arbër Kuçi, kanë bërë analizë të hollësishme dhe kanë zhvilluar intervista me shumicën e njerëzve që ndihmuan në formësimin e skenës së sotme politike. Kjo ishte detyrë e lodhshme dhe shpeshherë nevojitej edhe pika e fundit e energjisë për zgjidhjen e raporteve konfliktuoze të cilat i merrnim. Megjithatë, ne u jemi mirënjohës të gjithë atyre që u treguan të gatshëm ta ndajnë njohurinë e tyre rreth rëndësisë së ngjarjeve vendimtare që ndodhën në skenën vazhdimisht të ndryshueshme politike në Kosovë.

Ka pasur edhe të atillë që nuk ishin të gatshëm apo të hapur t'i ndajnë informatat e tyre me ne, por ua lëmë lexuesve t'i gjykojnë ata.

Në fund, por po aq e rëndësishme, është mirënjohja e jashtëzakonshme për përkrahjen e palodhshme dhe këshillat që anëtarët tonë të bordit, Eggert Hardten, Tim Judah dhe Dominik Zaum, na ofruan gjatë procesit të redaktimit. Poashtu i jemi mirënjohës Rosie Whitehouse për ndihmën e saj gjatë procesit të lodhshëm të redaktimit.

Engjellushe Morina

Drejtoreshë Ekzekutive

Prishtinë

Dhjetor 2011

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	GIG - Gradanska Inicijativa Gora (Inicijativa Qytetare e Gorës)	KKR - Koalicioni për Kosovë të Re
ADK - Alternativa Demokratike e Kosovës	GIS - Gradanska Inicijativa Srbija (Inicijativa Qytetare Serbe)	KP - Koalicija za Povratak (Koalicioni “Kthimi”)
AKR - Aleanca Kosova e Re	HRW - Human Rights Watch (Organizata për të Drejtat e Njeriut)	KMLDNJ - Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut
AQK - Aleanca Qytetare e Kosovës	ICG - International Crisis Group (Grupi Ndërkombëtar i Krizave)	KTB - Kosova Türk Birliği (Bashkimi Turk i Kosovës)
AVNOJ - Antifašističko Vijeće Narodnog Oslobođenja Jugoslavije (Këshilli Anti-Fashist Nacional Çlirimtar i Jugosllavisë)	ICTY - International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia (Tribunali Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi)	KTV - TV Kohavisioni
BDA - Bosnjačka Demokratska Alternativa (Alternativa Demokratike Boshnjake)	IKS - Inicijativa Kosovare për Stabilitet	KVM - Kosovo Verification Mission (Misioni Verifikues në Kosovë)
BK - Balli Kombëtar	ONJQ - Organizatë Ndërkombëtare Joqeveritare	LB - Lëvizja për Bashkim (Movement for Unity)
BSDAK - Bosnjačka Stranka Demokratske Akcije Kosova (Partia Boshniake për Aksion Demokratik në Kosovë)	IPVQ - Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes Demokratike e Kosovës	LBD - Lëvizja e Bashkuar Demokratike
BTD - Balkan Trust for Democracy (Fondi i Ballkanit për Demokraci)	IRDK - Inicijativa e Re Demokratike e Kosovës	LKK - Lidhja e Komunistëve të Kosovës
CDS - Crnogorska Demokratska Stranka (Partia Demokratike e Malazezëve)	JNA - Jugoslovenska Narodna Armija (Armata Popullore e Jugosllavisë)	LDD - Lidhja Demokratike e Dardanisë
LKJ - Lidhja Komuniste e Jugosllavisë	JSL - Jedinstvena Srpska Lista (Lista e Bashkuar Serbe)	LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës
PKJ - Partia Komuniste e Jugosllavisë	KACI - Kosovo Action for Civic Initiatives (Aksioni Kosovar për Inicijativa Qytetare)	LDSH - Lëvizja Demokratike Shqiptare
E15 - Grupi i ekspertëve	KAN - Kosovo Action Network (Rrjeti i Aksionit Kosovar)	LEK - Lidhja e Egjiptianëve të Kosovës
ESI - European Stability Initiative (Inicijativa Evropiane për Stabilitet)	KDTP - Kosova Democratic Türk Partisi (Partia Demokratike Turke e Kosovës)	LIB - Lëvizja për Integrim dhe Bashkim
BE - Bashkimi Evropian	KEK - Korporata Energjetike e Kosovës	LKÇK - Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës
EULEX - European Union Rule of Law Mission in Kosovo (Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë)	KFOR - Kosovo Force (Forca paqëruajtëse e NATO-s në Kosovë)	LPK - Lëvizja Popullore e Kosovës
FARK - Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës	KIC - Kosovo Information Center (Qendra Informative e Kosovës)	LPRK - Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës
FER - Partia Fryma e Re	KIPRED - Kosovar Institute for Policy Research and Development (Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave)	LRSSHJ - Lëvizja për Republikën Socialiste të Shqiptarëve në Jugosllavi
FES - Friedrich Ebert Stiftung		NATO - North Atlantic Treaty Organisation (Organizata e Aleancës Veri-Atlantike)
GAP - Institute for Advanced Studies (Instituti për Studime të Avancuara)		OJQ - Organizatë Joqeveritare
		ND - Nova Demokratija (Demokracia e Re)

NDS - Nova Demokratska Stranka (Partia e Re Demokratike)
NP - Ndërmarrje Publike
NSH - Ndërmarrje Shoqërore
OSCE - Organisation for Security and Cooperation in Europe (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë)
ORA - Partia Reformiste ORA
OZNA - Odeljenje za Zaštitu Naroda (Departamenti për Mbrojtjen e Popullit)
PAI - Partia e Ashkalinjëve për Integrim
PBD - Partia e Bashkimit Demokratik
PD - Partia e Drejtësisë
PSDK - Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës
PDASHK - Partia Demokratike e Ashkali Shqiptare të Kosovës
PDK - Partia Demokratike e Kosovës
PDKI - Partia Demokristiane për Integrim
PFK - Partia Fshatare e Kosovës
PGJK - Partia e të Gjellbërve të Kosovës
PK - Policia e Kosovës
PLK - Partia Liberale e Kosovës
PNDSh - Partia Nacional Demokratike Shqiptare
PPDK - Partia e Progresit Demokratik të Kosovës
PPI - Partia e Pensionistëve dhe Invalidëve
PPK - Partia Parlamentare e Kosovës
PQLK - Partia Qendra Liberale e Kosovës
PREBK - Partia Rome e Bashkuar e Kosovës
PSDK - Partia Social Demokrate e Kosovës
PSK - Partia Socialiste e Kosovës

PSHDK - Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës
PTK - Posta dhe Telekom i Kosovës
QPK - Qeveria e Përkohshme e Kosovës
RAE - Roma, Ashkali and Egyptians (Romë, Ashkali dhe Egjiptas)
SANU - Srpska Akademija Nauka i Umetnosti (Akademia e Shkencave dhe Arteve të Serbisë)
PSA - Provinca Socialiste Autonome
ASP - Aleanca Socialiste për Punëtorët
SDA - Stanka Demokracija Akcije (Partia e Aksionit Demokratik)
SDSKiM - Srpska Demokratska Stranka Kosova i Metohije (Partia Demokratike Serbe e Kosovës dhe Metohisë)
SFRJ - Republika Federale Socialiste e Jugosllavisë
SHIK - Shërbimi Informativ i Kosovës
SKMS - Srpska Kosovsko-Metohijska Stranka (Partia Serbe e Kosovës dhe Metohisë)
SKOJ - Savez Komunističke Omladine Jugoslavije (Lidhja e Rinisë Komuniste të Jugosllavisë)
SLKM - Srpska Lista za Kosovo i Metohiju (Lista Serbe për Kosovë dhe Metohi)
SLS - Samostalna Liberalna Stranka (Partia Liberale e Pavarur)
SNS - Srpska Narodna Stranka (Partia Popullore Serbe)
SNSKiM - Savez Nezavisnih Socijaldemokrata Kosova i Metohije (Unioni i Pavarur i Social Demokratëve të Kosovës e Metohisë)

SPPA - Strukturat e Përbashkëta të Përkohshme Administrative
TMK - Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UÇK - Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UD - Unioni Demokratik
UDBA - Uprava Državne Bezbednosti (Departamenti i Shërbimit Sekret Shtetëror)
UJDI - Ujedinjena Jugoslovenska Demokratska Inicijativa (Inicijativa e Bashkuar Demokratike e Jugosllavisë)
UNIKOMB - Uniteti i Kombit
UNMIK - United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (Misioni i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë)
UNSC - United Nations Security Council (Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara)
US - United States (Shtetet e Bashkuara)
VATAN - Koalicija VATAN (Koalicioni VATAN)
VV - Lëvizja Vetëvendosje!

HYRJE

Më 30 mars 2011, pas vetëm 35 ditësh në postin e Presidentit të Kosovës, Gjykata Kushtetuese vendosi që emërimi i Behgjet Pacollit në këtë post ishte bërë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe prandaj ishte e jashtëligjshme. Pacolli u detyra të jap dorëheqje. Ai megjithatë poashtu kishte nënshkruar marrëveshjen për krijimin e qeverisë së koalicionit me Hashim Thaçin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe me Slobodan Petroviqin e Partisë Liberale Serbe (SLS). Vazhdimi i koalicionit qeverisës tash ishte i rëndësishëm parësor. Shumë vendimmarrës filluan të pyesin se si mund të arrihej kjo pa pasur nevojë të shkohej në zgjedhje të reja të përgjithshme. Atëbotë, filluan të qarkullojnë disa emra për president të ri, mirëpo për të fituar dy të tretat e votave në parlament duhej llogaritur edhe në përkrahjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), e cila tashmë për herë të parë ishte në opozitë.

Më 6 prill, Pacolli, Thaçi dhe Isa Mustafa, lider i LDK-së, u ftuan në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, ku sipas Pacollit një pliko në të cilat gjendeshin tre emra ishte prezantuar para tyre. Pastaj, tre udhëheqësit partiak zgjodhën personin që sipas tyre ishte kandidati më adekuat për postin e presidentit. Kështu, Atifete Jahjaga morri thirrjen telefonike të cilin as që e kishte ëndërruar ndonjëherë.

E kishin pyetur nëse ishte e gatshme t'i shërbente vendit si figurë e përkohshme. Deri atëherë, Jahjaga kishte qenë zëvendës udhëheqëse e Policisë së Kosovës (PK). Ajo më parë kishte zhvilluar trajnime në SHBA dhe nuk ishte anëtarë në ndonjë parti politike. Jahjaga e pranoi ofertën dhe u emërua në postin e presidentes në seancën e Kuvendit të mbajtur më 7 prill, ku i morri 80 vota në raundin e parë. Emërimi i shpejtë e shpëtoi qeverinë dhe krijoi ndjenjë të lehtësisë tek të gjitha palët.

Ajo që e dallonte dukshëm administratën e re ishte fakti se për herë të parë qeverinë e kishte krijuar njëra prej tri partive më të mëdha politike pa pasur nevojë për njërin nga dy të tjerat në koalicion. Këtë

radhë, nevojiteshin vetëm një parti e vogël dhe partitë e komuniteteve pakicë.

Megjithatë, kjo e dëshmonte edhe sa e brishtë ishte situata politike në atë kohë. Partia qeverisëse, PDK-ja, është goditur nga disa stuhit politike. Raporti i Këshillit të Evropës i hartuar nga Dick Marty i cili pohonte që kryeministri mund të ketë qenë i përfshirë në trafikimin e organeve njerëzore, u pasua shumë shpejt edhe me mosmarrëveshje të rënda brenda partisë rreth procesit të vendimmarrjes. Për t'i bërë punët edhe më keq, nënkryetari i PDK-së, Fatmir Limaj, akuzohet për krime të luftës dhe për korrupsion. Në plan më të gjerë, kompleksitetin e skenës politike e dëshmon edhe fakti që Ramush Haradinaj, ish-kryeministër i Kosovës, për herë të dytë po akuzohet nga Tribunali Ndërkombëtar në Hagë. Përveç kësaj, skenën politike e ka turbulluar edhe hyrja në parlament e Lëvizjes Vetëvendosje, parti kjo jokonvencionale, e cila haptazi bën thirrje për bashkim me Shqipërinë. E gjithë kjo i ka vënë vëzhguesit para një ankthi të vazhdueshëm. Çka do të ndodh tash?

Por si arritëm deri këtu? Në këtë libërth, kemi bërë orvatje ta ofrojmë këtë shpjegim.

Ky libërth synon ta shpjegoj pejsazhin aktuale politike dhe të identifikoj faktorët dhe proceset që e kanë formësuar atë. Libërthi është dizajnuar në atë mënyrë që t'i jap lexuesit njohuri themelore mbi politikën bashkëkohore në Kosovë dhe forcat historike dhe partitë politike që e kanë krijuar atë.

Një dimension i rëndësishëm në çdo skenë politike është mënyra sesi organizohet individët për t'i promovuar qëllimet e tyre politike. Në rastin e demokracive bashkëkohore, mënyra kryesore, edhe pse jo e vetmja, për ta bërë këtë është nëpërmjet partive politike. Prandaj, partitë dhe zhvillimi i tyre na ofrojnë lentën primare nëpërmjet të cilës mund ta studiojmë skenën politike. Duke i analizuar partitë, origjinën e tyre, strukturat dhe performancat, ne mund të studiojmë një gamë të tërë faktorësh që



ATIFETE JAHJAGA

20 PRILL 1975,
RASHKOC, GJAKOVË

Jahjaga ndjeku shkollën e mesme në Prishtinë. Në vitin 2000 përfundoi studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Menjëhërë pas diplomimit Jahjaga i'u bashkangjiti Policisë së Kosovës ku gradualisht u promovua në pozitën e Zëvendës Drejtores së Përgjithëshme. Gjatë kohës në Policinë e Kosovës Jahjaga

vazhdoi studimet në Universitetin e Leicester-it në Mbretërinë e Bashkuar në fushën e Menaxhimit Policor dhe Ligjin Penal dhe në Shkenca Kriminallistike në Universitetin e Virginia-s në SHBA. Në Prill të 2011 Jahjaga u zgjodh presidentja e parë femër pas marrëveshjes së arritur në mes të PDK-së, LDK-së dhe AKR-së.

e kanë formësuar skenën politike në Kosovë. Për shembull, duke analizuar PDK-në dhe AAK-në, ne kuptojmë trashëgiminë e UÇK-së dhe mënyrën sesi ajo ka formësuar politikën sot, dhe rolin e qëndrueshëm që ajo akoma luan përtej suazave të sistemit partiak.

Edhe gjeografia luan rol kyç në formësimin e mendimit në mesin e kosovarëve. Rëndësia politike e ndarjeve lindje-perëndim dhe veri-jug është vendimtare për politikën e shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Rrënjët rajonale të partive politike janë poaq të rëndësishme sa edhe ndarjet rurale-urbane. Peisazhi politike mund të definohet gjerësisht duke i përfshirë institucionet dhe strukturat politike kosovare dhe ndërkombëtare, partitë politike dhe shoqërinë civile. Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) tashmë ka shkruar për institucionet dhe strukturat kyçe politike, përfshirë këtu edhe ato ndërkombëtare, prandaj, në këtë libërth nuk do të përqendrohemi në këtë drejtim.¹

E lëmë anash faktin që shumica e kosovarëve dyshojnë në legjitimitetin e rezultateve elektorale të njëjës apo partisë tjetër politike. Kosova ka listë jashtëzakonisht të vjetruar elektorale e cila ngjason fare pak me realitetin. Votuesit shpeshherë votojnë në shkëmbim të favoreve që i marrin nga partitë politike para ose pas zgjedhjeve. Ne i pranojmë rezultatet ashtu siç janë, por poashtu mendojmë që këto çështje nuk e ndryshojnë në mënyrë thelbësore analizën tonë. Ne e marrim elektoratin e Kosovës dhe e studiojmë atë. Ne shkruajmë për ngritjen e partive të cilat votuesit mund t'i votojnë dhe për vendimet që ata i marrin.

Pse nuk ia kemi kushtuar një kapitull partive

¹ Shih, Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), Kush është Shefi? Prishtinë, 2008.

politike serbe? Serbët e Kosovës, deri vonë, nuk kanë marrë pjesë në zhvillimin demokratik të Kosovës. Përveç në zgjedhjet e vitit 2001, kur shumica e serbëve të Kosovës votuan për një lëvizje të vetme me një agjendë mjaft të kufizuar, pjesëmarrja e tyre në jetën politike u shua pothuajse plotësisht deri në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010. Fakti që partitë serbe janë regjistruar dhe që serbët e Kosovës, të paktën në qendër dhe jug të Kosovës, i'u janë kthyer qendrave të votimit, pjesërisht mund t'i atribuohet kokëfortësisë së *Partisë së Pavarur Liberale* (Partisë Liberale Serbe – SLS) nën udhëheqjen e Sllobodan Petroviqit. Kjo parti sot ka shumicën e ulëseve serbe në kuvend. Megjithatë, aspekti më i gjerë i politikës dhe partive serbe në Kosovë, dhe posaçërisht në veri të vendit, është përtej fushëveprimit të këtij libërthi, dhe ne jemi përmbajtur nga një orvatje e tillë posaçërisht pas ndryshimeve të shpejta që po ndodhin në veri që nga korriku i këtij viti.

Historia e demokracisë kosovare nuk mund të parafytyrohet pa ndikimin e “faktorëve të jashtëm.” Zyrtarë të huaj ishin prezent në disa momente kyçe, posaçërisht nga viti 1997 e tutje. Në vitin 1998, shqiptarët e Kosovës bënë thirrje për ndërhyrjen e bashkësisë ndërkombëtare dhe tash me kalimin e kohës po e refuzojnë atë. Prej vitit 1999 e këtej, gjatë administratës së UNMIK-ut, çdo hap i rrugës demokratike të Kosovës është dokumentuar, komentuar, ushqyer e në disa raste edhe penguar. Kosovarët kujtojnë se si në vitin 2001, shefi i atëhershëm i UNMIK-ut, Hans Haekkerup i'a ndërpreu mikrofonin Fatmir Limajt në kuvend. Për përzierjen e zyrtarëve të huaj në politikën kosovare mund të flitet gjatë, mirëpo, kjo nuk është tema e punimit tonë.

Ky libërth shërben si hyrje në skenën politike

të Kosovës. Ai nuk synon të shkruaj historinë e saj, pjesërisht për shkak të ndërlikimeve por edhe për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme. Në skenën vazhdimisht të ndryshueshme politike të Kosovës në periudhën e pasluftës, nuk është bërë asnjë analizë sistematike mbi trendet dhe faktorët që ndikojnë atë. Nuk është bërë as ndonjë hulumtim paraprak për ndikimin e këtyre trendeve në jetën politike në Kosovë. Hulumtimet e pakta mbi peisazhin politike në Kosovës nuk i janë vënë në dispozicion publik në një mënyrë të kuptueshme ose të dobishme. Megjithatë, shpjegimi i qartë dhe i saktë i peisazhit të ndryshueshëm politike është i rëndësishëm për proceset demokratike. Këto informata janë kyçe për qytetarët në mënyrë që ata të mund të marrim vendime të informuara se kush do t'i përfaqësoj ata dhe interesat e tyre në qeveri. Qytetaria e informuar është element i rëndësishëm i demokracisë.

E vërteta është se Kosova nuk e shkruan historinë e saj, të paktën akoma jo. Këtë është dashur ta mësojmë në mënyrë të vështirë. Pas intervistave me personalitete kyçe të dy dekadave të fundit, u habitëm tejmasë nga mungesa e dëshmimeve objektive që do t'i konfirmonin tregimet e tyre. Dëshmitë objektive mungojnë pothuajse në tërësi. T'iu japim disa shembuj të habitshëm: rezultatet e zgjedhjeve të vitit 1998 nuk i kemi gjetur në asnjë faqe të internetit dhe në asnjërinë nga gazetatat kryesore të Kosovës. Mungon lista përfundimtare e deputetëve të kuvendit të Kosovës pas zgjedhjeve të vitit 1992. Emrat e themeluesve të UÇK-së, sipas disa pohimeve katër të tillë, mbesin në errësirë. Në asnjë botim kosovar nuk mund të gjenden informata për punën e kuvendit të fundit socialist të Kosovës, në të cilin morën pjesë shqiptarët e Kosovës.

Asnjë gjykim përfundimtar nuk mund të bëhet për dekadën e parë të shtetësisë së Kosovës, në formën fantome të saj, nga viti 1989 deri në vitin 1999, sepse edhe ajo histori është akoma e papjekur. Ne megjithatë frikësohemi se kurrë nuk do të ketë një raport të tillë nëse askush nuk merr me shënimin e historisë në të ardhmen e afërt. Për këtë periudhë janë shkruar shumë pak libra, e aq më pak dëshmi të dorës së parë nga personat që morën pjesë në këtë histori. Prandaj, e vërteta mbetet mjegull e raporteve gazetareske dhe memoareve. Ç'është më e keqja, edhe ajo pak punë që është bërë, shpeshherë është bërë nga të huajt. Nganjëherë në kërkim të vërtetës, na dukej thujse ishte hedhur një shtresë e harresës kolektive mbi çështjen më prekëse të historisë së Kosovës, çështjen e kolaboracionit dhe rezistencës gjatë periudhës socialiste dhe më vonë. Ka plagë të thella të cilat duhet shëruar dhe procesi i shërimit duhet të

filloj diku.

Prandaj, për arsye të qarta, kemi vendosur ta mbajmë një ton të përgjithshëm e të distancuar. Jemi të vetëdijshëm se mund të akuzohemi për qasje sipërfaqësore por ne e dimë pse nuk kemi dashur të bëjmë gjykime. Ne nuk do t'iu tregojmë “tregimin e plotë,” thjeshtë për shkak se ai tregim është shumë i gjatë dhe i ndërlikuar për ta shpjeguar në një libërth si ky.

Derisa punimi i trajton mënyrat sesi shoqëria civile mund të ketë ndikuar në skenën politike në Kosovë, fokusi ynë primar megjithatë është tek partitë politike. Sistemi partiak është crucial për të kuptuar se kush e mban pushtetin mbi procesin e vendimmarrjes në Kosovë. Meqë partitë politike përbëhen nga individë dhe përfshijnë dinamika të brendshme të pushtetit, gjatë studimit të sistemit partiak duhet t'i kushtohet vëmendje individëve përbrenda partive, historive të tyre dhe marrëdhënieve sociale në mes anëtarëve të partive. Prandaj, ne kemi vendosur t'i shqyrtojmë faktorët që kontribuojnë në formimin e partive politike; historinë e udhëheqësve partiak; dinamikat e pushtetit që ndikojnë në proceset e brendshme të vendimmarrjes dhe programet partiake.

Me këtë hulumtim, Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) synon të ofroj një mapë të peisazhit politike të Kosovës në periudhën e pasluftës, përfshirë këtu formësimin e saj gjatë periudhës para luftës. Peisazhi politike në Kosovë po zhvillohet së bashku me shoqërinë kosovare, dhe të dyja kanë ndikime të këmbyeshme njëra mbi tjetrën. Pas vitit 1999, zhvillimet politike dhe institucionale sillëshin rreth çështjeve siç ishin bartja e kompetencave dhe Shpallja e Pavarësisë. Prandaj, fakti që Kosova e kishte arritur pavarësinë e saj nënkuptonte që premtimi i vetëm më i rëndësishëm politik i të gjitha partive shqiptare – si të arrihej pavarësia – nuk ishte më çështje. Besnikëritë e dikurshme ndaj partive politike duket se po veniten ngadalë derisa njerëzit përsëri po shikojnë se kush do t'i përfaqësoj ata dhe kush do t'i trajtoj çështjet e shumta shoqërore që rëndojnë mbi Kosovën sot.

Nëpërmjet këtij libërthi, IKS synon t'iu ofroj lexuesit njohuri më të mira rreth skenës politike në Kosovë, dhe të shpjegoj në veçanti pse i ka udhëheqësit aktual politik. Punimi synon të shpjegoj çka sjellin ata në aspektin shoqëror dhe kulturor në tavolinën politike për shkak të historisë së tyre dhe shkallën në të cilën ata i përfaqësojnë interesat e votuesve të tyre. Prandaj ky libërth, rezultati i hulumtimit tonë duhet të jenë shpjegim lehtë i lexueshëm, i shoqëruar me një analizë mbi formacionet dhe individët që kanë shënuar 20 vitet e fundit në Kosovë.

Por para se të vazhdojmë më tutje, ju kemi

ofruar një shënim mbi metodologjinë tonë. Gjatë hulumtimit, IKS ka zhvilluar më tepër se 50 intervista të hollësishme me figura aktuale dhe të dikurshme të njohura politike dhe me udhëheqës të degëve lokale të partive politike. Njëri prej qëllimeve ishte të kuptohen dinamikat që ndikojnë mbi bastionet e partive kryesore politike. Hulumtimin kryesor e kemi shoqëruar me burime shtesë, përfshirë këtu leximin e hollësishëm të ligjeve mbi zgjedhjet dhe partitë politike, politikat, librat, botimet, mediat dhe dokumentet e tjera.

Për ta kuptuar peisazhin aktual politik në Kosovë, duhet t'i kthehemi kontekstit politik, ligjor dhe të sigurisë që çoi në lindjen e sistemit shumë-partiak në fillim të viteve 1990. Kapitulli i parë trajton lindjen dhe rënien e komunizmit në Kosovë dhe trashëgiminë e tij në politikën aktuale. Në kapitullin e dytë flitet për lindjen e partive politike dhe udhëheqësit e tyre para vitit 1999. Kapitulli i tretë trajton skenën politike në Kosovën e pasluftës dhe si UÇK-ja ndihmoi në formësimin e politikës. Është trajtuar edhe lindja e partive politike nga gjiri i shoqërisë civile si dhe partitë e krijuar pas luftës dhe pas pavarësisë që nuk i takojnë asnjërit prej grupeve kryesore. Të gjithë kapitujt përfshijnë analiza të trendëve kyçe gjatë këtyre periudhave.

Libërthi është i shoqëruar me biografitë e shkurta të individëve që kanë ndikuar në formësimin e peisazhit politike. Përveç kësaj, ka edhe një shpjegim të shkurtë të partive politike, përfshirë këtu edhe partitë e komuniteteve pakicë. Në fund, librin e kemi shoqëruar edhe me një bazë të dhënave lehtë të disponueshme online.

Hulumtimi synon të ofroj përgjigje në një pyetje mjaft direkte: Si kanë arritur udhëheqësit politik këtu ku janë sot?

NGRITJA DHE RËNIA E KOMUNIZMIT

Sistemi i detyrueshëm

Për dallim nga viset e tjera të Jugosllavisë, lëvizja komuniste në Kosovë nuk gëzonte përkrahje të madhe, posaçërisht nga popullsia shqiptare. Në mes luftërave, Kosova ishte vend i varfër dhe kryesisht rural. Qytezat ishin të vogla dhe në ekonomi dominonte tregtia zejtare e shkallës së vogël. Administrata shtetërore jugosllave ishte e centralizuar, dhe arsimi e shëndetësia ofroheshin në shkallë të ulët apo nuk ekzistonin fare. Shumë pak njerëz ishin të interesuar në ide socialiste. Megjithatë, disa shqiptarë të shkolluar u bënë anëtarë të lëvizjes komuniste jugosllave, e cila dominohej nga serbët, kroatët dhe të tjerët. Në Kosovë nuk ekzistonte një parti lokale e shqiptarëve dhe kontaktet e pak njerëzve me partinë jugosllave ishin më tepër rezultat i shkollimit të tyre jashtë Kosovës, posaçërisht në Shkup dhe Beograd. Edhe në vitin 1944, kur tashmë ishte themeluar sektori kosovar brenda partisë komuniste jugosllave, vetëm 30 përqind e 1,238 anëtarëve të partisë në Kosovë ishin shqiptarë.² Në mesin e shqiptarëve, partia komuniste shihej e dominuar nga serbët dhe me orientime pro-jugosllave. Që nga viti 1941, pjesa dërrmuese e Kosovës ishte përfshirë në Shqipërinë e Madhe dhe shumica e shqiptarëve donin ta mbanin këtë status edhe pas luftës dhe frikësosheshin nga kthimi i sundimit serb dhe jugosllav, i cili gjithnjë e më tepër shihej i mishëruar në partinë komuniste të Jugosllavisë. Komunizmi prandaj shihej si pengesë për trajtimin e çështjes së vetëvendosjes.³ Siç shkruante historiani kroat, Ivo Banac, shqiptarët e Kosovës i pritën njësitë “ekskluzivisht shqiptarë” të partizanëve me “tolerancë të rastit” dhe jo me entuziazëm.⁴

2 Lenard J. Cohen. *Piramida Socialiste: Elitat dhe Pushteti në Jugosllavi*. Ontario: Mosaic Press, 1989. p.347. Noel Malcolm pohon që partia komuniste në Kosovë kishte 2,250 anëtarë, shih: *Kosova, Histori e Shkurtër*. Londër: Pan Macmillan, 2002. f.315.

3 Stephen Schwartz. “‘Enveristët’ dhe ‘Titistët,’ Komunizmi dhe Islami në Shqipëri dhe Kosovë, 1941-1999: Nga Lëvizja Partizane e Luftës së Dytë Botërore deri te Lufta Çlirimtare e Kosovës.” *Zhurnal i Studimeve Komuniste dhe Politike të Tranzicionit*, 2009.

4 Ivo Banac i cituar në librin e Stephen Schwartz. “‘Enveristët’ dhe ‘Titistët,’ Komunizmi dhe Islami në Shqipëri dhe Kosovë, 1941-1999: Nga Lëvizja Partizane e Luftës së Dytë Botërore deri te Lufta Çlirimtare e Kosovës.” *Zhurnal i Studimeve Komuniste dhe Politike të Tranzicionit*, 2009.

Gjatë luftës, qëndrimi komunist rreth statusit të Kosovë së pasluftës evoluoi. Deri në vitin 1943, partia komuniste përkrahte idenë që Kosova t’i bashkohej, apo më parë të qëndronte e bashkuar me Shqipërinë.⁵ Pastaj Tito, i cili në vitin 1940 në mënyrë të qartë e kishte përkrahur këtë ide, e ndryshoi qëndrimin e partisë, duke thënë se vetëm duke e mbajtur Kosovën brenda Serbisë ai mund të “shpresonte ta fitonte përkrahjen e serbëve për komunizmin.”⁶ Këshilli Antifashist i Çlirimit Popullor të Jugosllavisë (AVNOJ), në seancën e dytë të tij në nëntor të vitit 1943, vendosi ta krijojë Jugosllavinë federale ku “sllavët e jugut” do të jetonin në gjashtë republika përbërëse. Kosova nuk u përmend në atë rezolutë. Anëtarët shqiptarë të Komitetit të Kosovës brenda Partisë Komuniste Jugosllave bënë përpjekje ta zvogëlojnë ndarjen në mes lëvizjes partizane dhe popullsisë shqiptare të Kosovës.⁷ Atëbotë, u krijua Komiteti Nacional Çlirimtar i Kosovës. Konferenca e parë u mbajt më 31 dhjetor 1943 – 2 janar 1944 në Bujan, në veri të Shqipërisë, në malësinë e Gjakovës, ku 49 komunistë nga Shqipëria, Mali i Zi, Kosova dhe Serbia, 43 prej tyre shqiptarë, miratuan rezolutën për bashkimin e Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit me Shqipërinë pas përfundimit të luftës. Deklarata u pa si “manifest separatist” nga lëvizja komuniste e Jugosllavisë.⁸

Në sytë e serbëve dhe malazezve të Kosovës, të cilën dominonin në anëtarësinë e lëvizjes komuniste në Kosovë, rezoluta e konferencës së Bujanit ishte anateme. Andaj, ajo u refuzua pothuajse menjëherë nga udhëheqësit komunistë jugosllav, gjë që e konfirmonte mosbesimin e tyre ndaj anëtarëve shqiptarë të partisë.⁹ Ky mosbesim u shtua edhe më


5 Sabrina P. Ramet, *Tri Jugosllavitë: Shtetndërimi dhe Legitimimi, 1918 -2005*. Uashington, DC, dhe Bloomington: Woodrow Wilson Center Press, 2006. f.155. Shih poashtu Paulin Kola. *Kërkitimi i Shqipërisë së Madhe*. Nju Jork: Nju Jork University Press, 2003. ff. 42-43.

6 Julie A. Mertus. *Kosova: si mëtet dhe të vërtetat e filluan një luftë*. Berkeley: University of California Press, 1999. Chronology, f.287.

7 Në mesin e anëtarëve ishin Fadil Hoxha, Mehmet Hoxha, Hajdar Dushi, Ali Shukria dhe Zekirja Rexha.

8 Paulin Kola. *Kërkitimi për Shqipërinë e Madhe*. Nju Jork: Nju Jork University Press, 2003. f.54. Owen Pearson. *Shqipëria nën Okupim dhe në Luftë: Nga fashizmi në komunizëm, 1940-1945*. Nju Jork: Qendra për Studime Shqiptare, 2005. f.318.

9 Stephen Schwartz. “‘Enveristët’ dhe ‘Titistët,’ Komunizmi dhe Islami në Shqipëri dhe Kosovë, 1941-1999: Nga Lëvizja Partizane e Luftës së Dytë Botërore deri te Lufta Çlirimtare e Kosovës.” *Zhurnal i Studimeve*



SHABAN KASTRATI – POLLUZHA

1871, POLLUZHË, DRENICË –
21 SHKURT 1945, DRENICË

Luftëtar partizan dhe politikan lokal që luftoi për kauzën shqiptare. Ai ishte nga fshati Polluzhë. Ai nuk kishte shkollim formal. Si djalë i ri u përfshi në protesta politike dhe gjatë Luftës së Parë Botërore ai luftoi kundër pushtimit austriak dhe bullgar. Në kohën e Mbretërisë së Jugosllavisë, Polluzha përfaqësoi rajonin e Drenicës në cilësinë e deputetit. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Polluzha ishte komandant i batalioneve partizane në Kollashin, Mal të Zi dhe në Sanxhak, Serbi.

Pavarësisht rezervave të tij kundër dominimit të serbëve dhe malazezëve në lëvizje, ai përkohejshisht u bashkua me forcat e partizanëve jugosllavë, të cilët ai i konsideronte gjithashtu si pushtues. Polluzha u kthye kundër lëvizjes, pasi që ishte urd-

hëruar të porosis trupat e tij për çlirimin e rajoneve veriore të Serbisë, dhe krijoi njësinë e tij që kishte rreth 15,000 burra. Ai u vra në fillim të vitit 1945 dhe shumë prej ndjekësve e tij u detyruan të largohen nga vendi. I nderuar si hero i luftës shqiptare, kujtesa e tij jeton akoma në folklor dhe në këngë. Ai konsiderohet simbol i rezistencës shqiptare ndaj çdo lloj pushtimi të huaj në Kosovë.

tej kur *Balli Kombëtar*, lëvizja nacionaliste shqiptare filloi kryengritjen kundër komunistëve në vitin 1944, dhe vendosi kontroll mbi rajonin.¹⁰ Më 2 dhjetor 1944, *Ballistët* nga rajoni i Drenicës sulmuan minierën Trepça dhe caqet e tjera.¹¹ Ballistët, të cilët numëronin rreth 2,000 trupa nën udhëheqjen e Shaban Polluzhës dhe që më parë kishin luftuar së bashku me partizanët, tash u bënë rezistencë forcave të tyre për dy muaj me radhë. Pas luftës, anëtarët e *Ballit Kombëtar* në Kosovë dhe Shqipëri u arrestuan, ekzekutuan dhe torturuan për rolin e tyre gjatë luftës dhe për bashkëpunim me gjermanët dhe italianët. Edhe pse kryengritja e Polluzhës u shtyp, vetëm në fund të vitit 1945 Jugosllavia arriti ta fuste nën kontroll të plotë Kosovën.¹² Kjo përfundimisht shkatërroi besimin e Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ) në aftësitë e komunistëve shqiptarë të Kosovës që t'i kontrollonin bashkëkombësit e tyre, sikur të fitonin të drejta më të mëdha për administrimin e krahinës. Shumë anëtarë shqiptarë e

Komuniste dhe Politikave të Tranziçionit, 2009.

10 Balli Kombëtar ishte organizatë nacionaliste, anti-komuniste dhe anti-mbretërore shqiptare e themeluar në tetor të vitit 1939. Organizata udhëhoqte nga Ali Këlcyra dhe Mit-hat Frashëri. Motoja e Ballit Kombëtar ishte: “Shqipëria Shqiptarëve, Vdekje Tradhëtarëve!”.

11 Cituar nga Sabrina P. Ramet, *Tri Jugosllavitë: Shtetndërtimi dhe Legjitimimi, 1918 -2005*. Uashington, DC, dhe Bloomington: Woodrow Wilson Center Press, 2006. f.156.

12 Lenard J. Cohen. *Piramida Socialiste: Elitat dhe Pushteti në Jugosllavi*. Ontario: Mosaic Press, 1989. f.348.

braktisën partinë komuniste, të mllefosur me faktin se i kishin mashtruar rreth çështjes së vetëvendosjes.

Në korrik të vitit 1945, Këshilli Rajonal Popullor i Kosovës, i zgjedhur nga vet PKJ-ja, u mbledh në Prizren dhe votoi që Kosova të bëhet pjesë e Serbisë. Vetëm 33 nga 142 anëtarë të Këshillit ishin shqiptarë.¹³ Krahinës së re Autonome të Kosovës iu premtuan të drejtat e njëta me Vojvodinën, krahinës tjetër të re të Serbisë.¹⁴ Mirëpo për dallim nga Vojvodina, Kushtetuta e Jugosllavisë e vitit 1946 nuk i dha Kosovës kontroll mbi gjykatat, ndërmarrjet publike dhe arsimin.¹⁵

Kontrolli mbi Kosovën tash ishte në duart e serbëve lokalë dhe në duart e shërbimeve serbe dhe jugosllave të sigurimit. Figurë kyçe në këtë periudhë ishte Aleksandar Ranković, ministri i punëve të brendshme dhe shefi i policisë sekrete të Jugosllavisë.¹⁶ Kështu, vitet e pas luftës deri në

13 ‘Anëtarët e këtij trupi të pazgjedhur që përfaqësonin vetëm 2,250 anëtarë të Partisë Komuniste të Kosovës u përkujuan që në Kosovë ishin më tepër se 50,000 trupa të gatshme ti mbrojnë fitimet e luftës.’ Noel Malcolm. *Kosova, Histori e Shkurtyrë*. Londër: Pan Macmillan, 2002. f.315.

14 Lenard J. Cohen. *Piramida Socialiste: Elitat dhe Pushteti në Jugosllavi*. Ontario: Mosaic Press, 1989. f.350.

15 Julie A. Mertus. *Kosova: si mitet dhe të vërtetat e filluan një luftë*. Berkeley: University of California Press, 1999. Chronology, f.288. Vojvodina u shpall ‘krahinë e pavarur’ derisa Kosova quhej ‘rajon autonom’.

16 Ranković ishte ministër për punë të brendshme dhe nënkryetar i Jugosllavisë nga viti 1945 deri në vitin 1966.



FADIL HOXHA

15 MARS 1916, GJAKOVË, KOSOVË
– 22 PRIL 2001, PRISHTINË,
KOSOVË

Shkoi në Shqipëri si adoleshent që të vijoj shkollën e mesme në shqip, ngase arsimimi i mesëm në Kosovë nuk ishte i disponueshëm nën rregullat e Serbisë. Në atë peiudhë ai vendosi kontaktet dhe më vonë i'u bashkua grupeve Marksiste-Leniniste. Më pas Hoxha u kthye për një kohë të shkurtë në Gjakovë ku punoi si mësues. Megjithatë, shumë shpejt ai i'u bashkua rezistencës antifashiste dhe u bë një figurë e rëndësishme në lëvizjen komuniste në Kosovë, ku në vitin 1943 luajti një rol të rëndësishëm në afrimin rreth miratimit të rezolutës në Konferencën e Bujanit.

Hoxha vazhdoi të mbajë poste të larta edhe gjatë kohës kur Aleksandër Rankoviç ishte në kulmin e karrierës së tij në vitet 1950 dhe 1960 dhe u emërua në Këshillin Ekzekutiv Jugosllav në vitin 1963. Pasi që Rankoviç ra nga pushteti në vitin 1966, Hoxha u bë anëtarë i Kryesisë së Jugosllavisë. Prej vitit 1978 deri në vitin 1979 ai mbajti pozitën e kryetarit të kryesisë federale me rotacion, që ishte pozita më e lartë në Jugosllavi pas pozitës së presidentit Josip Broz Tito. Megjithatë, pas vdekjes së Titos dhe demonstratave të mëvonshme të vitit 1981, Fadil Hoxha u akuzua për "separatizëm" nga

politikantët serbë dhe u kritikua nga udhëheqja jugosllave për dëshitim në kontrollimin e nacionalizimit shqiptar. Në vitin 1991, pasi Millosheviqi e kishte marrë kontrollin e partisë në Kosovë dhe e bashkoi atë me partinë serbe, Hoxha u përjashtua, u arrestuar dhe u gjykua pa procedurë të rregullt gjyqësore. Fadil Hoxha ishte aktor kyç në Lidhjen e Komunistëve të Kosovës gjatë përpjekjes për fitimin e të drejtave më të mëdha të shqiptarëve në Jugosllavi. Ai arriti ta bëj gjuhën shqipe gjuhë primare në Kosovë, kishte rol kyç në themelimin e Universitetit të pavarur të Prishtinës dhe Akademisë e Shkencave të Kosovës. Ai gjithashtu ka luajtur rol të madh në rritjen domethënëse të ndihmave federate dhe zhvillimin e programeve në Kosovë, e cila rezultoi me industrializim të shpejtë të Kosovës në vitet 1970 dhe në fillim të viteve 1980.

Në vitin 1992 ai mori pjesë në zgjedhjet e para demokratike dhe deklaroi haptazi që do ta votonte LDK-në. Gjatë luftës në Kosovë ai deklaroi, "nëse do të isha i ri, do t'i veshja përsëri opingat [këpucët] dhe do t'i bashkoheja UÇK-së." Ai u varros me nderimet më të larta.

mes të viteve 1960 ishin vite të represionit të ashpër ndaj shqiptarëve të Kosovës të cilët shiheshin si të pasigurtë dhe të pabesë.

Serbët dhe malazezët, të cilët përbënin më pak se një të tretën e popullsisë së Kosovës në vitin 1954, megjithatë përbënin rreth 67 përqind të forcave të sigurisë, mbanin 68 përqind të pozitave udhëheqëse në partinë komuniste, dhe 50 përqind të anëtarësisë.¹⁷ Në Kosovë kishte shumë pak mundësi të punësimit formal dhe serbët e malazezët ishin tejet të favorizuar në këtë drejtim. Në vitin 1958, me

17 Sabrina P. Ramet, *Tri Jugosllavitë: Shtetndërtimi dhe Legjitimimi, 1918-2005*. Uashington, DC, dhe Bloomington: Woodrow Wilson Center Press, 2006. f.294. 1,956 serbë përbënin 23.5 përqind të popullsisë dhe kontrollonin 58.3 përqind të forcave të sigurisë dhe 60.8 përqind të policisë së rregullt. Malazezët përbënin 3.9 përqind të popullsisë por 28.3 përqind të forcave të sigurisë dhe 7.9 përqind e policëve të rregullt ishin malazez.

popullsi përafërsisht të njëjtë me Slloveninë, Kosova kishte 49 ndërmarrje publike derisa Sllovenia kishte 465.¹⁸ Zhvillimi ekonomik në Kosovë, në krahasim me pjesët e tjera të Jugosllavisë, ishte jashtëzakonisht më i ulët, dhe prandaj nuk mund të nxiste entuziazëm në mesin e shqiptarëve të Kosovës për "vëllazërim e bashkim" me jugosllavët e tjerë. Shqiptarët e Kosovës ishin të nën-përfaqësuar në fuqinë punëtore, posaçërisht në pozitat me kualifikim më të lartë. Në vitin 1961, përqindja e punëtorëve serbë ishte 36.5 përqind krahasuar me 47.6 përqind të shqiptarëve. Në vitin 1971, numri i punëtorëve serbë kishte shënuar rënie të vogël në 32.6 përqind derisa numri i shqiptarëve ishte rritur vetëm në 54.2 përqind. Punëtorët serbë mbanin 41.3 përqind të pozitave me

18 Noel Malcolm. *Kosova, Histori e Shtetndërtimit*, Londër: Pan Macmillan, 2002. p.323.



ALEKSANDER RANKOVIÇ

28 NËNTOR 1909,
OBRENOVAC, SERBI -
19 GUSHT 1983,
DUBROVNIK, KROACI

Ai u lind në një familje të varfër. Menjëherë pasi përfundoi shkollën e mesme, shkoi në Beograd për të punuar. Kushtet e vështira të jetesës e kanë shtyrë atë të bashkohet me lëvizjen e punës, dhe pastaj të anëtarësohet në partinë komuniste ilegale. Gjatë kësaj periudhe, ai u arrestua dhe u dënua me gjashtë vjet burg.

Rankoviç ishte një nga personalitetet më të rëndësishëm në Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore, dhe figura e katërt më e shquar pas Josip Broz Titos, Edvard Kardelj dhe Milovan Djilas. Ai ishte kreu i forcave të policisë publike dhe sekrete të njohura si UDBA, si dhe sekretarë organizativ i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Ai themeloi Departamentin famëkeq për Mbrojtjen e Popullit (OZNA). Deri më 1 korrik 1966, Rankoviç ishte në krye të Shërbimit Sekret Jugosllav kur në Plenumin e katërt të Partisë Komuniste udhëheqja vendosi ta shkarkojë atë nga të gjitha postet e tij zyrtare. Hetimet treguan se Rankoviç i kishte spiunuar

në mënyrë sistematike komunistët kryesorë duke përfshirë edhe presidentin Tito.

Rankoviç u etiketua më vonë si Stalinist për shkak të persekutimit të tij nga disidentët jugosllav. Entuziazmi me të cilin ai i ndiqte shqiptarët në Kosovë, si nacionalistë dhe kundër revolucionarët ka lënë gjurmë të thella. Për shqiptarët, periudha e sundimit të Rankoviçit nënkuptonte ngacmim të vazhdueshëm nga forcat serbe të dominuara nga shërbimet sekrete dhe me shkeljen e të drejtave të njeriut. Shqiptarëve të Kosovës u janë mohuar të drejtat themelore kulturore, siç janë e drejta për arsimin e lartë në gjuhën shqipe dhe ishin tejet të nënpërfaqësuar në aparatit komunist. Shkarkimi i Rankoviçit i dha fund shtypjes dhe hapi rrugën për zbatimin e reformës kushtetuese dhe dhënien e të drejtave themelore për popullsinë shqiptare të Kosovës.

shkollim më të lartë derisa shqiptarët mbanin vetëm 38.7 përqind të pozitave të tilla.¹⁹

Në vitin 1966, Rankoviç u largua nga pushteti pasi ishte zbuluar se ai e kishte spiunuar Titon. Një vit më vonë, udhëheqësi jugosllav vizitoi Kosovën për herë të parë dhe haptazi dënoi pozitën e dobët sociale dhe ekonomike të shqiptarëve dhe kritikoi supremacinë serbe në krahinë.²⁰ Atëbotë u iniciuan reforma që ofronin më tepër të drejta për dy krahinat serbe, lëvizje kjo që u mirëprit nga ana e shqiptarëve të Kosovës. Megjithatë në vitin 1968, si në Beograd, Pragë dhe Paris, studentët protestonin edhe në Kosovë. Njëpërmjet sloganeve të tyre, ata sfidonin autoritetet komuniste si dhe pozitën e Kosovës në

federatën jugosllave. Disa kërkonin që Kosova të bëhej republikë si pjesët e tjera të vendit, ndërsa disa të tjerë kërkonin që Kosova ta kishte universitetin e saj. Deri atëherë, Kosova kishte pasur vetëm fakultete që ishin nën vartësi të Universitetit të Beogradit. “Poshtë politikat kolonialiste” si dhe “Rroftë Shqipëria” ishin disa slogane tjera. Të alarmuar nga këto reagime, autoritetet reagues duke i dhënë Kosovës pozitë të avancuar në kornizën kushtetuese të Serbisë. Kosova tashmë kishte kushtetutën e saj dhe jo vetëm një statut të thjeshtë. Kuvendi i saj tash mund të hartonte dhe miratonte ligje, dhe jo më dekrete që mbështeteshin në ligjin serb. U themelua Gjykata Supreme si dhe u hap universiteti në gjuhën shqipe në Prishtinë. U iniciuan programe të shkëmbimit me profesorë nga Shqipëria, gjuha shqipe u bë gjuhë zyrtare dhe flamuri shqiptar u

19 Lenard J. Cohen. *Piramida Socialiste: Elitat dhe Pushteti në Jugosllavi*. Ontario: Mosaic Press, 1989. f.358.
20 Po aty. f.356.



ADEM DEMAÇI

26 SHKURT 1936, PRISHTINË

Ademi u lind në një familje të varfër. Kur ishte në moshë shumë të re, babai i tij dhe vëllai i madh vdiqën duke e lënë atë si kreun e familjes. Demaçi shkoi në Beograd për të studiuar literaturën ndërkombëtare, por, vitin e tij të fundit u detyrua të kthehej në shtëpi për t'u kujdesur për nënën e tij të sëmurë. Menjëherë pas kësaj ai u bë avokues i hapur i bashkimit të Kosovës me Shqipërinë dhe u dënua me tre vjet burg nga viti 1958 deri në vitin 1961. Ai u burgos përsëri në vitin 1964 për dhjetë vjet. Menjëherë pas lirimit ishte rivënë në gjyq dhe ishte burgosur për 15 vjet, nga viti 1975-1990.

Pas një vale protestash ndërkombëtare, ai u lirua përfundimisht pasi kaloi një total prej 28 viteve në burg. Demaçi shërbeu si Kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KLMDNJ) prej vitit 1991-1996. Gjatë kësaj kohe ai ishte gjithashtu edhe redaktor i gazetës Zëri, themeloi revistën Forum dhe

ishte aktiv në shumë sfera të tjera të jetës publike.

Në vitin 1996, Demaçi u largua nga KLMDNJ-ja me qëllim që të drejtojë Partinë Parlamentare të Kosovës. Ai avokonte për rezistencë aktive kundër qeverisë serbe në vend të rezistencës pasive të favorizuar nga Ibrahim Rugova. Po ashtu, ishte kritik i ashpër i Rugovës gjatë gjithë gjysmës së dytë të viteve 1990-ta. Kur UÇK-ja u shfaq publikisht në vitin 1997, Demaçi u largua nga PPK-ja dhe u bë një nga përfaqësuesit politik të UÇK-së në Prishtinë. Ai ishte kundër pjesëmarrjes së UÇK-së në Konferencën e Rambujesë dhe për këtë arsye në mënyrë të rregullt dha dorëheqje nga posti i tij. Që nga periudha e luftës, Demaçi nuk ishte më i përfshirë zyrtarisht në politikë, por, akoma merr pjesë në shumë ngjarje kulturore dhe akademike dhe vazhdon të jetë një zë kritik dhe me ndikim në zhvillimet politike. Ai jeton në Prishtinë dhe merr pension shtetëror.

lejua të përdorej si simbol kombëtar. Emri i krahinës u ndryshua nga *Kosova dhe Metohija* sipas emërimit serb në Kosovë, dhe tashmë krahina autonome përfaqësohej në strukturat federative.²¹

Në vitin 1974, kushtetuta e re jugosllave i dha Kosovës kompetenca pothuajse të njëjta me republikat e tjera, përfshirë këtu përfaqësim të barabartë në institucionet federale. Komunistët shqiptarë të Kosovës, siç ishte Fadil Hoxha, ishin tejet të suksesshëm në mobilizimin e përkrahjes për riorientimin e fondeve zhvillimore jugosllave nga viset më të pasura të vendit siç ishin Kroacia dhe Slovenia në drejtim të Kosovës.

Në të njëjtën kohë, megjithatë, disa aktivistë të fshehtë radikal bënë thirrje për bashkim me Shqipërinë. Më i shquari prej tyre ishte Adem Demaçi dhe *Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve*. Këto lëvizje ishin çështje të kufizuara në politikën kosovare në vitet 1970, dhe kryesisht

u çrënjësën nga policia sekrete dhe gjykatat. Sipas raporteve jugosllave, në mes të vitit 1974 dhe 1981, të paktën 618 shqiptarë u akuzuan për aktivitetet të jashtëligjshme në Kosovë.²² Së paku pesë grupe të fshehta të shqiptarëve të Kosovës u identifikuan si aktive në fillim të viteve 1980 dhe roli i tyre në demonstratat e vitit 1981, në rastin më të mirë, është i paqartë.²³

Në po të njëjtën periudhë, shqiptarët filluan t'i bashkohen masovikisht partisë komuniste. Në vitin 1978, shqiptarët përfaqësonin 78 përqind të anëtarësisë lokale, që shënonte rritje të jashtëzakonshme krahasuar me vetëm 30 përqind në vitin 1945.


Trazirat e vitit 1981

Reformat kushtetuese sollën përmirësim të dukshëm në jetën e shqiptarëve të Kosovës.

21 Noel Malcolm. *Kosova, Histori e Shkurtër*. Londër: Pan Macmillan, 2002. f.324. Sabrina P. Ramet, *Tri Jugosllavitë: Shtetdërtimi dhe Legjitimimi, 1918 -2005*. Uashington, DC, dhe Bloomington: Woodrow Wilson Center Press, 2006. f.297.

22 Julie A. Mertus. *Kosova: si mitet dhe të vërtetat e filluan një luftë*. Berkeley: Universiteti i Kalifornisë Press, 1999. f.20.

23 Siç argumenton Mertus, lidhjet me këto organizata gjithmonë u morën seriozisht. Përveç kësaj, shumica e shqiptarëve që morën pjesë në demonstrata pothuajse gjithmonë mohonin lidhjet me këto grupe.



AZEM VLLASI

23 DHJETOR 1948,
KAMENICË, KOSOVË

Si i ri, Azem Vllasi udhëhoqi disa organizata rinore, duke përfshirë ligën studentëve të Kosovës dhe atë të Jugosllavisë. Në vitin 1974 ai ishte kryetar i Lidhjes së Rinisë Socialiste të Jugosllavisë (SKOJ), pozitë që i dha atij popullaritet dhe fitoi simpatinë e Titos, të gjitha këto në masë të madhe i kanë ndihmuar të bëhet udhëheqësi i parë i të rinjve që u rizgjodh. Pas studimeve në Beograd, Vllasi u kthye në shtëpi për të ushtruar profesionin e avokatit.

Në vitin 1980, ai publikisht kundërshtoi sunduesin shqiptarë Enver Hoxhën, dhe pohoi se shqiptarët në Jugosllavi kanë standarde më të mira të jetës sesa shqiptarët në Shqipëri. Në vitin 1986, ai u bë kreu i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës dhe në këtë mënyrë anëtar i Komitetit Qendror Jugosllav dhe president i Kosovës. Nën sundimin e Vllasit, aktivistët në Kosovë u bënë më

të drejtpërdrejtë në kundërshtimin e tyre për përpjekjet e Serbisë për të dominuar në Kosovë. Megjithatë, në nëntor të vitit 1988 ai dhe bashkëpartiajka e tij Qaqusha Jashari, u rrëzuan nga pushteti ngase refuzuan të pranojnë ndryshimet kushtetuese që cunguan të drejtat e Krahinës Autonome të Kosovës. Në mars të vitit 1989, Vllasi u arrestua dhe u akuzua për 'aktivitete kundër-revolucionare.' Pas protestave dhe demonstratave masive dhe presionit të konsiderueshëm ndërkombëtarë, Vllasi u lirua në prill të vitit 1990.

Pas luftës, Vllasi u bë anëtar i Partisë Social Demokrate të Kosovës por nuk ishte më në ballë të politikës. Në vitin 2005, ai dhe Mahmut Bakalli u emëruan si këshilltarë të kryeministrave, Bajram Kosumi dhe Agim Çeku. Sof, Vllasi punon si avokat në Prishtinë.

Ndryshime të mëdha u bënë posaçërisht në arsimin e lartë. Krahasuar me vitin 1955, numri i mjekëve të trajnuar ishte dyfishuar në vitin 1975 dhe më tepër se katërfishuar në vitin 1985.²⁴ Në vitin 1967, rreth 8,000 studentë ishin regjistruar në arsim të lartë në Kosovë, por, në vitin 1979, falë themelimit të Universitetit të Prishtinës, ky numër ishte rritur në 47,000.²⁵ Derisa shqiptarët e Kosovës bëheshin më të shkolluar, skena politike në krahinë shqiptarizohej gjithnjë e më tepër dhe shqiptarët merrnin përsipër pozitën udhëheqëse.

Megjithatë brenda këtij suksesi fshiheshin farat e trazirave. Zhvillimi i dobët ekonomik nënkuptonte që tregu i punës thjesht nuk mund të pranonte një numër kaq të madh të të diplomuarve, pritet e të cilëve ishin rritur me shkollimin e tyre. Protestat të cilat filluan më 11 mars 1981 rreth cilësisë së dobët të ushqimit dhe banimit në universitet, shumë shpejtë eskaluan në protesta më të gjëra shoqërore. Protestuesit filluan të

kërkojnë kushte më të mira të jetesës për shqiptarët në përgjithësi dhe pastaj filluan edhe kërkesat specifike politike, siç ishte lirimi i të burgosurve politik, statusi i republikës për Kosovën, dhe në mes tjerash, edhe bashkimi i Kosovës me Shqipërinë. Protestat, të cilat kishin filluar në mesin e studentëve, pas një muaji përfshinë tërë krahinën.²⁶ Më 2 prill 1981, kryesia e Jugosllavisë shpalli gjendje të jashtëzakonshme në Kosovë. Azem Vllasi, udhëheqës i lartë komunist në Kosovë, kujton se këto ngjarje shënuan edhe fillimin e zvogëlimit të drejtave për shqiptarët e Kosovës. "Serbia filloi të na akuzonte se ne nuk ishim të aftë të qeverisim. Ngjarjet që ndodhën atë vit ishin pretekst për Serbinë t'i ringjallte ambiciet e saj në raport me Kosovën."²⁷

24 Raporti vjetor i statistikave të Jugosllavisë, 1991.

25 Lenard J. Cohen. *Piramida Socialiste: Elitat dhe Pushteti në Jugosllavi*. Ontario: Mosaic Press, 1989. Slobodan Stanković. "Aleksandar Ranković – Profil Politik i "Stalinistit" Jugosllan." 1 shtator 1983: f.361. Arkivat e Shoqërisë së Hapur. 09 shtator 2011.

26 Edhe pse nuk thuhet qartë, mund të supozojmë se vala e dytë e demonstratave ka pasur numër dukshëm më të madh të pjesëmarrësve në krahasim me demonstratën e parë, prandaj paraqitja e sloganeve për republikë dhe kërkesa të tjera mund të kenë qenë faktorë që e kanë iniciuar protestën e parë. Konkluzione të nxjerra nga krahasimi i raporteve mbi ngjarjen e njëjtë nga Julie A. Mertus, *Kosova: si miet dhe të vërtetat e nisën një luftë*. Berkeley: University of California Press, 1999 dhe Noel Malcolm. *Kosova, Histori e Shkurtyr*. Londër: Pan Macmillan, 2002.

27 Intervista e IKS me Azem Vllasin, Prishtinë. 26 janar 2011.

Institucionet zyrtare jugosllave filluan t'i akuzojnë udhëheqësit komunist të krahinës se po fshihnin informata nga Beogradi dhe se po i mbronin bashkëkombësit e tyre. Megjithatë veprimet e udhëheqësve të shqiptarëve të Kosovës dëshmonin se ata ishin në favor të mbrojtjes së statusit para vitit 1981 sepse besonin që demonstratat, posaçërisht kërkesat që krahina të bëhej republikë, të paktën për momentin do të bënin më tepër dëm sesa mirë.²⁸ Megjithatë është me rëndësi të ceket se protestat e vitit 1981 më tepër ishin të shtyra nga brengat socio-ekonomike sesa nga nacionalizmi shqiptar apo nga dëshira për bashkimin e Kosovës më Shqipërinë, që ishte kërkesë vetëm e një pakice protestuesish. Organizatat e ndryshme ilegale nacionaliste, që propagonin për bashkim me Shqipërinë, duket se kanë pasur vetëm lidhje të rralla me protestat.

Demonstratat megjithatë dëshmuar ekzistimin e ndarjes në mesin e udhëheqësish shqiptare, *Lidhjes Komuniste të Kosovës* në njërin anë dhe shumicës së popullsisë shqiptare të krahinës e cila tregonte zhgënjim gjithnjë në rritje me pozitën e saj ekonomike. Jashtë sektorit të qeverisë, kishte shumë pak vende të punës dhe niveli i papunësisë ishte më i larti në Jugosllavi.²⁹ Meqë shumica e fondeve shkonin në sektorin administrativ të burokracisë dhe tek gjigantët industrial, vetëm disa njerëz me lidhje të forta mund t'i gëzonin benefitet, derisa njerëzit e rëndomtë nuk shihnin ndonjë ndryshim të madh. Përveç kësaj, të pakënaqurit pohonin që vendet e punës ndaheshin në mënyrë joproporcionale, dhe që serbët përfitonin më tepër vende të mira të punës në raport me numrin e tyre. Përshtypja që ishin tradhtuar nga rrethanat historike tash u shoqërua edhe me pakënaqësinë rreth mungesës së vendeve të punës në një ekonomi edhe ashtu stagnuese. Kjo ndihmoi në shtrirjen e nacionalizmit shqiptar dhe përcaktoi mënyrën se si do të formuloheshin tash e tutje kërkesat politike.

Faktor tjetër i rëndësishëm në përcaktimin e natyrës së demonstratave ishte Universiteti i Prishtinës. Meqë gjithnjë e më shumë të rinjë po regjistroheshin në universitet, vetëm disa prej tyre mbeteshin në mesin e të papunësuarve. Të qenit student e shtynte papunësinë, të paktën përkohësisht. Në anën tjetër, studimet në universitet i rrisnin pritjet dhe ndjenjën e vetes. Megjithatë, pas përfundimit të

studimeve, të diplomuarit nuk kishin treg të punës për aftësitë e tyre të reja. Përveç kësaj, universiteti specializohej në arte të lira, me fokus në gjuhën dhe kulturën shqipe, duke i neglizhuar programet teknike dhe shkencore. Prandaj nuk është për tu çuditur që në prag të demonstratave të vitit 1981, lëvizja nacionaliste shqiptare gjeti përkrahësit e saj më të flaktë në mesin e të rinjëve të shkolluar dhe të papunë.³⁰

Shtypja e shqiptarëve të Kosovës nga lartë-poshtë që nga koha e Rankoviçit e deri në fund të viteve 1980, duke përjashtuar këtu periudhën e shkurtër të përmirësimit relativ në fund të viteve 1970, do të kishte pasoja të pakthyeshme për jetën politike në Kosovë dhe në mbarë Jugosllavinë. Nga viti 1981, kjo nënkuptonte që shqiptarët e arrestuar për arsye politike do të shiheshin si dëshmorë dhe do ta zinin vendin e tyre, siç shkruan akademikja amerikane Julie Mertus, "si heronjtë e rinjë në mesin e udhëheqësve real dhe të imagjinuar të shqiptarëve të Kosovës."³¹

Kthimi i Shtypjes pas vitit 1981

Pas vdekjes së Titos në vitin 1980 dhe pas demonstratave të vitit 1981, Kosova hyri në një fazë të paqëndrueshmërisë së vazhdueshme politike dhe sociale. Shtypja, si dhe arrestimet, shënuan rritje. Diskursi politik tash ishte dukshëm i orientuar kah vijat etnike dhe solli me vete edhe debat të shtuar në mesin e politikanëve, intelektualëve, aktivistëve lokalë dhe gazetarëve. Shqiptarët dhe serbët ankoheshin si kurrë më parë për fatin e kombeve të tyre. Shtypi serb ishte dhënë pas histerisë. Raportohej se meshkujt shqiptarë po i dhunonin femrat serbe. Në vitin 1984, Atanasije Jevtiq, një prift ortodoks serb, ankohej se akte të tilla ishin të rëndomta në Kosovë.³² Rasti më famëkeq ishte ai i bujkut Martinoviç i cili në vitin 1985 shkaktoi panik në mesin e serbëve dhe malazezve.³³ Martinoviç pohonte se tre shqiptarë e kishin dhunuar atë me një shishe. Gjendja filloi të përkeqësohej.

Në këtë atmosferë, filluan të reagojnë elemente të shoqërisë serbe. Në janar të vitit 1986, në parlamentin e Jugosllavisë, u dorëzua një peticion kundër keqtrajtimit të supozuar të serbëve në Kosovë, i iniciuar dhe nënshkruar nga 216 intelektualë të njohur serbë. Kjo pastaj çoi në hartimin e një dokumenti

28 Julie A. Mertus. *Kosova: si mitet dhe të vërtetat e nisën një luftë*. Berkeley: University of California Press, 1999. Intervistat me Mahmut Bakallin dhe Azem Vllasin.

29 Julie A. Mertus. *Kosova: si mitet dhe të vërtetat e nisën një luftë*. Berkeley: University of California Press, 1999. f.23. një e katërta e të gjithë të punësuarve kosovarë ishin nëpunës të qeverisë dhe shkalla e papunësisë ishte 27.5 përqind, krahasuar me shkallën prej 2 përqind në Slloveni, republikën më të zhvilluar, po atë vit.

30 Julie A. Mertus. *Kosova: si mitet dhe të vërtetat e nisën një luftë*. Berkeley: University of California Press, 1999. p.29.

31 Po aty. p.21

32 Amphilohije Radoviç (peshkop). *Nga Kosova në Jadovno*. Peshkop i Zahumljes dhe Hercegovinës (Ret.) Atanasije (Jevtiq). Shënimi i Udhëtimit, Beograd, 1984.

33 Gjorgje Martinoviç, një bujk serb nga Vitia në afërsi të Gjilanit, pohonte që e kishin sulmuar dy shqiptarë të maskuar, të cilët e kishin lidhur dhe ia kishin shkaktuar lëndimin.



MAHMUT BAKALLI

19 JANAR 1936, GJAKOVË,
KOSOVË - 14 PRILL 2006,
PRISHTINË, KOSOVË

U diplomua në Universitetin e Beogradit në degën e shkencave politike në vitin 1967 dhe megjithatë në vitin 1970. Në fund të viteve 1950, Bakalli punoi në kompaninë e tekstilit në Prizren dhe pastaj në linjat ajrore jugosllave JAT, por gjithmonë ushqente ambicie politike. Ai u bashkua në organizatat rinore të LKJ-së (Lidhja Komuniste e Jugosllavisë) dhe u zgjodh kryetar i Unionit të Rinisë së Kosovës në vitin 1961. Dhjetë vite më vonë, u zgjodh kryesues i presidencës së Lidhjes së Komunistëve të Kosovës. Ngritja e Bakallit në pozitë më të larta udhëheqëse në Kosovë, ndodhi kryesisht për shkak të njohurive të tij të brendshme të burokracisë komuniste.

Pozita e Bakallit përkoi me një periudhë në të cilën kufizimet e vëna mbi shumicën etnike shqiptare në Kosovë ishin të qeta dhe kishin kushte të mira të jetës. Kosova fitoi autonomi të konsiderueshme nga ish sundimtarët e saj serbë në Beograd. Prishtina filloi të marrë pamjen e një qytetit

modern ngase fondet për zhvillim filluan të vërshojnë nga pjesët më të prosperuara të Jugosllavisë. Megjithatë, në qershor të vitit 1981 Bakalli u hoq nga të gjitha pozitat që mbante dhe u akuzua se shkaktoi protestave të vitit 1981 duke adoptuar një strategji të investimeve dhe që ka dështuar të vërejë se demonstratat masive ishin gati të shpërthejnë.

Bakalli u rishfaq në skenën publike gjatë ngjarjeve të viteve 1990. Në vitin 1998, ai shoqëroi Ibrahim Rugovën në negociimin e një marrëveshjeje për paqe me Slllobodan Millosheviçin. Pas luftës, Bakalli u bashkua me AAK-në dhe në vitin 2001 u zgjodh deputet në Parlamentin e Kosovës. Në vitin 2002 ai u thirr si dëshmitar në gjyqin kundër Slllobodan Millosheviçit në ICTY dhe e akuzoi duke thënë se me qëllim e kishte filluar luftën në vitin 1999. Përderisa AAK ishte në qeveri, Bakalli ishte këshilltar i tre Kryeministrave të tij. Ai vdiq më 14 prill 2006 në Prishtinë.

nga Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve (SANU) e cila u botua në shtyp në vitin 1986.³⁴ Në dokument flitej për “gjenocidin fizik, politik, ligjor dhe kulturor kundër popullsisë serbe në Kosovë e Metohi.”³⁵ Dokumenti, i cili më vonë do të njihet si “Memorandumi,” u frymëzua nga Dobrica Qosiq, kryetar i ardhshëm i Jugosllavisë. Në vitin 1998, departamenti i shkencave shoqërore në SANU, botoi rezultatet e një hulumtimi i cili ishte kryer gjatë viteve 1985 dhe 1986. Hulumtimi synonte që me anë të statistikave të tregonte që serbët dhe malazezët po detyroheshin të largoheshin nga Kosova.³⁶

34 Memorandumi kritikoi rreptë Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974 duke e fajësuar atë për krijimin e bazës ideologjike për zhvillimin e separatizmit dhe nacionalizmit. Thirrja për ta përkrahur dhe promovuar “integritetin e popullit serb” shkon në linjë me zërat e shtuar për ndryshime kushtetuese.

35 Memorandum, Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve (SANU). Beograd: *Bërja e Historisë së vitit 1989*, punimi #674. 11 tetor. 2011. <http://www.ess.uwe.ac.uk/kosovo/Kosovo-Background17.htm>.

36 Ruza Petroviq, Marina Blagojeviq. *Shpërngulja e serbëve dhe malazezëve nga Kosova dhe Metohija: Rezultatet e Hulumtimit në vitet 1985-1986*.

Beograd: Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve, Departamenti i Shkencave Shoqërore, 1992. web. 14 tetor 2011. <http://balkania.tripod.com/resources/history/migrations/index.html>.

Gjendja u përkeqësua edhe më tepër kur më 3 shtator 1987, një shqiptar i Kosovës, ushtar në Armatën Popullore të Jugosllavisë (JNA), i vrau katër dhe i plagosi pesë ushtarë të kombësive të ndryshme në bazën ushtarake në Paraçin të Serbisë.³⁷ Edhe pse rezultatet e hetimeve kurrë nuk u publikuan në tërësi, ky rast famëkeq ndihmoi në rritjen e ankesave nacionaliste serbe dhe në sytë e tyre dëshmonte që serbët ishin të kërcënuar nga shqiptarët e Kosovës. Në këtë luftë të propagandës, serbët u gjetën të pasfiduar meqë shqiptarët e Kosovës nuk kishin si t’i përgjigjeshin këtyre pohimeve.

E tërë kjo ndihmoi në krijimin e skenës për ngritjen e Slllobodan Millosheviçit dhe lëvizjes së tij oportuniste nga komunizmi në nacionalizmin serb. Siç vërejnë edhe Laura Silber e Allan Little, që shkruanë historinë e kësaj periudhe:

<http://balkania.tripod.com/resources/history/migrations/index.html>.

37 Aziz Kelmendi, ushtar shqiptar nga Kosova, i cili në kohën e vrasjeve ishte në muajin e fundit të shërbimit në ushtrinë jugosllave. Pas sulmeve, ai iku nga baza ushtarake, dhe pasi u rrethua dhe u zu bëri vetëvrasje.

Asgjë rreth vizitës së udhëheqësit komunist serb në Pushë Kosovë më 24 prill 1987, nuk mund të sugjeronte ndryshimin e rrjedhës së historisë. Por për herë të parë, Sllobodan Millosheviq veshi petkun e mbrojtësit të të gjithë serbëve. Ky ishte moment i fatit të mirë për udhëheqësin e ri të partisë. Presidenti i Serbisë, Stamboliq, është dashur të shkojë vetë në Kosovë që të bisedojë me udhëheqësit serbë, por e dërgoi në vend të tij Millosheviqin. Kjo u tregua lëvizje e pakujdesshme e cila do të niste një zinxhir të ngjarjeve të cilat do t'i kushtonin atij me karrierë.³⁸

Pas takimit me serbët e mllefosur, Millosheviq iu drejtua turmës me fjalët: "Askush nuk guxon t'ju rrahë." Sipas tij, ekzistenca e Jugosllavisë varej nga mbetja e Kosovës nën Serbi.³⁹ Kjo e mobilizoi edhe më tepër masën dhe inkurajoi urrejtjen në mes të serbëve dhe shqiptarëve.⁴⁰ Millosheviq e rriti presionin për ta ndryshuar kushtetutën e Kosovës dhe për ta futur atë përsëri nën kontrollin e plotë të Serbisë. Periudha deri dhe pas revokimit të autonomisë, solli pakënaqësi të shtuar në mesin e shqiptarëve të Kosovës. Në nëntor të vitit 1988, për shembull, minatorët e Trepçës protestuan duke marshuar deri në Prishtinë. Në mbrojtje të kushtetutës ekzistuese, logjika e protestimit, për dallim nga imazhi i demonstratave të vitit 1981, që sugjeronte padrejtë irredentizmin si katalizator kryesor, kishte ndryshuar. Besnik Pula, sociolog, ka shkruar që protestat tash: ... tërhiqin një formacion krejtësisht tjetër të shqiptarëve të Kosovës – jo vetëm rininë radikale dhe studentët të cilët kishin qenë në ballë të protestave të vitit 1981, por edhe klasat punëtoresh dhe profesionale të shqiptarëve të cilit ishin integruar mirë në sistemin socio-ekonomik jugosllav dhe që ndikoheshin drejtpërdrejt nga ndryshimet politike me të cilat kërcënohej Millosheviq.⁴¹

Protesta e minatorëve, duke qenë ngjarja e parë e mobilizimit masiv që nga viti 1981, ndihmoi në bashkimin e shqiptarëve të Kosovës. Një ditë pas marshimit, minatorëve iu bashkëngjitën edhe punëtorët e fabrikave, studentët dhe nxënësit, duke e rritur kështu numrin e protestuesve në më tepër se

100,000.⁴² Pas këtyre ngjarjeve, udhëheqësit shqiptarë të Lëvizjes Komuniste të Kosovës u suspenduan, në mesin e tyre edhe kryetari i saj Azem Vllasi, i cili pastaj edhe u arrestua në mars të vitit 1989. Kështu tensionet u shtuan me shpejtësi dramatike dhe rezultuan në solidaritet të gjerë në mesin e komunitetit shqiptar.

Në mars të vitit 1989, deputetët shqiptarë të kuvendit, morën, siç thotë historiani Noel Malcolm, qëndrimin e "nënshtrimit të palavdishëm nën presion."⁴³ Kuvendi i Kosovës, i gjetur nën presion të madh nga Beogradi dhe pas kërcënimeve ndaj deputetëve, hoqi dorë nga autonomia të cilën Kosova e kishte fituar me kushtetutën jugosllave të vitit 1974.⁴⁴

Disa javë më herët, në shkurt, Kryesia e Jugosllavisë kishte shpallur masa të jashtëzakonshme dhe njësi të policisë federale ishin dërguar në Kosovë për të siguruar ndërtesat kyçe, përfshirë këtu edhe Kuvendin.⁴⁵

Njerëzit e rëndomtë u treguan më të qëndrueshëm se të ashtuquajturit udhëheqësit e tyre. Ndryshimet kushtetuese u përcollën me demonstrata masive në muajt shkurt dhe mars. Ka të dhëna kundërthënëse rreth numrit të personave të vrarë nga forcat jugosllave të sigurisë. Raportet flasin për një numër prej 28 deri në më tepër se 100 persona të vrarë.⁴⁶ Besohet se 200 persona janë lënduar dhe 254 janë arrestuar.⁴⁷

Kosova megjithatë nuk ishte ishull. Pas rënies së Murit të Berlinit, ndryshimet po e gllabëronin tërë Evropën njëkohësisht. Jugosllavia po ecte me hapa të shpejtë drejt shpërbërjes së dhunshme. Në Kosovë, sfidat e reja çuan në krijimin e mekanizmave të rinjë për t'iu përgjigjur këtyre sfidave.

38 Howard Clark në librin e tij *Rezistenca Civile në Kosovë*, thotë se numri i pjesëmarrësve ishte "ndoshta 300,000" ndërsa Shkelzen Maliqi në *Kosova, Botët e Ndara* pohon që numri ishte rreth 400,000.

39 Noel Malcolm. *Kosova Histori e Shkurtër*. Londër: Pan Macmillan Pan Books, 2002. f.346.

40 Më 23 mars 1989, Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet me votim të rregullt, nga 190 anëtarë të kuvendit me tri dhoma, 187 morën pjesë në takim. Vetëm 10 prej tyre votuan kundër ndryshimeve dhe 2 abstenuan. Mbi 140 delegatë të Kuvendit ishin shqiptarë.

41 Më 1 mars 1990, u shpall ora policore, punëtorët kosovarë u urdhëruan në detyra të obligueshme. Nuk e di çka po mendoni me këtë – a mendoni se janë urdhëruar të kthehen në vendet e tyre të punës?

42 Miranda Vickers. *Në mes serbëve dhe shqiptarëve: Histori e Kosovës*. Nju Jork: Columbia University Press, 1998. Vickers thotë që 28 kosovarë u vranë. Paulin Kola. *Kërkimi i Shqipërisë së Madhe*. Nju Jork: Nju Jork University Press, 2003. Sipas Paulin Kolës, mbi 100 persona ishin vrarë. Sipas gazetës *The Daily Times*, 2 qershor 1989, 900 protestues u arrestuan.

43 Projekti mbi Pakicat e Rrezikuara, *Kronologji e Shqiptarëve të Kosovës në Jugosllavi*, 2004, mund të gjendet në: <http://www.unhcr.org/ref/ord/docid/469f38f5e.html> [shikuar më 10 tetor 2011].

38 Laura Silber dhe Allan Little. *Jugosllavia: Vdekja e një Kombi*. Penguin Books. Penguin Books, 1995. f.37.

39 Miranda Vickers. Në mes serbëve dhe shqiptarëve: Historia e Kosovës. Nju Jork: Columbia University Press, 1998. ff. 227-228.

40 "Gjashtë shekuj më vonë, ne jemi në luftë dhe grindemi. Këto nuk janë lufta të armatosura, edhe pse këto gjëra akoma nuk mund të përjashtohen" tha Sllobodan Millosheviq. Laura Silber dhe Allan Little. *Jugosllavia: Vdekja e një Kombi*. Penguin Books. 1995. f.177.

41 Besnik Pula. *Lindja e "Shtetit Paralel" të Kosovës, 1988–1992*, Nationalities Papers, Vol 32, No. 4. Dhjetor 2004. f.803.

PARTI APO LËVIZJE? – LDK

Lindja e *Lidhjes Demokratike të Kosovës* (LDK) shpeshherë shihet si pasojë e drejtpërdrejtë e abrogimit të autonomisë. Në fakt, procesi i cili çoi në krijimin e saj filloi shumë më herët dhe mbështetej në pakënaqësinë e shtuar ndaj LKK-së. Partia u formua nëntë muaj pas ndryshimeve kushtetuese që iniciuan heqjen e autonomisë. Megjithatë, pasojat e këtij akti ishin ato që lançuan LDK-në të bëhej zemra e shtetit paralel.

Në fund të viteve 1980, pakënaqësia me LKK-në, e cila filloi të merrte valë në vitin 1981, po rritej. Në vitet 1988 dhe 1989, minatorët e Trepçës u hodhën në grevë dhe kërkonin largimin e ‘marionetave’ të Millosheviqit, domethënë të Ali Shukrisë, Hysamedin Azemit dhe Rrahman Morinës.⁴⁸ Frustrimi me udhëheqësinë komuniste krijoi hapësirë për lojtarë të rinj që ti artikulonin brengat e shqiptarëve të Kosovës. Në fillim u bënë përpjekje për të shprehur pakënaqësi rreth mënyrës si LKK-ja kishte provuar ta mbronte autonominë. Më 22 shkurt 1989, intelektualë shqiptarë hartuan ‘Apelin 215,’ të nënshkruar nga 215 persona, kryesisht gazetarë të *Rilindjes*, gazeta kryesore në Kosovë, dhe nga mjekë të Fakultetit të Mjekësisë.⁴⁹ Apeli u dërgua Parlamentit të Serbisë, mirëpo hasi në veshë të shurdhër.

Gjithnjë e më tepër udhëheqës të pakënaqur po largoheshin nga LKK-ja. Kështu u krijua hapësira për krijimin e një lëvizjeje alternative e cila do ti artikulonte kërkesat e shqiptarëve të Kosovës. Mehmet Kraja, njëri ndër themeluesit e LDK-së, kujton si ai dhe kolegët e tij i kishin parë ato zhvillime:

Çdo gjë filloi në *Rilindje* dhe u zhvillua me hov të jashtëzakonshëm. Disa gazetarë të sektorit të kulturës në *Rilindje* bisedonin për ngjarjet e natës së kaluar – minatorët i kishin

dhënë fund grevës së tyre dhe se si ishin mashtruar sepse kryetari i komitetit autonom (red, p.sh. kryetari i Kosovës) nuk kishte dhënë dorëheqje, edhe pse kjo kishte qenë kërkesa kryesore e minatorëve. Pas asaj që ndodhi, ishte e patolerueshme të shiheshim si anëtarë të Lidhjes Komuniste... Shpejt u hartua lista e atyre të cilët do të hiqnin dorë nga anëtarësia e tyre... Në fillim të letrës futëm një fjali ku shpjeguar që dorëheqja jonë nga anëtarësia e partisë ishte akt moral për shkak të përgjegjësisë së Lidhjes Komuniste për gjendjen e krijuar në Kosovë... Pas gjysmë ore, dyzetë persona e kishin nënshkruar listën.⁵⁰

Letra kishte efektin e njëjtë me topin e dëborës i cili shkakton orteun. Njerëzit masovikisht filluan të largohen nga partia. Ata papritmas ishin në gjendje të kërkonin shkëputje të plotë nga e kaluara.


Më 2 korrik 1990, 111 deputetë shqiptarë të Kosovës, shumica e të cilëve më herët kishin votuar për revokimin e autonomisë, tash e shpallën Kosovën republikë me të drejta të plota brenda Jugosllavisë, në hyrje të ndërtesës së Kuvendit. Më 7 shtator, ata u takuan përsëri në Kaçanik, afër kufirit me Maqedoninë. Aty ata votuan për një kushtetutë të re, e cila sipas tyre e legjitimonte shpalljen e pavarësisë nga Serbia në muajin korrik.⁵¹

Megjithatë veprimi i këtyre deputetëve në fakt ishte veprim personal. Ky veprim nuk gëzonte përkrahjen e LKK-së, e cila tashmë ishte nën kontrollin e plotë të partisë komuniste serbe. Pasi Millosheviqi i kishte shpërndarë dhe ua kishte humbur kuptimin institucioneve autonome të Kosovës, peisazhi politik ndryshoi rrënjësisht dhe LKK-ja e kishte humbur tërë legjitimitetin e saj.

48 Rrahman Morina ishte udhëheqës i Partisë Komuniste të Kosovës, nga 27 janari 1989 deri më 12 tetor 1990, dhe ministër i mbrojtjes nga viti 1981. Ali Shukriu ishte anëtar i Komitetit Qendror Federal i Partisë, dhe Hysamedin Azemi, udhëheqë i degës së Partisë Komuniste në Prishtinë. Të lartpërmendurit duhej të shqyrtonin rishikimin e ndryshimeve kushtetuese të propozuara nga Kuvendi i Serbisë.

49 Howard Clark. *Rezistenca Civile në Kosovë*. Londër: Pluto Press, 2000. f.50. Mehmet Kraja. *Vite të bumbura*. Prishtinë: Rozafa, 2003.

50 Mehmet Kraja. *Vite të bumbura*. Prishtinë: Rozafa, 2003. ff. 183-184. 51 Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK). *Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës: 2 korrik 1990 – 2 maj 1992*. Prishtinë: ASHAK, 2005. f.99.



IBRAHIM RUGOVA

2 DHJETOR 1944, CËRRCE,
ISTOG - 21 JANAR 2006,
PRISHTINË

U lind në një fshat të vogël në një familje të shquar lokale. Kur ishte një vjeç, babai dhe gjyshi i tij u vranë nga UDBA. Ai ishte rritur nga nëna e tij e ve. Rugova përfundoi shkollën e mesme në Pejë, dhe më pas studioi në Fakultetin Filozofik, në departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Prishtinë. Rugova kaloi një vit në Paris, në Ecole Pratique des Hautes Etudes para se ta merrte titullin doktor i shkencës në Prishtinë.

Përderisa ishte student, Rugova shkroi në një numër të madh dhe të shumëllojshëm të gazetave. Pastaj, u bashkua në Institutin Albanologjik në Prishtinë që në atë kohë drejtohej nga Rexhep Qosja. Ai punoi aty për dy dekada. Emërimi i Rugovës si kryetarë i Shoqatës së Shkrimtarëve në vitin 1988, shënoi fillimin e karrierës së tij politike. Në vitin 1989, LDK-ja emëroi Ibrahim Rugovën udhëheqës të saj. Nga ai moment e tutje Rugova udhëhoqi partinë më të madhe politike, nëpër kohë të vështira dhe dinamike të viteve 1990-ta. Ai u zgjodh drejtpërdrejt president i Kosovës në vitin 1992 dhe 1998, dhe po ashtu u rizgjodh president nga parlamenti i IPVQ-së (Institucionet e Përkohshme të

Vetë-Qeverisjes) në vitin 2002 dhe 2005. Karriera politike e Rugovës është karakterizuar me avokimin e tij për rezistencë pasive, paqe dhe dialog. Ai i shmangej rezistencës aktive dhe qëndrimit luftarak të UÇK-së. Rugova mori pjesë në negociata shumë të rëndësishme, duke përfshirë ato të vitit 1996 me Millosheviç-in për shtrirjen e të drejtave arsimore të shqiptarëve, Konferenca e Paqes në Rambuje në vitin 1999, dhe ishte anëtar themelues i "Ekipit të Unifitetit" që ishte përgjegjës për negociatat me Serbinë në Vjenë të vitit 2006.

Për arritjet e tij, Ibrahim Rugova u shpërblye me çmime të shumta, në mesin e tyre Çmimi i Paqes nga Fondacionit Paul Litzer, Danimarkë (1995), doktoratë nderi nga Universiteti i Parisit VIII: Vincennes - Saint-Denis, (1996), qytetarë i nderit nga qytetet e Venedikut, Milanos dhe Breshias (1999). Po ashtu, u nderua me çmimin 'Senator Evropian i Nderit' (2003), dhe pas vdekjes u dekorua me Urdhërin e Flamurit të Shqipërisë nga presidenti i Shqipërisë Alfred Moisiu (2006). Ibrahim Rugova ishte president i Kosovës dhe i LDK-së deri në vdekjen e tij si pasojë e kancerit në mushkëri.

Krijimi i LDK-së

Rënia dramatike e Partisë Komuniste dhe shpërbërja e institucioneve autonome të Kosovës nënkuptonte që debati politik tashmë ishte në duart e njerëzve që nuk kishin pasur pozita udhëheqëse në LKK. Më të shquarit në mesin e tyre ishin figura nga Universiteti i Prishtinës, posaçërisht nga Instituti i Albanologjisë, anëtarë të Shoqatës së Shkrimtarëve, gazetarë të *Rilindjes* dhe aktivistë të partive të reja politike të cilat kishin lindur si rezultat i legalizimit të sistemit shumë-partiak në Jugosllavi në vitin 1989.

LDK-ja, e cila shumë shpejt do të dominonte në skenën politike, u themelua nga 23 intelektualë nga Shoqata e Shkrimtarëve dhe *Rilindja* më 23 dhjetor 1989. E përbashkët e këtyre figurave ishte se ata ishin mirë të shkolluar dhe anëtarë të mëhershëm

të LKK-së. Megjithatë, asnjëri prej tyre, nuk kishte pasur pozitë udhëheqëse në parti. Mirëpo, asnjëri prej tyre nuk kishte shprehur pakënaqësi ndaj saj dhe nuk kishte qenë i lidhur me ngjarjet e vitit 1981. Asnjëri prej tyre nuk kishte pasur problem me autoritetet më herët.⁵² Mehmet Kraja, njëri ndër 23 themeluesit, më vonë kujtoi:

... Lidhja Komuniste e Kosovës kishte rreth 100,000 anëtarë, derisa vetëm në *Rilindje* për shembull, 90 përqind e gazetarëve ishin anëtarë... Kjo përqindje duhet të ketë qenë e njëjtë edhe në institucionet e tjera, përfshirë këtu Universitetin e Prishtinës, Institutin e Albanologjisë dhe Akademisë [red. Shkencave

52 Mehmet Kraja. *Vite të humbura*. Prishtinë. Rozafa. 2003. fq. 198-199.



REXHEP QOSJA

25 QERSHOR 1936,
VUTHAJ, MALI I ZI

U zhvendos nga Mali i Zi në Prishtinë në mënyrë që të ndjek shkollën e mesme. Ai u regjistrua në Departamentin e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Qosja e mori doktoraturën në Beograd. Menjëherë pas kësaj, filloi të punoj në Institutin Albanologjik në Prishtinë. Në të njëjtën kohë Rexhep Qosja u bë profesor në Fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Prishtinës, pastaj, drejtor i Institutit Albanologjik, dhe më vonë dekan i Fakultetit të Gjuhës Shqipe.

Në vitin 1989, Qosja refuzoi të bëhet udhëheqës i LDK-së. Sidoqoftë, ai mbeti aktiv në jetën publike si një figurë e respektuar intelektuale dhe kishite ndikim të konsiderueshëm. Që nga themelimi i saj dhe me fitoren e mëvonshme në zgjedhjet e vitit 1992, Rexhep Qosja mbeti kritik i madh i LDK-së dhe haptazi kundërshtoi politikën e tyre për rezistencë pasive. Në vitin 1998 Qosja themeloi partinë e tij politike, Lëvizja e Bashkuar Shqiptare (LBSH). Pastaj, formoi një koalicion që e udhëheqte vetë, 'Lëvizja e Bashkuar Demokratike' (LBD). Partia e tij fitoi përkrahjen

e ish të burgosurve politikë dhe partive të tjera që e përkrahnin rezistencën aktive. LBD-ja haptazi mbështeti veprimtarinë e UÇK-së. LBD-ja me Qosjen si përfaqësues të saj, mori pjesë në Konferencën e Rambujesë dhe poashtu mori pjesë në qeverinë e përkohshme të pasluftës si dhe në SPPA. Pas luftës LBD-ja pushoi së ekzistuari dhe Qosja abstenoj në politikë.

Qosja botoi libra, shqyrtime të shumta, artikuj dhe studime në gazeta të shumta shkencore dhe letrare në letërsinë shqiptare. Deri më sot ai ka shkruar 16 libra. Rexhep Qosja është i përfshirë në projekte të ndryshme në Akademinë e Arteve dhe Shkencave si dhe në Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës, por rrallë herë angazhohet në debate publike.

dhe Arteve]. Prandaj, sipas kësaj logjike, ne nuk kishim kundërshtarë të hapur të sistemit të kaluar dhe asnjëri prej nesh nuk kishte qenë i përndjekur politik, apo anëtarë i ndonjë grupi ilegal në Kosovë.⁵³

Gjatë takimit themelues, u zgjodh kryesia dhe kryetari i saj.⁵⁴ Zgjedhja e udhëheqësit nuk ishte e lehtë. Jusuf Bajraktari, njëri ndër themeluesit, thotë,

53 Po aty. f.198.

54 Anëtarë të këshillit themelues ishin: Jusuf Buxhovi, Zekirja Cana, Milazim Krasniqi, Ajri Begu, Ibrahim Rugova, Bujar Bukoshi, Fehmi Agani, Ibrahim Berisha, Mehmet Kraja, Ali Aliu, Zenel Kelmendi, Ramiz Kelmendi, Idriz Ajetu, Dervish Rozhaja, Mark Krasniqi, Anton Çetta, Zenun Çelaj, Mustafa Radoniqi, Basri Çapriqi, Jusuf Bajraktari, Xhemail Mustafa, Hysen Matoshi dhe Nexhet Nushi. Kryesia e partisë kishte shtatë anëtarë: Ibrahim Rugova (kryetarë), Jusuf Buxhovi (sekretar i partisë), Fehmi Agani, Nekibe Kelmendi, Ali Aliu, Bujar Bukoshi dhe Mehmet Kraja (anëtarë të kryesisë).

“Ibrahim Rugova, Fehmi Agani dhe Rexhep Qosja ishin në garë.” Rugova fillimisht hezitoi të bëhej kryetar, sepse ishte i zënë me postin e kryetarit të Shoqatës së Shkrimtarëve. Jusuf Buxhovi, një themelues tjetër, u dërgua t'i kërkoj Rexhep Qosjes, akademik dhe albanolog i mirënjohur, ta pranoj postin e kryetarit. Qosja megjithatë kishte kushte.⁵⁵ Qosja kujton:

Për mua ishte e papranueshme përbërja e kryesisë së LDK-së dhe ata donin ta regjistronin partinë pranë Ministrisë së Drejtësisë në Beograd. Nuk më pëlqente as programi i tyre për autonominë. Aty shihej qartë se LDK-ja dëshironte më pak autonomi

55 Intervistë e IKS me telefon me Jusuf Buxhovin, Prishtinë, 29 prill 2011.



FEHMI AGANI

23 JANAR 1932, GJAKOVË –
6 MAJ 1999, PRISHTINË

Agani i'u bashkua Lëvizjes Komuniste Rinore kur ishte vetëm 13 vjeç dhe u bë anëtar i Partisë Komuniste në moshën 15 vjeçare. Përfundoi studimet në Beograd në vitin 1959 dhe doktoroi në degën e sociologjisë në Universitetin e Beogradit, në vitin 1973. Në vitin 1967, u zgjodh kreu i Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe më vonë dekan i fakultetit të Filozofisë në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 1984, për shkak të trazirave studentore, Fehmi Agani së bashku me shumë nga kolegët e tij u shkarkuan, për shkak se vazhdimisht refuzoi ta dënojë protestën e vitit 1981. Si rezultat i kësaj ai u përjashtua edhe nga Lidhja e Komunistëve.

Agani i'u kthye politikës në vitin 1989, ku ishte një nga anëtarët kryesorë në themelimin e LDK-së dhe nënkryetari i saj. Ai konsiderohej të jetë truri i Ibrahim Rugovës. Agani poashtu, ishte arkitekti i shtetit të vetëshpallur të

Republikës së Kosovës, 'shtet virtual' me institucionet e saj politike dhe sociale, e cila përfshinte presidencën dhe një qeveri plotësisht funksionale. Gjatë viteve të 90-ta, Agani ishte gjithmonë në anën e Rugovës. Sidoqoftë, në gjysmën e dytë të dekadës filluan të shfaqen çarje në marrëdhënien e tyre pasi që ai besonte se partia duhet të bëhet më pro-aktive. Kur shpërtheu lufta në vitin 1998, Agani dha dorëheqje nga posti i nënkryetarit mirëpo vazhdoi ta këshillojë Rugovën.

Agani ka qenë figurë qendrore në të gjitha ekipet negociuese, duke përfshirë atë për të drejtat e shqiptarëve për arsimim në vitin 1996 dhe në Konferencën e Rambujesë në vitin 1999. Më 6 maj 1999, Agani u vra në rrethana të dyshimta nga forcat serbe ndërsa ishte duke u përpjekur të largohej nga Kosova gjatë bombardimeve të NATO-s.

[seç kishte pasur Kosova] në vitin 1974.⁵⁶

Pas refuzimit të Qosjes, Kraja mendoi se ishte me rëndësi ta bindnin Rugovën që të bëhej kryetar. Siç do të dëshmojnë ngjarjet, kjo rrjedhë e rrethanave do ta bënte Rugovën figurën kyçe në jetën politike dhe në historinë e Kosovës. Ai u gjet në vendin e duhur, në momentin e duhur.

LDK-ja si Lëvizje Masovike

Transformimi i LDK-së nga një grup intelektualësh në një lëvizje masovike popullore sa do që ishte rezultat i reputacionit të themeluesve të saj poaq ishte edhe rezultat i shpërbërjes së LKK-së. Ajo poashtu fitoi përkrahjen e të burgosurve të dikurshëm politik të cilit ishin arrestuar pas trazirave të vitit 1981. Shumë prej tyre iu bashkuan thirrjes së Adem Demaçit, të burgosurit të dikurshëm të famshëm politik, për t'u bashkuar lëvizjes.⁵⁷ Jusuf Buxhovi, sekretari i parë i partisë, kujton:

LDK-ja u transformua në organizatë masovike brenda vetëm tre muajve, njëkohësisht me shpërbërjen e LKK-së. Rreth 700,000 njerëz i'u bashkuan LDK-së dhe disa u befusuan nga kjo

rritje e shpejtë. Për mua kjo nuk ishte befasi.

Ne kishim një rregull të mos bënim dallime në mes njerëzve, të gjithë ishin të mirëseardhur, policë dhe ushtarë të dikurshëm, etj.⁵⁸

Buxhovi thotë se ka insistuar të mbahen shënime rreth të gjithë pjesëmarrësve në takimet e partisë. Këto shënime përfshijnë familjen Jashari, më konkretisht Hamëz Jasharin, vëllain e Adem Jasharit, i cili më vonë do të luante rol kyç në formimin e UÇK-së. Hamëz Jashari, si avokat, "ishte shumë aktiv." Hashim Thaçi, kryeministër aktual i Kosovës, poashtu ishte anëtar. Buxhovi shton, "afro 90 përqind të shqiptarëve të rritur ishin anëtarë."⁵⁹ Kraja, për dallim nga Buxhovi, ishte befusuar me shpërthimin e anëtarësisë së LDK-së:

Nuk kishim ide të qartë të partisë politike me anëtarësi të madhe, por LDK-ja u shndërrua në lëvizje. Në aspektin organizativ, ajo ishte organizatë konfuze, mirëpo në aspekt të evoluimit, ishte mrekullë. Disa anëtarë të Aleancës Socialiste të Punëtorëve e braktisën atë për t'u bërë anëtarë të LDK-së.⁶⁰ Disa

58 Intervistë e IKS me Jusuf Buxhovin. Prishtinë, 29 Prill 2011.

59 Po aty.

60 Aleanca Socialiste e Punëtorëve ishte "shoqatë e shoqatave" që përfshinte rreth 80 përqind të popullatës së përgjithshme të vendit mbi

56 Intervistë e IKS me Rexhep Qosjen, Prishtinë, 23 shkurt 2011.

57 Vet Demaçi i'u bashkua LDK-së më vonë. Shkëlzen Gashi. *Adem Demaçi: biografi e paautorizuar*. Prishtinë. Rrokullia, 2010. f.92.

prej tyre u deklaruan publikisht se po i bashkoheshin LDK-së, edhe pse nuk ishin takuar fare me ne. Ne nuk kishim shumë njohuri rreth këtyre proceseve dhe nganjëherë ballafaqoheshim me situata paradoksale, komike dhe tragjike. Anëtarët na jepnin besimin e tyre, mirëpo ne nuk e dinim çka të bënim me të.⁶¹

Programi i LDK-së ishte i paqartë. Ajo përkushtohej për “demokraci dhe drejtësi.” Megjithatë, në fillim, Milazim Krasniqi, shkrimtar dhe njëri prej themeluesve, kujton që “koncepti ishte që Kosova duhet të ketë status të barabartë me Republikat e tjera jugosllave, dhe e përkrahte konceptin e Sllovenisë dhe Kroacisë për administratë asimetrike që nënkuptonte më tepër kompetenca për republikat e Jugosllavisë.”⁶² Megjithatë, pas një kohe të shkurtër, përderisa Jugosllavia u zhyt në gjak, ky qëndrim duhej të ndryshonte.

Edhe pse LDK-së i'u bashkëngjiten anëtarët e dikurshëm të LKK-së, asnjëri prej tyre nuk ishte nga pozitat udhëheqëse të partisë së vjetër.⁶³ Ngjashëm me këtë, asnjëri prej 111 deputetëve që kishin shpallur Kosovën republikën në korrik të vitit 1990, nuk do të merrnin pozita udhëheqëse në LDK, edhe pse nuk u përjashtuan nga inkuadrimi.

U ftuan të burgosur të dikurshëm politik si dhe ata që kishin qenë pjesëtarë të organizatave ilegale gjatë tërësive viteve 1980.⁶⁴ Kjo kontribuoi në zgjerimin e bazës së LDK-së. Sipas Buxhovit, Rugova besonte që ata “ishin njerëz të sakrificës” dhe shton që “ata ishin shumë aktiv në nivelin lokal.”⁶⁵ Më vonë, mendohej që kjo lëvizje kishte pasur rëndësi kyçe në ndryshimin e karakterit të organizatës nga një strukturë fillimisht e dominuar nga anëtarët e mëhershëm të partisë komuniste. Përfshirja e këtyre njerëzve ndihmoi në

zvogëlimin e hendekut politik, i cili kishte ekzistuar që nga viti 1981, në mes të radikalëve dhe atyre që kishin mbetur në parti.

Faktor tjetër që ndihmoi në shndërrimin e LDK-së në organizatë masovike ishte fushata për pajtimin e gjaqeve. Gjatë viteve 1980, lufta e gjaqeve, shumica prej të cilëve ishin ngrirë me dekada të tëra, ende përbënin rrezik për jetën e rreth 17,000 njerëzve.⁶⁶ *Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut* (KMLDNJ), kishte nisur iniciativën për tejkalimin e kësaj tradite të vjetër shqiptare. Në krye të fushatës ishte Anton Çetta, profesor i mirënjohur i etnologjisë.⁶⁷ Fushata u bë aq masovike sa që më 1 maj 1990 te Verrat e Llukës, një fushë në afërsi të Deçanit, u mbledhën 100,000 njerëz nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Shqipëria për të marr pjesë në pajtimin e familjeve që kishin hasmëri të gjakut. Kjo ndihmoi në konsolidimin e ndjenjës së unitetit kombëtar. Çetta thoshte: “Entuziazmi dhe ndjenja e vëllazërisë u dha kurajë politikanëve dhe poashtu inkurajoi vet-organizimin e popullit tonë.”⁶⁸ LDK-ja e asocoi veten me fushatën e re, dhe kështu ishte në pozicion të mirë të mblidhte meritat e ndjenjës së unitetit dhe ti jepte asaj shprehje politike.

LDK-ja nuk ishte partia ose lëvizja e vetme që lindi gjatë viteve 1989-90 si përgjigje ndaj revokimit të autonomisë dhe kolapsit të LKK-së. Njëra prej tyre ishte Shoqata për Iniciativën Demokratike të Jugosllavisë (UJDI), e cila veçmë ishte themeluar në vitin 1988, me qëllim të demokratizimit të mbarë Jugosllavisë por e cila themeloi degën e saj në Kosovë në dhjetor të vitit 1989. Në mesin e themeluesve të UJDI-t ishin Shkëlzen Maliqi dhe Muhamedin Kullashi. Veton Surroi u emërua kryetar i degës në Kosovë.⁶⁹

Në mes të dhjetorit të vitit 1989 dhe të shkurtit të vitit 1990, u krijuan shumë organizata. Në mesin e tyre ishte KMLDNJ e udhëhequr nga Idriz Ajeti dhe më vonë nga Adem Demaçi, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura Tregtare të Kosovës (BSPK) e udhëhequr nga Hajrullah Gorani, Shoqata Nëna Terezë e udhëhequr nga Anton Çetta (dhe më vonë nga kolegu i tij nga fushata për pajtimin e gjaqeve,

moshën 15 vjeçare. “Kryesisht si rezultat i segmenteve të Aleancës që kolektivisht i'u bashkuan LDK-së, ndodhi rritja e menjëhershme e LDK-së, si dhe fakti që ai ishte grupi i parë që përkrahte një botëkuptim politik kryesisht shqiptarë që kundërshtonte plotësisht politikën serbe në Kosovë.” Besnik Pula. *Lindja e “Shtetit Paralel” të Kosovës, 1988–1992*. Nationalities Papers, Vol 32, Nr. 4. Dhjetor 2004. p.803

61 Intervistë e IKS me Mehmet Krajën, Prishtinë. 14 mars 2011

62 Intervistë e IKS me Milazim Krasniqin, Prishtinë. 2 shkurt 2011

63 Fadil Hoxha ishte në krye të Lidhjes Komuniste të Kosovës dhe përfaqësuesi më i lartë i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë. “Fadil Hoxha për vite me radhë nuk kuptonte pse Rugova nuk pranoi t'i takonte ata [ish-udhëheqësit komunist të Kosovës]. Kur e pyeta një herë Rugovën për këtë, ai më tha që do t'i takonte, por e formuloi përgjigjen e tij në mënyrë të paqartë, ashtu që unë kuptova se nuk ishte i gatshëm t'i takonte ata... meqë më tha pa e zgjatur shumë se ishte nën presion të strukturave të brendshme të LDK-së. Në mënyrë diskrete, Fehmi Agani takohej me partizanët..., nënkryetari i LDK-së...” Veton Surroi. *Fadil Hoxha në Vetën e Parë*. Prishtinë. KOHA, 2010. f.51

64 Disa nga të burgosurit e dikurshëm të demonstratave të vitit 1981 që i'u bashkuan LDK-së ishin: Hydayet Hyseni, Mehmet Hajrizi, Berat Luzha, Myrvete Dreshaj, Ali Lajqi, Ramë Bujë, etj.

65 Intervistë e IKS me Jusuf Buxhovin, Prishtinë. 29 prill 2011

66 Mark Thompson, *Punim: Fundi i Jugosllavisë*. Londër: Hutchinson Radius/Vintage, 1992. f.141.

67 Viti 1990 u shpall ‘Viti i Pajtimit.’ Në fund të fushatës, në vitin 1992, ishin pajtuar rreth 1,000 gjaqe të shkaktuara nga vrasjet, 500 të shkaktuara nga plagosjet, dhe 700 konflikte të tjera.

68 Marie Rushani shkroi “pikë së pari, si vepër e vetëmbrojtjes, jo thirrje për t'i bashkuar armët, siç kishte ndodhur pothuajse gjithmonë në fushatat historike të Pajtimit të Madh [për shembull në 1444, 1703 dhe 1878], por për t'i bashkuar rezistencën së përgjithshme pa armë, me vetëdijën se rezistenca paqësore mund të barte vuajtje të jashtëzakonshme dhe çmim shumë të lartë,” Marie Rushani. *La vendetta e il perdon, nella tradizione consuetudinaria Albanese*. Religioni e Società 29. f.150.

69 Intervistë e IKS me Shkëlzen Maliqin, Prishtinë. 24 mars 2011.

Don Lush Gjergji), Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Kosovë i udhëhequr nga Gazmend Pula, dhe Forumi i Gruas së LDK-së udhëhequr nga Luljeta Pula. Në të njëjtën kohë u krijuan parti të reja politike. Partia Social Demokrate u themelua më 10 shkurt 1990 nën udhëheqjen e Muhamedin Kullashit dhe Shkëlzen Maliqit dhe më vonë nga Luljeta Pula. Parlamenti Rinor i Kosovës në vitin 1990 u shndërrua në Partinë Parlamentare të Kosovës (PPK) të udhëhequr nga Veton Surroi dhe pastaj Bajram Kosumi dhe Adem Demaçi. U krijuan edhe Partia e Gjelbër e udhëhequr nga Daut Maloku dhe Partia Fshatare e Hivzi Islamit.

Në fund të vitit 1990, në përpjekje për ta rritëksuar përkushtimin e tyre ndaj rezistencës paqësore, LDK-ja dhe pesë parti të tjera themeluan Këshillin Koordinues të Partive Politike. Këshilli synonte të bashkërendonte ndihmat dhe ta rriste legjitimitetin e tyre.⁷⁰ Këshilli përfshinte edhe përfaqësues jopartiak si Adem Demaçi dhe Hajrullah Gorani.

Në mes 26-30 shtatorit të vitit 1991, u mbajt referendumi nën organizimin e Këshillit. Votuesit u pyetën nëse dëshirojnë që Republika e Kosovës të bëhet shtet i pavarur, dhe opsioni tjetër ishte të mbetej në federatë së bashku me republikat tjera jugosllave. Nga numri total i 1,051,357 qytetarëve me të drejtë vote, rreth 87 përqind morën pjesë dhe 98.87 votuan në favor të pavarësisë. Referendumi i përmblushte kriteret ligjore të përcaktuara me Kushtetutën e Kaçanikut.⁷¹

Më 19 tetor 1991, Këshilli Koordinues emëroi qeverinë e përkohshme të udhëhequr nga mjeku i mirënjohur Bujar Bukoshi. Meqë Kosova ishte nën kontrollin e Serbisë, Bukoshi shpejt u largua në ekzil, së pari në Slloveni dhe pastaj në Bon.

Më 24 maj 1992, u mbajtën zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare. Ibrahim Rugova ishte kandidati i vetëm në zgjedhjet presidenciale. Në zgjedhjet parlamentare morën pjesë rreth 490 kandidatë nga 22 parti politike, si dhe disa kandidatë të pavarur. LDK-ja i fitoi zgjedhjet me 76.44 përqind. Tri parti të vogla fituan rreth 27 ulëse, kandidatët e pavarur i fituan dy ulëse dhe 14 ulëse mbetën të zbrazëta pasi që serbët dhe malazezët e bojkotuan procesin zgjedhor.⁷² Së paku 10 prej anëtarëve të

70 Këshilli Koordinues i Partive Politike përbëhej nga gjashtë parti: LDK, PPK, PFK, PSHDK, PSDK dhe PR.

71 1,051,257 ishte numri i përgjithshëm i personave me të drejtë vote. 914,802 vota u hodhën prej të cilave 931,705 në favor, 164 kundër, 933 ishin vota të pavlefshme. Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, *Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës: 2 korrik 1990 – 2 maj 1992*, Prishtinë, 2005.

72 Shih Qendrën për Informim të Kosovës (QIK), shikuar më 6 Tetor 2011.

LDK-së të zgjedhur, ishin të burgosur të dikurshëm politik.⁷³

Hegjemonia politike e LDK-së deri në vitin 1997

LDK-ja tashmë ishte konsoliduar si forca e vetme politike në Kosovë dhe si e tillë ajo njihej ndërkombëtarisht si *përfaqësuesja* e shqiptarëve të Kosovës. Megjithatë, roli i saj ishte i dykuptimtë. Ajo ishte lëvizje masovike dhe përfaqësuese legjitime politike e shtetit paralel të cilin përipiqej ta organizonte. Kjo ndihmoi në inkurajimin e besimit që LDK-ja, në një mënyrë, e udhëhiqte “vendin.”

Shteti paralel financohej nga i ashtuquajtur i “fondi i tre-përqindëshit.” Zyrtarët e LDK-së mblidhnin taksa në mbarë vendin. Në vendet e jashtme, këtë proces e mbikëqyrte Bukoshi. Sipas një raporti zyrtar të prezantuar në parlament në vitin 2000, gjatë periudhës 1990-1999 qeveria në ekzil mblodhi DM 217.6 (€111.2m), US\$ 3.6m, SFr 30.5m dhe £24,120.⁷⁴ Bukoshi ishte kryeministër dhe njëkohësisht ministër i punëve të jashtme, dhe në terren atë e ndihmonte Edita Tahiri e cila vepronte si përfaqësuese e LDK-së për punë të jashtme. Xhafer Shatri, me seli në Gjenevë, ishte ministër i informimit. Qeveria emëroi edhe ministra të tjerë: Adem Limani, ministër i shëndetësisë, Muhamet Bicaj, ministër i arsimit, Isa Mustafa, ministër i financave, Halit Muharremi, ministër i drejtësisë. Qeveria kishte edhe dy ministri të tjera të cilat mbetën sadopak në hije. Ministri për punë të brendshme, Ramush Tahiri, dhe ministri i mbrojtjes, Nikë Gjeloshi. Me ndihmën e OJQ-së Nënë Tereza u krijua edhe sistemi paralel i shëndetësisë. Ministria e arsimit ishte dukshëm ministria më aktive, meqë e organizonte një sistem të tërë paralel të arsimit.

LDK-ja dhe qeveria e saj dominonin mbi organizatat e tjera aktive të asaj periudhe, përfshirë këtu edhe KMLDNJ-në e cila regjistronte rastet e shkeljes së drejtave të njeriut të shqiptarëve të Kosovës nga autoritetet serbe. Më tepër se gjysma e themeluesve të saj, shumica prej tyre të burgosur të dikurshëm politik, ishin edhe themelues të LDK-së. Megjithatë, funksioni dytësor dhe jozyrtar i Këshillit ishte të monitoronte aktivitetet politike dhe të sigurohej që askush të mos shmangej nga politika paqësore e LDK-së.⁷⁵

73 Mehmet Hajrizi, Selatin Novosella, Rame Bujra, Berat Luzha, Basri Musmurati, Hydajet Hyseni, Ilaz Pireva, Jakup Krasniqi dhe Ali Lajqi.

74 Jusuf Buxhovi citohet të ketë iniciuar Raportin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 1991-1999 dorëzuar Kuvendit të Kosovës në janar të vitit 2000. f.36.

75 Besnik Pula. Lindja e “Shtetit Paralel” të Kosovës,” 1988–1992. Nationalities Papers, Vol.32, Nr. 4. Dhjetor 2004. f.808.



BUJAR BUKOSHI

13 MAJ 1947,
SUHAREKË, KOSOVË

Studioi mjekësinë në Beograd ku u diplomua në vitin 1971. Para se të bëhej fytyrë e rëndësishme politike, ai ushtronte profesionin e urologut. Bukoshi ishte një nga themeluesit e LDK-së dhe të KLMDNJ-së. U emërua Kryeministër në Qeverinë e Kosovës “në ekzil,” nga Këshilli Koordinues në vitin 1991. Qeveria dhe aktivitetet e saj u financua nga taxa vullnetare nga të ardhurat prej tre përqind e paguar nga të gjithë kosovarët gjatë viteve të 90-ta. Disa nga paratë e mbledhura janë përdorur për të krijuar “Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës” (FARK). Megjithatë, në vitin 1997, Bukoshi bllokoi ndarjen e fondeve për institucionet shtetërore paralele të Kosovës, dhe mori kontrollin e drejtpërdrejtë në menaxhimin e fondit.

Pas luftës, Bukoshi u largua nga LDK-ja dhe themeloi Partinë e Re të Kosovës (PREK). Në këtë pikë, Bukoshi haptazi akuzoi Ibrahim Rugovën dhe djalin e tij Ukën, për udhëheqjen e LDK-së në stil mafioz, që gjoja funksiononte si ‘Cosa Nostra.’ Partia e Bukoshit nuk doli mirë në zgjedhjet lokale të vitit

2002 dhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2004, pas të cilave ajo u shpërbë.

Në vitin 2007 pas vdekjes së Rugovës dhe tradhtisë së Nexhat Dacit, Bukoshi u ri-bashkua LDK-së dhe u zgjodh deputet në parlament. Në vitin 2009 ai u emërua Ministër i Shëndetësisë. Në vitin 2010, Bukoshi deklaroi se do ta sfidoi Fatmir Sejdiun në zgjedhjet për kryetar të LDK-së. Disi e habitshme që në këtë përpjekje u mbështet nga Ukë Rugova. Në fund, Bukoshi nuk doli në zgjedhje dhe braktisi LDK-në, në vend të kësaj hartoi një listë për kandidaturë të pavarur së bashku me Ukën, të njohur si “Lista Ibrahim Rugova.” Ky grup u bashkua në koalicion para-zgjedhor me AAK-në dhe Ukë Rugova, nga lista, fitoi një vend në parlament. Bukoshi dhe Ukë Rugova formuan një nga miqësitë më të habitshme në politikën moderne të Kosovës. Të dy burrat më pas braktisën opozitën e AAK-së dhe hynë në koalicion me PDK-në. Si shpërblim për këtë veprim, Bujar Bukoshi u emërua zëvendëskryeministër i qeverisë aktuale të Kosovës.

Derisa pjesa tjetër e Jugosllavisë u fut në luftë dhe Kosova mbeti nën kontrollin e rreptë policor serb, ishte e qartë që ky ishte çdo gjë pos një vend normal. Prandaj, t’i kuptosh sot strukturat vendimmarrëse të asaj periudhe shpeshherë është më vështirë sesa që ishte për njerëzit në atë kohë. Sot e kësaj dite mbetet e paqartë nëse arsimi ishte nën kontrollin e LDK-së apo të qeverisë, apo cili ishte dallimi në mes të këtyre dyjave, dhe kush kishte kontroll mbi fondet. Për shkak se qeveria e Bukoshit më vonë raportoi se në periudhën 1990-99 rreth 81 përqind të fondeve u dedikuan për arsimin fillor për më tepër se një çerek milion fëmijë, nuk është vështirë të paramendohet se jo çdo cent i mbledhur ka arritur në destinacionin e synuar.

Gazeta e vetme në gjuhën shqipe e cila lejohej të botohej ishte *Bujku*. Ajo ishte nën kontroll të plotë të LDK-së, njëllor si raporti mbi lajmet ditore nga Kosova në transmetuesin publik shqiptar në Tiranë, i cili kishte shikueshmëri të madhe, dhe Qendra

për Informim e Kosovës (QIK) e cila operonte si agjenci e lajmeve mirëpo më tepër ishte zëdhënëse e LDK-së.⁷⁶ Mediat tjera të pavarura nga LDK-ja do të themeloheshin më vonë me përkrahjen e Fondacionit për Shoqëri të Hapur (SOROS) në Beograd. Këto përfshinin gazetën *Zëri* dhe *Koha* të cilat ekzistojnë edhe sot, si dhe *Forum*, një revistë jetëshkurtër e udhëhequr nga Adem Demaçi.

Në këtë mënyrë, LDK-ja, në sytë e shqiptarëve të Kosovës, padashur dhe në shumë aspekte, e kishte zëvendësuar fuqinë politike të LKK-së. Megjithatë, është me rëndësi të kujtohet se fuqia politike në këtë kohë ishte e ndarë. Derisa LDK-ja kishte ndikim moral tek shqiptarët, të cilët në shkallë të lartë u rreshtuan pas saj duke i dhënë kështu një masë të fuqisë – çdo kush që refuzonte ta paguante taksën prej tre përqind kritikohet rëndë – autoritetet dhe

76 Sabrina P. Ramet. *Serbia nga viti 1989: Politika dhe shoqëria nën sundimin e Millosheviqit*. Seattle: University of Washington Press, 2005. f.324. Tim Judah, *Kosova: Lufta dhe Hakmarrja*. Yale University Press, 2002.



EDITA TAHIRI

27 KORRIK 1956, PRIZREN

Studioi për electroteknikë dhe komunikim në Universitetin e Prishtinës, dhe magjistroi në Administrim Publik në Shkollën e Qeverisë Kenedi në Universitetin e Harvardit. Tahiri kohët e fundit doktoroi në Universitetin e Prishtinës. Jetën e saj politike e filloi në vitin 1991, kur i'u bashkua kryesisë së LDK-së. Që nga fillimi ajo ishte e specializuar në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe u emërua përfaqësuese e LDK-së për punë të jashtme në vitet 1991-1999. Tahiri ishte udhëheqëse e Forumit të Gruas të LDK-së dhe deputete në parlament në mes të viteve 1992 dhe 2000. Si anëtare e LDK-së ajo ishte poashtu përfaqësuese në Konferencën e Rambujesë.

Pas luftës Tahiri mbeti në LDK dhe ishte deputete në Parlamentit në vitet 2001-2004. Megjithatë, në vitin 2005 ajo u largua nga LDK-ja dhe themeloi

partinë e saj, Alternativa Demokratike e Kosovës (ADK). Në vitin 2007 partia e saj shkoi në një marrëveshje parazgjedhore me PDK-në dhe mori një vend në parlament. Gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010, partia e saj përsëri garoi në koalicion parazgjedhor me PDK-në, por kësaj rradhe ADK nuk siguroi asnjë vend në parlament. Megjithatë, Tahiri u emërua zëvendëskryeministre dhe aktualisht është kryenegociatore e Kosovës në dialogun e sponsorizuar nga Bashkimi Evropian (BE) me Serbinë.

policia serbe poashtu kishin kontroll në baza ditore.


Autoritetin e LDK-së e forconte edhe më tej imazhi i ndërtuar me kujdes i Ibrahim Rugovës si udhëheqës i padiskutueshëm dhe si vetë Mahatma Gandhi i Kosovës. Kur lëshohej një urdhër, ai pothuajse gjithmonë respektohej dhe kjo zgjati kështu deri në vitin 1995 kur fuqia politike e Rugovës filloi të lëkundej. Atëbotë, ekzistonte një përshtypje e përgjithshme që Rugova kishte kanal të hapur në administratën amerikane dhe prandaj besohej se ai e dinte çka po bënte.

Kjo hegjemoni nënkuptonte që nga fundi i vitit 1992 deri pas Marrëveshjes së Dejtonit e cila i dha fund luftës në Bosnje në nëntor të vitit 1995, Kosova u vendos në një gjendje të çuditshme por shumë të qetë në raport me autoritetet serbe. Rugova nuk dëshironte t'i jepte serbëve ndonjë arsye për dhunë, nga frika se lufta do ta provokonte pastrimin etnik të shqiptarëve. Në shkëmbim, serbët e lejonin ta ushtronte pushtetin e tij, ta udhëhiqte sistemin e arsimit, të vozitej në makinën presidenciale Audi dhe të mbante konferenca për shtyp çdo të premte ku i falënderonte miqtë dhe dashamirët. As këta të fundit nuk dëshironin konflikt. Luftimet së pari në Kroaci

dhe pastaj në Bosnje, gjëja e fundit që Millosheviqi e donte ishte një front i ri në jug i cili do t'i ndante dhe dobësonte forcat serbe. Kështu, me pushtetin e LDK-së pas zgjedhjeve, institucionet e tjera siç ishte Këshilli Koordinues filluan të shuhen. Vetëm në vitin 1995 gjërat filluan të ndryshojnë.

Në ndërkohë, parlamenti i zgjedhur në vitin 1992 nuk u mblodh asnjëherë dhe nuk miratoi asnjë ligj. Polica serbe kishte parandaluar përpjekjen e vetme për tu mbledhur. Presidenti i Kosovës kështu ishte figura e vetme legjitime. Në njërën anë, shteti serb e udhëhiqte Kosovën, derisa në anën tjetër, ajo ekzistonte si demokraci, të paktën në letër. Në fakt, pushteti të cilin nuk e kishin serbët ishte në duart e presidentit të fuqishëm i cili e ushtronte atë nëpërmjet makinerisë së fuqishme dhe të gjerë partiake. Siç shkroi Shkëlzen Maliqi, sociolog, gazetar dhe aktivist, në vitin 1998:

Është e pamundur të flitet për qeverinë ose opozitën në parlamentin e Kosovës në terma formale. Është e qartë që nuk ka opozitë të artikuluar parlamentare ndaj LDK-së e cila ushtron kontroll të plotë politik. Opozitë më e mirëfilltë janë disa grupe jashtë-parlamentare



NEXHAT DACI

26 KORRIK 1944,
TËRNOÇ, PRESHEVË

U lind në një fshat tash në jug të Serbisë. Ai studioi për kimi në Beograd, dhe magjistroi të doktoronte në Universitetin e Zagrebit në vitin 1973. Punoi si shkencëtarë në Mbretërinë e Bashkuar, Belgjikë dhe Çekoslovakia. Që nga viti 1970, Daci është profesor i kimisë në Universitetin e Prishtinës. Që nga viti 1994 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, ku ishte president i saj nga viti 1998 deri në vitin 2002.

Gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2000, Nexhat Daci i drejoi dhe i fitoi zgjedhjet në Prishtinë. Megjithatë, Daci nuk pranoi të marrë postin e kryetarit të komunës së Prishtinës, por kërkoi nga LDK-ja që ta emëroj Sali Gashin në vend të tij. Në zgjedhjet e para parlamentare të vitit 2001, Daci u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës në LPVQ, dhe u emërua kryetar i saj në mënyrë të rregullt. Në vitin 2004, Daci u rizgjodh Kryetar i

Kuvendit. Sidoqoftë, ai nuk ishte në gjendje ta përfundojë mandatin pasi e humbi mbështetjen e partisë së tij në prag të vdekjes së Rugovës. Gjatë zgjedhjeve të brendshme të LDK-së në vitin 2006, ai pa sukses sfidoi Fatmir Sejdiun për kryetarë të partisë.

Pas kësaj pengese, Nexhat Daci vendos të ndahet nga LDK-ja dhe krijoi partinë e tij, Lidhjen Demokratike të Dardanisë (LDD). Pastaj, hyri në një koalicion parazgjedhor me Partinë Shqiptare Demokristiane të Kosovës (PSHDK) dhe fitoi dhjetë përqind të votave në zgjedhjet parlamentare të vitit 2007. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010, partia e Dacit nuk arriti të kalon pragun prej pesëpërqind, dhe si rrjedhojë e kësaj shumë prej anëtarëve të saj braktisën partinë. Para zgjedhjeve, Daci u gjet fajtor për keqpërdorim të fondeve ndërsa ishte kryetar i Parlamentit.

siç është “Forumi i Intelektualëve Shqiptarë” dhe “Partia e Unitetit Kombëtar” të cilët përkrahin bashkimin e menjëhershëm me Shqipërinë. Edhe kjo megjithatë është variant i programit kombëtar dhe jo opozitë reale.⁷⁷

Sfidat e para për LDK-në filluan të shfaqen pas Konferencës së Dejtonit. Së pari, kishte zemërim që përkundër lidhjeve ndërkombëtare të Rugovës, çështja e Kosovës nuk u diskutua në konferencë. Kjo do të thoshte që pjesa e mbetur e Jugosllavisë, e përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi, tash njëjzë ndërkombëtarisht dhe që Kosova kishte mbetur e mbyllur në atë shtet.

Shenjat e para të telasheve erdhën kur u arrit marrëveshja me ndihmën e një organizate të Vatikanit sipas së cilës studentët dhe fakultetet shqiptare përsëri mund t'i përdornin hapësirat e Universitetit të Prishtinës prej ku ishin dëbuar në shtator të vitit 1991. Marrëveshja nuk u zbatua dhe më 1 tetor 1997 u mbajtën demonstrata nën organizimin e *Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës* (UPSUP). Kjo dëshmoi fillimin e ndarjeve në mesin e kosovarëve. Studentët kërkonin zbatimin

e marrëveshjes. Duke lobuar në vendet e jashtme, studentët kishin dhënë kontribut të çmueshëm në përfundimin e konsensusit të gjerë ndërkombëtar për përkrahjen e rezistencës paqësorë të LDK-së.⁷⁸ Kjo e vetme mund të mos ketë mjaftuar; megjithatë, kjo ngjau njëkohësisht me ngritjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo UÇK-në, e cila u mundësua nga ngjarjet e vitit 1997 në Shqipëri.

Fillimi i vërtetë i fundit të hegjemonisë para luftës, prandaj filloi kur shteti fqinj i Shqipërisë u fut të anarki. Për herë të parë, sasi të mëdha të armatimit të lirë ishin në dispozicion. Në nëntor të vitit 1997 UÇK-ja e bëri paraqitjen e parë publike dhe në muajt e ardhshëm ndodhën disa përleshje. Në mars të vitit 1998, forcat speciale të policisë serbe rrethuan shtëpinë e Adem Jasharit, anëtar i hershëm i UÇK-së, dhe kur mbaroi rrethimi më tepër se 50 anëtarë të familjes ishin vrarë.

Përgjigja e Rugovës ishte thirrja për zgjedhje, proces ky të cilin ai e kishte shtyrë për dy vite me radhë. Zgjedhjet u mbajtën më 22 mars 1998 dhe LDK-ja përsëri korri fitore bindëse. Katër parti të

77 Shkelzen Maliqi, *Kosova: Botë të Ndara; Reflektime dhe Analiza 1989-1998*. Prishtinë, Dukagjini, 1998. ff. 39-40.

78 Howard Clark, *Rezistenca Civile në Kosovë*. Londër: Pluto Press, 2000. ff. 145 – 157.



FATMIR SEJDIU

23 TETOR 1951,
PAKASHTICË, PODUJEVË

Shkoi në shkollë në Podujevë dhe më pas studioi për drejtësi në Prishtinë, ku përfundimisht doktoroi. Përderisa ishte student, Sejdiu kaloi një vit në Francë dhe katër muaj në Arizona. Ai ka botuar shpesh dhe ishte profesor në Universitetin e Prishtinës për shumë vite.

Karriera e tij politike filloi kur u bë anëtar i këshillit themelues të LDK-së, në dhjetor të vitit 1989. Në vitin 1991 u zgjodh anëtar i këshillit të përgjithshëm, dhe në vitin 1992 ai u bë anëtar i kryesisë së LDK-së. Në vitin 1994 ai u bë Sekretar i Përgjithshëm i LDK-së. Ai u zgjodh deputet në të dyja zgjedhjet parlamentare të viteve 1992 dhe 1998.

Pas luftës, Sejdiu u zgjodh përsëri deputet në vitet 2001 dhe 2004. Në shkurt të vitit 2006 Sejdiu u zgjodh President i Kosovës, dhe po atë vit u zgjodh poashtu president i LDK-së, duke filluar

të plotësojnë boshllëkun e lënë nga vdekja e Ibrahim Rugovës. Si President i Kosovës, mori pjesë në negociatat e Vjenës me Serbinë për statusin e ardhshëm të Kosovës. Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2007, si President i LDK-së, ai formoi koalicionin me kundërshtarët e mëdhenj të partisë, PDK-në. Sejdiu kritikoi shpesh dhe ashpër për këtë veprim. Në vitin 2010, Gjykata Kushtetuese vendosi se Sejdiu do të duhet të zgjedh në mes të postit të kryetarit të LDK-së dhe Presidentit të Republikës së Kosovës, ngase mbajtja e të dy posteve ishte jokushtetuese. Sejdiu zgjodhi të japë dorëheqje nga pozita e Presidentit të Republikës. Pastaj ai e fërhoqi partinë e tij nga koalicioni qeverisës me PDK-në, gjë e cila e dërgoi vendin në zgjedhje të paparakhshme. Një muaj më vonë Sejdiu humbi gjithashtu presidencën e LDK-së nga Isa Mustafës.

vogla, përcollen shembullin e Rexhep Qosjes dhe bojkotuan procesin zgjedhor duke thënë se nuk ishte koha e duhur për votime. Atyre i'u bashkuan edhe organizatat studentore, të burgosurit e dikurshëm politik dhe të tjerë. Hegjemonia e LDK-së filloi të thërrmohet.

Fragmentimi i LDK-së

Me hyrjen e Kosovës në luftë në vitin 1998, UÇK-ja i'a mori primatin LDK-së. Vetëm një vit më vonë, në shkurt të vitit 1999, kur delegacioni i shqiptarëve të Kosovës arriti në Konferencën e Rambujesë, Ibrahim Rugova kishte rol dytësor sepse udhëheqja tash ishte në duart e Hashim Thaçit, udhëheqësit politik të UÇK-së. Në Rambuje, Thaçi, Rugova dhe Qosja u pajtuan për formimin e qeverisë së përkohshme pas luftës. Megjithatë, pas përfundimit të luftës në qershor të vitit 1999, Rugova nuk e respektoi marrëveshjen dhe shprehu përkrahjen e tij për qeverinë në ekzil të udhëhequr nga Bukoshi.

Kështu Kosova u bë me dy “qeveri” me legjitimitet të diskutueshëm. Në njërin anë, ishte qeveria e përkohshme e udhëheqësit të UÇK-së Hashim Thaçit dhe Rexhep Qosjes, e përkrahur nga partitë e vogla.

Në anën tjetër, ishte qeveria e Bukoshit, e cila nuk ishte rikonfirmuar nga parlamentet e vitit 1992 dhe 1998. Aktiviteti i Bukoshit ishte dukshëm i kufizuar në krahasim me atë të Thaçit, i cili, megjithatë, ishte rritur nga tyta e pushkës. Me largimin e forcave serbe, UÇK-ja morri pushtetin në nivelin komunal.⁷⁹ Rugova, i cili ishte larguar në ekzil në Romë gjatë bombardimeve të NATO-së, hezitoi para se të kthehej në Kosovë. Atëbotë, mendohej se karrierës politike të Rugovës tashmë i kishte ardhur fundi.

Pas përfundimit të luftës, *Misioni i Përkohshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë* (UNMIK) themeloi atë që u quajt Struktura e Përbashkët e Përkohshme Administrative (SPPA). Në maj të vitit 2000, kjo strukturë mbledhi një numër të madh të udhëheqësve të Kosovës, përfshirë edhe serbët e Kosovës. Atëbotë, u themelua këshilli i përkohshëm prej 35 anëtarëve, që përfshinte përfaqësues të partive politike, organizatave fetare, pakicave kombëtare dhe grupeve të shoqërisë civile. Megjithatë, në periudhë të shkurtër në mes përfundimit të luftës dhe themelimit të SPPA-së, UÇK-ja provoi ta imponoj pushtetin e saj nëpërmjet qeverisë së saj të përkohshme.

⁷⁹ Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI), *Dilema Otomane: Marrëdhëniet e Pushtetit dhe Pronës nën Misionin e OKB-së në Kosovë*. Berlin, 2002.



ISA MUSTAFA

15 MAJ 1951,
PRAPASHTICË, PRISHTINË

Shkollën e mbaroi në Prishtinë dhe u diplomua në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës, ku gjithashtu magjistroi dhe doktoroi. Karriera e tij profesionale filloi në vitin 1974 kur u emërua pedagog në Universitetin e Prishtinës. Me kalimin e kohës, Mustafa u bë figurë udhëheqëse në politikën e Kosovës. Midis viteve 1984 dhe 1988 ai u emërua kryetarë i qeverisë komunale të Prishtinës, [kryetarë i komunës] si dhe udhëheqës i zyrës për planifikimin dhe zhvillimin e Kosovës.

Mustafa i'u bashkua LDK-së në vitin 1990 dhe u emërua Ministër i Ekonomisë dhe Financave në qeverinë e Bukoshit në ekzil. Gjatë viteve të 90-ta Isa Mustafa kaloi shumë vite jashtë vendit në ekzil. Pas luftës, Mustafa u angazhua përveq punëve të ndryshme profesionale, edhe në mësimdhënie nëpër universitete të ndryshme në Kosovë dhe në

hulumtime empirike në Institutin Riinvest. Ai ishte gjithashtu anëtar i disa këshilleve ekzekutive bankare duke përfshirë Organin Qendror Bankar të Kosovës.

Nga viti 2006 deri në vitin 2007, Isa Mustafa ka qenë këshilltar i Presidentit të Kosovës dhe udhëheqësit të LDK-së, Fatmir Sejdiut. Në vitin 2007, Mustafa kandidoi për kryetar të Prishtinës dhe e mundi Fatmir Limajn. Si kryetar popullor i Prishtinës, ai shpesh përdorte pozitën e tij për të kritikuar dhe kundërshtuar udhëheqjen e LDK-së që u bashkua në koalicion me PDK-në. Në vitin 2010 ai e mundi Fatmir Sejdiun në garën për presidencën e LDK-së.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010 Mustafa u zgjodh deputet i Parlamentit të Kosovës. Megjithatë, ai zgjodhi të mbetet kryetarë i komunës së Prishtinës dhe kryetarë i LDK-së.

Papandehur, kjo i dha shtytje të madhe LDK-së. Në muajt kaotike të pas luftës, UÇK-ja e dëmtoi imazhin e saj heroik të kohës së luftës. Shumë njerëz filluan ta asociojnë UÇK-në me korrupsion, hajni dhe vrasjet hakmarrëse të të ashtuquajturve *kolaboracionistë*. Përveç kësaj, me shkatërim aq të madh dhe me dhjetëra mija të vdekur, shumë njerëz pyesnin veten nëse LDK-ja kishte pasur të drejtë që gjatë tërë kohës ishte përpjekur ta parandalonte konfliktin e armatosur. Partia e Ibrahim Rugovës kështu fitoi zgjedhjet komunale të tetorit të vitit 2000. Epërsia e LDK-së do të vazhdonte deri në vdekjen e Rugovës në janar të vitit 2006, kur partia e humbi asetin e saj të vetëm më të vlefshëm. Askush pas Rugovës nuk ishte në gjendje ta rivendoste autoritetin e tij të dikurshëm dhe partia ka vazhduar ta humb përkrahjen përkundër përpjekjeve për t'i joshur votuesit me deklarata rreth "filozofisë rugoviane."

LDK-ja humbi votues edhe ndaj partive që dolën nga gjiri i saj, *Lidhjes Demokratike të Dardanisë* (LDD) të udhëhequr nga Nexhat Daci dhe *Listës Ibrahim Rugova* të udhëhequr nga djali i tij. Në kuvendin e përgjithshëm të partisë në vitin 2006, situata eskaloi kur delegatët filluan të përlëshen dhe ta godasin njeri tjetrin me karrige. Megjithatë, Fatmir Sejdiu, sekretar

i përgjithshëm i partisë gjatë kohës së Rugovës, u zgjodh lider i partisë. Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2004, LDK-ja ishte përsëri partia e parë me 45 përqind të votave. Mirëpo, në zgjedhjet e vitit 2007, kjo shifër ra në 22 përqind kur LDD-ja mori për vite 10 përqind të votave.

LDK-ja sot

Ndarja përbrenda LDK-së, në vitin 2006, pati pasoja katastrofike për reputacionin dhe fuqinë e partisë. Partia u dëmtua edhe më tepër kur arriti koalicion me *Partinë Demokratike të Kosovës* (PDK) të udhëhequr nga Hashim Thaçi në vitin 2007, me ç'rast Fatmir Sejdiu humbi përkrahjen e dikurshme brenda partisë. Sejdiu, i cili u zgjodh President i Kosovës me përkrahjen e PDK-së, u detyra të jap dorëheqje në shtator të vitit 2010, pasi Gjykata Kushtetuese vendosi që ai nuk mund ta ushtroj njëkohësisht postin e presidentit dhe postin e udhëheqësit të LDK-së. Sejdiu u largua nga posti i presidentit dhe i dha fund koalicionit me PDK-në, duke shpresuar se do ta mbante postin e udhëheqësit partiak. Kjo manovër dështoi. Në nëntor të vitit 2010, Isa Mustafa, kryetar i komunës së Prishtinës, e sfidoi Sejdiun dhe fitoi postin e liderit të LDK-së.

Bukoshi poashtu ishte kandidat për postin e udhëheqësit të LDK-së, mirëpo u tërhoq sepse i mungonte përkrahja e duhur. Për ironi, për shkak të marrëdhënieve të tij të ndjera me Rugovën që nga viti 1995 kur e kishte ndaluar financimin e tij, ai u përkrah nga Ukë Rugova, djali i Rugovës, i cili i'u kishte bashkuar partisë. Megjithatë, Uka i mori me vete disa anëtarë të LDK-së dhe e formoi partinë e tij. Lista Ibrahim Rugova ishte e gatshme të marr pjesë në zgjedhjet parlamentare të dhjetorit 2010, në koalicion me AAK-në. Pastaj, pasi fitoj një ulëse në parlament (ulësja e vetme e partisë), Ukë Rugova ndryshoi mendjen dhe i'u bashkua koalicionit qeverisës të udhëhequr nga PDK-ja.

Në zgjedhjet e vitit 2010, në krahasim me zgjedhjet e vitit 2007, LDK-ja shënoi ngritje modeste, por u gjet në opozitë për herë të parë që nga viti 2000. Që atëherë, Isa Mustafa po përpiqet ta rindërtoj partinë duke sjell njerëz të rinj.⁸⁰ Megjithatë, pas zgjedhjeve të fundit partiake në nëntor të vitit 2010, vetëm gjashtë nga 22 anëtarët e kryesisë janë të porsaardhur.⁸¹

Për ta sfiduar në mënyrë më të efektshme qeverinë, LDK-ja formoi grupe ekspertësh për fusha të ndryshme. Në të njëjtën kohë, të qenit në opozitë, nuk e ka penguar LDK-në që të bisedoj dhe arrij kompromise me PDK-në sa herë që ishte e nevojshme. Kur në prill të vitit 2010, Gjykata Kushtetuese shpalli zgjedhjen e Behgjet Pacollit në postin e presidentit të paligjshme, LDK-ja u pajtua që Atifete Jahjaga, zëvendës drejtoreshë apartiake e Policisë së Kosovës, ta zëvendësoj atë në postin e presidentit.

80 Përveç Arben Gashit, deputet i ri e i zëshëm, i cili më herët kishte punuar si këshilltar i Isa Mustafës në komunën e Prishtinës, anëtarët e tjerë të rinj nuk janë aq të dukshëm në LDK.

81 Teuta Sahatçija, Vjosa Osmani, Gazmend Muhaxheri, Avdullah Hoti, Kujtim Shala dhe Xhafer Tahiri u emëruan për herë të parë anëtarë të kryesisë.

NGA TYTA E PUSHKËS: PDK DHE AAK

Strukturat Ilegale dhe UÇK-ja

Edhe pse në vitin 1998 u pa qartë që strategjia e Rugovës për rezistencë pasive nuk po funksiononte, pika kthesë ishte Konferenca e Dejtonit në vitin 1995.⁸² Atëbotë, shumë kosovarë për herë të parë kuptuan që strategjia e Rugovës për bashkëpunim me diplomatë dhe bashkëbisedues të huaj, dhe ajo e evitimit të përbaljes me autoritetet serbe, nuk po arrinte ta siguronte pavarësinë e vendit. Në ndërkohë, Sllovenia, Kroacia dhe tashmë Bosnja dhe Hercegovina, në sytë e shumë kosovarëve, kishin siguruar pavarësinë e tyre vetëm me forcë. Rezultati i Konferencës së Dejtonit, apo dështimi i saj që të ofrojë ndonjë zgjidhje për Kosovën, e forcoi

82 Konferenca e Paqes së Dejtonit u mbajt në Dejton, Ohajo, SHBA në vitin 1995. Slobodan Milošević, Franjo Tuđman dhe Alija Izetbegović u mblodhën për ta nënshkruar marrëveshjen e paqes që do të jepte fund luftës në Bosnje. Kosova u injorua plotësisht.

argumentin e grupeve ilegale. Ato tashmë me lehtësi argumentonin tezën e tyre dhe publikisht ndiqnin synimin e tyre që ‘ta heqin qafe Serbinë me anë të konfliktit të armatosur.’

Ekzistimi i grupeve ilegale kishte qenë traditë në Kosovë për një kohë të gjatë. Arrestimet e shpeshta gjatë periudhës pas Luftës së Dytë Botërore ishin përkujtime të vazhdueshme për ekzistimin e këtyre grupeve. Në mesin e të arrestuarve ishte Adem Demaçi, i cili e kishte themeluar Lëvizjen Revolucionare për Bashkim me Shqipërinë. Grupe tjera ilegale ishin Lëvizja për Çlirimin Kombëtar të Kosovës, e themeluar në vitin 1964, dhe Grupi Revolucionar i cili u shndërrua në Organizatën Marksiste-Leniniste në vitin 1969. Të gjitha këto promovonin qëllimin e njëjtë: bashkimin me



XHAVIT HALITI

8 MARS 1956,
NOVO SELLË, PEJË

U diplomua në degën gjuhës dhe lefersisë shqipe edhe në Universitetin e Prishtinës dhe në Universitetin e Tiranës. Haliti ishte i përfshirë në organizatat ilegale që nga ditët e tij në universitet. Pas protestës të vitit 1981 dhe një periudhe të shkurtër në qeli, Haliti emigroi në Zvicër, ku u bë anëtar aktiv i LPK-së. Aktivitetet e tij gjatë viteve 1980 ishin të bazuara jashtë Kosovës, kryesisht në Zvicër dhe në Shqipëri.

Xhavit Haliti pretendon se është një nga anëtarët themelues të UÇK-së. Gjatë kësaj periudhe, ai ka mbajtur lidhjet me zyrtarët në Shqipëri dhe ishte i përfshirë shpesh në kontrabandën e armëve dhe mbledhjen e fondeve. Pasi u themeluan drejtoritë në UÇK, ai u

emërua Shef i Financave dhe kreu i Drejtorisë së Logjistikës duke u bërë përgjegjës për menaxhimin e tërë Fondit ‘Vendlindja Thërret.’

Pas luftës, Haliti i'u bashkua PDK-së dhe mbetet një figurë e rëndësishme brenda partisë. Në të gjitha zgjedhjet e përgjithshme, Haliti është zgjedhur deputet i Parlamentit. Edhe pse Haliti ka mbetur i popullarizuar dhe ka marrë një numër të konsiderueshëm të votave, ai kurrë nuk luajti rol aktiv në qeveri.

Ashtu si shefi dhe homologu i tij, Hashim Thaçi, Haliti gjithashtu akuzohet në raportet ndërkombëtare lidhur me krimin e organizuar dhe trafikimin e organeve. Megjithatë, akuzat e tilla nuk janë provuar.

Shqipërinë.⁸³ Gjatë periudhës 1973-1975, të gjitha intensifikuan veprimet e tyre dhe shumicën e kohës u zbuluan nga policia sekrete.⁸⁴ Nga viti 1979 deri në vitin 1981, u zbuluan edhe gjashtë grupe tjera. Prej vitit 1974 deri në vitin 1981, u arrestuan më tepër se 600 persona nën akuzën e “separatizmit shqiptar.”⁸⁵ Ata u arrestuan, gjykuan dhe dënuan kryesisht nga policë dhe gjykatës shqiptarë.⁸⁶

Prej demonstratave të vitit 1981 e këtej, autoritetet intensifikuan kërkimin e këtyre njerëzve dhe ishte vetëm çështje kohe para se të vdiste dikush, apo, në shtëpi të shqiptarëve, para se të krijoheshin dëshmorët e parë. Në janar të vitit 1982, u vranë tre kundërshtarë të regjimit komunist. Vëllezërit Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka kishin marrë pjesë në ngjarjet e vitit 1981 para se të largoheshin në Gjermani. As sot e kësaj dite nuk dihet kush i vrau ata, edhe pse të dyshuarit kryesorë besohet të kenë qenë shërbimet sekrete jugosllave dhe shqiptare. Vdekja e tyre i nxiti përkrahësit ta formojnë Lëvizjen e fshehtë për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSSHJ), në Turqi.⁸⁷ LRSSHJ bënte thirrje për Kosovën e pavarur ose për bashkim me Shqipërinë.⁸⁸ Në vitin 1985, grupi ndryshoi emrin e tij në Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK). Në shumicën e rasteve, këto grupe ishin klika të vogla të konspiratorëve, të motivuara ideologjikisht dhe me organizim të dobët. Autoritetet jugosllave i quajtën ata “kundër-revolucionarë,” por me ngritjen e Millosheviqit në pushtet kjo terminologji ndryshoi në “struktura ilegale.” Megjithatë, në diskursin publik, “strukturat ilegale” u bënë frazë që përdorej shpesh për ti identifikuar jo vetëm kundërshtarët e sundimit jugosllav dhe pastaj serb, por me kalimin e kohës, edhe politikën e LDK-së për rezistencë pasive. Këto grupe shpeshherë quheshin edhe “enveristë.” Jo pse e ndiqnin me vetëdije filozofinë e diktatorit shqiptar Enver Hoxha, sepse shumë pak prej tyre dinin ndonjë gjë për jetën e vërtetë në vendin fqinj stalinist. Kjo më tepër kishte

të bënte me faktin se konspiratorët e rinj shpeshherë e ngritnin në qiell llojin e komunizmit të Hoxhës dhe në të njëjtën kohë ëndërronin për krijimin e Shqipërisë së Madhe.

Aktivistët e LPRK-së punonin kryesisht në mesin e diasporës, posaçërisht në Zvicër. Në fillim të viteve 1990, ata kishin mbledhur nën një ombrellë politike shumicën e personave që ishin arrestuar apo përndjekur pas demonstratave të vitit 1981.⁸⁹ Pas referendimit të vitit 1992, në të cilin shumica dërmuese e shqiptarëve të Kosovës votuan në favor të shtetit të pavarur, lëvizja pësoi ndryshime të brendshme. Në gusht të vitit 1993, u mbajt një takim në Drenicë, në zemrën tradicionale të rezistencës kosovare. Bisedimet u përqendruan në qasjen e cila duhej ndërmarë pas ngjarjeve të viteve të fundit në Kosovë dhe Jugosllavi. LPRK-ja ndryshoi emrin e saj në *Lëvizja Popullore e Kosovës* (LPK). Sipas Tim Judah, gazetar britanik, LPK-ja caktoi një komision prej katër vetash të cilët kishin për detyrë nisjen e kryengritjes së armatosur.⁹⁰ Kjo shënonte lindjen e *Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës* (UÇK). Në dhjetor të atij viti, UÇK-ja ishte formuar dhe LPK-ja e kishte ndryshuar statutin e saj. Emrush Xhemajli, anëtar i këtij grupi, kujton se ata kishin vendosur ta përfshijnë “luftën si mjet për ruajtjen e paqes.”⁹¹ Që atëherë, LPK-ja provoi të mbledhë armë për UÇK-në por përpjekjet e tyre të para në këtë drejtim si dhe ato për formimin e njësisë të armatosura u treguan të pasuksesshme.⁹²

LPK-ja nuk ishte grupi i vetëm militant në skenën e asaj kohe. Ajo kishte një rival i cili ishte themeluar në mars të vitit 1993 – *Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës* (LKÇK).⁹³ Dallimi në mes të këtyre dy lëvizjeve ishte deri diku teologjik, për shkak të vështirësisë së sigurimit të armëve. LKÇK-ja insistonte në kryengritje të menjëhershme derisa LPK-ja përkrahte idenë e luftës guerile. LPK-ja, megjithatë, ishte më aktive në diasporë, derisa LKÇK-ja kishte prezencë më të fuqishme në Kosovë. Avni Klinaku, njëri ndër themeluesit e LKÇK-së, thotë se

83 Sabile Keçmezi-Basha. *Organizatat dhe Grupet Ilegale në Kosovë 1981-1989*. Prishtinë, Instituti i Historisë, 2003. pp. 91-101. Sabrina P. Ramet, *Tri Jugosllavitë: Shtetndërtimi dhe Legjitimimi, 1918-2005*. Uashington, DC, dhe Bloomington: Woodrow Wilson Center Press, 2006. f.299.

84 Julie A. Mertus, *Kosova: si mitet dhe të vërtetat e nisen një luftë*. Berkeley: University of California Press, 1999. f.2.

85 Sabrina P. Ramet, *Tri Jugosllavitë: Shtetndërtimi dhe Legjitimimi, 1918-2005*. Uashington, DC, dhe Bloomington: Woodrow Wilson Center Press, 2006. f.299.

86 Paneli i gjykatësve i përbërë nga Tahir Ibrani, Radimir Stojkoviç, Hazir Haziri, Tefik Shala dhe Nebih Qena i dënuan anëtarët e LRBHSH-së me burgim të gjatë. Adem Demaçi u dënu me 15 vite burgim, Hazir Shala dhe Dibran Bajraktari me 13 vite, Sabri Novosella dhe Tefik Sahiti me nëntë vite. Shkelzen Gashi. *Adem Demaçi, biografi e paautorizuar*. Prishtinë. Rrokullia, 2010. f.51.

87 LRSSHJ u themelua më 17 Shkurt 1982 në Stamboll nga Sabri Novosella dhe Avdullah Prapashtica.

88 Intervistë e IKS me Emrush Xhemajlin, Prishtinë, 16 Shkurt 2011.

89 Mehmet Kraja në *Vitet e Humbura* thotë: ‘LPRK kërkon dhe gjen përkrahjen më të madhe në mesin e të burgosurve dhe të përndjekurve politik, të cilët janë bërë ashtu vetëm pse ishin anëtarë dhe aktivistë të saj.’

90 Tim Judah në librin e tij *Kosova: Lufta dhe Hakemarrja* pohon që ata ishin Xhavit Haliti, Ali Ahmeti, Kadri Veseli dhe Hashim Thaçi. Megjithatë, në mesin e anëtarëve të lartë të UÇK-së vazhdojnë kundërtheniet se kush e themeloi UÇK-në. Rexhep Selimi pohon që Mujë Krasniqi, Zahir Pajazitit dhe Nait Hasani ishin arkitektët e parë të lëvizjes dhe strukturës së saj. Nait Hasani pohon që UÇK-ja u formua më 17 Nëntor 1994 nga ai, Azem Syla, Xhavit Haliti dhe Xheladin Gashi.

91 Intervistë e IKS me Emrush Xhemajlin, Prishtinë. 16 Shkurt 2011. 92 Në Çetën e Llapit në rajonin e Llapit ishin të përfshirë Hasan Ramadani, Gani Hoxha, Ismet Avdullahu, Sabri Kijçari.

93 Intervistë e IKS me Avni Klinakun, Prishtinë, 16 Shkurt 2011. Themeluesit e LKÇK-së ishin Avni Klinaku, Raif Qela, Bahri Fazliu, Sabit Gashi dhe Mursel Sopi.

e themeluan organizatën si alternativë ndaj pacifizimit të LDK-së.⁹⁴ Njëra prej aktiviteteve të saj ishte botimi dhe shpërndarja klandestine e gazetës *Çlirimi* e cila synonte mobilizimin e popullit për kryengritje. Sipas Liburn Aliut, atëbotë anëtar i LKÇK-së, synimi i tyre ishte kryengritja e armatosur popullore jo vetëm në Kosovë por edhe në Maqedoni dhe në viset e banuara me shqiptarë në pjesën jugore të Serbisë.⁹⁵ Ç'është interesante, LKÇK-ja bashkëpunoi me qeverinë e Bukoshit në ekzil, e cila i dha asaj përkrahje financiare.⁹⁶

LKÇK-ja i vazhdoi aktivitetet e saj klandestine në Kosovë gjatë viteve 1990 dhe më vonë i bashkoi forcat me UÇK-në. Në maj të vitit 2000, LKÇK-ja, së bashku me disa parti tjera të vogla, vendosi t'i bashkangjitej Ramush Haradinajt, ish-komandant i UÇK-së, në formimin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e cila në atë kohë ishte koalicion. Megjithatë, ky veprim u tregua jetëshkurtër. Ata shumë shpejt e braktisën AAK-në dhe vazhduan si parti e vetme në jetën politike. Në vitin 2008, pas pavarësisë dhe për shkak të rrethanave të reja, partia u nda në dysh. Një grup e formoi *Lëvizjen për Integrim dhe Bashkim* (LIB), derisa të tjerët të udhëhequr nga Avni Klinaku formuan *Lëvizjen për Bashkim* (LB). Pak para zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010, LB-ja iu bashkua *Vetëvendosjes!* në një koalicion parazgjedhor. Në tetor të vitit 2010, pas pohimeve se *Vetëvendosje!* kishte marrë më shumë se që i takonte nga fondi për partitë politike, LB-ja e braktisi *Vetëvendosjen!* Aktualisht, kjo lëvizje ka dy ulëse në parlamentin e Kosovës.

UÇK-së iu deshën gati katër vite për të dalë në publik. Ajo bëri paraqitjen e parë të saj zyrtare në varrimin e Halit Gecit më 28 nëntor 1997, në ditën e festës kombëtare shqiptare. Halit Geci ishte mësues të cilin e kishin vrarë policia serbe në fshatin e Llaushës. Tek varri i tij, tre burra të armatosur dhe në uniformë mbajtën një fjalim të shkurtër duke shpjeguar synimet e luftës së tyre. Ata ishin Rexhep Selimi, Mujë Krasniqi dhe Daut Haradinaj. Ata poashtu shfrytëzuan rastin të denoncojnë pohimet e LDK-së se rezistenca e armatosur ishte krijesë e forcave serbe të sigurimit e cila synonte ta zhvlerësonte politikën e rezistencës paqësore.⁹⁷

94 Intervistë e IKS me Avni Klinakun, Prishtinë, 16 Shkurt 2011.

95 Intervistë e IKS me Liburn Aliun, Prishtinë, 1 Shkurt 2011. Sipas Aliut, bashkëpunimi me përfaqësuesit politik shqiptarë të Maqedonisë nuk ishte aq i mirë; në anën tjetër, bashkëpunimi me Shqipërinë ishte "shumë i mirë." Liburn Aliu është njëri ndër themeluesit e *Lëvizjes Vetëvendosje* dhe aktualisht deputet në Kuvendin e Kosovës.

96 Intervistë e IKS me Liburn Aliun, Prishtinë, 1 Shkurt 2011.

97 Intervistë e IKS me Daut Haradinajn, Prishtinë, 11 Maj 2011. Haradinaj i referohet kryesisht së atëherëshme të Kosovës të udhëhequr nga Ibrahim Rugova. Politika e Rugovës ndaj shfaqjes së UÇK-së, në rastin më të mirë, ishte e paqartë. Ai në fillim hezitonte ta njihje ekzistencën

Paraqitja e UÇK-së do ta transformonte rrënjësisht skenën politike kosovare. Së pari, ajo ishte sfida e parë serioze dhe e hapur ndaj autoritetit të LDK-së dhe politikës së rezistencës pasive. Së dyti, trashëgimia e saj politike janë partitë politike që dolën nga gjiri i saj pas përfundimit të luftës, PDK-ja që qeveris sot me Kosovën, dhe AAK-ja. Megjithatë, fillimet e UÇK-së nuk ishin aq premtuese. Në fakt, në janar të vitit 1998, UÇK-ja nuk kishte më tepër se 350 ushtarë.⁹⁸ Rexhep Selimi, njëri prej komandantëve të Drenicës, thotë që në vitin 1997 organizata kishte vetëm 100 pjesëtarë. Selimi poashtu thotë që në fund të vitit 1998, UÇK-ja kishte 10,000 pjesëtarë të armatosur.⁹⁹ Ka të dhëna kundërtëse rreth numrit të saktë të pjesëtarëve të armatosur si dhe për strukturën e saj komanduese. Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG) thotë që para demilitarizimit të saj në shtator të vitit 1999, UÇK-ja kishte rreth 10,000 pjesëtarë të regjistruar.¹⁰⁰

Financimin e UÇK-së e organizonin përfaqësues në vende të jashtme nën fondin *Vendlindja Thërret*. Me seli në Zvicër, Jashar Salihu ishte personi kyç për mbledhjen e fondeve, derisa kjo detyrë që nga viti 1997 në SHBA i ishte deleguar Florin Krasniqit.¹⁰¹ Brenda një periudhe prej katër muaj e gjysmë, Krasniqi kishte mbledhur gjysmë milioni dollarë. Kur në mars të vitit 1998, forcat serbe kishin rrethuar Prekazin dhe kishin vrarë Adem Jasharin dhe më tepër se 50 anëtarë të familjes së tij të gjerë, shqiptarët në Nju Jork organizuan një protestë para selisë së Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ku morën pjesë rreth 2,000 vetë. Njerëzit menjëherë filluan të interesohen për Adem Jasharin dhe për UÇK-në misterioze anëtarë i së cilës kishte qenë vetë Jashari. Vetëm atë pasdite, Krasniqi mbledhi \$280,000. Në pjesët tjera të SHBA-ve, shqiptarët filluan të mbledhnin para dhe t'ia dërgonin atij.¹⁰²

Gjatë dhe pas luftës, UÇK-ja arriti të projektojë në publik imazhin e një grupi të disiplinuar dhe të organizuar. Kjo megjithatë nuk e pasqyrore të vërtetën. Në realitet, UÇK-ja ishte përplot grindje politike, personale dhe rajonale dhe u tregua e dobët në trajnimin e vullnetarëve. Shumë njerëz u ankuan se

e saj duke thënë se në rast të kryengritjes së armatosur, e jo luftës, serbët do të kryenin masakra në mesin e shqiptarëve të Kosovës.

98 Howard Clark, *Rezistenca Civile në Kosovë*. Londër: Pluto Press, 2000. f.173.

99 Intervistë e IKS me Rexhep Selimin, Prishtinë, 23 Shkurt 2011.
100 Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG). *Dhuna në Kosovë: Kush po e vret kënd?* Prishtinë/Londër/Uashington: ICG, 2 Nëntor 1999.

101 Tim Judah, *Kosova: Lufta dhe Hakmarrja*. Yale. Yale University Press, 2002. f.127.

102 Stacy Sullivan, *Mos krij frikë, se i ke djemtë në Amerikë: Si e futi pul-lazxhin Amerikën në luftë në Kosovë* (Be Not Afraid, For You Have Sons in America: How a Brooklyn Roofer Helped Lure the US into the Kosovo War). Prishtinë. KOHA, 2004. ff.204-205.

ishin lënë të vetëm në fshatrat e varfra të Shqipërisë veriore.¹⁰³ Megjithatë, UÇK-ja u tregua shumë e suksesshme në arritjen e synimeve të saj dhe dukej se kishte ardhur në momentin e duhur si pasojë e disa rrethanave. Njëra prej rrethanave më të rëndësishme ishte kolapsi i vitit 1997 në Shqipëri, me ç'rast u krijua mundësia për blerjen e armëve.

Në të njëjtën kohë, gjatë periudhës 1997-1998, UÇK-së iu bashkuan edhe shumë anëtarë të zhgënjyer të LDK-së. I bindur që UÇK-ja po i'a merrte popullaritetin dhe autoritetin e tij, Rugova bëri thirrje për zgjedhje parlamentare dhe presidenciale më 22 mars 1998, zgjedhje këto që tashmë ishin shtyrë disa herë. Diplomatët amerikan me sukses e bindën Rugovën të takohej me Millosheviqin për çka ai pastaj do të shpërblehej me një takim me presidentin Bill Clinton. Në atë kohë, Rugova tashmë e kishte themeluar grupin e tij negociator të quajtur G-15, por anëtarët e tij që përfshinin politikanë të LDK-së, udhëheqës të dikurshëm komunist dhe opinionistë, ishin lënë në hije.¹⁰⁴

Përkrahja për UÇK-në u rrit shumë kur Richard Holbrooke, i dërguari special amerikan, qoftë rastësisht apo me qëllim pranoi të fotografohej me komandantë të UÇK-së, gjatë një vizite në Junik në qershor të vitit 1998.¹⁰⁵ Një faktor që ndikoi në shumë vende perëndimore ta përkrahnin UÇK-në ishte frika që nëse nuk veprojnë në rastin e Kosovës atëherë mund të përsëritej masakra e vitit 1995 në Srebrenicë të Bosnjës. UÇK-ja nuk zhvilloi luftë totale por përfundimisht arriti ta bindte NATO-n të intervenonte, duke e siguruar kështu fitoren.

Në ndërkohë, lindi nevoja për ndryshim e strukturës së organizatës për shkak të zgjerimit të zonës nën kontrollin e UÇK-së në Drenicë në vitin 1998 si dhe për shkak të fluksit të vullnetarëve. Tash duhej trajtuar mungesa e krahut politik meqë LPK-ja nuk mund ta kryente më këtë funksion. Në mars

të vitit 1998, Hashim Thaçi u emërua drejtor për informim publik, Kadri Veseli shef i inteligjencës dhe Jakup Krasniqi në postin e zëdhënësit.¹⁰⁶ Pak pas kohe, Thaçi do të emërohej shef politik i UÇK-së.

Pranvera dhe vera e vitit 1998, pas masakrës së Jasharajve, ishin vendimtare për UÇK-në. Ajo tash gëzonte përkrahje nga i tërë spektri politik, përveç LDK-së, edhe pse në qershor edhe Rugova e kishte zbutur qëndrimin e tij.¹⁰⁷ Pas takimit të vendeve të Grupit të Kontaktit, që koordinonte tërë ish-Jugosllavinë, më 9 mars u bë thirrja për negociata në mes autoriteteve serbe dhe udhëheqësve shqiptarë.¹⁰⁸ Richard Holbrooke dhe diplomati tjetër amerikan Chris Hill u dërguan për ti bindur kosovarët që të arrijnë konsensus në mënyrë që të fillojnë bisedimet në Beograd. Ideja ishte të formohej Këshilli i Shpëtimit Kombëtar, i cili do të përfaqësonte të gjitha partitë politike, përfshirë edhe UÇK-në.

Në ndërkohë, si pjesë e çuditshme e konfliktit, Adem Demaçi u bë përfaqësuesi politik i UÇK-së në Prishtinën e kontrolluar nga serbët, derisa udhëheqësi studentor Albin Kurti u angazhua për ti ndihmuar atij.¹⁰⁹ Rexhep Qosja bashkoi forcat me ish-anëtarët e tjerë të LDK-së që i ofruan përkrahje të plotë publike UÇK-së. Si rezultat i kësaj, struktura e UÇK-së u bë më e shumëllojshme. Pasi fati ushtarak e kishte braktisur UÇK-në në vjeshtë të vitit 1998, konflikti u zvarrit derisa vendet e jashtme po bënin përpjekje për ta arritur një zgjidhje paqësore.

Bashkësia ndërkombëtare po e humbte durimin me Millosheviqin, posaçërisht për shkak të përvojës me të në rastin e Kroacisë dhe Bosnjës. Tashmë dukeshin shenjat e para që NATO po brengosej gjithnjë e më tepër me nivelin e shtuar të dhunës dhe me përshkallëzimin e dhunës dhe përkeqësimit e gjendjes në terren. NATO i bëri kërcënimet e saj të para në vjeshtë.¹¹⁰ Pastaj, filloi zbankimi i operacionit të paarmatosur të OSBE-së, me 2,000 pjesëtarë, i quajtur Misioni i Verifikimit për Kosovën (KVM), i udhëhequr nga amerikani William Walker. Ky mision kishte rol të kufizuar dhe përfshinte negociatat për lirin e të burgosurve serbë të UÇK-së.

103 Uk Lushi, *Shqiptaro-Amerikanët e UÇK-së*. Prishtinë. KOHA, 2009. Tim Judah, *Kosova: Lufta dhe Hakmarrja*. Yale. Yale University Press, 2002.

104 Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG), *Vera e Gjatë e Kosovës*: njoftim mbi zhvillimet ushtarake, humanitare dhe politike në Kosovë, 2 Shtator 1998. Në realitet, grupi ishte G-13, pasi që Bukoshi ishte në Gjermani dhe Demaçi refuzonte të merrte pjesë në një mekanizëm të udhëhequr nga Rugova. Përveç kësaj, sipas dëshmvite të anëtarëve, ata e shihnin vetën si negociatorë por Rugova i shihte ata si "grup këshill-dhënës." Në maj të vitit 1998, Hydadjet Hyseni, ish-zëvendës i Rugovës në LDK, dhe Bujar Dugolli, përfaqësues studentor, e braktisën grupin. Me 13 gusht 1998, Rugova prezantoi një grup të ri negociatorësh, tash të quajtur G-5, i cili përveç Fehmi Aganit përfshinte "përkrahës të flaktë të Rugovës."

105 Vizita e Holbrookut erdhi pas komenteve të para të sekretares amerikane të shtetit Madeleine Albright dhe të dërguarit të posaçëm amerikan Robert Gelbard të cilët e quajtën UÇK-në "grup terrorist." Kjo vizitë ishte poashtu sinjal i fortë që administrata amerikane de fakto e njihje UÇK-në, gjë që rezultoi edhe me pjesëmarrjen e saj në Konferencën e Rambujesë gjashtë muaj më vonë.

106 Intervistë e IKS me Rexhep Selimin, Prishtinë. 26 Tetor 2011.

107 Që atëherë, kredibiliteti i Rugovës u komprometua edhe më tepër nga refuzimi i tij për ta njohur publikisht ekzistimin e UÇK-së. Ai iu afrua më së shumti kësaj më 19 qershor 1998, kur gjatë një konference për shtyp pas kthimit nga vizita në Uashington, D.C., deklaroi: "Ato janë grupe të qytetarëve të rëndomtë, të cilët po përpiqen ti mbrojnë shtëpitë e tyre. Por ne do të sigurohemi që këto grupe të jenë nën kontroll dhe të japin përgjegjësi për gjendjen."

108 Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG). *Vera e Gjatë e Kosovës*: Njoftim mbi zhvillimet ushtarake, humanitare dhe politike në Kosovë. Prishtinë. ICG, 2 Shtator 1998.

109 Udhëheqësi dhe themeluesi i *Lëvizjes Vetëvendosje*.

110 Për më tepër shih: ICG *Pranvera e Kosovës*, 20 Mars 1998 dhe ICG *Vera e Gjatë e Kosovës*: Njoftim mbi zhvillimet ushtarake, humanitare dhe politike në Kosovë. 2 Shtator 1998.



HASHIM THAÇI

24 PRILL 1968,
BROJË, SKENDERAJ

Filloi karrierën e tij në vitin 1989, në Lëvizjen Popullore të Republikës së Kosovës (LPRK). Ishte udhëheqës i shquar i lëvizjes studentore të viteve 1989–1993. Në vitin 1991, Thaçi u zgjodh prorektor student i Universitetit të Prishtinës, ku regjistroi studimet në Departamentin e Historisë. Më pas, Thaçi vazhdoi studimet në Universitetin e Cyrihut, Zvicër, deri në vitin 1998.

Thaçi, besohet të jetë një nga themeluesit e UÇK-së në vitin 1993. Në vitin 1997 ai u dënua me burgim në mungesë nga gjykatat jugosllave. Në vitin 1998, Hashim Thaçi u bë kreu i Drejtorisë Politike të UÇK-së. Në vitin 1999, Thaçi kryesoi delegacionin e UÇK-së në Konferencën e Rambujesë dhe u bë një nga katër nënshkruesit e dokumentit. Në mars të vitit 1999, Thaçi u bë Kryeministër i Qeverisë së Përkohshme, që zgjati deri në vendosjen e SPPA-së në janar të vitit 2000.

Në periudhën e pas luftës, Thaçi i'u bashkua Këshillit tranzicional të SPPA-së, e cila ishte thelbësore në përpilimin e detajuar të elementeve të institucioneve të

shtetit të ri. Thaçi nënshkroi marrëveshjen për demilitarizimin e UÇK-së dhe e transformoi atë në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Menjëherë pas kësaj, Thaçi u bë udhëheqës i PDK-së. Pas zgjedhjeve të vitit 2001, të cilat PDK nuk fitoi, LDK-ja kundërshtoi kandidaturën e tij për kryeministër dhe Bajram Rexhepi u emërua si kandidat kompromisi. Në vitin 2007, megjithatë, ai u emërua Kryeministër i Kosovës, post ky që e mban ende. Gjatë mandatit të tij, Kosova shpalli pavarësinë në vitin 2008.

Karriera politike e Hashim Thaçit, pas-luftës, është lënë nën hije të akuzave të vazhdueshme për përgjegjësitë e tij për krimet e kryera nga UÇK-ja. Ish-prokurori i shtetit Zvicran nga kantoni i Ticinos dhe anëtar i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Dick Marty, haptas e akuzonin atë për lidhjet e tij me mafian e trafikimit të organeve, gjatë luftës në Kosovë, në vitin 1999. Sidoqoftë, akuzat e filla mbeten të paprovuara. Kohëve të fundit EULEX-i formoi një grup pune për të hetuar akuzat e paraqitura në raportin e Martit.

Në shkurt të vitit 1999, shqiptarët dhe serbët u ftuan në kështjellën franceze të Rambujesë në përpjekje të fundit për të arritur marrëveshje. Konferenca dështoi. Më 24 mars, NATO nisi fushatën e bombardimeve kundër Serbisë që do të zgjaste 78 ditë dhe do të çonte në humbjen dhe tërheqjen e forcave serbe.

Shou i një njeriu – PDK

Hashim Thaçi, i njohur me nofkën “Gjarpri,” hyri në Prishtinë në këmbë pak pas zbarkimit të forcave të NATO-së në qershor të vitit 1999. Ai shoqërohej nga Veton Surroi, botuesi i *Koha Ditore*, i cili kishte marrë pjesë në Konferencën e Rambujesë dhe ishte njëri ndër katër nënshkruesit e dokumentit. Thaçi, i parë si yll në ngritje, ishte përkrahur nga *Koha Ditore* në vitin 1998 dhe do të vazhdonte të përkrahej edhe menjëherë pas luftës.¹¹¹

111 Baton Haxhiu në atë kohë ishte kryeredaktor në *Koha Ditore*, ndërsa Dukagjin Gorani është njëri prej redaktorëve. Haxhiu aktualisht

Periudha e Rambujesë shënoi zenitin e unitetit të shqiptarëve të Kosovës, por edhe atëherë kishte shumë pak unitet. Marrëveshje e arritur në Rambuje për formimin e qeverisë së unitetit pas përfundimit të luftës, që do të përfshinte LDK-në dhe UÇK-në, nuk u realizua kurrë. Menjëherë pas luftës, UÇK-ja mori kontrollin në terren derisa LDK-ja pohonte që qeveria e përkohshme e PDK-së nuk gëzonte përkrahje. UÇK-ja e denoncoi LDK-në në mënyrën e njëjtë. Sipas Rexhep Qosjës, gjendja ishte aq serioze saqë shumë lehtë mund të ketë eskaluar në luftë civile.¹¹²

Në korrik të vitit 1999, një grup i ish-anëtarëve të UÇK-së themeluan një parti të re politike të quajtur *Partia për Bashkim Demokratik* (PBD).¹¹³ Slogani i tyre

është udhëheqës i Klan Kosova dhe besohet të jetë i afërt me Hashim Thaçin. Dukagjin Gorani është këshilltar i Thaçit për çështje të sigurisë.

112 Intervistë e IKS me Rexhep Qosjën. Prishtinë, 23 Shkurt 2011.

113 Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG). Kush është Kush në Kosovë. Prishtinë: ICG, 31 Gusht 1999. E.3.

ishite “Mendo për të ardhmen, mos e harro luftën.” Në mesin e themeluesve të saj ishin Bardhyl Mahmuti, i cili e kishte përfaqësuar UÇK-në në Zvicër, Jakup Krasniqi dhe Shaban Shala. Figura tjera të njohura ishin Jashar Salihu, i cili kishte udhëhequr me Fondin Vendlindja Thërret në Zvicër, Azem Syla dhe Pleurat Sejdiu, përfaqësues i UÇK-së në Londër.¹¹⁴ Përkundër historisë së tyre, udhëheqësit e saj mohonin që partia e tyre përfaqësonte UÇK-në. Në fakt ata kundërshtonin idenë e themelimit të një partie e cila do ta përfaqësonte UÇK-në, duke thënë që UÇK-ja kishte qenë lëvizje e gjerë e cila përfaqësonte rezistencën e të gjithë kosovarëve, gjë që PBD-ja nuk pohonte ta bënte.¹¹⁵ Thaçi nuk ishte në mesin e këtij grupi.

Disa muaj më vonë, udhëheqësit e PBD-së arritën marrëveshje me Thaçin. Me 10 tetor 1999, ata së bashku formuan *Partinë për Progres Demokratik në Kosovë* (PPDK). Kjo parti, në fakt, ishte pasardhësja e drejtpërdrejt e drejtorisë politike të UÇK-së. PPDK mbajti këtë emër deri në kongresin e parë të partisë i cili u mbajt në qershor të vitit 2000, kur mori emrin *Partia Demokratike e Kosovës* (PDK).¹¹⁶ Thaçi u zgjodh kryetar i partisë. PDK-ja themeloi 32 degë rajonale, kryesinë qendrore, si dhe forumin e rinisë dhe forumin e gruas.¹¹⁷

PDK-ja kishte marr pozitën e trashëgueses të natyrshme politike të UÇK-së. Ajo supozonte se kjo do t'i mjaftonte në zgjedhjet e para lokale në tetor të vitit 2000, nën patronazhin e UNMIK-ut. Kjo llogaritje u tregua e gabuar. LDK-ja i fitoi zgjedhjet. Bajram Rexhepi, figurë udhëheqëse e PDK-së dhe ish-anëtar i UÇK-së, thotë se gabimi i tyre kryesor kishte qenë përjashtimi i atyre që mendonin se partia duhej të kishte strategji politike. Apo me fjalë tjera, që trashëgimia e lavdishme nuk ishte e mjaftueshme. Në vend të kësaj, partia kishte menduar vetëm për ish-anëtarë të UÇK-së dhe kjo “ishite tërësisht e gabueshme.”¹¹⁸

PDK-ja megjithatë e kishte edhe një problem tjetër. Reputacionin e saj e kishin goditur mjaft keq aktet kriminale shumica e të cilave ishin kryer nga persona që ishin apo pohonin që ishin anëtarë të UÇK-së, gjatë periudhës kaotike pas përfundimit të luftës. Përveç sulmeve hakmarrëse dhe vrasjes së

serbëve dhe romëve, ata poashtu zaptuan prona dhe sulmuan e madje supozohet se edhe vranë zyrtarë të LDK-së.¹¹⁹ Hetimet e policisë, edhe pse të pakta në atë kohë, nuk gjetën dëshmi për përfshirjen e anëtarëve të PDK-së në këto krime, por prapavija politike e këtyre akuzave nuk vihej në dyshim.¹²⁰

LDK-ja ishte bindshëm partia më e madhe në skenën politike të pasluftës. Ajo megjithatë humbi përkrahjen e dikurshme meqë shumica e kosovarëve e fajësonin moralisht për pasivitetin e saj gjatë luftës dhe e dënonin Rugovën për takimin e tij me Millosheviqin në Beograd gjatë bombardimeve të NATO-s. Në anën tjetër, mendimi se disa ish-udhëheqës të UÇK-së ishin të përfshirë në krim të organizuar dhe në kërcënimin e kundërshtarëve politikë, i largoi shumë votues në drejtim të partisë me reputacion “më të civilizuar.”¹²¹

Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, LDK-ja pësoi rënie prej afro 10 përqind, apo rreth 39,000 vota. Në anën tjetër, PDK-ja e Thaçit me sukses arriti ta rrisë numrin e përgjithshëm të votave me afro 8 përqind apo me 15,000 vota.¹²²

Ky rezultat zgjedhor nënkuptonte që qeveria e Kosovës duhej të ishte koalicion në mes të dy partive kryesore. Marrëveshja u arrit pas përpëlitjeve disamujore. Më 4 mars 2002, katër muaj pas zgjedhjeve, u formua qeveria dhe Bajram Rexhepi i PDK-së u zgjodh kryeministër. Rexhepi shihej si figurë e moderuar në mesin e ish-anëtarëve të UÇK-së. Përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare në përgjithësi ishin kundër Thaçit, duke besuar se në ofitë se ai emërohej kryeministër kjo vetëm do ta acaronte më tej armiqtë e LDK-në.

Pas zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 2004, PDK-ja doli në opozitë. Ajo megjithatë formoi të ashtuquajturën “qeveri në hije.” Ky ishte projekt ofanziv nëpërmjet të cilit PDK-ja e kritikonte punën e qeverisë. Bajram Rexhepi kujton se kjo ishte pjesë e strategjisë së PDK-së për të shfrytëzuar ndryshimet politike dhe ndarjet brenda partive të tjera, posaçërisht brenda LDK-së, për të dhënë partisë “avantazh për fitore në zgjedhjet e ardhshme.”¹²³

119 OKB, Letër me datë 24 Tetor 2000 nga Sekretari i Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit, 25 Tetor 2000.

120 Human Rights Watch. HRW Backgrounder. Tetor 28, 2000. Zgjedhjet Komunale në Kosovë.

121 Clem S. Watkins. *Balkanin*. Nju Jork. Nova Science Publishers, 2003. f.39.

122 Rezultatet zgjedhore të OSBE-së ofruar nga Komisioni Qendror Zgjedhor; krahasim në mes zgjedhjeve lokale 2000 dhe zgjedhjeve të përgjithshme 2001.

123 Pika kthesë për PDK-në ishte krijimi i të ashtuquajturës qeveri në hije. Shumë këshilltarë ndërkombëtarë e përkrahën këtë strategji. PDK-ja kishte marrëdhënie shumë të mira me Partinë e Punës në Britani. Rexhepi thotë që PDK-ja ishte në pozitë të fortë sepse kishte ekspertë në shumë fusha të cilët e kritikonin qeverinë dhe propozonin strategji të reja.

114 Bardhyl Mahmuti është anëtar i Bashkimi Demokratik Shqipëtar (BDSH) në Maqedoni, Jakup Krasniqi është Kryetar i Kuvendit, Azem Syla është deputet në Kuvend, Shaban Shala është pjesëtarë i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Pleurat Sejdiu është zyrtar pranë Ministrisë për Integritim Evropian dhe Jashar Salihu ka ndërruar jetë.

115 Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG). *Kush është Kush në Kosovë*. Prishtinë. ICG, 31 Gusht 1999. f.3.

116 Intervistë e IKS me Jakup Krasniqin, Prishtinë, 10 Mars 2011.

117 Intervistë e IKS me Ramadan Gashin, kryetar i degës së PDK-së në Skenderaj. Skenderaj, 29 Mars 2011.

118 Intervistë e IKS me Bajram Rexhepin, Prishtinë. 7 Qershor 2011.



JAKUP KRASNIQI

1 JANAR 1951,
DRENAS/ GLLOGOVÇ

Krasniqi përfundoi shkollimin e mesëm në qytetin e tij në Drenicë para se të diplomohej në Fakultetin Filologjik në Universitetin e Prishtinës, në degën e Historisë në vitin 1976. Ai u bë mësues dhe vazhdoi në këtë rrugë karrierën e tij deri në vitin 1981. Gjatë asaj kohe, ai ishte i përfshirë fshehurazi në grupe ilegale si Organizatat marksiste-leniniste. Në vitin 1981 ai ka luajtur një rol aktiv në trazira dhe u dënua me dhjetë vjet burgim.

Pas lirimimit në vitin 1991, Krasniqi u kthye për të dhënë mësim në Drenas, ku punoi në një shkollë deri në vitin 1994. Ishte ajo kohë kur Krasniqi iu bashkua Kryesisë LDK-së dhe kryesoi degën e saj në Drenas nga viti 1991-1998. Ai u zgjodh deputet në Parlamentin e parë të Kosovës 1992-1998. Në vitin 1998, ai u bë zëdhënës i UÇK-së dhe mori pjesë në Konferencën e Rambujesë.

Pas luftës, Krasniqi u emërua Ministër për Rindërtim dhe Zhvillim në Qeverinë e Përkohshme. Në vitin 2000 ishte një nga themeluesit e PDK-së. Në vitin 2002, ai u emërua Ministër i Shërbimeve Publike. Në vitin 2007 ai u zgjodh kryetarë i Parlamentit të Kosovës. Ai e mbajti këtë post deri pas zgjedhjeve të vitit 2010. Në periudhën kur Fatmir Sejdiu dha dorëhaje, Krasniqi ishte presidentit i përkohshëm.

Kohëve të fundit, Krasniqi e ka bërë emrin e tij si anëtar i fraksionit anti-Thaçi në PDK dhe njihet për deklaratat e tij dhe sjelljet kontraverse. Si kryetar i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm i PDK-së haptazi kundërshtoi kandidaturën e Behgjet Pacollit për president të Kosovës përkundër faktit që partia e tij ka hyrë në koalicion me AKR-në.

Në zgjedhjet e vitit 2004, LDK-ja fitoi 45 përqind të votave dhe u fut në koalicion me AAK-në e udhëhequr nga Ramush Haradinaj, ish-komandant i UÇK-së, e cila kishte fituar 8.3 përqind të votave. Haradinaj u bë kryeministër por tre muaj më vonë u akuzua për krime lufte nga Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë. Haradinaj dha dorëheqje dhe u nis për në Hagë. Atë e zëvendësoi në fillim Bajrami Kosumi i AAK-së dhe më vonë Agim Çeku, atëherë figurë jopartiake por udhëheqës i njohur i UÇK-së. Të dy ishin figura të respektuara por meqë nuk kishin bazën e tyre të pushtetit e kishin të vështirë ta impononin autoritetin e tyre.

Momenti i PDK-së erdhi pas vdekjes së Rugovës më 21 janar 2006. Grindjet brenda LDK-së, dhe krijimi i LDD-së, e dobësoi partinë aq shumë sa që në zgjedhjet e nëntorit 2007, PDK-ja më në fund u bë partia e parë në Kosovë. Megjithatë, kjo nuk erdhi si rezultat i rritjes së votave të PDK-së, por falë rënies së përkrahjes për LDK-në. Në janar të vitit 2008, vetëm një muaj pas shpalljes së pavarësisë, Hashim Thaçi u bë kryeministër i qeverisë së koalicionit me LDK-në.

Ylli fatlum i UÇK-së po shkëlqente fortë për Hashim Thaçin. Durimi i tij gjatë kohës në opozitë

ishte shpëguar. Kështu fati e zgjodhi atë ta lexonte deklaratën e hartuar nga amerikanët për shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008. Vdekja e Rugovës dhe qëndrimi i Haradinajt në Hagë u dëshmuan shumë të përshtatshme për Thaçin. Por nuk ishte vetëm fati që favorizonte Thaçin dhe PDK-në.

Strategjia e PDK-së gjatë fushatës parazgjedhore të vitit 2007 ishte të përfshinte individë nga shoqëria civile dhe bota akademike në përpjekje për ta ndryshuar imazhin e saj prej partisë maço të përbërë nga ish-pjesëtarë të UÇK-së. Futjet e reja përfshinin Hajredin Kuçin, Enver Hoxhajn, Vlora Çitakun dhe Memli Krasniqin, të cilët më vonë do të merrnin poste ministrore.¹²⁴ Megjithatë, ndryshimet në nivelin e qeverisë nuk pasqyronin plotësisht ngjarjet brenda partisë. Nga nëntë anëtarë të kryesisë së PDK-së, vetëm tre nuk kishin qenë anëtarë të UÇK-së. Shpjegimi për këtë ishte që PDK-ja nuk kishte mjaft fytyra të reja edhe për qeverinë edhe për partinë. Siç kujton Rexhepi, “u bë e qartë që përkushtimi jonë

124 Kryeministri Thaçi ka caktuar rreth vetes emra të rinj të cilët kanë shumë pak lidhje me UÇK-në apo me grupet e tjera ilegale. Këshilltarët e tij politik janë: Bekim Çollaku, shef i stafit, Lirim Greiçevci, Dhurata Hoxha, Mrika Kotorri, Fadil Hysa, Dukagjin Gorani, Ismail Sylja dhe Blerim Latif.



FATMIR LIMAJ

4 SHKURT 1971,
MALISHEVË

Ai ishte i përfshirë në lëvizjen ilegale që në moshë të re. Ai u bë komandant i operacioneve të UÇK-së në Zonën e Llapushnikut gjatë luftës në Kosovë. Menjëherë pas kësaj, Limaj i'u bashkua PDK-së. Në vitin 2003 ai u arrestua nga KFOR-i dhe u akuzua për krime lufte nga Tribunali e Hagës ku edhe u gjykua. Limaj u akuzua për krime të kryera kundër civilëve serbë dhe shqiptarë, si dhe ndaj të burgosurve ushtarak serb dhe ndaj oficerëve të policisë në vitin 1999. Megjithatë, në vitin 2005 ai u shpall i pafajshëm dhe u lirua. Deri para pak kohësh, Limaj konsiderohej dora e djathtë e Thaçit. Në zgjedhjet e vitit 2007, ai ishte personi i dytë më i votuar në mesin e politikanëve në të gjithë Kosovën. Në zgjedhjet lokale të vitit 2009, Fatmir Limaj kandidoi për kryetarë të Prishtinës por humbi garën nga Isa Mustafa i cili më vonë u bë kreu

i LDK-së. Pas kësaj, Limaj u emërua Ministër i Postës dhe Telekomunikacionit, departament ky që kishte buxhetin më të madh ndërministror. Gjatë mandatit të tij si ministër, Limaj mbikqyri ndërtimin e 1.300 kilometrave rrugë.

Që nga viti 2010 Limaj akuzohet për korrupsion dhe krime të luftës dhe aktualisht është nën hetime nga EULEX-i. Në zgjedhjet e vitit 2010, Limaj ishte personi i dytë më i votuar në mesin e politikanëve të PDK-së. Megjithatë, në vitin 2011 një gjykatës i EULEX-it konfirmoi aktakuzën ku e akuzon Limajn për krime lufte. Kreu i parlamentit ishte në anën e Limajt dhe refuzoi t'ia heqë imunitetin për ndjekje penale. Aktualisht, Fatmir Limaj është nën arrest shtëpiak dhe duke kaluar nëpër shqyrtim gjyqësor lidhur me krimet e luftës në të ashtuquajturin rasti Kleçka.

ndaj partisë nuk ishte i njëjtë si më parë.¹²⁵ Me fjalë të tjera, kur bëhej fjalë për freskimi të imazhit, qeveria vinte në rend të parë.

Prandaj, kryesia e partisë ka mbetur pak a shumë e njëjtë.¹²⁶ Për dallim nga kjo, lista e deputetëve të zgjedhur në vitin 2010 ka pësuar ndryshime rrënjësore, vetëm 10 nga 34 deputetë janë të njëjtit që kanë shërbyer në legjislativin e kaluar.¹²⁷ Mirëpo, fytyrat miqësore dhe të buzëqeshura nga shoqëria civile dhe bota akademike nuk ishin risia e vetme e partisë. Në vitin 2010, disa ish-anëtarë të supozuar të asaj që njihet si SHIK, shërbimi inteligjent i UÇK-së, dhe pastaj i PDK-së, poashtu fituan ulëse në parlament.¹²⁸ Në vitin 2007, pesë kandidatët e parë të partisë, në kuptim të votave të fituara, ishin pjesëtarë të dikurshëm të UÇK-së. Në vitin 2010, ky numër u rrit në shtatë, përfshirë këtu edhe disa ish-anëtarë të SHIK-ut.

125 Intervistë e IKS me Bajram Rexhepin, Prishtinë. 7 Qershor 2011.

126 Kryesia e PDK-së përbëhet nga: Hashim Thaçi, kryetar, Jakup Krasniqi, sekretar i përgjithshëm, Fatmir Limaj, nënkryetar, Rrustem Mustafa, Bajram Rexhepi, Hajredin Kuçi, Enver Hoxhaj, Fehmi Mujota, Berat Luzha.

127 Adem Grabovci, Jakup Krasniqi, Xhavit Haliti, Safete Hadërgjonaj, Nait Hasani, Flora Brovina, Arsim Bajrami, Hydajet Hyseni, Fatmir Limaj dhe Sala Berisha.

128 Disa kanë konfirmuar publikisht se kanë qenë anëtarë të SHIK-ut, siç janë: Bekim Haxhiu – Kamishi, Latif Gashi, Fatmir Xhelili dhe Fadil Demaku.

Procesi i vendimmarrjes në PDK ishte bërë më i vështirë dhe nuk mund të karakterizohet më si shou i udhëhequr nga një njeri. Vendimi i Thaçit në vitin 2011 për tu futur në koalicion me Aleancën Kosova e Re (AKR), të udhëhequr nga Behgjet Pacolli, manjat i shndërruar në politikan, u kritikua ashpër dhe hapur nga anëtarët e lartë të partisë. Fatmir Limaj, komandant i njohur i UÇK-së, e kritikoi vendimin për arritjen e këtij koalicioni, duke thënë se Thaçi e kishte marr vendimin krye në vete duke e injoruar mendimin e kolegëve të tjerë të partisë. Limaj nuk ishte i vetmi që e kritikonte këtë vendim.¹²⁹ Jakup Krasniqi, kryetar i Parlamentit të Kosovës, poashtu vuri në pah mungesën e vendimmarrjes demokratike brenda PDK-së: “Ne mund të shohim shenja të totalitarizmit në PDK, si dhe në partitë e tjera politike. Demokracia dhe debati në PDK janë ngulfatur.”¹³⁰

Shumë, përfshirë këtu edhe vet Thaçin, e shohin Limajn dhe Krasniqin si rivalë të mundshëm në

129 Limaj e konfirmoi qëndrimin e tij në ditën kur u votua për Presidentin në kuvend. Pas seancës parlamentare, Limaj publikisht deklaroi që ai kishte votuar kundër Pacollit, kandidatit të vetëm për president. Në një debat televiziv, Limaj argumentoi që me vetëm dy përqind të votave Pacolli as që duhet të merret parasysh për postin e presidentit. Ai poashtu shtoi që Pacolli akoma nuk e kishte dëshmuar “dashurinë e tij për Kosovën.” Klan Kosova, Zona e Debatit; 20 Shkurt 2011.

130 Jakup Krasniqi intervistuar me Adriatik Kelmendin, Rubikon, KTV. 23 Shkurt 2011



AGIM ÇEKU

29 TETOR 1960,
QYSHK, PEJË

Karrierën e filloi në ushtrinë jugosllave (JNA) menjëherë pas mbarimit të shkollës. Ai mori pjesë në akademitë ushtarake në Beograd dhe Zadar. Gjatë luftërave të Jugosllavisë ai i shërbeu ushtrisë të sapoformuar kroate. Gjatë luftës, ai u gradua në nivele më të lartë në ushtrinë kroate. Në të njëjtin vit, Çeku u plagos rëndë në betejë. Pavarësisht nga plagët e tij Çeku u emërua Shef i Shtabit të Qarkut Ushtarak të Gospiqit në vitin 1995, dhe ishte në komandë gjatë operacionit “Oluja” (Stuhia), që çoi në çlirimin e Krajines nga okupimi serb. Deri në Marrëveshjen e Dejtonit të vitit 1995, Çeku ka vazhduar të marrë pjesë në operacionet ushtarake në Bosnje dhe Hercegovinë.

Në vitin 1999, Agim Çeku iu bashkua UÇK-së dhe u bë shef i Shtabit të Përgjithshëm. Pas

demilitarizimit dhe transformimit të UÇK-së, Çeku u emërua Komandant i Përgjithshëm i Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Ai e mbajti këtë post deri kur u emërua kryeministër pas dorëheqjes së Bajram Kosumit. Si kryeministër, ishte pjesë e “Ekipit të Unitetit,” në negociatat me Serbinë mbi të ardhmen e statusit të Kosovës në Vjenë. Pas mandatit të tij si kryeministër, në vitin 2008, Agim Çeku u bashkua me Partinë Social Demokratike të Kosovës (PSDK) dhe shpejt u bë lideri i saj. Në vitin 2010 ai u bashkua me një koalicion parazgjedhor me AKR-në e Behgjet Pacollit dhe u bë Ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

udhëheqje. Me publikimin e mosmarrëveshje të tilla joserioze, bëhet e qartë që udhëheqja e vazhdueshme e Thaçit mbi PDK-në nuk është e garantuar.¹³¹ Limaj dhe Krasniqi madje kanë thënë se Thaçi ka tradhtuar trashëgiminë e UÇK-së, e cila sipas tyre është vetë esenca e partisë. Kjo demonstron trashëgiminë e luftës në krijimin dhe ideologjinë politike të partive të ndryshme. Dy kundërshtarët e rreptë brenda PDK-së u ndien të neglizhuar nga vendimi për tu futur në koalicion me AKR-në dhe mospajtimi i tyre i hapur tregon shenja të çarjeve në mes tyre dhe të tjerëve të cilët Krasniqi i quajti “parashutistë.”¹³²

Derisa Limaj po e sulmonte kryeministrin, kundër tij u hapën hetime për korrupsion si dhe aktakuza për krime luftar ndaj tij u shpall mu në kohën kur përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare po i bënin thirrje PDK-së që të sigurohej se qeveria e saj e re të mos përfshinte persona të dyshuar. Kështu, Limaj ishte njëri prej zyrtarëve të lartë të PDK-së, të cilët nuk morën poste ministrore në qeverinë e shkurtit 2011. Më 28 prill 2010, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit e udhëhequr nga Limaj, dhe shtëpia

131 Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, PDK-ja fitoi 224,339 vota, Hashim Thaçi fitoi 160,850 vota, Fatmir Limaj 75,689 vota dhe Jakup Krasniqi 35,379 vota.

132 Krasniqi i quajti anëtarët e rinj “parashutistë” derisa po fliste për organizimin e brendshëm të PDK-së. Intervistuar nga Adriatik Kelmendi, Rubikon, KTV. 23 Shkurt 2011.

e tij, u bastisën nga policia e EULEX-it.¹³³ Në qeverinë e re, përveç kryeministrit, vetëm dy ministra tjerë kanë lidhje relativisht të dobëta me UÇK-në e vjetër. Të tjerët, përfshirë këtu edhe gjashtë zëvendës kryeministrat, nuk kanë fare lidhje me UÇK-në.¹³⁴

Tash grupe të ndryshme rivale mund të identifikohen brenda PDK-së, parti kjo e cila dikur njihet për disiplinën e saj të brendshme. Në njërin anë, janë ata që i'u bashkuan partisë si rezultat i vendimit të Thaçit për prurje të reja. Ata konsiderohen të jenë besnik ndaj Thaçit më parë se ndaj partisë dhe rradhitën kundër atyre që mendojnë se strategjia e Thaçit për reformimin e partisë është gabim i cili e dëmton ideologjinë e partisë. Grupi i fundit, i mbledhur rreth Fatmir Limajt dhe Jakup Krasniqi, i ka bërë thirrje Thaçit që të sigurohet se partia nuk do të shndërrohet në magnet për oportunistët ambicioz. Megjithatë mbetet e diskutueshme se cila është ideologjia e tyre pas luftës. Sidoqoftë, argumentohet me të drejtë se frika e tyre është që nën udhëheqjen e Thaçit partia po distancohet gjithnjë e më tepër nga vlerat e saj themelore – lufta dhe UÇK-ja.

133 Gazeta ditore Express, *Bastiset Ministria e Transportit*, 29 Prill 2010.

134 Bajram Rexhepi, ministër i punëve të brendshme, ishte mjek në UÇK në rajonin e Shalës, dhe Ramë Buja, ministër i arsimit, shkencës dhe teknologjisë, ishte anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së nga nëntori 1998 deri në prill 1999. Në të njëjtën kohë, ai ishte shef i Drejtorisë për Marrëdhënie me Publikun dhe Administratë Civile të UÇK-së.



RAMUSH HARADINAJ

3 KORRIK 1968,
GLLOGJAN, DEÇAN

Shkollën fillore e kreu në Gjakovë dhe pas shërbimit në ushtrinë jugosllave emigroi në Zvicër, ku punoi një sërë punësh që nga ndërtimtaria e deri tek sigurimi. Ndërkohë iu bashkua LPK-së. Në fund të viteve 1990 i'u bashkua UÇK-së. Gjatë luftës në Kosovë, Haradinaj u emërua komandant i Zonës së Dukagjinit. Ai humbi dy vëllezër në luftë, Luanin dhe Shkelzenin dhe ishte lënduar edhe vetë shumë raste.

Pas luftës dhe pas demilitarizimit dhe transformimit të UÇK-së, ai u bë anëtar i TMK-së deri në vitin 2000. Në të njëjtin vit, Haradinaj themeloi "Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës" (AAK), dhe u përpoq ta poziciononte në mes të dy partive të polarizuara LDK-së dhe

PDK-së. Në atë kohë ai u regjistrua në Universitetin e Prishtinës për të studiuar drejtësinë. Në vitin 2004, Haradinaj hyri në koalicionin me LDK-në e udhëhequr nga Rugova dhe u zgjodh Kryeministër i Kosovës, post ky që e mbajti vetëm për 100 ditë. Në fillim të vitit 2005 ai u detyrua të japë dorëheqje dhe të paraqitet në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (ICTY). Gjatë kohës së tij në parburgim, Haradinaj arriti të magjistrojë në Universitetin Amerikan në Kosovë (AUK). Në vitin 2008 ai u shpall i pafajshëm për shkak të mungesës së provave bindëse dhe u kthye në Kosovë. Në vitin 2010 çështja e tij në Tribunalin e Hagës (ICTY) u rihap dhe Haradinaj është përsëri në pritje të gjykimimit.

Ambicioz dhe Finok – AAK

Në muajin shkurt të vitit 1999, në "shtabin" e UÇK-së në Likoc, në një fshat në mes të Drenicës, komandantët u mbledhën në një takim tejet të rëndësishëm. Udhëheqësit më të lartë politik dhe ushtarak të UÇK-së ishin në Rambuje ndërsa komandantët e tjerë ishin mbledhur për të vendosur se cili do të ishte qëndrimi i tyre rreth përfundimit të konferencës dhe si ta riorganizojnë strukturën e tyre komanduese. Ata e emëruan Sylejman Selimin si udhëheqës në mungesë të Azem Sylës i cili ishte në Rambuje dhe i cili kishte mbajtur atë pozitë deri në atë kohë. Kur delegacioni u kthye nga Franca, u morr vendimi, me konsensus apo ndryshe, që Agim Çeku, ish-oficer në Armatën e Jugosllavisë i cili kishte luftuar në anën e ushtrisë kroate, të emërohej Shef i Shtabit të Përgjithshëm. Kjo ngjarje shënoi hyrjen e Çekut në skenën politike. Pas luftës, ai do të udhëhiqte *Trupat Mbrojtëse të Kosovës* (TMK) dhe më vonë do të bëhej edhe kryeministër i Kosovës në periudhën 2005-2007.

Në verë të vitit 1999, pjesa më e madhe e krahut politik të UÇK-së u organizua në një parti të re politike. Megjithatë, aty nuk u përfshinë të gjithë ata që pohonin se kishin qenë pjesë thelbësore e luftës çlirimtare. Më i zëshmi në mesin e këtyre të fundit ishte Ramush Haradinaj, komandant i UÇK-së në rajonin e Dukagjinit. Njëloj si në takimin e Likocit, Haradinaj nuk hezitoi ta kritikonte drejtorinë politike.

Pas përfundimit të luftës, marrëveshja, e cila me

gjasë ishte arritur në Rambuje, për formimin e qeverisë gjithëpërfshirëse të përkohshme, u prish. Haradinaj nuk ishte përfshirë në këtë qeveri, përkundër faktit që ia kishte bërë të qartë Thaçit dëshirën që të bëhej ministër i mbrojtjes. Derisa Rugova vazhdonte ta përkrahte qeverinë në ekzil të udhëhequr nga Bukoshi dhe qeveria e përkohshme mbështetej në njerëz të afërt me Thaçin, Haradinaj u la jashtë në të *fjohët*. Mirëpo, kjo do të ndryshonte shumë shpejt.

Më 2 maj 2000, Haradinaj themeloi një lëvizje të re, *Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës* (AAK). Fillimisht, ky ishte një koalicion, që përfshinte partinë e tij të vogël *Aleancën Qytetare të Kosovës* (AQK), partitë e tjera të vogla dhe njerëz me të kaluara të ndryshme, përfshirë këtu ish-komunistë, ish-anëtarë të UÇK-së dhe individë të cilët kishin qenë anëtarë të partive të ndryshme politike.¹³⁵ Sipas Grupit Ndërkombëtar të Krizave, Haradinaj e kritikoi PDK-në, partinë më të madhe nga këto dyja që dolën nga gjiri i UÇK-së, për shkak se "pohonte se vetëm ajo kishte maar legjitimitetin mbi trashëgiminë e UÇK-së." Ai poashtu e kundërshtonte ndarjen e skenës politike në mes LDK-së dhe PDK-së.¹³⁶

Me kalimin e kohës, partitë e vogla, përfshirë këtu LPK-në, LKÇK-në dhe UNIKOMB-in u larguan nga koalicioni AAK, derisa PPK-ja u largua pa zhurmë. Kështu, në vitin 2004, Haradinaj e shndërroi

¹³⁵ Intervistë e IKS me Ahmet Isufin, Prishtinë, 1 Mars 2010.

¹³⁶ Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG). Çka ndodhi me UÇK-në? Prishtinë/Uashington/Bruksel: ICG, 3 Mars 2000. f.10.



BLERIM SHALA

15 MARS 1963, PRISHTINË

U diplomua në Universitetin e Prishtinës në degën e sociologjisë dhe filozofisë. Ai ka punuar si gazetar në Rilindje deri në vitin 1992. Shala ishte një nga themeluesit e Partisë Parlamentare (PPK) në vitin 1991 dhe i gazetës Zëri. Në mes të viteve 1991 dhe 1999, Shala ishte arrestuar pesë herë nga autoritetet serbe. Si përfaqësues i shoqërisë civile, Shala ishte i ftuar të marrë pjesë në Konferencën e Rambujesë. Jetën e tij publike e vazhdoi pas luftës pasi ai ishte pjesë e Këshillit të Përkohshëm të SPPA-së. Nga viti 2006 në 2007, Shala ka qenë koordinator i Ekipit të Unitetit, një grup i negociatorëve të zgjedhur për të marrë pjesë në bisedimet

me Serbinë në vitet 2005-07.

Karriera e tij politike filloi në vitin 2008, kur ai u emërua nënkryetar i AAK-së. Që nga viti 2010, dhe në mungesën e Ramush Haradinajt, Shala në mënyrë efektive ka drejtuar partinë në baza ditore. Ai është deputet në Parlament.

ombrellën AAK në një parti të vetme politike. Ideja origjinale, prapa së cilës qëndronte këshilltari i Haradinajt, ish-lideri komunist Mahmut Bakalli, ishte që të bashkoheshin ata që kishin marrë pjesë në luftë por që nuk ishin pjesë e PDK-së, partitë që datonin që nga vitet 1990 e që nuk ishin LDK (posaçërisht PPK-ja) dhe strukturat e dikurshme “ilegale,” siç ishte LKÇK-ja. Me themelimin e një koalicioni kaq të gjerë, Haradinaj synoi të krijonte diçka që do ti gjasonte idesë për Këshillin e Shpëtimit Kombëtar të cilën e kishin propozuar diplomatët amerikan në vitin 1998. Po të funksiononte, do të kishte qenë forca e parë e tillë në skenën politike të shqiptarëve të Kosovës. Në fund, njëra prej arsyeve pse nuk pati sukses ishte dallimi rrënjësor në mes synimeve të partive të ndryshme. Për shembull, LKÇK-ja avokonte për bashkim me Shqipërinë, derisa AAK-ja, të paktën zyrtarisht, nuk e përkrahte këtë ide.

AAK-ja u fut në skenën politike vetëm pesë muaj para zgjedhjeve lokale të vitit 2000. Atëbotë, nuk arriti ta fitonte asnjë komunë të vetme. Dështimi i saj në Deçan, në vendlindjen e Haradinajt, ishte posaçërisht befasues në një vend ku partia pritet të fitojë më së shumti vota në vendlindjen e liderit të saj. Atëherë, partia vendosi ti konsolidonte radhët e saj duke i bërë ofertë Naim Malokut, një ish-anëtar tjetër i UÇK-së nga rajoni i Dukagjinit, i cili tash e udhëhiqte Partinë e Qendrës Liberale të Kosovës (PQLK). Në zgjedhjet lokale të vitit 2002, AAK-ja fitoi më së shumti vota në komunën e Deçanit. Në ndërkohë, zgjedhjet

parlamentare të vitit 2001 tashmë kishin dëshmuar që kjo parti kishte potencial. AAK-ja kishte fituar tetë ulëse në parlament dhe ishte futur në qeveri me dy ministri.¹³⁷ Zgjedhjet e bënë AAK-në partitë e tretë në Kosovë.

Pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2004, AAK-ja, PDK-ja dhe Partia Reformiste ORA, u përfshinë në bisedime të drejtpërdrejta për formimin e koalicionit i cili do ta hidhte LDK-në në opozitë për herë të parë. Megjithatë, në atë që besohet të ketë qenë vendim i momentit të fundit, Haradinaj pranoi ofertën e Rugovës për koalicion. Edhe pse AAK-ja kishte fituar vetëm 8.3 përqind të votave, sipas marrëveshjes së koalicionit, ai mori postin e kryeministrit. Ka shumë spekulime pse Haradinaj e refuzoi idenë e koalicionit anti-LDK. Një teori në atë kohë ishte se Haradinaj donte ti hakmerrej Thaçit i cili e kishte injoruar atë kur donte të bëhej ministër i mbrojtjes në qeverinë e përkohshme. Por Ardian Gjini, nënkryetar i AAK-së, sjell një shpjegim krejtësisht tjetër dhe interesant të ngjarjeve. “Në vitin 2004,” thotë ai, “ne arritëm koalicion me LDK-në që ndryshoi shumë gjëra. Ne e ndryshuam parajgykimin e pasluftës që UÇK-ja nuk mund të bashkëpunonte me LDK-në dhe njëkohësisht e ndryshuam qasjen politike të partive tjera politike.”¹³⁸ Një shpjegim tjetër

137 Në zgjedhjet komunale, AAK-ja fitoi 53.074 vota (7.7 përqind), derisa në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2001 ata kishin fituar 61.688 vota (7.83 përqind).

138 Intervistë e IKS me Ardian Gjinin. Prishtinë, 10 Gusht 2011

është se të qenit kryeministër ishte shumë më mirë se të qenit udhëheqës i një partie të vogël opozitare.

Qeveria e periudhës 2004-2007 më së miri mund të përshkruhet si një qeveri e ndërlikuar. 100 ditë pasi ishte emëruar kryeministër, Haradinaj dha dorëheqje meqë akuzohej nga Tribunali i Hagës për krime të luftës. Bajram Kosumi, njëri prej zëvendësve të tij, u emërua kryeministër, derisa Ahmet Isufit i'u kërkua ta udhëhiqte partinë. Rugova ndërroi jetë në janar të vitit 2006 dhe AAK-ja e zëvendësoi Kosumin e paqëndrueshëm dhe në vend të tij emëroi Agim Çekun. LDK-ja emëroi Fatmir Sejdiun në postin e presidentit të Kosovës, dhe Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës, u zëvendësua nga Kolë Berisha.

Në mungesë të Haradinajt, popullariteti i AAK-së shënoi rënie. Megjithatë, sipas Avni Arifit, anëtar i kryesisë së AAK-së, partinë e dëmtoi edhe përkushtimi i saj ndaj konceptit të “Standardeve para Statusit” të dizajnuar nga UNMIK-u. Ky proces synonte arritjen e standardeve institucionale në Kosovë para se të kalohej në çështjen e zgjedhjes eventuale të statusit të Kosovës. “Procesi e dëmtoi AAK-në për shkak se përqendrimi në përmbushjen e standardeve teknike nënkuptonte që ne ishim përqendruar në bashkësinë ndërkombëtare. Kështu, të lodhur me probleme ekonomike dhe sociale, qytetarët nuk arritën ta kuptojnë pozicionin tonë dhe na ndëshkuan në zgjedhje.”¹³⁹

Pas zgjedhjeve të përgjithshme në nëntor të vitit 2007, AAK-ja doli në opozitë. Kjo ishte hera e parë që nga viti 2001, që AAK-ja nuk ishte pjesë e qeverisë. Që atëherë, strategjia e AAK-së ishte të përqendrohej në nivelin komunal. Degët komunale të AAK-së në rajonin e Dukagjinit arritën ta shfrytëzojnë ndarjen përbrenda LDK-së pas vdekjes së Rugovës në vitin 2006, dhe në zgjedhjet lokale të vitit 2007, të mbajtura në ditën e njëjtë me zgjedhjet e përgjithshme, korrën fitore, posaçërisht në komunat e Gjakovës dhe Pejës. Ky rezultat i motivoi aktivistët e partisë që të punojnë edhe më tepër për zgjedhjet e ardhshme komunale. Lirimi i Ramush Haradinajt nga Haga në vitin 2008 i solli edhe më tepër përkrahje partisë, e cila kishte zgjedhur me kujdes kandidatët lokalë për zgjedhjet komunale të vitit 2009, dhe kështu i fitoi edhe komunat e Suharekës dhe Junikut. (AAK-ja “fitoi” edhe në komunën e Zveçanit, por vetëm pse popullata e atjeshme serbe e bojkotoi procesin dhe ajo zonë në fakt është nën kontrollin e komunës “paralele” serbe).

Derisa partia po rimëkëmbej nga mungesa e Haradinajt, ky i fundit u detyrua të kthehej në Hagë për rigjykim në korrik të vitit 2010. Kjo ishte goditje

shumë e rëndë për partinë. Në prag të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010, AAK-ja hyri në koalicion me Listën Ibrahim Rugova, të udhëhequr nga Ukë Rugova. Pas zgjedhjeve, AAK-ja doli partia e katërt në Kosovë. Edhe pse PDK-ja i bëri ofertë ti bashkohej koalicionit qeverisës, këtë herë Haradinaj dhe pjesa tjetër e partisë i rezistuan joshjes për pushtet.

Ramush Haradinaj ka qenë dhe mbetet gurthemeli i AAK-së. Sipas statuteve të partisë, asnjë vendim i rëndësishëm nuk mund të merret pa pëlqimin e liderit të partisë.¹⁴⁰ Nivelin e lartë të varshmërisë së partisë ndaj Haradinajt e dëshmon edhe pritja e miratimit të tij në vitin 2011 për të hyrë apo jo në koalicion me PDK-në, derisa po shkëmbeheshin porosi me Hagën. Përveç kësaj, edhe pse ai gjendej në burg, emri i Haradinajt ishte në krye të listës së partisë dhe ai akoma mbetet kandidati i saj më i popullarizuar.

139 Intervistë e IKS me Avni Arifin. Prishtinë, 20 Prill 2011

140 Statuti partiak i AAK-së, 2008.

PROJEKTE TË KOTËSISË: ORA DHE FER

Rrënjët e shoqërisë civile mund të gjinden në fillim të viteve 1990, kur komunizmi i lëshoi rrugën pluralizmit politik. Ngritja e LDK-së si lëvizja e vetme politike për shqiptarët e Kosovës ngjau njëkohësisht me krijimin e organizatave të cilat shumë shpesh zëvendësuan mekanizmat institucional siç janë ministrinë dhe agjencitë tjera qeveritare. Kështu, Shoqata Nëna Terezë, e regjistruar zyrtarisht në Beograd në vitin 1990 si OJQ humanitare, de fakto shërbeu si ministri e shëndetësisë në qeverinë në ekzil të udhëhequr nga Bujar Bukoshi, dhe sipas një vëzhguesi u shndërrua në “njën kyçe të strukturave paralele.”¹⁴¹ Ngjashëm me këtë, Këshilli për Mbrojtjen

e Lirive dhe Drejtave të Njeriut (KMDLNJ) punoi si agjenci qeveritare e cila në rrethana normale do të operonte si ministri për informim dhe për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. KMDLNJ-ja përfshinte një rrjet të gjerë njerëzish të cilët në baza ditore raportonin për shkeljet e të drejtave të njeriut nga autoritetet serbe.¹⁴² Të dyja organizatat punuan nëpërmjet vullnetarëve të cilët vinin nga strukturat e komunitetit, rrjeteve familjare ose lidhjeve farefisnore.¹⁴³ Këto, dhe disa organizata të tjera të shoqërisë civile, të cilat u krijuan me synim të promovimit të koncepteve më të gjëra të shoqërisë

141 Bill Sterland. *Ndërtimi i Kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Shqipëri dhe Pasluftës: Përvoja e Bosnjës e Hercegovinës dhe Kosovës*. Oxford: INTRAC Punim Nr.9. 2006. f.13.

142 KMDLNJ kishte 15 anëtarë të stafit dhe ndihmohet nga një rrjet prej rreth 2,000 vullnetarëve lokal.

143 Bill Sterland. *Ndërtimi i Kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Shqipëri dhe Pasluftës: Përvoja e Bosnjës e Hercegovinës dhe Kosovës*. Oxford: INTRAC Punim Nr.9. 2006. f.13



VETON SURROI

17 KORRIK 1961, PRISHTINË

Si djali i një ish-diplomati jugosllav, Surroi kaloi disa vjet të rinisë së tij në Amerikën Latine. Ai studioi dhe u diplomua në filozofi dhe letërsi në Universitetin Autonom Kombëtar të Meksikës. Pasi që u kthye në Kosovë, Surroi punoi si gazetar në Rilindje.

Surroi filloi jetën e tij politike në vitin 1989 kur u emërua kreu i degës lokale të Asociacionit të Iniciativës Demokratike të Jugosllavisë (UJDI) dhe anëtar i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK). Në vitin 1991 Surroi mori pjesë në themelimin e Parlamentit Rinor që më vonë njihet si Partia Parlamentare e Kosovës (PPK). Ai e drejtoi PPK-në deri në vitin 1993, kur dha dorëheqje dhe i'u përkushtua përsëri gazetarisë. Në vitin 1992 me mbështetjen e Fondacionit të Shoqërisë së Hapur në Beograd, Surroi krijoi revistën javore Koha, dhe mblodhi një ekip të gazetarëve të rinj, ku përfshihen: Ylber Hysa, Baton Haxhiu, Dukagjin Gorani, Eqrem Basha dhe Shkëlzen Maliqi.

Në vitin 1997, Surroi ktheu Kohën javore në gazetën Koha Ditore, e cila u bë gazeta më e lexuar në mbarë Kosovën. Si përfaqësues i shoqërisë civile, Surroi ka marrë pjesë në Konferencën e Rambujesë. Pas luftës, biznesin Koha e zgjeroi me themelimin e Grupit Koha e cila tani përfshin shtëpinë e vet botuese. Në vitin 2000, Surroi themeloi kanalën televizive KTV- Kohavision të financuar fillimisht nga USAID. Koha Ditore, Kohavision dhe shtëpia botuese Koha janë pjesë e Grupit Koha.

Në vitin 2004, Surroi themeloi 'partinë reformiste' ORA, e cila në të njëjtin vit fitoi 6.2 përqind të votave dhe shtatë vende në parlament. Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2007, ORA nuk arriti të kalojë pragun e nevojshëm prej pesëpërqind. Pas këtij dështimi, Surroi u tërhoq nga roli aktiv në politikë dhe vendosi të kthehej në shoqëri civile. Ai aktualisht udhëheq me bordin e Klubit të Politikës së Jashtme në Prishtinë.

civile, shumë shpejt e gjetën vetën të përfshirë në nevojën për të promovuar dhe përkrahur rezistencën kombëtare dhe kauzën e përgjithshme kombëtare.

Në vitin 1999, pas përfundimit të luftës, në Kosovë erdhën shumë organizata joqeveritare ndërkombëtare. Gjashtë muaj pas përfundimit të luftës, rreth 285 OJQ ishin regjistruar pranë misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, krahasuar me rreth 50 sosh para fillimit të bombardimeve të NATO-së. Në këto rrethana, OJQ-të vendore që u krijuan ishin të varura dhe njëkohësisht të detyruara në një mënyrë nga bollëku i parave të gatshme të donatorëve. Kjo “mbarsje artificiale” e shoqërisë civile shpeshherë ndërlihet me organizatat që dominoheshin nga liderët dhe të cilat nuk kishin mision të qartë shoqëror e as kapacitete të përgjithshme organizative.

Me kalimin e kohës, numri i organizatave ndërkombëtare dhe i fondeve të tyre shënoi rënie, posaçërisht sa i përket projekteve të ndihmës dhe pajtimit. Në të njëjtën kohë, kultura e papjekur politike në Kosovë e pengonte zhvillimin e një procesi ku organizatat e shoqërisë civile do të konsultoheshin për këshilla politike dhe sociale. Ata të cilët kishin nevojë për këto këshilla nuk e shihnin të dobishme ti kërkonin ato dhe edhe kur e bënin këtë, kjo ndodhte në moment të fundit.¹⁴⁴

Për shkak të shkallës së lartë të politizimit të shoqërisë, kalimi i përkrahjes së donatorëve ndërkombëtarë nga organizatat e shoqërisë civile në ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve të reja të vendit shkaktoi rënie të theksuar në sektorin e OJQ-

144 Sterland argumenton që kjo ndodhi vetëm për shkak të ndjenjës së përgjegjshmërisë ndaj bashkësisë ndërkombëtare që ishte donatori kryesor i këtyre organizatave.

ve. Pas shpalljes së pavarësisë, shumë personalitete të njohura të shoqërisë civile filluan ta rishqyrtojnë rolin e tyre dhe shumë prej tyre kaluan në politikë. Disa prej tyre iu bashkuan partive ekzistuese, derisa disa të tjerë vendosën ti krijojnë partitë e tyre politike. Ata llogarisnin në reputacionin të cilin e kishin ndërtuar gjatë kohës së kaluar në shoqëri civile, dhe në marrëdhëniet e tyre të forta me akterët kyç ndërkombëtarë.

Partia e cila mbeti pa kohë - ORA

Veton Surroi ishte figurë kyçe në shoqërinë civile që nga fundi i viteve të 1980. I biri i një diplomati jugosllav, Surroi tash është pronar i shtëpisë botuese Koha.¹⁴⁵ Ai ishte forca shtytëse prapa themelimit të asaj që u quajt Partia Reformiste ORA në vitin 2004. ORA ishte parti me orientim social-demokrat e cila synonte në veçanti të përfaqësonte votuesit e shkolluar urban të cilët ishin të zhgënjyer me partitë e vjetra. Surroi ishte personalitet i njohur dhe një kohë të gjatë kishte qenë pjesë e njohur e skenës politike. Ai filloi karrierën e tij si gazetar i ri e ambicioz me njohuri të mirë të gjuhëve të huaja dhe më vonë u pa si përfaqësuesi kryesor i shoqërisë civile. Surroi për një kohë të shkurtër udhëhoqi me degën e UJDI-të në Kosovë. Pastaj, u bë anëtar i PPK-së. Më vonë, në një funksion apo tjetër, ai ishte pjesëmarrës në të gjitha takimet e rëndësishme për Kosovën prej fillimit të viteve 1990 e deri në Konferencë e Rambujesë në vitin 1999. Me përkrahjen e Fondacionit për Shoqëri të Hapur të George Soros-it, Surroi themeloi shtëpinë e suksesshme botuese Koha, e cila e përkrahu pozitën

145 Grupi KOHA përbëhet nga Koha Ditore, Televizioni Koha Vision dhe Shtëpia Botuese KOHA.



SHPEND AHMETI
18 PRILL 1978, PRISHTINË

U diplomua në Universitetin Amerikan të Bullgarisë në ekonomi dhe administrim biznesi. Ahmeti magjistroi në Shkollën e Qeverisë Kenedi në Universitetin e Harvardit. Karrierën e tij profesionale e filloi fillimisht në projekte hulumtuese, ku punoi si analist financiar në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe në Bankën Botërore, zyra në Prishtinë.

Si drejtor ekzekutiv i institutit të hulumtimeve për politika publike, Instituti GAP, Ahmeti ishte angazhuar në shoqërinë civile. Në vitin 2010 së bashku me aktivistë

të tjerë të shoqërisë civile ai vendosi të hyjë në arenën politike. Me Ilir Dedën, drejtor ekzekutiv i institutit kërkimor, KIPRED, ai themeloi një parti të re politike, Fryma Re (FER). Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, partia FER nuk arriti ta kalonte pragun e nevojshëm prej pesëpërqind. Si rezultat, disa prej anëtarëve të partisë braktisën anijen, ndërsa Shpend Ahmeti dhe pjesa tjetër e FER-it iu bashkuan Vetëvendosjes!

Në kongresin e parë të partisë që u mbajt menjëherë pasi Ahmeti i'u bashkua Vetëvendosjes!, ai u zgjodh nënkryetarë i partisë.

e tij në shoqëri civile dhe poashtu i ofroi rastin të bëhej komentues i mirëseardhur i zhvillimeve politike. Shpeshherë i parë si përfaqësues *par excellence* i shoqërisë civile, Surroi e kaloi pjesën më të madhe të karrierës së tij me një këmbë në politike dhe këmbën tjetër në shoqëri civile.

Siç nënkupton edhe emri i partisë “ORA,” Surroi dhe themeluesit e tjerë të partisë besonin që Kosovës po i ikte koha dhe që ajo kishte nevojë për ndryshime rrënjësore.¹⁴⁶ Kjo ishte porosia e tyre kryesore në fushatën parazgjedhore të vitit 2004. Edhe pse ishte themeluar vetëm disa muaj para zgjedhjeve, ORA mori 6.2 përqind të votave dhe fitoi shtatë ulëse në parlament. Sipas pritjeve të shumë njerëzve, ORA u tregua e suksesshme në zonat urbane ku mori në mes shtatë dhe 16 përqind të votave. Në Prishtinë, ajo doli partia e tretë pas PDK-së dhe LDK-së dhe e zhvendosi AAK-në në pozitën e katërt. Në zonat rurale megjithatë partia nuk ishte e suksesshme dhe arriti të merrte vetëm 1-2 përqind të votave.

Deputetët e ORA-së ishin tejet të angazhuar në parlament. Udhëheqësi i tyre, Surroi, mori pjesë në negociatat e Vjenës mbi të ardhmen e Kosovës, si anëtar i të ashtuquajturit Ekip i Unitetit. Teuta Sahatqija, nënkryetare e ORA-së, kujton se kjo ishte njëra prej arsyeve kryesore për dështimin e mëvonshëm të partisë në vitin 2007. “Ne u përfshimë në bisedime rreth çështjeve shumë të ndjeshme siç janë të drejtat e pakicave dhe trashëgimia kulturore... Opinioni publik e keqkuptoi pozicionin tonë dhe ORA i humbi zgjedhjet.”¹⁴⁷

Programi politik i ORA-së ishte inovativ posaçërisht në politikën e saj liberale sociale. Ajo promovonte rëndësinë e pronësisë së vazhdueshme shtetërore të ndërmarrjeve publike (NP-të) dhe të përfshirjes së vazhdueshme të shtetit në sektorët e ekonomisë me interes shtetëror. Ajo përkrahte themelimin e bankës bujqësore. Favorizonte liberalizimin e ligjit mbi abortin dhe legalizimin e martesave të gjinisë së njëjtë. ORA mblodhi rreth vetes individë të cilët kishin qenë në favor të rezistencës paqësore në vitet 1990 por që nuk kishin qenë pjesë e LDK-së dhe as të UÇK-së më vonë. Sahatqija shton: “Nëse programi politik do të ishte kyç për mobilizimin e votuesve, ORA sigurisht do të kishte fituar zgjedhjet e vitit 2007.”¹⁴⁸ Atë vit, megjithatë, ORA nuk arriti ta kalonte pragun prej pesë përqind për të hyrë në parlament. Për ironi, vet

146 Themeluesit e ORA-së ishin: Ylber Hysa (drejtor ekzekutiv në KACI, një institut kërkimor lokal), Ylli Hoxha (hulumtues në KACI) dhe Jetmir Balaj (kryetar i OJQ Forumi). Veton Surroi, ishte kryesues i listës zgjedhore dhe Ylber Hysa ishte kryetar i ORA-së.

147 Intervistë e IKS me Teuta Sahatqija, Prishtinë. 15 shkurt 2011.

148 Po aty.

ORA kishte propozuar ngritjen e pragut zgjedhor prej tre në pesë përqind.

Shumica e vëzhguesve pajtohen që ORA nuk arriti ta kapitalizonte humbjen e përkrahjes për LDK-në, pas ndarjes së partisë dhe lindjes së LDD-së. Por në vitin 2007, përveç lindjes së LDD-së, në skenën politike ishte futur edhe AKR-ja e formuar nga manjati Behgjet Pacolli. Përkundër ndryshimit të strategjisë politike, përkrahja për ORA-në përsëri vinte pothuajse krejtësisht nga qendrat urbane. Surroi bëri përpjekje ta fitonte përkrahjen e popullsisë rurale duke bërë shëtitje të gjata nëpër fshatrat e Kosovës. Kjo fushatë jokonformiste me ç’rast Surroi do të hynte në odë dhe do të provonte ta fitonte përkrahjen e udhëheqësve të fshatit, me shpresë se ata pastaj do të ndikonin tek pjesa tjetër e fshatit, u tregua e kotë e madje edhe e dëmshme.¹⁴⁹ Me prejardhje nga një familje me lidhje të forta e cila kishte prosperuar gjatë kohës së komunizmit, Surroi e llogariti keq vlerën e reputacionit të tij në sytë e “elitës” rurale.

Duke u përqëndruar në viset rurale, Surroi e nënvlerësoi përkrahjen nga qendrat urbane. Kjo jo vetëm që u dëshmuar si gabim por ishte edhe faktor kyç për rënien e partisë. Në zonat rurale, ORA nuk fitoi më tepër vota, derisa në zonat urbane shënoi rënie të theksuar. Vetëm në Prishtinë, e cila ishte bastioni i saj, votat e ORA-së ranë nga 11,100 në vitin 2004 në vetëm 5,700 në vitin 2007. Dështimi për të hyrë në parlament solli me vete fundin e partisë. Surroi u tërhoq dhe Sahatqija, njëra nga shtatë deputetët e partisë në legjislativin e kaluar, mori përsipër udhëheqjen e partisë në vitin 2008. Sahatqija ishte afariste dhe aktivizmi i saj politik filloi kur iu bashkua ORA-së në vitin 2004.

Strategjia e themeluesve të partisë ishte të joshin njerëz nga të gjitha fushat e jetës të cilët nuk kishin pasur lidhje me ndonjë parti politike në të kaluarën. Profesional në fushat e tyre respektive dhe me reputacion të mirë në komunitetin e tyre, ishin parakushtet e vetme për tu bërë anëtarë të partisë. Kur Sahatqija e mori përsipër partinë, ajo u desh t'i shpjegonte numrit në rënie të përkrahësve arsyet për rezultatet e dobëta të partisë në zgjedhje. Ajo ia atribuoi këtë faktit se Kosova ishte në mes të procesit të negociatave për statusin e saj përfundimtar politik dhe që Surroi, i angazhuar në procesin e bisedimeve, nuk kishte qenë në gjendje të kontribuonte shumë për partinë. Megjithatë, duke mos qenë më pjesë e parlamentit dhe pa Surroin, ORA shumë shpejt u desh ta pranonte realitetin. Partia u shkri në LDK, e cila së fundmi kishte zgjedhur Isa Mustafën në postin e kryetarit të partisë. Në këshillin e ri ekzekutiv të

149 Oda – dhomë tradicionale e caktuar për pritjen e mysafirëve meshkuj, mund të gjenden zakonisht në fshatra anëmbanë Kosovës.

LDK-së, Sahatqija u zgjodh njëra prej nënkryetarëve të partisë.

Rëndësia e ORA-së në skenën politike ishte se ajo dëshmoi së pari sa lehtë është të futesh në sistemin partiak dhe së dyti sa vështirë është të mbetesh aty.

Jeta nuk është fer - FER

FER, apo Fryma e Re, u themelua në tetor të vitit 2010, nga kryesuesit e dy instituteve kërkimore politike dhe ekonomike, dhe provoi të zbatonte një qasje tjetër nga partitë tjera politike. FER-i përfshinte anëtarë të rinj dhe shumë prej tyre ishin shkolluar jashtë. Asnjëri prej tyre nuk kishte qenë i përfshirë në UÇK e as nuk kishte pasur ndonjë rol politik gjatë viteve 1990. Dy themeluesit e FER-it promovonin idenë e “hierarkisë horizontale” e cila synonte të joshte përkrahës më “teknokratik.” Rrjedhimisht, nuk ishte befasi kur kjo parti dështoi ta kalonte pragun zgjedhor prej pesë përqind në zgjedhjet që u mbajtën vetëm dy muaj pas formimit të partisë.

Ilir Deda, njëri nga dy udhëheqësit e partisë, fajëson kohën e shkurtër prej themelimit të FER-it dhe zgjedhjeve për dështimin e partisë. Ata kishin menduar që zgjedhjet do të mbaheshin në vitin 2011.¹⁵⁰ Kështu, partia nuk kishte kohë të mjaftueshme për të themeluar një strukturë adekuate në mbarë vendin dhe prandaj duhej të përqendrohej kryesisht në zonat urbane, posaçërisht në Prishtinë. Në viset rurale, FER-i arriti të fitonte vetëm 2.7 përqind të votave, derisa në Prishtinë, ku shënuan rezultatën e tyre më të mirë, fituan megjithatë vetëm 6.14 përqind.

FER e pati poashtu të vështirë të gjente kandidatë adekuat. Fillimisht ata premtuan që vetëm persona me shkollim adekuat dhe pa lidhje të mëhershme politike do të futeshin në listën e tyre zgjedhore. Megjithatë, këtë e minoj presioni i kohës dhe mungesa e njerëzve të përshtatshëm. Në vend të numrit të lejuar të 110 kandidatëve, partia arriti të siguronte vetëm 86 kandidatë. Dhjetëshja e parë e kandidatëve ishin anëtarët kryesor të FER-it të cilët provuan të komunikojnë vlerat e partisë së re gjatë fushatës dhe debateve parazgjedhore. Por mungesa e kohës poashtu pati ndikim negativ në bashkërendimin e partisë. Shumica e kandidatëve nuk ishin të njohur plotësisht me programin partiak, gjë që u bë shumë e qartë kur ata bënë deklarata kontradiktore për një gamë të gjerë çështjesh.

Manifesti partiak ishte imagjativ dhe liberal në aspektin ekonomik dhe social. FER-i shihej si parti politike e cila gëzonte përkrahje të gjerë nga diplomatët dhe ndërkombëtarët e tjerë në Prishtinë.

¹⁵⁰ Intervistë e IKS me Ilir Dedën, Prishtinë. 7 mars 2011.


Megjithatë, vet FER-i hartoi planin për strategjinë e largimit të misioneve ndërkombëtare jashtë vendit.

Christopher W. Dell, ambasadori i SHBA-ve në Prishtinë, dukej se i dha përkrahje partisë duke i vizituar themeluesit e saj dhe duke shprehur mirënjohje për lindjen e partisë së re me orientime liberale. Në retrospektivë megjithatë mund të argumentohet që kjo vizitë e kishte efektin e kundërt. I pyetur nga gazetarët nëse do ta vizitonte edhe *Vetëvendosjen!*, lëvizje e cila sapo ishte shndërruar në parti, Dell u përgjigj negativisht duke thënë se nuk ja vlente të vizitohej.¹⁵¹ Kështu, vizita e tij u pa nga opinioni publik si përpjekje e FER-it për ta dobësuar *Vetëvendosjen!*

Rezultatet e dobëta të partisë u treguan të jenë tejet dekurajuese jo vetëm për përkrahësit më besnik të saj por edhe për themeluesit e partisë. Ilir Deda dhe Shpend Ahmeti, themelues tjetër i partisë, dhanë dorëheqje pas zgjedhjeve të përgjithshme. Ahmeti dhe një numër i madh i anëtarësisë iu bashkuan *Vetëvendosjes!*, ndërsa Deda u emërua shef i kabinetit në Zyrën e Presidentes.

Aventura e shkurtër e Dedës dhe Ahmetit u pa si një dështim i radhës nga një parti politike e cila dëshiron të ngrihet nga mesi i shoqërisë civile.

¹⁵¹ *Express*. Dell: *Vetëvendosje nuk më meriton*, 19 nëntor 2010. Vetëm dy ditë më herët, më 15 nëntor 2010, Vetëvendosje! refuzoi të nënshkruante “Kodin e Mirësjelljes” të cilin e nënshkruan të gjitha partitë politike para zgjedhjeve të 12 dhjetorit. *Gazeta Express*. *Nënskëmbet Kodi i mirësjelljes për zgjedhjet e 12 dhjetorit*, 15 nëntor 2010. Dell e quajti këtë akt “jodemokratik.”



BEHGJET PACOLLI

30 GUSHT 1951,
MAREC, PRISHTINË

Ai është rritur në një familje të varfër. Në moshën 17 vjeçare, Behgjeti migroi në Hamburg edhe pse nuk e fliste asnjë fjalë të gjuhës gjermane.

Në vitin 1990, Behgjet Pacolli themeloi një ndërmarrje ndërtimi në Zvicër, Mabetex Menaxhim i Projekteve. Kompania ka punuar në projekte të ndryshme nëpër Evropë dhe në ish bllokun sovjetik, duke e rritur famën në rindërtimin e Parlamentit Federal Rus, Shtëpinë e Operës Ruse, dhe Kremlinin. Si rezultat, Pacolli shpeshherë akuzohej për përfshirje në çështjet korruptive me presidentin e atëhershëm të Rusisë, Boris Yeltsin. Pavarësisht nga akuzat, Pacolli u bë një nga shqiptarët e Kosovës më të pasur dhe të njohur. Mabetexi tani vepron kryesisht në Kazakistan, ku ka të angazhuar një numër të madh të fuqisë punëtoje,

shqiptarë nga Kosova.

Në vitin 2006, Pacolli themeloi "Aleancën për Kosovë të Re" (AKR). Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2007 partia pati paraqitje të mirë, ku fitoi 12.3 për qind të votave. Pacolli u zgjodh deputet në vitin 2007. Megjithatë, AKR-ja ka qenë në rënie nëpër sondazhe qysh atëherë. Para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010 Pacolli formoi një koalicion me disa parti të vogla që e siguroi AKR-në të kalojë pragun e kërkuar prej pesë për qind. Pas zgjedhjeve grupi i'u bashkua koalicionit qeverisës me PDK-në. Në vitin 2010, parlamenti zgjodhi Behgjet Pacollin President të Kosovës, por pas 35 ditëve, Gjykata Kushtetuese vendosi se votimi ishte jokushtetues. Pacolli nuk ka kandiduar për president përsëri dhe tani është një nga zëvendëskryeministrat e Qeverisë së Kosovës.

JASHTË ETALONEVE – AKR DHE VETËVENDOSJE!

Ndërtimi i Kosovës apo i vetvetes? – AKR

Aleanca Kosova e Re (AKR) u themelua më 3 maj 2006 nga manjati Behgjet Pacolli i cili pjesën dërrmuese të jetës së tij e kishte kaluar jashtë vendit. Partia joshi kryesisht fytyra të reja të cilët nuk kishin ndonjë përvojë të shquar në politikë. Si rezultat, partia, të paktën fillimisht, u identifikua me karakterin e jashtëzakonshëm të liderit të saj.

Në prag të zgjedhjeve të vitit 2007, AKR-ja e promovonte vetën si parti liberal demokrate e qendrës së djathtë. Zhvillimin ekonomik e kishte identifikuar si prioritetin e saj më të lartë.¹⁵² Megjithatë, strategjia e saj gjatë fushatës parazgjedhore nuk mbështetej vetëm në manifestin partiak. Anëtarët e partisë i'u premtorin njerëzve në fshatrat e largëta vende të punës në vendet e huaja, kryesisht në Kazakistan, ku do të punonin për

firmën e ndërtimtarisë të Pacollit. Pjesërisht si rezultat i kësaj fushate, AKR-ja fitoi 12.3 për qind të votave dhe u bë partia e tretë në parlament me 13 ulëse. Përkundër kësaj, ajo nuk u fut në qeveri dhe kaloi në opozitë.

Ambicjet politike të Pacollit shpesh përkojnë me ambicjet e tij ekonomike. Rasti më famëkeq ishte ai i vitit 2008, kur kompania e ndërtimit Mabetex, e Pacollit, fitoi tenderin prej €14 milionë për renovimin e ndërtesës së mediave në Prishtinë, e cila pastaj u shndërrua në ndërtesë të disa ministrive. Komisioni zyrtar vlerësues për procedurën e tenderimit raportoi që Pellagonia Construction, një konsorcium nga Maqedonia, kishte fituar 99 pikë në procesin e tenderimit derisa Mabetex-i kishte fituar vetëm 84 pikë.¹⁵³ Ky raport shumë shpejt u zhduk nga gazetat dhe reputacioni i Pacollit nuk u

152 Koha Ditore e cituar në Balkan Insight. <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-govt-under-pressure-over-contract-web>. 18 tetor 2011.

152 Programi politik i AKR-së, 2006.



MIMOZA KUSARI-LILA
16 TETOR 1975, GJAKOVË

U diplomua në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës dhe magjistroi në e-biznes në Institutin e Ekonomisë, Universiteti i Kolorados dhe Duquesne, Universiteti i Pitsburgut. Nga viti 2001 deri në vitin 2003, Kusari-Lila ka punuar në AUK, USAID dhe Bankën Botërore. Nga viti 2003-2004 ajo ishte zëdhënëse e kryeministrit Bajram Rexhepi. Në vitet 2006-2009, Kusari-Lila ka punuar si Drejtoreshë Ekzekutive e Dhomës Amerikane të Tregtisë në Kosovë.

Kusari-Lila u aktivizua në politikë në vitin 2009, kur vendosi të bashkohet me AKR-në dhe të

kandidojë për postin e kryetares së komunës së Gjakovës. Edhe pse Kusari-Lila nuk fitoi, megjithatë fitoi popullaritet të konsiderueshëm dhe një pjesë të madhe të votave. Kusari-Lila u emërua nënkryetare e AKR-së dhe mbetet një lojtare e fortë në politikën partiake, së bashku me Behgjet Pacollin.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010, Kusari-Lila ishte kandidatja më e votuar femër në Kosovë. Aktualisht, ajo është Ministre e Tregtisë dhe Industrisë dhe zëvendëskryeministre e Qeverisë aktuale në Kosovë.

dëmtua aq keq megjithatë votuesit nuk ishin më aq të sigurt kur duhej të zgjidhnin në mes AKR-së dhe partive tjera politike.

Rënia e AKR-së filloi menjëherë pas zgjedhjeve. Kjo u vërejt më së shumti në parlament, kur disa deputetë të partisë vendosën ta braktisin atë dhe të bëhen të pavarur.¹⁵⁴ Para zgjedhjeve komunale të vitit 2009, AKR-ja hyri në koalicion parazgjedhor me LDD-në e Nexhat Dacit. Megjithatë, në zgjedhje AKR-ja pësoi dështim. Imazhi i saj ishte dëmtuar nga grindjet brenda-partiake dhe, sipas nënkryetarit të saj Ibrahim Makolli, koalicionet me partitë e tjera politike u treguan të dëmshme për identitetin e saj.¹⁵⁵

Pas rezultateve të zgjedhjeve të vitit 2009, Pacolli filloi të mendonte ndryshe. I frymëzuar nga strategjia e re e Hashim Thaçit për PDK-në, edhe Pacolli filloi të rekrutoj anëtarë të rinj të cilët ishin të njohur për publikun.

Mimoza Kusari-Lila, ishte një anëtare e re e profilit të lartë, e cila iu bashkua AKR-së pak para zgjedhjeve komunale. Deri atëherë ajo kishte udhëhequr një organizatë afariste dhe kishte qenë zëdhënëse e qeverisë së parë të pasluftës të udhëhequr nga kryeministri Bajram Rexhepi. Në zgjedhjet lokale, Kusari kandidoi për kryetare të Gjakovës por u mund nga AAK-ja.¹⁵⁶ Më vonë, ajo u bë nënkryetare e partisë. Kalimi i saj në AKR u tregua i suksesshëm. Ajo menjëherë ndihmoi në

riformësimin e partisë duke u bërë fytyra dhe zëri i ri i AKR-së.

Në prag të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010, AKR-ja hyri në koalicion parazgjedhor me gjashtë parti tjera të vogla. Ato ishin: Partia e Drejtësisë (PD), Partia Social-Demokrate (PSD), Partia e Pensionistëve të Kosovës (PPK), Partia e Pensionistëve dhe Invalidëve (PPI), Partia Nacional Demokrate Shqiptare (PNDSH), dhe Partia e të Gjelbërve të Kosovës (PGJK). Ombrella që e krijuan ato u quajt *Koalicioni për Kosovën e Re*.¹⁵⁷ Koalicionit i'u bashkëngjit edhe grupi i 15 ekspertëve (E-15) të cilët ishin kryesisht ekonomistë.¹⁵⁸ Koalicioni fitoi 7.29 përqind të votave dhe tetë ulëse në parlament. Pesë ulëse i mori AKR-ja dhe tri ulëse i morën partitë e tjera të koalicionit.

Pas zgjedhjeve, PDK-së, e cila kishte fituar shumicën e votave, i nevojiteshin partnerë për formimin e qeverisë. LDK-ja e Isa Mustafës vendosi të qëndroj në opozitë.¹⁵⁹ As AAK-ja nuk pranoi të futej në koalicion me PDK-në.¹⁶⁰ Kështu, AKR e gjeti veten me fuqi të konsiderueshme për të bërë pazar politik. Marrëveshja e arritur më 19 shkurt 2011, e bëri Pacollin president dhe Thaçin kryeministër. Sipas marrëveshjes, *Koalicioni për Kosovën e Re* i mori tre

154 Driton Tali ishte njëri ndër deputetët e parë të AKR-së që u largua nga partia për shkak të nepotizmit dhe të demokracisë të pamjaftueshme në vendimmarrje.

155 Intervistë e IKS me Ibrahim Makollin, Prishtinë, 1 mars 2011.

156 Ajo u emërua nga partia për të kandiduar në vendlindjen e saj në Gjakovë, ku humbi ndaj Pal Lekajt të AAK-së, në mes të supozimeve për parregullsi dhe vjedhje votash. Rasti pastaj u dërgua në Gjykatën Kushtetuese e cila vendosi se pohimet e Kusarit ishin të "pabaza."

157 AKR-ja u fut në koalicion parazgjedhor me: Partinë e Drejtësisë (PD), Partinë Social-Demokrate (PSD), Partinë e Pensionistëve dhe Invalidëve (PPI), Partinë Nacional Demokratike Shqiptare (PNDSH) dhe me Partinë e Gjelbër të Kosovës (PGJK).

158 Më 9 nëntor 2010, AKR-ja arriti marrëveshje me grupin E-15 që përbëhej nga 15 ekspertë të udhëhequr nga Muhamet Mustafa, kryetar i Institutit Rinvest, institut lokal për hulumtime zhvillimore.

159 Isa Mustafa në disa raste ka deklaruar që partia e tij nuk do të hyj në koalicion nëse nuk i fiton zgjedhjet.

160 Kushti i AAK-së për koalicion me PDK-në ishte që edhe LDK-ja duhet t'i bashkohej koalicionit të madh.



ALBIN KURTI

24 MARS 1975, PRISHTINË

Filloi studimet në vitin 1993 në Fakultetin Elektroteknik në Universitetin e Prishtinës, ku ishte një student i shquar. Karriera e tij politike filloi në Unionin e Studentëve në vitin 1997 ku filloi të organizojë protesta paqësore. Ai shpejt fitoi famë si udhëheqës i UPSUP-it (Unioni Studentëve të Pavarur të Universitetit të Prishtinës).

Gjatë viteve 1990, Kurti udhëtoi shumë jashtë vendit dhe ishte bashkëbisedues në takime të ndryshme (Uashington, Nju Jork, Bruksel, Kopenhagë). Në atë kohë, Kurti vizitoi Parlamentin Europian në Strasburg për ta ngritur vetëdijen e komunitetit ndërkombëtar në lidhje me kërkesat që studentëve. Në vitin 1998, Kurti u bë sekretar në Zyrën politike të UÇK-së në Prishtinë nën Adem Demaçin. Në vitin 1999 Kurti u arrestua nga policia serbe dhe u dënua me 15 vjet burg. Ai u lirua dy vjet më vonë.

Pas luftës, Kurti ka punuar në Rrjetin Aksionit për Kosovën (KAN) që ishte themeluar në vitin 1997. Në vitin 2005, ai e transformoi shoqatën në lëvizjen Vetëvendosje!, që do të kundërshtojë strukturat politike kosovare dhe ndërkombëtare në Kosovë dhe do të mbështes

haptazi qëllimin politik të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë.

Në vitin 2007, Vetëvendosje! organizoi demonstrata kundër Pakos së Ahtisaarit, gjatë të cilave dy njerëz ishin vrarë nga policët e UNMIK-ut që kishin qenë të pajisur me plumba gome. Si rezultat i këtyre protestave paqësore, që ishin kthyer në të dhunshme, Kurti u arrestua dhe ishte vënë në arrest shtëpiak nga policia e UNMIK-ut.

Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, Kurti akuzohej nga EULEX-i. Gjithsesi, asnjë avokat në Kosovë nuk ishte i gatshëm për ta mbrojtur Kurtin, hap që u cilësua si mosbindje civile. Kurti u gjet fajtor dhe u dënua me nëntë muaj burgim, mirëpo u lirua menjëherë pasi që e kishte shërbyer tashmë kohën e tij në arrest shtëpiak. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2010, Kurti e udhëhoqi Vetëvendosjen!, dhe ariti ta transformojë me sukses atë nga një lëvizje jashtë parlamentare në një parti që tashmë fitoi 12.7 përqind të votave. Kurti është deputet në Parlamentin e Kosovës dhe kreu i komisionit parlamentar për punë e jashtme.

ministri, prej të cilave vetëm njëra do të udhëhiqej nga AKR-ja, më konkretisht nga Mimoza Kusari-Lila. Ajo u emërua zëvendës kryeministre dhe ministre e tregtisë dhe industrisë. Agim Çeku i PSD-së mori ministrinë e mbrojtjes dhe Ferid Agani, lider i PD-së, mori ministrinë e shëndetësisë.

Vetëm 35 ditë pas inaugurimit të Pacollit në postin e presidentit, Gjykata Kushtetuese vendosi që zgjedhja e tij kishte qenë në kundërshtim me kushtetutën e vendit për shkak të parregullsive procedurale. Pacolli dha dorëheqje por pastaj u emërua zëvendës kryeministër i parë dhe tash është kryesisht jashtë vendit, qoftë në udhëtime biznesi apo në funksionin e tij si i dërguar për të kërkuar më tepër njohje të pavarësisë së Kosovës.

Vetëvendosje! – e ardhmja e ndritur e Kosovës?

Në vitin 2003, UNMIK-u shpalli programin Standardet para Statusit, nëpërmjet të cilit donte të definonte një shkallë minimale të standardeve të cilat Kosova duhet ti përmbushte para se të mund të hapej çështja e statusit të saj përfundimtar. Në të njëjtën kohë, ky proces nuk trajtoj çështjen se çfarë statusi do të ishte ky dhe si do ta arrinte Kosova atë. Derisa shqetësimi i shqiptarëve të Kosovës me të ardhmen e tyre politike po rritej dhe vendimet e qeverisë së përkohshme në instancë të fundit varehin nga miratimi i UNMIK-ut, dhe pa asnjë shenjë se këtij sistemi po i afrohej fundit, frustrimi i popullatës shpërtheu më 17 mars 2004.

Protestuesit sulmuan ndërtesat e UNMIK-ut dhe pakicën serbe e cila jetonte e shpërndarë nëpër kuazi-

enklava. Trazirat ishin goditje e fuqishme ndaj politikës së Standardeve para Statusit por vunë në lëvizje disa ngjarje të cilat përfundimisht çuan në shpalljen e pavarësisë. Kai Eide, diplomat norvegjez, u emërua nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, për të bërë një nishikim gjithëpërfshirës të situatës. Më 7 tetor 2005, Eide botoi raportin e tij ku thoshte se përkundër zbatimit jo të njëjlojtë të standardeve, Kosova duhej të futej në fazën e ardhshme të proceseve politike për ta qartësuar statusin e saj politik.¹⁶¹

Në ndërkohë u shfaq një lëvizje e re e cila haptazi e kundërshtonte administratën e OKB-së dhe shtyrjen e procesit i cili çonte në pavarësi. Kjo lëvizje e quante veten *Vetëvendosje!*. Ajo u themelua më 10 qershor 2005, saktë gjashtë vite pas miratimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së e cila ruante statusin e përkohshëm të Kosovës dhe e cila kundërshtojë aq ashpër nga *Vetëvendosje!*. Në manifestin e saj, lëvizja shkruante se “administrata e UNMIK-ut në Kosovë është regjim jodemokratik ... Prezenca e saj është antitezë e vetëvendosjes sonë.” Aty shtohet se “Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, janë, në rastin më të mirë, pjesë përbërëse e legjitimizimit të kësaj mënyre të qeverisjes.”¹⁶² Grupet e *Vetëvendosjes!* kishin qenë aktive edhe para krijimit të saj formal, shpeshherë duke gëzuar përkrahje nga populli dhe duke tërhequr vëmendjen e mediave nëpërmjet grafiteve dhe sloganeve si *UNMIK Jasthtë* dhe *Jo Negociata, Vetëvendosje!*.¹⁶³

Rrënjët e *Vetëvendosjes* janë të thella. Lideri i saj, Albin Kurti, iu bashkua Partisë Parlamentare të Kosovës (PPK) në vitin 1996. Një vit më vonë, ai e braktisi PPK-në dhe iu bashkua Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës (UPSUP). Në këtë pozitë, Kurti ishte njëri ndër organizatorët kryesor të protestave studentore në vjeshtë të vitit 1997 dhe në pranverë të vitit 1998. Protesta e parë masive u mbajt më 1 tetor 1997. Atëbotë kishte kaluar një vit që kur Rugova kishte nënshkruar një marrëveshje me Millosheviqin e cila duhej t’iu lejonte studentëve shqiptarë t’i vazhdonin studimet në hapësirat e universitetit, prej ku shqiptarët ishin larguar në vitin 1991. Marrëveshja megjithatë nuk ishte zbatuar. Siç thotë Kurti: “Kjo ishte e papranueshme për ne sepse gjendja vazhdonte të mbetej e njëjtë.”¹⁶⁴

Kurti u bë edhe redaktor në revistën mujore studentore *Bota e Re* e cila që nga fundi i vitit 1997 i kushtonte hapësirë të madhe UÇK-së. Në atë kohë, ai shihej si revolucionar i ri me flokë të gjata. Megjithatë, në qershor të vitit 1998, kur UÇK-ja kishte futur

nën kontroll një territor të madh në pjesën qendrore të Kosovës, Kurti akoma mbetej përkrahës i epur i protestave paqësore. Ai madje u përpoq të organizoj një punëtori e cila si prioritet do të kishte rezistencën aktive paqësore para konfliktit të armatosur.¹⁶⁵

Mirëpo, tashmë entuziazmi rreth paraqitjes së UÇK-së e kishte lënë plotësisht në hije dinamizmin që shoqëronte protestat studentore. Masakrat në rajonin e Drenicës në shkurt dhe mars të vitit 1998, si dhe ofenziva e ashpër ushtarake serbe e cila do ta zmbrapste UÇK-në, ishin momente kyçe në rritjen e përkrahjes popullore për UÇK-në. Politika e Rugovës për rezistencë paqësore pasive po humbte përkrahje dita ditës. Në këto rrethana, Kurti doli në përkrahje të UÇK-së dhe u bë ndihmës i Adem Demaçit, i cili atëbotë ishte bërë përfaqësues politik i UÇK-së në Prishtinë. Ai qëndroi në Prishtinë kur filluan bombardimet e NATO-së më 24 mars 1999 dhe u arrestua nga forcat serbe më 28 prill. Më 13 mars 2000, gjykata serbe e dënoi Kurtin me 15 vite burgim nën akuzat e “rrezikimit të integritetit territorial të Jugosllavisë dhe për komplot për zhvillim të aktiviteteve armiqësore të lidhura me terrorizëm.” Më tepër se një vit pas rënies së Millosheviqit nga pushteti në tetor të vitit 2000, Kurti u lirua nga burgu i Nishit.

Pas kthimit në Kosovë, Kurti iu bashkëngjiti Rrjetit Kosovar për Veprim (KAN), i cili u themelua në dhjetor të vitit 1997 dhe financohej nga jashtë. KAN mbledhte studentë nga Prishtina dhe trajtonte çështjet e të drejtave të njeriut dhe arsimit.¹⁶⁶ Kurti e mori përsipër organizatën dhe ngadalë e transformoi atë në *Vetëvendosje!*, lëvizje e fuqishme jashtëparlamentare.

Ideja e lëvizjes ishte të promovonte rezistencë aktive dhe jo të mjaftohej vetëm me deklarata. Kur Kosova hyri në negociata me Beogradin për statusin e saj përfundimtar, *Vetëvendosje!* zgjeroi gamën e metodave të saj jokonvencionale. Slogani i saj më i njohur, “*Jo negociata – Vetëvendosje!*” u shkrua nëpër mure dhe semaforë anembanë Kosovës. Megjithatë, autorët e grafiteve shumë shpejt kaluan në veprime më muskuloze. Në disa raste, aktivistët e *Vetëvendosjes!* rrokullisën veturat e policisë së UNMIK-ut (e më vonë edhe të EULEX-it), hodhën ngjyrë mbi ndërtesat qeveritare dhe i sulmuan udhëheqësit politik me vezë dhe domate të prishura.

Datë kyçe në historinë e lëvizjes ishte 10 shkurti 2007. Demonstrata kundër bisedimeve në mes delegacioneve të Kosovës dhe Serbisë në Vjenë eskaluan në dhunë kur protestuesit u përleshën me policinë e UNMIK-ut dhe këta të fundit pastaj përdorën gaz

161 Këshilli i Sigurimit i OKB-së, letër me datë 7 tetor 2005 nga Sekretari i Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit.

162 Manifesti i Vetëvendosjes! 2010.

163 Ashok Swain, eds. Ashok Swain, Ramses Amer dhe Joakim Öjendal: *Globalizimi dhe sfidat e ndërimit të paqes*. Londër/Nju Jork. Anthem Press, 2008. f.163.

164 Intervistë e IKS me Albin Kurtin, Prishtinë. 26 mars 2011.

165 Howard Clark, *Rezistenca Civile në Kosovë*, Londër. Pluto Press, 2000. ff.156-157. Autori do të duhej ta mbante një seminar në Tetovë, Maqedoni, në gusht, por ajo u anulua në korrik.

166 Rrjeti Kosovar i Veprimit (KAN) u themelua “me qëllim të përkrahjes së Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës në përpjekjet e tyre të kthehen në hapësirat e universitetit nëpërmjet protestave aktive paqësore.”

lotsjellës dhe plumba gome. Dy plumba gome, me gjasë me afat të skaduar, i vranë dy protestues në afërsi të teatrit të Prishtinës. Kurti u arrestua nën akuzat e “organizimit të turmës e cila kreu akt penal; udhëheqjen dhe pjesëmarrjen në grup që i pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare; dhe thirrje për rezistencë me forcë ose kërcënim serioz.”¹⁶⁷

Aktakuza kundër Kurtit u ngrit më 31 maj 2007 dhe seanca e parë gjyqësore u mbajt më 19 shtator. Kurti u arrestua në ditën e protestës dhe u mbajt në burg deri në korrik të vitit 2007, pastaj kaloi në arrest shtëpiak, masë kjo e cila u largua më 19 dhjetor 2007. Gjatë kësaj periudhe, Kurti e kishte të ndaluar të largohej nga banesa e tij dhe kontaktin me *Vetëvendosjen!* apo me mediat. Kurti pastaj refuzonte thirrjet për tu paraqitur në gjykatë duke thënë se i tërë procesi ishte i motivuar politikisht. Procesi gjyqësor u suspendua më 7 shkurt 2008 kur gjashtë avokatë kishin refuzuar ta përfaqësonin Kurtin në gjykatë.

Pas shpalljes së pavarësisë në shkurt të vitit 2008, rasti u bart nga UNMIK-u tek misioni i Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë, EULEX. Pas suspendimit dyvjeçar, rasti u hap përsëri më 15 shkurt 2010. Kurti duhej të paraqitej para trupit gjykues për aktakuzën e njëjtë. Vetëm pasi Kurti refuzoi të paraqitej në gjykatë dhe pas dështimit të paraqitjes së avokatit të caktuar, policia e Kosovës e arrestoi Kurtin më 12 qershor 2010. Dy ditë më vonë, gjykatësi i EULEX-it, Ferdinando Boatier de Mangeot, shpalli vendimin i cili e dënonte Kurtin me nëntë muaj burgim. Kurti megjithatë u lirua menjëherë pasi që veçmë i kishte kaluar 11 muaj në burg dhe arrest shtëpiak në vitin 2007.

Prej vitit 2007 deri në vitin 2010, *Vetëvendosje!* vazhdonte t'i kundërshtonte pothuajse të gjitha proceset e iniciuara nga bashkësia ndërkombëtare. Ata konsideronin se EULEX-i ishte thjesht zëvendësim i UNMIK-ut dhe kritikonin udhëheqësit shqiptarë se janë shërbëtorë të prezencës ndërkombëtare në vend. Demonstratat dhe veprimet në rrugë vazhduan dhe në disa raste rezultuan me dëme të vogla të ndërtesave zyrtare.

Në vitin 2007, *Vetëvendosje!* i'u shmang idesë së transformimit në parti politike dhe pjesëmarrjes në zgjedhjet e përgjithshme. Sipas Kurtit, arsyeja kryesore për këtë ishte që i tërë procesi kishte mbështetje ligjore në Kornizën Kushtetuese të hartuar nga UNMIK-u.¹⁶⁸ Megjithatë, Glauk Konjufca, anëtar tjetër në udhëheqësinë e *Vetëvendosjes!* pohon se kjo nuk ishte arsyeja e vetme. Ai thotë që në vitin 2007, lëvizja nuk ishte e gatshme për tu futur në zgjedhje duke marr parasysh anëtarësinë e saj të kufizuar.¹⁶⁹ Mirëpo, kjo kishte ndryshuar në vitin 2010. Tashmë zyrtarisht e shndërruar

në parti, kishte arritur të fitonte 12.7 përçind të votave në zgjedhje që i siguruan 12 ulëse në parlament.

Karakteristika më interesante të *Vetëvendosjes* është evoluimi i mendimit të saj rreth të ardhmes politike të Kosovës. Derisa më herët kishte kundërshtuar me tërë qenien pronësinë e ndërkombëtarëve mbi proceset politike në Kosovë dhe prezencën e tyre, ajo akoma vazhdon ta bëjë këtë por tashmë e përqendruar në idenë e bashkimit me Shqipërinë. Ata besojnë se kjo është mënyra e vetme që Kosova të mbijetojë ekonomikisht dhe politikisht.

Idëja e bashkimit me Shqipërinë megjithatë mbetet e paqartë dhe në efekt vetëm një slogan, duke marr parasysh refuzimin e institucioneve të të dyja vendeve për të biseduar madje për këtë çështje. Konjufca, në anën tjetër, mendon që bashkimi mund të arrihet kur Kosova të bëhet plotësisht sovranë. “Bashkimi nuk duhet të bëhet vetëm nëpërmjet shkëmbimit të territoreve apo me anë të kompromisit me ndonjë shtet të tretë, por vetëm me gatishmërinë e qytetarëve.”¹⁷⁰

Vetëvendosje! shpeshherë mendohet se provon ta përvetësojë trashëgiminë e UÇK-së, e cila është tradicionalisht në domenin e PDK-së dhe AAK-së, të cilat dolën nga radhët e saj. Në tetor të vitit 2011, gjatë përkujtimit të 14 vjetorit të vdekjes së Adrian Krasniqit, ushtarit të parë të UÇK-së të vrarë në uniformë, Rexhep Selimi, ish-komandant i lartë i UÇK-së dhe anëtar i dikurshëm i AAK-së, i cili iu kishte bashkangjitur *Vetëvendosjes*, tha se ekzistonte një përputhje e natyrshme në mes partisë së tij të re, trashëgimisë së UÇK-së dhe synimit për bashkim me Shqipërinë.¹⁷¹

Sa i përket politikave ekonomike, *Vetëvendosje!* dallon nga të gjitha partitë tjera. Ajo ka tendencë të qarta të majta dhe e kundërshton privatizimin e ndërmarrjeve publike. Sipas *Vetëvendosjes*, asetet strategjike të Kosovës kanë potencial të madh dhe janë baza e zhvillimit të ardhshëm ekonomik të vendit. Në këtë kontekst, ata përmendin KEK-un (Korporata Energjetike e Kosovës), Trepçën (minierat) dhe PTK-në (Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës). Ata kundërshtuan dhënien me koncesion të aeroportit të Prishtinës duke thënë: “Shitja e pronës publike nënkupton dëmtimin e popullit.”

Vetëvendosje! ka deklaruar se kurrë nuk do të hyj në koalicion me partitë politike që veçmë kanë qenë pjesë e qeverisë. Megjithatë, ajo është treguar shumë e hapur ndaj anëtarëve të dikurshëm të këtyre partive, si për Rexhep Selimin (AAK) Ismajl Kurteshin dhe Gani Krasniqi (PDK).

167 *Vetëvendosje!* Rifillimi i gjyqimit kundër Albin Kurtit 2010. Komunikatë për Shtyp, 2010. 18 nëntor 2011.

168 Intervistë e IKS me Albin Kurtin, Prishtinë. 26 mars 2011.

169 Intervistë e IKS me Glauk Konjufcën, Prishtinë. 15 shkurt 2011.

170 Po aty.

171 Në fjalimin e tij, Rexhep Selimi tha: “Adriani është hero i kombit shqiptar që është më i madh se Kosova, më i madh se Shqipëria, dhe më i madh se të dyja së bashku.”

GJEOGRAFIA, POLITIKA DHE VOTIMI

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, skena politike e Kosovës ka pësuar ndryshime rrënjësore. Në zgjedhjet e para lokale në vitin 2000, 89.5 përqind të votave valide u hedhën vetëm për tri parti, LDK-ja e cila mori 55.9 përqind, PDK-ja me 26.3 përqind dhe AAK-ja me 7.4 përqind. Asnjë parti tjetër nuk arriti të fitonte më tepër se një përqind të votave. Në zgjedhjet lokale të vitit 2009, megjithatë, tri partitë kryesore morën vetëm 71.3 përqind të votave, LDK-ja 24.5 përqind, PDK-ja 31.8 përqind dhe AAK-ja 15.1 përqind. Këtë herë megjithatë pesë partitë e vogla arritën të fitojnë jo vetëm më tepër se një përqind të votave secila, por kolektivisht një hise të konsiderueshme: LDD-ja e Nexhat Dacit fitoi 7.2 përqind të votave, AKR-ja e Behgjet Pacollit 8.5 përqind, Partia Reformiste ORA 1.5 përqind të votave dhe partia turke KTDP-ja 1.2 përqind.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010, hisa e kombinuar e votave të fituara nga tri partitë kryesore mbeti e qëndrueshme në 70.5 përqind, LDK-ja 25.7 përqind, PDK-ja 33.4 përqind dhe AAK-ja 11.5 përqind. Partitë e vogla në anën tjetër i kishin punët dukshëm më ndryshe. LDD-ja arriti të fitonte vetëm 2.1 përqind. ORA e cila ishte shkrirë në LDK tashmë ishte zhdukur. AKR-ja, përkundër koalicionit parazgjedhor me partitë e vogla, ra në 7.3 përqind. KTDP-ja e pakicës turke mbeti në 1.2 përqind. Në të njëjtën kohë, në skenën politike u futën dy parti të reja: *Vetëvendosja!* e cila fitoi 12.7 përqind të votave, dhe FER-i, i cili zhgënjeu me 2.2 përqind. Partia Liberale Serbe (SLS), e cila është pjesë e institucioneve të Kosovës, kërceu nga 0.7 përqind në zgjedhjet lokale të vitit 2009 në 2.1 përqind. Skena politike kështu u bë më e llojëllojshme, më e përzier në aspektin etnik dhe poashtu më e decentralizuar.

Më tepër se dhjetë vite në demokracinë e pasluftës, ka ekzistuar një variacion i dallueshëm rajonal në trendet e votimit. Ky trend në veçanti i prek partitë e mëdha shqiptare. Përveç kësaj, ekziston edhe ndarja e dukshme rurale-urbane në

mes preferencave të votimit në komunat me qytete më të mëdha dhe komunat me popullsi më të madhe rurale. Një trend i veçantë gjeografik mund të vërehet lehtë edhe në trendet votuese të komuniteteve pakicë. Meqë grupet kryesore - serbët, turqit, boshnjakët dhe goranët - të gjithë jetojnë në zona të dallueshme, dhe nuk janë të shpërndarë njësoj në mbarë vendin, kjo e përforcon edhe më tepër trendin e votimit rajonal.

Regjionalizimi

Ndarja e qartë fizike dhe gjeografike Kosovës krijon tre rajone të cilat kanë ndikimin e tyre në trendet votuese të kosovarëve.


Kosova Perëndimore

Kosova Perëndimore përbëhet nga Rrafshi i Dukagjinit, i cili shtrihet përgjatë lumit Drin, nga kufiri malor me Malin e Zi, afër Pejës, deri në juglindje të Prizrenit dhe në kufirin me Shqipërinë. Këto fusha pjellore në jug kufizohen me Malet e Sharrit që e ndajnë Kosovën nga Maqedonia. Kufiri lindor i këtij rajoni shënohet nga vargmalet i Carralevës përgjatë kufijve të komunave të Suharekës, Rahovecit dhe Klinës.

Sipas rezultateve preliminare të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, territori relativisht i vogël i Kosovës Perëndimore është mjaft i populluar me 501 vendbanime. Ai ka 644,000 banorë që jetojnë në rreth 106,000 ekonomi familjare me rreth 6.3 persona për çdo shtëpi. Rreth 28 përqind të shtëpive në këtë rajon janë të zbrazëta, pjesërisht për shkak të shpërnguljes së serbëve dhe malazezve pas vitit 1999. Në zgjedhjet e vitit 2010 morën pjesë 258,955 banorë.¹⁷²

Kosova Perëndimore gjithmonë ka pasur jetë

172 Të dhëna të numërit të popullsisë bazuar në rezultatet preliminare të regjistrimit të popullsisë në Kosovë në pranverë të vitit 2011. Shih: Enti Statistikor i Kosovës (SOK). Të dhënat mbi zgjedhjet mbështeten në rezultatet e botuara nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), e cila organizoi dhe zhvilloi zgjedhjet në vitet 2000, 2001, 2002, 2004 dhe Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) i cili organizoi zgjedhjet në vitet 2007, 2009 dhe 2010.



më të zhvilluar urbane dhe politike në krahasim me pjesën tjetër të vendit. Tradita e fortë e zanatlinjve dhe tregtisë në qendrat urbane i vuri bazat për rilindjen kombëtare të shqiptarëve në fund të shekullit XIX, duke filluar me Lidhjen e Prizrenit më 1878. Edhe viset rurale malore përfituan nga rrugët tregtare duke kaluar nëpër Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi. Rezistenca e armatosur kundër otomanëve, më vonë serbëve dhe pastaj regjimi i Zogut në Shqipëri gjetën shumë prej përkrahësve të tyre të patundur në Gjakovë. Në dekadat pas Luftës së Dytë Botërore, Partinë Komuniste të Kosovës e udhëhoqën politikanë nga qyteti i Gjakovës.

Ky rajon përbëhet nga 11 komuna. Tri prej tyre, Peja, Gjakova dhe Prizreni, janë shumë të urbanizuara me tradita qindrvjeçare të zanatit

dhe tregtisë. Prizreni është qyteti i dytë më i madh në Kosovë dhe kryeqyteti historik i vilajetit të dikurshëm osman të Kosovës. Të tria qytetet ishin shumë të industrializuara gjatë kohës së komunizmit. Komunitat e Deçanit dhe Suharekës ishin pjesërisht të industrializuara, tekstili në Deçan dhe përpunimi i gomave në Suharekë. Komuna e Rahovecit kishte industri shumë të zhvilluar të verës. Së bashku me fushat pjellore të Gjakovës, Suharekës dhe Prizrenit, ajo ishte zona e dytë më e madhe në Jugosllavi për prodhimin e verës. Vera e Kosovës eksportohej nga kompania atëherë-shumë e njohur *Amsselfelder*, posaçërisht në Gjermani.¹⁷³ Klina dhe Istogu poashtu e kishin relativisht mirë të zhvilluar fushën e

¹⁷³ Shih Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), *RabooceBrusselsExpress*, 2009.

bujqësisë dhe specializimin në prodhimin e pemëve dhe peshkut. Vetëm Dragashi malor në jug të vendit kishte sektor të nën-zhvilluar bujqësor dhe nuk kishte fare industri.

Ky rajon historikisht ka pasur prezencë të fortë të pakicave, posaçërisht turqit dhe serbët në Prizren, serbët dhe malazetët në Pejë dhe fshatrat përreth, dhe goranët dhe boshnjakët në Dragash. Serbë ka edhe në Rahovec, manastiri i Deçanit është njëri prej manastireve më të rëndësishme serbe, dhe Peja është selia historike e patriarkanës së Kishës Ortodokse Serbe.

Gjatë procesit të decentralizimit është krijuar komuna e vetme me shumicë turke – Mamusha – e cila më herët ishte pjesë e Prizrenit, dhe një komunë e re shqiptare – Juniku – që u nda nga komuna e Deçanit.

Romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit jetojnë në të gjitha komunat posaçërisht në qyteza dhe në rrethinën e tyre. Klina është qendra e shqiptarëve katolik, ndërsa edhe Prizreni dhe Gjakova kanë pakica të vogla katolike.

Derisa sot në aspektin ekonomik pjesa lindore e Kosovës është pjesa më e rëndësishme e vendit, në kohën e komunizmit, shumica e prodhimit industrial dhe e ndërmarrjeve shoqërore (NSH-të) ishin të vendosura në Dukagjin, posaçërisht në Prizren, Pejë dhe Gjakovë. Për këtë arsye, kur në vitin 1990 regjimi i Millosheviqit i largoi shqiptarët nga fuqia punëtore industriale, kjo pati efekte shkatërruese për qendrat më të zhvilluara urbane. Përveç qendrës së minierave dhe metalurgjisë, Mitrovicës dhe kryeqytetin Prishtinën, kjo përfshiu edhe qytetet si Pejën dhe Gjakovën. Kjo, si dhe afërsia me kufirin me Shqipërinë, shpjegon pse UÇK-ja u bë shumë e fortë në këto anë. Gjatë luftës së viteve 1998-99, Peja, Gjakova dhe Deçani përbënin bërthamën e zonës operative të UÇK-së në Dukagjin. Prandaj, ky rajon i ndikua më së tepërmi nga luftimet në mes UÇK-së dhe serbëve dhe u godit jashtëzakonisht shumë nga sulmet ndëshkimore të forcave serbe. Ramush Haradinaj, komandanti i UÇK-së në këtë rajon, më vonë u bë themelues i AAK-së dhe sot të tri komunat udhëhiqen nga AAK-ja.

Rajoni i Drenicës dhe më gjërë¹⁷⁴

Rajoni i Drenicës përbëhet nga 11 komuna. Për shkak të bojkotimit të regjistrimit të popullsisë nga ana e serbëve, të dhënat mbi numrin e popullsisë janë

174 Rajoni i Drenicës është vetëm një emër arbitrar që përfshin më shumë sesa rajonin gjeografik të Drenicës. Siç shpjegohet edhe në tekst, termi përfshin edhe komunën e Kaçanikut, Shtimes, Shtërpçës në jug, dhe komunën e Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, dhe Mitrovicës në veri.

shumë të pasigurta. Ky rajon ka 427 vendbanime, 370,000 banorë, por vetëm 139,244 votuan në zgjedhjet e vitit 2010.

Ky rajon ndahet në tri zona. Lumi Ibër shënon kufirin gjeografik të pjesës veriore të Kosovës. Në veri-perëndim, rrjedha e Ibrit bie në liqenin e madh artificial të Gazivodës i cili gjendet në komunën e Zubin Potokut. Ibrit pastaj vazhdon në juglindje dhe e ndan qytetin e Mitrovicës në pjesën jugore dhe atë veriore. Ibrit përsëri vazhdon në veri nëpërmjet një gryke të ngushtë në vargmalet e Kopaonikut në kufi me Serbinë. Lugina mbaron në kufirin me rajonin e Sangjakut në Serbi.

Komunat e Zubin Potokut, Zveçanit, Leposaviqit dhe Mitrovicës Veriore, (kjo e fundit akoma është vetëm në letër) janë të banuara kryesisht me popullsi serbe. Prandaj të dhënat për këtë rajon nuk janë shumë të besueshme për shkak se të gjithë serbët i bojkotojnë zgjedhjet e Kosovës, nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë dhe institucionet “paralele” lokale janë pjesë e strukturave komunale të Serbisë dhe nuk kanë fare kontakt me institucionet e Kosovës. Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI) vlerësoi në vitin 2004 që numri i përgjithshëm i popullsisë së Mitrovicës veriore dhe komunave tjera veriore është rreth 57,000 banorë.¹⁷⁵

Që nga shpërbërja e Jugosllavisë, ky rajon ka rënë në depresion të thellë ekonomik. Kompleksi Trepça, përfshirë edhe minierën e qymyrit në Leposaviq, si dhe shkritoren e hekurit në Zveçan, është pak a shumë i vdekur. Njerëzit jetojnë nga vendet e punës që Serbia i ka krijuar në sektorin publik. Këto përfshijnë vende të punës në spitalin e Mitrovicës dhe në mbarë sektorin e shëndetësisë, në universitet, në komunat paralele dhe në institucionet shtetërore.¹⁷⁶ Njerëzit mund të gjenin punë, të paktën para shpërthimit të konfliktit rreth pikëkalimeve kufitare në korrik të vitit 2010, duke bërë tregti në zonën gri jashtë kontrollit të qeverisë së Kosovës dhe të kontrolluar lirshëm nga Beogradi.

Pjesa qendrore e viseve malore është rrafsh mjaft i ngritur i cili kalon nëpër malet e Carralevës nga jugu i Mitrovicës deri në komunën e Shtimes. Mitrovica është qendra e vetme urbane në këtë rajon. Industritë e saj dikur ishin të shquara në Kosovë. Sot ato kanë mbetur vetëm kujtime dhe arkeologji industriale. Qyteti i Mitrovicës ndahet në pjesën jugore të banuar me shqiptarë dhe në pjesën veriore të banuar me serbë.

Pjesa qendrore e Kosovës tradicionalisht quhet Drenica, sipas luginës e cila gjendet në pllajën e lart të maleve të Carralevës. Ajo shtrihet nga jugu i

175 Shih Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI), *E ardhmja post-industriale? Ekonomia dhe shoqëria në Mitrovicë dhe Zveçan*. 30 Janar 2004
176 Shih Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), *Mitrovica: Një Qytet, Dy Realitete*, 2009.

Mitrovicës deri në Shtime. Kjo zonë e ndan Kosovën fizikisht. Lidhjet e vetme në mes të Dukagjinit dhe Kosovës lindore janë rruga kryesore Fushë Kosovë-Pejë dhe rruga Shtime-Suharekë. Ekonomia përbëhet nga industria e rëndë e cila u themelua gjatë periudhës socialiste e edhe më herët. Në Mitrovicë ka miniera të hekurit dhe zinkut, të cilat janë ngjallur deri diku pas luftës, megjithatë impiantet e përpunimit janë jashtë funksionit. Miniera ka edhe në Gillogoc (*Drenas*¹⁷⁷) dhe impianti i përpunimit Ferronikeli. Kjo zonë është e banuar vetëm me shqiptarë. Malisheva është komunë tërësisht rurale. Në të vërtetë, e tërë zona është kryesisht rurale, e përbërë nga fshatrat e mëdhenj që kanë shkallë të lartë të emigrimit.

Qendra e Drenicës përbëhet nga tri komuna, Skenderaj, Drenasi dhe Malisheva. Kjo pjesë gjithmonë ka qenë e varfër. Ajo është lënë qëllimisht pas dore nga regjimi komunist në aspektin ekonomik dhe politik. Rrënjët e rezistencës kundër okupimit serb janë të forta në këto anë, dhe datojnë që nga vitet e rivendosjes së sundimit serb, apo jugosllav, në vitin 1918. Serbët e kishin kontrolluar këtë rajon edhe gjatë periudhës 1912-1915. Personalitet nga Drenica kishin rol kyç në lëvizjen guerile anti-serbe *Kaçak*. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, lëvizja nacionaliste *Balli Kombëtar* gëzonte përkrahjen më të madhe nga ky rajon. Shaban Polluzha, i cili njihet për luftën e tij kundër partizanëve në vitin 1944, ishte poashtu nga ky rajon. Gjatë luftës së Kosovës, Drenica ishte zona qëndrore e UÇK-së. Shumica e anëtarëve të UÇK-së, siç janë Adem Jashari si dhe kryeministri aktual Hashim Thaçi, shefi i dikurshëm politik i UÇK-së dhe lider i PDK-së, janë nga këto anë. Si rezultat i kësaj, PDK-ja fiton më tepër se 90 përqind të votave gjatë zgjedhjeve në Drenas dhe Skenderaj.

Në jug të Drenicës, rajoni shtrihet në drejtim të Maleve të Sharrit në komunën e Shtërpçës, më shumicë serbe, dhe komunën e Kaçanikut dhe Hanit të Elezit në kufi me Maqedoninë, të banuara vetëm me shqiptarë. Në komunën e Shtërpçës gjendet qendra për skijim dhe turizëm. Para luftës, Shtërpça kishte një numër të konsiderueshëm të NSH-ve të cilat kishin 860 punëtorë dhe jo vetëm në fushën e turizmit. Rishtazi, serbët e Shtërpçës janë dukshëm

177 Komunitet dhe qytetet e Kosovës që zyrtarisht njiheshin me emra serb dhe shqiptar nga koha e Jugosllavisë. Megjithatë, ka pasur përpjekje nga grupe të ndryshme politike për t'i riemërtuar qytetet dhe komunat, shpeshherë për t'i hequr emrat serb. Suva Reka (serbisht) / Suhareke (shqip) ose Obilić (serbisht) / Obiliq (shqip) janë disa shembuj. Shumica e përpjekjeve megjithatë u treguan të pasuksesshme meqë popullsia shqiptare e Kosovës nuk i pranoi ato. Disa megjithatë janë pranuar, siç është Skenderaj, emërtimi shqip për Sërbicën (Srbica në serbisht) apo Theranda për Suharekën. Mbetet të shihet nëse në të ardhmen, Kuvendi i Kosovës do të inicioj zyrtarisht ndërrimin e emërtimeve.

më pak armiqësor ndaj institucioneve të Kosovës dhe shumë prej tyre morën pjesë në zgjedhjet e fundit. Ekonomia në dy komunat e tjera mbështetet në industrinë e rëndë. Kaçaniku ka një minierë dhe fabrikë të shkurës ndërsa në Han të Elezit gjendet fabrika e çimentos *Sharri*.

Kosova lindore

Kosova lindore përbëhet nga 15 komuna. Ka 776,881 banorë që jetojnë në 196,101 shtëpi të banuara nga 140,091 ekonomi familjare. Rreth 340,070 banorë votuan në zgjedhjet e fundit. Komunitet janë: Vushtrria, Podujeva, Fushë Kosova, Lipjani, Vitia dhe katër komunat e decentralizuara serbe, Graçanica, Klokoti, Parteshi dhe Ranillugu. Komunitet e reja serbe janë rurale por të zhvilluara mirë në fushën e bujqësisë. Komuna e Obiliqit gjendet mbi njërin prej rezervave më të mëdha të qymyrit të linjtit në Evropë.¹⁷⁸ Termocentralet e Obiliqit prodhojnë shumicën e energjisë elektrike në Kosovë. Ferizaji dhe Gjilani janë qytete të dikurshme industriale të cilat sot ballafaqohen me ditë shumë të vështira. Prishtina është qyteti më i madh në Kosovës dhe qendra ekonomike ku janë të vendosura qeveria, shërbimet financiare, shëndetësia dhe institucionet e arsimit. Novobrda është komuna e vetme malore në këtë rajon e cila poashtu ka miniera të zinkut dhe hekurit.

Në lindje të viseve malore, fushat më pjellore të Kosovës shtrihen nga Vushtrria në veri deri në Ferizaj në jug. Dy lugina të ndara shtrihen në lindje të këtyre fushave. Komuna e Podujevës gjendet në verilindje të Prishtinës dhe kufizohet me pjesën qëndrore të Serbisë. Rrafshi i Anamoravës shtrihet nga Ferizaji, përgjatë maleve të Karadakut, në kufi me Maqedoninë, drejt Gjilanit dhe në luginën e Kamenicës, në kufi me pjesën jugore të Serbisë. Komuna e Novobërdës gjendet në malet e Gollakut në perëndim të Prishtinës.

Nëse i shikojmë rezultatet e zgjedhjeve gjatë periudhës 2000-2010, mund të vërejmë se këto dallime gjeografike janë përkthyer në trendet të ndryshme sociale dhe rajonale të votimit. Këto janë bërë edhe më të theksuara gjatë dekadës së fundit dhe kanë pasojë të qarta në politikën kombëtare.

Bastionet

Në zgjedhjet e para lokale në vitin 2000, tri partitë kryesore – LDK, PDK dhe AAK – së bashku fituan 89.5 përqind të votave në Dukagjin, 96.1 përqind

178 Shih: M. Rizaj, E. Beqiri, I. McBow, E.Z. O'Brien, dhe F. Kongoli, Baza Minerale dhe Kapacitetet Prodhuese të Metaleve dhe jo-Metaleve në Kosovë, Zhurnal i Shoqërisë mbi Minerale, Metalet dhe Materialet, vol. 60, nr. 8. *Shih*: <http://www.springerlink.com/content/v3662817182g3134/fulltext.pdf>.

Viti i zgjedhjeve	Kosova perëndimore		Rajoni i Drenicës		Kosova lindore	
	2000L	2010P	2000L	2010P	2000L	2010P
Votat totale	265,527	245,682	125,096	129,692	296,709	322,343
LDK	161,535	59,804	49,694	16,257	187,643	96,430
PDK	45,214	57,697	67,680	86,156	74,925	80,371
AAK	30,878	52,575	2,840	5,280	19,356	19,248
Partitë tjera	27,900	75,606	4,882	21,999	14,785	126,294

	2000	2010
Totali i votave të tri partive kryesore	89.50%	70.50%
LDK-PDK-AAK në Kosovën perëndimore	89.50%	69.23%
LDK-PDK-AAK në rajonin e Drenicës	96.10%	83.04%
LDK-PDK-AAK në Kosovën lindore	87.50%	60.82%
Partitë e tjera mbi 1%	0%	27.60%
Totali i partive nën 1%	10.50%	1.90%


të votave në rajonin e Drenicës dhe 87.5 përqind të votave në Kosovën lindore. Ishte e qartë që derisa AAK-ja ishte aktor i rëndësishëm në Kosovën perëndimore, PDK-ja dominonte në rajonin e Drenicës, ndërsa LDK-ja në Kosovën lindore. Edhe pse mund të ketë qenë e natyrshme të pritët se këto ndarje rajonale do të shkriheshin me kalimin e kohës, realiteti ka dëshmuar tërësisht të kundërtën e kësaj. Secila prej tri partive kryesore ka shfaqur tendencë të shtuara për dominimin e një rajoni në raport me dy partitë e tjera.

Tri partitë e mëdha, në përgjithësi, mbesin të mëdha. Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, ato së bashku siguruan 83 përqind të të gjitha votave valide në rajonin e Drenicës. Megjithatë, në Dukagjin kjo shifër ishte 69.2 përqind dhe në Kosovën lindore 66.1 përqind. Secili rajon ka lojtarin e vet kyç. Në Dukagjin për shembull, AAK-ja e ka zgjeruar bazën e saj në mënyrë të konsiderueshme mirëpo plotësisht ka dështuar ta shtoj joshjen e votuesve në pjesët tjera të vendit. Në çdo palë zgjedhje, PDK-ja e ka forcuar përkrahjen e saj në rajonin e Drenicës dhe ka arritur ta zgjerojë këtë duke u shtrirë në drejtim të lindjes dhe të perëndimit. PDK-ja megjithatë nuk ka arritur ti fitoj zonat e humbura nga LDK-ja. Derisa LDK-ja, natyrisht, ka humbur kontrollin mbi tërë Kosovën që e kishte para luftës, kjo parti ka shënuar një kthim të konsiderueshëm në Kosovën lindore. Partitë e reja, jo PDK-ja dhe AAK-ja, kanë përfituar më së tepërmi nga kjo rënie.

Shkaktari kryesor i këtyre ndryshimeve mund të gjendet në rënien dhe shpërbërjen e LDK-së. Në vitin 2000, LDK-ja ishte ende parti me shtrirje më të gjerë në Kosovë. Prandaj, në zgjedhjet lokale të vitit 2000, kjo parti fitoi 21 nga 27 komunat e atëhershme. Ajo fitoi 60.8 përqind të votave në Dukagjin, 58.2 përqind në Kosovën lindore dhe madje 39.7 përqind të votave valide në rajonin e Drenicës. Në vitin 2010, ajo e kishte humbur këtë dominim. LDK-ja fitoi vetëm katër nga 37 komunat, duke udhëhequr në Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Podujevë, të cilat të gjitha shtrihen afër kryeqytetit.

Gjatë periudhës 2000-2010, numrat e votuesve të LDK-së ranë nga 398,872 në 172,491, rënie prej 56.8 përqind. Në vitin 2010, vetëm 24.3 përqind të votuesve në Dukagjin votuan për LDK-në, në rajonin e Drenicës ky numër ishte 12.5 përqind. Vetëm në Kosovën lindore, LDK-ja arriti të qëndroj më e fortë se PDK-ja, me 32.5 përqind. Ky zhvillim e ndryshoi LDK-në nga një parti me shtrirje në tërë Kosovën në një parti rajonale. Derisa në vitin 2000, Kosova lindore përbënte 47 përqind të përkrahjes së saj, në vitin 2010 kjo shifër arriti në 55.9 përqind. Megjithatë, këtu kemi një trend brenda një trendi tjetër. Zgjedhjet komunale të vitit 2009 tregojnë që LDK-ja ka mbajtur bazë të fortë komunale. Partia doli e para në shtatë komuna – Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Suharekë, Istog dhe Zubin Potok (për shkak të bojkotit serb) dhe mori pjesë në 12 kuvende komunale. LDK-ja poashtu ka shtatë

Bastionet e partive politike në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 (partitë që fituan më shumë se 40 përqind)



kryetar të komunave të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejt.

Rënia e LDK-së mund të shihet në faktin se në mes zgjedhjeve lokale të vitit 2000 dhe zgjedhjeve parlamentare të vitit 2004, ajo humbi më tepër se një të pestën e votuesve të saj. Pastaj në vitin 2006, partia u godit nga vdekja e Rugovës dhe në vitin 2007 nga përleshjet brendapartiake të cilat çuan në largimin e ish-anëtarit të kryesisë Nexhat Daci i cili mori me vete disa anëtarë dhe formoi LDD-në.

LDD-ja megjithatë nuk ia arriti t'ia zinte vendin LDK-së. Ajo mori kryesisht votat e përkrahësve të dikurshëm të LDK-së në zonat kufitare dhe në rajonin e Drenicës. Në zgjedhjet komunale të vitit 2007, LDD-ja e mposhti LDK-në në Kamenicë, Viti dhe Ferizaj dhe e përgjysmoi përkrahjen për LDK-në në qytetin e Gjilanit. Kjo është e ashtuquajtura Anamorava, me numër të konsiderueshëm të emigrantëve dhe njerëzve me prejardhje nga

Maqedonia dhe Serbia jugore. Daci është njëri prej tyre. Ai vjen nga fsahti Tërnoc i Serbis, e banuar me shqiptarë dhe është afër kufirit me Kamenicën. Në rajonin e Drenicës, LDD-ja arriti të fitonte poaq vota sa LDK-ja në Drenas dhe Skenderaj, por përkundër programit të saj më nacionalist nuk arriti të merrte votues nga PDK-ja. Në Kosovën perëndimore, LDD-ja fitoi poashtu numrin përafërsisht të njëjtë të votave si LDK-ja në Deçan dhe Pejë (gjithashtu edhe në Shtimë). Në Klinë, Kaçanik, Gjakovë dhe Lipjan, LDD-ja arriti të merrte rreth një të tretën e përkrahësve të LDK-së.

Megjithatë, në zgjedhjet komunale të vitit 2009, baza e përkrahësve të LDD-së kishte filluar të zvogëlohej. Këtë herë, LDD-ja fitoi vetëm në komunën e Vitisë. Rezultatet zgjedhore tregojnë që një pjesë e madhe e votuesve të tyre tashmë kishin zgjedhur *Vetëvendosjen!* programi nacionalist i së cilës mund të ketë qenë më i bindshëm për votuesit urban.

Besohet që PDK-ja arriti ta merrte pushtetin në vitin 2010 vetëm kur i'a kishte dalë të fitonte përkrahje jashtëzakonisht të madhe në rajonin e Drenicës dhe t'i mposhte partitë e tjera. Është e qartë që qysh nga viti 2000, rajoni i Drenicës ka qenë qendra e përkrahjes për PDK-në, mirëpo përveç rënies së vogël në zgjedhjet parlamentare të vitit 2004, PDK-ja ka arritur ta zgjerojë përkrahjen edhe në pjesët tjera të Kosovës, nga 187,821 votues në vitin 2000 në 224,339 votues në vitin 2010. Kështu, PDK-ja e rriti përkrahjen e përgjithshme nga 27.1 përqind në rrafshin kombëtar në vitin 2000 në 32.6 përqind në vitin 2010. Gjysma e kësaj rritje erdhi nga rajoni i Drenicës.

Në rajonin e Drenicës u shtua edhe numri i votuesve. Në Kosovën perëndimore, në periudhën 2000-2010 numri i votave valide shënoi rënie prej 7.4 përqind, nga 265,527 në 245,682. Në rajonin e Drenicës, numri i votave valide u rrit nga 125,096 në vitin 2000 në 129,692 në vitin 2010, ose për 3.7 përqind. Në Kosovën lindore, numri i votave u rrit për 8.6 përqind kryesisht si rezultat i mobilizimit të votuesve në Prishtinë, ku votat shënuan rritje prej 34 përqind nga zgjedhjet lokale të vitit 2009 në zgjedhjet e përgjithshme në vitin 2010. Ky mobilizim kryesisht mund ti atribuohet efektit të *Vetëvendosjes!*. Prandaj, suksesi i PDK-së i ka disa elemente kyçe. Njëri është që kundërshtarët janë dobësuar dhe tjetri është që kjo parti është zgjeruar gradualisht dhe ka konsoliduar kontrollin e saj anëmbanë rajonit të Drenicës.

Në zgjedhjet lokale në vitin 2000, PDK-ja fitoi 54.1 përqind të votave në rajonin e Drenicës, por fitoi vetëm në Skenderaj, Drenas, Shtime dhe Kaçanik. Në atë kohë, LDK-ja fitoi 39.7 të votave në rajonin e Drenicës. Në vitin 2004, PDK-ja doli e para edhe në Malishevë dhe në Shtërpce. Duke i shfrytëzuar zënkat në LDK, PDK-ja arriti ta shtrinte dominimin e saj në zgjedhjet lokale të vitit 2007, duke e shtuar kontrollin e saj prej gjashtë në 14 komuna prej numrit të përgjithshëm të 30 komunave në atë kohë. Ajo megjithatë arriti ta bënte këtë jo sepse ishte bërë më e fuqishme por sepse LDK-ja kishte humbur përkrahje. Që atëherë, PDK-ja doli më së miri në tri qytetet e mëdha – Mitrovicë dhe Prizren – ku LDK-ja kishte humbur vota, dhe në Gjilan ku arriti të bëhej partia e parë pa fituar vota të reja. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010, PDK-ja shtoi dominimin e saj në 18 prej numrit të përgjithshëm të 36 komunave.

Suksesi i PDK-së tregon dallime të dukshme rajonale. Në rajonin e Drenicës, PDK-ja u rrit nga 54.1 përqind në vitin 2000 në 66.4 përqind në vitin 2010, apo me afro 20,000 vota. Në Dukagjin, PDK-ja fitoi vetëm 17 përqind në vitin 2010. Në vitin 2010, ajo fitoi 23.5 përqind. Kjo rritje kryesisht erdhi

në komunën e Gjakovës, Prizrenit dhe Dragashit dhe vetëm pjesërisht në Klinë dhe Malishevë. Në Kosovën lindore, megjithatë, PDK-ja fitoi 24.9 përqind në vitin 2000 dhe në vitin 2010 kjo përkrahje ishte rritur vetëm në 25.3 përqind.

AAK-ja gjithnjë ka qenë dhe mbetet para së gjithash parti rajonale. Derisa PDK-ja ka arritur ta shtrijë ndikimin e saj në shkallë të konsiderueshme nga rajoni i Drenicës në rajonet fqinje, AAK-ja në anën tjetër e ka forcuar përkrahjen e saj në bastionin e saj në Dukagjin. Që nga viti 2000, AAK-ja ka qenë e fuqishme në rajonin që shtrihet nga Peja deri në Gjakovë. Megjithatë, AAK-ja nuk arriti të udhëhiqte në këto komuna derisa nuk fillo rënia e LDK-së. Që atëherë, AAK-ja është bërë partia e parë në Pejë, Gjakovë dhe Deçan, dhe pas decentralizimit, edhe në komunën e re të Junikut. Në vitin 2000, partia fitoi 53,074 vota dhe në vitin 2007 vetëm 54,611 vota në zgjedhjet e përgjithshme. Megjithatë, në vitin 2009, pas kthimit të liderit të saj, Ramush Haradinaj, nga Haga, përkrahja për partinë arriti në 95,066 vota. Kjo pastaj shënoi rënie në 77,130 në vitin 2010, kur Haradinaj u desh të kthehej për rigjykim në Hagë.


Prej vitit 2000 deri në vitin 2010, AAK-ja e dyfishoi përqindjen e votave në Dukagjin nga 11.6 përqind në 21.4 përqind. Edhe në rajonin e Drenicës e dyfishoi përkrahjen e saj nga përqindja modeste 2.3 në 4.1 përqind. Në Kosovën lindore, në vitin 2000 AAK-ja kishte fituar 6.0 përqind dhe në vitin 2010 vetëm 6.5 përqind. Në rezultatit e saj më të mirë në vitin 2009, AAK-ja arriti të fitonte përkrahjen e 23.3 përqind të votuesve në Dukagjin, 8.0 përqind në rajonin e Drenicës dhe 11.3 përqind në Kosovën lindore.

Ndarja Rurale-Urbane

Në vitet 2001, 2004 dhe 2007, qeveritë e Kosovës ishin të gjitha koalicionet që ishin arritur si rezultat i marrëveshjeve në mes dy prej tri partive kryesore.

Kjo megjithatë ndryshoi në vitin 2010 kur PDK-ja formoi koalicionin me partitë e vogla shqiptare dhe ato të pakicave. Para ditës së zgjedhjeve, PDK-ja kishte arritur pakt parazgjedhor me ADK-në e Edita Tahirit dhe PPK-në e Bajram Kosumit. Pas zgjedhjeve, PDK-ja formoi koalicionin me partinë minoritare turke, KTDP-në, SLS-në serbe dhe AKR-në. Kjo e fundit kishte hyrë në zgjedhje së bashku me PD-në, PSD-në, PGJK-në, PNDSh-në, PPK-në, PPI-në dhe me grupin e ekspertëve ekonomik E15. AAK-ja kishte formuar aleancë parazgjedhore me *Listën Ibrahim Rugova* të udhëhequr nga Ukë Rugova. Më vonë, Rugova do ta prishte marrëveshjen me AAK-në për të hyrë në qeveri së bashku me PDK-në.

Bastionet e partive politike në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010 (partitë që fituan më shumë se 40 përqind)



Nëpërmjet krijimit të aleancës shumë-partiake, PDK-ja arriti ta shfrytëzoj disavantazhin e skenës së ndarë politike. Njëkohësisht, ajo arriti ta trajtoj një dobësi të vazhdueshme brenda vetes – paaftësinë për të mobilizuar votuesit urban. Shumica e partive të vogla, të cilat u futën në koalicion me PDK-në, i fituan votat e tyre në zonat urbane.

Në sjelljen e votuesve në Kosovë shihet qartë ndarja rurale-urbane. Komunat në Kosovë poashtu mund të ndahen në ato rurale dhe urbane, për shkak të faktit se ato kryesisht kanë mbetur të njëjta si kur janë krijuar gjatë sundimit socialist jugosllav. Ato ishin krijuar për t'iu përshtatur konceptit të atëhershëm të zhvillimit socialist, i cili kombinonte decentralizimin dhe vetëqeverisjen me politikën e ndërlidhur të alokimit të fondeve që datonte qysh nga vitet 1950. Kështu, qytetet që veç më ekzistonin në Kosovë në fund të Luftës së Dytë Botërore u shndërruan në

caqe primare të zhvillimit socialist. Qytetet që kishin numër të konsiderueshëm të serbëve apo malazezve, siç ishin Mitrovica, Peja dhe Prishtinë, që atëkohë përfshinte Fushë Kosovën dhe Obiliqin, u favorizuan dukshëm. Së bashku me Prizrenin, Gjakovën, Gjilanin dhe Ferizajin, ato ishin qendrat kryesore urbane, dhe që nga vitet 1950, u zhvilluan me akordime industriale nga lartë-poshtë dhe me sigurime sociale. Shumica e industrive të asaj kohe sot janë jashtë përdorimit. Çdo qytet më i madh ka tregimin e vet industrial, shumica e të cilëve kanë përfundim të dhimbshëm, ose të paktën përfshijnë mbylljen e impianteve industriale.

Në fund të Luftës së Dytë Botërore, Kosova, si tërë Jugosllavia, ishte kryesisht rurale, shumë e varfër, kishte pak infrastrukturë dhe fare pak fonde për zhvillim. Modeli socialist për zhvillim parashihte krijimin e komunave të reja përreth vendbanimeve më të vogla qendrore, shpeshherë me popullsi të përzier

etnike, që do të planifikoheshin dhe ndërtoheshin nga zeroja, për tu zhvilluar pastaj në qendra urbane. Kosova megjithatë ishte ndryshe dhe deri në fund të viteve 1960 nuk kishte qasje në fondet e mëdha, posaçërisht në fondet e decentralizuara që synonin zonat rurale. Prandaj, komunat e vogla, në shumicën e rasteve, nuk u zhvilluan deri para viteve 1970. Me shkallën e shtuar të autonomisë në vitet 1970, dhe zgjerimin e fondeve zhvillimore për krahinën nga niveli federal, filluan të bëhen akordime më të mëdha industriale për komunat e vogla rurale, ku kryesisht përdorreshin në agrikulturë dhe në agroindustri. Ky proces u ndërpre në mesin e viteve 1980.

Sot, në këto komuna, gjejmë qytete të vogla, gjysmë të zhvilluara, me kryetarë të komunave, kuvend komunal, institucione shtetërore dhe kulturore, shkolla fillore dhe të mesme, qendra mjekësore dhe rrugë të asfaltuara. Në kohët e kaluara, ofrohej edhe banim për elitën politike socialiste dhe për punëtorët e sektorëve industrial. E gjithë kjo megjithatë rrethohet nga fshatra të mbipopulluar dhe kryesisht të pazhvilluar. Prandaj, të gjitha këto komuna ende i kanë karakteristikat e tyre gjysmë-rurale.

Sot, procesi i decentralizimit, i paraparë nga plani i Ahtisaarit i cili hapi rrugën për shpalljen e pavarësisë në vitin 2008, ka krijuar shtatë komuna të reja të vogla dhe kryesisht rurale. Logjika e këtij procesi është krejtësisht ndryshe nga ajo që ka ndodhur më herët. Së paku pesë prej tyre ishin krijuar për të fuqizuar dhe siguruar pakicat, dhe për ti mundësuar komunat e tyre, të paktën në rastin e komunave serbe, të kenë lidhje të veçanta me Serbinë, siç ishte paraparë në planin e Ahtisaarit. Ranillugu, Kllokoti dhe Parteshi gjenden në pjesën lindore të Kosovës dhe janë tejet rurale. Graçanica është poashtu kryesisht rurale por gjendet në një vendbanim të madh gjysmë-urban i cili është ndarë për serbët nga komuna e Prishtinës. Ngjashëm, komuna rurale e Mamushës është ndarë për turqit nga komuna e Prizrenit. Juniku është ndarë nga Deçani në pjesën perëndimore të Kosovës. Kjo është komunë rurale e banuar me shqiptarë. Hani i Elezit është komunë kryesisht malore por gjendet në një qytezë me emrin e njëjtë afër fabrikës së çimentos Sharri në kufi me Maqedoninë. Nëse në të ardhmen, komuna e paraparë e Mitrovicës së veriut i afrohet realitetit, ajo do të jetë komuna-qytet e parë, e dizajnuar përsëri mbi kriteret etnike, për serbët.

Ndërkohë, Prishtina dhe qytetet e mëdha, si Prizreni, Peja, Gjakova, Ferizaj, Gjilani dhe Mitrovica, po bëjnë përpjekje të gjejnë ringjallje ekonomike pas deindustrializimit pothuajse të plotë. Hulumtimet e kryera nga Njësi i Mësimave të Nxjerra dhe Analizave i Shtyllës së BE-së në UNMIK, në vitin

2003-04, treguan që Mitrovica, e cila dikur kishte industri të zhvilluar, në atë kohë kishte më pak industri prodhuese sesa komuna rurale e Vitisë e cila kishte zhvilluar një sektor klandestin privat me ndihmën e dërgesave nga diaspora.¹⁷⁹

Hulumtimet e bëra nga IKS në periudhën 2005-06 treguan që Prishtina nuk kishte fare industri funksionale të përpunimit përveç fabrikës së dyerve dhe dritareve, shtypshkronjave dhe një impianti që prodhon keçap.¹⁸⁰ Zhvillimi në zonat urbane pas luftës në vitin 1999 prandaj u arrit kryesisht nëpërmjet projekteve të mëdha të banimit dhe ndërtimitarisë në përgjithësi. Kjo synonte të përmbushte kërkesën e shtuar për banim dhe fluksin e pas luftës të njerëzve nga fshati dhe personave që ktheheshin nga vendet e jashtme, si dhe kërkesës së shtuar nga zyrtarët e huaj që punonin për misionet e ndryshme ndërkombëtare. Ndërtimtaria, posaçërisht ajo ilegale, së bashku me tregtinë, ka qenë karakteristikë dominuese e “planifikimit” aktual për zonat urbane.

Si duhet ta analizojmë sjelljen e votuesve në zonat urbane dhe rurale? Komunat me qytete të mëdha kryesisht banohej nga popullsia urbane me vetëm një përqindje të vogël të njerëzve që banojnë në zonat rurale. Në anën tjetër, komunat rurale kryesisht përbëhen nga popullatat e fshatrave të mëdha me përqindje dukshëm më të vogël të banorëve në qendrat e tyre gjysmë-urbane. Prandaj, ne e kemi analizuar ndarjen rurale-urbane duke i krahasuar sjelljet e votuesve të komunave rurale me atë të gjashtë komunave urbane.

Numri i votuesve në komunat rurale është i ngjashëm me atë të zonave urbane. Në të gjitha zgjedhjet lokale dhe parlamentare, popullata e komunave urbane ka hedhur në mes 277,000 dhe 355,000 vota. Ngjashëm me këtë, popullata e komunave rurale ka hedhur në mes 287,000 dhe 362,000 vota. Trendi i parë i dukshëm është që votat në komunat rurale në dekadën e fundit janë rritur për rreth 20,000, derisa numri i votave në zonat urbane tregon rënie prej rreth 40,000 votave. Në vitin 2009, votuesit në komunat rurale hodhën pesë përqind më tepër vota se votuesit e komunave urbane dhe në vitin 2010 kjo shifër ishte rreth katër përqind.

Preferencat e votuesve në komunat rurale dallojnë dukshëm nga ato të votuesve në komunat urbane për të gjitha partitë, përveç për LDK-në dhe AAK-në. Këto dy parti tregojnë rezultate të ngjashme në zonat rurale dhe urbane. PDK-ja është partia e vetme e cila vazhdueshëm ka më tepër përkrahje në komunat rurale sesa në ato urbane. Në anën tjetër, partitë më të

179 ESI Njësi për Mësimet e Nxjerra dhe Analizat në Shtyllën e Katërt të UNMIK-ut, dokument i brendshëm.

180 Hulumtim i IKS në Prishtinë në 2005.

Preferencat elektorale në komunat urbane dhe rurale 2000 – 2010 sipas votave valide.

	Komunat urbane	Komunat rurale	Total	vota "urbane" %	vota "rurale" %
2000 local	354,555	332,777	687,332	51,6%	48,4%
2001 parliamentary	355,376	346,669	702,045	50,6%	49,4%
2002 local	353,874	345,525	699,399	50,6%	49,4%
2004 parliamentary	348,400	337,479	685,879	50,8%	49,2%
2007 local	277,592	288,327	565,919	49,1%	50,9%
2007 parliamentary	277,864	287,670	565,534	49,1%	50,9%
2009 local	298,582	331,732	630,314	47,4%	52,6%
2010 parliamentary	334,839	362,878	697,717	48,0%	52,0%

Preferencat elektorale në komunat rurale dhe urbane 2000- 2010, sipas partive

	Komunat urbane/rurale	LDK	LDD	PDK	AAK	ORA	AKR	FER	VV
2000 L	Urbane	63.4%		20.1%	8.1%				
	Rurale	52.4%		35.0%	7.3%				
2001 P	Urbane	53.4%		21.5%	10.6%				
	Rurale	44.6%		34.8%	6.3%				
2002 L	Urbane	48.8%		23.3%	10.5%				
	Rurale	43.0%		36.0%	7.1%				
2004 P	Urbane	46.7%		20.9%	8.5%	10.1%			
	Rurale	44.1%		37.3%	8.3%	2.3%			
2007 L	Urbane	21.6%	10.1%	25.0%	10.1%	6.6%	16.0%		
	Rurale	23.9%	8.7%	41.4%	9.9%	1.7%	7.9%		
2007 P	Urbane	21.2%	10.9%	25.8%	10.0%	6.8%	16.4%		
	Rurale	23.8%	8.8%	42.9%	9.1%	1.7%	8.4%		
2009 L	Urbane	25.8%	8.1%	23.2%	14.3%	2.9%	11.6%		
	Rurale	23.2%	6.4%	39.5%	15.8%	0.2%	5.7%		
2010 P	Urbane	25.8%	2.6%	23.1%	11.5%		10.3%	3.6%	15.8%
	Rurale	23.7%	1.7%	40.5%	10.6%		4.5%	0.9%	9.8%

vogla, LDD-ja, ORA, FER-i, AKR-ja dhe *Vetëvendosja!* gjithmonë kanë kaluar më mirë në komunat urbane sesa në ato rurale.

Duke mos arritur ta zgjeroj bazën e saj të përkrahjes në zonat urbane, PDK-ja nuk përfitoi në mënyrë të drejtpërdrejt nga rënia e përkrahjes për LDK-në. Në anën tjetër, ajo ka përfitur nga rritja e numrit të votuesve në zonat rurale, derisa numri i votuesve në zonat urbane ka shënuar rënie.

Në vitin 2000, LDK-ja ishte ende parti që mund të llogariste në përkrahjen e rreth 11 përqind më tepër votuesve urban në krahasim me votuesit e saj në zonat rurale. Në vitin 2002, dallimi në mes votuesve urban dhe rural u ngushtua në pesë përqind dhe në

zgjedhjet parlamentare të vitit 2004 në 2.6 përqind. Që atëherë, ky dallim ka mbetur marginal në të gjitha zgjedhjet.

AAK-ja, në përgjithësi, arrin të mobilizoj numër të ngjashëm të votuesve në të dy llojet e komunave. Vetëm në periudhën 2001-02, kur partia pësoi rënie, ajo humbi më tepër vota në zonat rurale sesa në qytetet e mëdha.

PDK-ja, në anën tjetër, gjithmonë ka pasur më tepër votues rural sesa urban. Në zgjedhjet lokale të vitit 2000, margjina e diferencës ishte 15 përqind por në vitin 2010 kjo ishte rritur në 17.4 përqind. Edhe pse PDK-ja e rriti hisen e votës nga 26.3 përqind në 31.8 përqind, ky proces ndodhi kryesisht në zonat rurale. Ky ishte

Rezultatet e grupeve etnike në zgjedhjet komunale dhe parlamentare në Kosovë 2000 - 2010

Zgjedhjet	Totali i votave valide të pakicave	Partitë turke: KDTP, KTB	Partitë boshnjake: BSDAK, SDA, VAKAT, NDS, SDP	Partia gorane: GIG	Partia malazeze: CDS	Partitë ashkalinje: PDASHK, PDAK, BDA, PAI	Partitë egjiptase: PAI, IRDK, LEK	Partia rome: PREBK	Partitë serbe të Kosovës: KP, GIS, SLKIM, SNS, ND, SLS, JSL, SDSKIM, SKMS, SNSDKIM
2000L	13,973	0	7,721	1,789	0	1,552	0	0	2,911
2001P	119,398	7,879	11,936	0	0	3,502	3,976	2,717	89,388*
2002L	37,198	7,760	8,294	1,505	0	3,265	3,136	0	13,238
2004P	27,061	8,353	8,944	1,358		2,916	2,658	1,049	1,783
2007L	20,209	5,184	7,737	989	0	2,718	2,135	442	1,004
2007P	24,517	4,999	9,089	1,227	0	3,443	2,121	600	3,038
2009L	27,910	7,497	9,411	454	470	2,542	2,306	596	4,634
2010P	51,675	9,912	11,194	787	771	2,871	4,086	690	21,364

* Votat për partitë serbe në zgjedhjet e vitit 2001 përfshijnë edhe votat e hedhura në Serbi dhe Mal të Zi – total 56,318.

rezultat i natyrës rurale të qendrës së Drenicës. Nëpër qytete, PDK-ja nuk ka arritur të josh votues të rinj. Shembull i mirë për këtë është Ferizaji. Në periudhën 2004-2007, LDK-ja humbi afro 20,000 vota por PDK-ja nuk fitoi më tepër se 500 vota të reja në vitin 2007.

As AAK-ja nuk ka qenë në gjendje të fitoj votat e humbura të LDK-së, të cilat i kanë ikur edhe PDK-së. Kjo për shkak se AAK-ja është në efekt, nëse jo me plan, parti thellësisht rajonale. Derisa votuesit urban e humbën besimin në LDK, ata nuk ia ofruan përkrahjen e tyre dy partive tjera të mëdha. Si rezultat i kësaj, partitë e tjera po e kërkojnë përkrahjen e tyre, siç janë ORA, FER-i, AKR-ja dhe *Vetëvendosja!*

Gjatë kulmit të saj në zgjedhjet e vitit 2004 dhe 2007, ORA ishte parti dukshëm urbane. Në vitin 2004, ajo fitoi 10.1 përqind të votave urbane por vetëm 2.3 përqind të votave rurale. Në zgjedhjet lokale dhe parlamentare të vitit 2007, këto shifra ishin 6.6 dhe 6.8 përqind të votave urbane dhe vetëm 1.7 përqind të votave rurale.

Edhe AKR-ja është kryesisht parti urbane. Pas themelimit, AKR-ja fitoi rreth 16 përqind në zgjedhjet lokale të vitit 2007 dhe 16.4 përqind të votave në zgjedhjet parlamentare në zonat urbane. Në anën tjetër, në komunat rurale, kjo parti fitoi vetëm 7.9 përqind dhe 8.4 përqind. Që atëherë, partia ka shënuar trajektore në rënie, por përqindjet e votave kanë mbetur përafërsisht të njëjta. Një e treta e përkrahjes për partinë vjen nga zonat rurale dhe pjesa tjetër nga zonat urbane.

Vetëvendosja! poashtu është parti dukshëm urbane me 15.6 përqind të votave në zonat urbane në zgjedhjet e vitit 2010. Megjithatë, partia po arrin të fitoj edhe 9.8 përqind të votave rurale.

Partia e fundit e vogël urbane është FER-i. Në zgjedhjet parlamentare 2010, FER fitoi 3.6 përqind të votave urbane dhe 0.9 të votave në komunat rurale. Meqë kjo nuk mjaftoi për të hyrë në parlament, partia bëri vetëvrasje politike dhe teknikisht u shkri në *Vetëvendosje*.

Partitë etnike

Partitë etnike apo minoritare janë faktori i fundit që i jep një element gjeografik shpërndarjes së votave. Pakicat janë të shpërndara jo njëjloj në mbarë vendin. Për shkak të përfaqësimit të tyre të garantuar në parlament dhe komuna, ato janë në pozitë të fitojnë pozita të fuqishme në skenën politike, nëse elektorati shqiptar nuk i jep fuqi të mjaftueshme partive kryesore politike.

Përveç pakicave etnike, ka edhe parti shqiptare që kanë orientime të dallueshme fetare. Në Kosovë ka traditë të partive shqiptare katolike, edhe pse katolikët përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të popullsisë shqiptare. Këto parti kanë luajtur rol aktiv social dhe politik që nga fillimi i viteve 1990. Meqë shqiptarët katolikë janë, si serbët dhe të tjerët, të shpërndarë jo njëjloj nëpër Kosovë, këto partitë në dhe në rrethinën e Prizrenit, Gjakovës, Klinës dhe Vitisë, ata i kontribuojnë dimensionit rajonal të

shpërndarjes së votuesve. Kohëve të fundit, ka dalë në pah edhe fenomeni i partive që synojnë specifiktisht votën e myslimanëve në mesin e shqiptarëve. Këto parti megjithatë nuk mund të konsiderohen “parti etnike.” Katolikët nuk mund të përfitojnë nga ulëset e rezervuara në parlament për pakicat, meqë ata janë pakicë fetare dhe jo etnike, dhe shqiptarët myslimanë janë natyrisht shumicë dërrmuese e popullatës.

Partitë etnike janë fenomen i veçantë. Së pari, Neni 3 i Kushtetutës e një karakterin multi-etnik të shoqërisë duke e përshkruar Kosovën si vend multi-etnik “i përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera.”¹⁸¹ Artikulli 57-62 të Kapitullit III përcaktojnë dispozitat për mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe për promovimin e mirëqenies së tyre sociale, kulturore dhe politike. Neni 61 në mënyrë të qartë thotë që “komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë në përfaqësim të barabartë në punësim në institucionet publike dhe në ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet.” Kushtetuta poashtu njeh që përveç gjuhës shqipe, gjuha serbe ka status të njëjtë dhe që boshnjakët, romët dhe turqit janë të barabartë në të gjitha nivelet komunale, në fushat ku janë të përfaqësuar fuqishëm (Neni VI).¹⁸² Përveç kësaj, dhe ç’është më interesante për skenën politike, janë rregulloret të cilat ofrojnë përfaqësim të rezervuar e të veçantë parlamentar për komunitetet e ndryshme.

Në Nenin 148, rregullorja e përkohshme flet për shpërndarjen e 20 ulëseve të rezervuara në parlament. Atu thuhet që në dy parlamentet e para pas shpalljes së pavarësisë, 10 ulëse do t’i ndahen “partive, koalicionëve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur që deklarohen si përfaqësues të komunitetit serb të Kosovës.”¹⁸³ Nga një ulëse është e rezervuar për komunitetin romë, një për atë ashkali, një për komunitetin egjiptas, dhe një ulëse tjetër për njërin prej këtyre tri komuniteteve. Boshnjakët i kanë tri ulëse, turqit dy ulëse dhe goranët një ulëse të rezervuar. Neni 64 rregullon strukturën e kuvendit në planin afatgjatë sipas konceptit të njëjtë.¹⁸⁴ Rregullore shumë të ngjashme kanë ekzistuar edhe në kornizën me të cilën Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) zhvilluan zgjedhjet prej vitit 2000 e deri në shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008.¹⁸⁵

Pas ndarjes së “ulëseve të rezervuara” për pakicat, votat numërohen edhe një herë si pjesë e votës totale

181 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Artikulli 3, 2008. <http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf>

182 Po aty. Kapitulli III. 2008

183 Po aty. Artikulli 148. 2008.

184 Po aty. Artikulli 64. 2008.

185 Rregullorja e UNMIK-ut 2001/0. Në kornizën kushtetuese për vetëqeverisje te përkohshme ne Kosovë.

(përfshirë këtu të gjitha votat për partitë joetnike) që rezultojnë me ulëse të tjera në mesin e 100 ulëseve të mbetura. Kjo shkakton diskriminim pozitiv për partitë etnike. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001, partitë e pakicave fituan 15 ulëse shtesë përveç 20 ulëseve të tyre të rezervuara. Në vitin 2004, ato fituan dy ulëse shtesë, në vitin 2007 katër dhe në vitin 2010 pesë.

Rezultatet e tetë palë zgjedhjeve që nga viti 2000 pasqyrojnë shumëllojshmërinë e vetëpërceptimit kombëtar dhe etnik por edhe mungesën e serbëve të Kosovës për të marr pjesë në procesin zgjedhor.

Kjo rregullore zemërgjerë i ka disa gabime. Për shembull, ajo nuk përmban asnjë dispozitë se çfarë duhet bërë nëse një komunitet pakicë i bojkoton zgjedhjet. Kështu që kur serbët nuk morën pjesë në zgjedhjet e vitit 2004 dhe 2007, kjo çoi në një situatë ku ato parti serbe të cilat morën pjesë në zgjedhje i morën të gjitha ulëset e rezervuara për komunitetin serb në parlamentin e Kosovës, edhe pse kishin fituar vetëm disa qindra vota gjë që e vinte në pyetje kredibilitetin dhe legjitimitetin e tyre.

Në zgjedhjet e vitit 2010, kishte interesim të shtuar për këto ulëse dhe në skenën politike u futën katër parti të reja:

- Një parti e re turke, *Kosova Türk Birliki* – Unioni i Turqve të Kosovës - KTU.
- Një parti të reja boshnjake, *Nova Demokratska Stranka* – Partia e Re Demokratike, NDS
- Një parti e ashkalinjëve, *Partia e Ashkalinjëve për Integrim* – PAI.
- Një parti e egjiptianëve, *Lidhja e Egjiptianëve të Kosovës* – LEK.

Në të njëjtën kohë, dy parti të pakicave kanë humbur përkrahje si rezultat i këtij procesi. *Partia Rome e Bashkuar e Kosovës* (PREBK), pësoi rënie nga 2,717 vota në vitin 2001 në 690 vota në vitin 2010. Partia e goranëve - *Iniciativa e Qytetarëve të Gorës* (GIG) pësoi rënie nga 1,789 vota në zgjedhjet e vitit 2000 në 778 vota në vitin 2010. Votat e tyre tash i'u shkojnë partive boshnjake me organizim dhe financim më të mirë. Në ndërkohë, nuk është shfaqur asnjë parti e re e goranëve.

Fakti që në parlamentin e Kosovës nuk ka ulëse të rezervuara për komunitetin malazez është mospërputhje e sistemit parlamentar. Hartuesit e legjislationit qartazi i harruan malazezët. Në shenjë të reagimit ndaj kësaj gjendje, Partia Demokratike Malazeze (DSC) mori pjesë në zgjedhjet e vitit 2010 mirëpo nuk kishte fare gjasë të futej në parlament. Ajo fitoi 771 vota. Derisa goranët me numër të ngjashëm të votave kishin një ulëse të rezervuar, malazezët nuk u morën parasysh.

Përfaqësimi i komuniteteve pakicë në kuvendet komunale

	Partitë qeverisëse	KDTP	VAKAT	SDA	PDAK	BDA	IRDK	GIG	SLS	SNSD	ZBB	SKMS	SDSKIM	CDS
Komuna	Ulëset totale	18	7	3	1	2	4	2	31	2	2	1	1	1
Istog	LDK, AAK						1							
Pejë	AAK, LDD, ORA		1	1			1							
Gjakovë	AAK, ORA, PSHDK, IRDK, LIB, PLK						1							
Prizren	PDK, PD, LDK, AKR, KDTP, Vakat, dhe LDD	3	3	1										
- Mamusha	KDTP	11												
Dragash	PDK, VAKAT		3	1				2						
Leposaviq	Bojkotuan zgjedhjet e vitit 2009													
Zubin Potok	Bojkotuan zgjedhjet e vitit 2009													
Zveçan	Bojkotuan zgjedhjet e vitit 2009													
Mitrovicë	PDK, AKR	1												
Shtërpce	SLS, PDK								8					
Vushtrri	PDK, AKR, LB	1												
Fushë Kosovë	LDK, LDD, AKR, AAK, CDS, PDAK dhe PSD						1	1						1
Prishtinë	LDK, PDK, KDTP	1												
- Graçanicë	SLS								12			1	1	
Novoberde	LDK, SNSD, ZBB								1	2	2			
- Ranillug	GIZO													
Gjilan	PDK, AAK, ORA, PD, PSD	1												
- Partesh	Themeluar pas vitit 2009													
- Klokot	SLS								10					
Ferizaj	PDK AKR				1	1								

Përderisa numri i ulëseve të rezervuara për pakicat etnike nuk ndërlihet me numrin valid të votave që i fitojnë ato, përfaqësimi i tyre do të mbetet çështje e diskutueshme. Në njëërën anë, pjesëmarrja dhe përfaqësimi i tyre janë elemente pozitive për shoqërinë. Megjithatë, mënyra si është strukturuar sistemi çon në mbi-përfaqësim të fushave ku janë të vendosura pakicat. Kjo posaçërisht vlen për zonat serbe, që gjenden kryesisht në pjesën lindore të Kosovës, në rajonin e Anamoravës dhe në rrethinë të Prishtinës. Pastaj është edhe komuniteti i madh serb në komunën e Shtërpçes dhe komunat në veri të Kosovës të banuara pothuajse plotësisht nga serbët.

Për dallim nga kjo, pjesa perëndimore e Kosovës, ku dikur jetonte pjesa më e madhe e malazezve, është

e nën-përfaqësuar dhe kjo nuk mund të balancohet me tri votat e turqve dhe goranëve që jetojnë kryesisht në Prizren dhe në Dragash.

Si janë të shpërndara votat e pakicave në Kosovë? Kjo më së miri mund të shihet në analizën e rezultateve të zgjedhjeve komunale të vitit 2009.

Nga kjo tabel mund të shohim se votat e komunitetit turk shkuan për KDTP-në, kryesisht në Mamushë, ku fitoi 11 ulëse në kuvendin komunal, dhe në Prizren ku fitoi tre ulëse. Ajo poashtu fitoi nga një ulëse në komunën e Mitrovicës, Vushtrrisë, Prishtinës dhe Gjilanit. Votat e komunitetit boshnjak i morën VAKAT dhe SDA. Në Dragash ata fituan katër ulëse, në Prizren katër dhe në Pejë dy. Votat e komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptas (RAE në fjalorin e ri)

janë specifike për çdo etnicitet. Komuniteti ashkali përfaqësohet me një ulëse në Ferizaj për PDAK-në dhe me një ulëse për BDA-në në Fushë Kosovë dhe në Ferizaj. Komuniteti egjiptas përfaqësohet nga IRDK-ja me nga një ulëse në kuvendin komunal të Istogut, Pejës, Gjakovës dhe Fushë Kosovës.

Serbët e Kosovës përfaqësohen me 33 ulëse në pesë komuna. SLS-ja ka tetë ulëse në Shtërpce, 12 në komunën e re të Graçanicës dhe 10 ulëse në komunën e re të Kllokotit. Iniciativa Qytetare Serbe i fitoi zgjedhjet në komunën e Ranillugut. Elektorati serb i bojkotoi zgjedhjet në Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan. SKMS-ja dhe SDSKiM-ja kanë nga një ulëse në Graçanicë. Ndërsa partia malazeze CDS fitoi një ulëse në Fushë Kosovë.

PËRSHKRIM I SHKURTËR I PARTIVE POLITIKE

LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës,
[president: Isa Mustafa, ka 41 degë, duke përfshirë ato të vendosura jashtë vendit]

LDK-ja e përshkruan veten si një parti konzervative në favor të liberalizimit ekonomik dhe uljës së taksave, për ekonomi të lirë të tregut pa pengesa, *laissez-faire* tregti dhe për zhvillimin e përgjithshëm të kapitalizmit. Qeveria e vogël dhe prona private janë dy elemente të shenjta në ideologjinë e LDK-së. Në politikat sociale, kjo parti politike mbështet sekularizmin shtetëror, si dhe ruajtjen e vlerave shoqërore dhe traditës.¹⁸⁶

Në bazë të hulumtimeve të pavarura, LDK-ja e sheh veten si një parti antikomuniste e cila promovon vlera siç janë pavarësia, demokracia, liria, tolerance dhe familja si shtyllat kryesore të një shoqërie të shëndoshë. LDK-ja qëndron mes nacionalizmit të shqiptarëve të Kosovës dhe respektimit të shtetit. Në çështjet rreth minoriteteve, kjo parti vë theksin në të ashtuquajturat “vlera metropolitane,” dhe nuk i dallon qytetarët e Kosovës në bazë të përkatësisë së tyre etnike. Ajo beson se feja duhet të jetë e ndarë nga shteti dhe nuk duhet të përfshihet në planprogramet e shkollave publike. LDK-ja mbështet ligjin mbi abortin. Megjithatë, kjo parti i refereohet abortit si “e drejta për përfundimin e parakohshëm të shtatëzanisë.” Kjo parti nuk promovon çështjet e homoseksualitetit dhe është kundër legalizimit të prostitucionit dhe drogave të lehta. LDK-ja favorizon privatizimin, duke përfshirë edhe privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore të mëdha, edhe pse beson se ky proces duhet të zbatohet më ngadalë dhe më me kujdes. Kjo parti parapëlqen që

në vend të privatizimit të tërësishëm, ndërmarrjet e mëdha shoqërore t’u nënshtrohen politikave të partneritetit publiko-privat (PPP). Një pjesë e secilës ndërmarrje shoqërore do të duhej të mbetej në pronësi të shtetit (për shembull KEK-u). Në anën tjetër, fondet e mbledhura nga procesi i privatizimit duhet të investohen në projekte kapitale dhe të shfrytëzohen për hapjen e vendeve të reja të punës. LDK-ja përkrah taksat progresive. Ajo gjithashtu përkrah marrëveshjen e CEFTA-s por beson se qeveria duhet të subvencionojë sektorët e ekonomisë të cilët tregojnë potencial për zhvillim. LDK-ja mbështet sistemin e tanishëm me tri shtylla (pensionet bazik, kursimet pensionale dhe pensionet shtesë), ndërsa është kundër lidhjeve horizontale (ridistribuirimin e përfitimeve pensionale), si dhe kundër lidhjeve ndërmjet gjeneratave. LDK-ja beson se tregu për kursimet pensionale duhet të liberalizohet edhe më tej dhe një pjesë e kursimeve pensionale ekzistuese duhet të investohen në Kosovë. Sigurimi shëndetësor duhet të garantohet me ligj dhe të përfshijë shërbimet bazike shëndetësore, barërat e obligueshme kurseve kategoritë sociale pa mundësi të pjesëmarrjes në pagesë për shërbimet tjera bazike duhet të mbulohen nga shteti. LDK-ja është kundër rritjes së asistencës sociale duke besuar se një gjë e tillë do të dekurajonte të varfërit që të kërkojnë punë.

Qysh nga formimi, LDK-ja ka marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet e mbajtura në Kosovë. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1992, kjo parti fitoi 76 përqind të votave. Në zgjedhjet e mbajtura në mars të vitit 1998, LDK-ja fitoi një përqindje të madhe të votave. Që nga viti 1992 e më tej, udhëheqësi i partisë, Ibrahim Rugova, ka qenë president i Kosovës, i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Në vitin 2001, ai është caktuar si president i Kosovës nën institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes të UNMIK-ut. Rugova ka ndërruar jetë në janar të vitit 2006 dhe deri më 10 shkurt 2006, ushtrues detyre i presidentit ka qenë Nexhat Daci, një udhëheqës i rendësishëm në LDK. Ai u zëvendësua nga kryetari i LDK-së, Fatmir Sejdiu, i cili mbajti këtë post deri në shkurt të vitit 2008 kur u zgjodh president për herë të dytë. Sejdiu u detyrua të

186 Shih: publikimin e Friedrich-Ebert-Stiftung (FES), Prishtinë: 1. Kushtrim Shaipi dhe Agon Maliqi, Qëndrimet e Partive kundrejt Shoqërisë: Vlerat, Religjioni, Shteti dhe Individualiteti, [Seria e Analizave të Politikave e FES-it – Raporti për Analizë të Politikave #3: Kushtrim Shaipi], Maj, 2009, Prishtinë; 2. Kushtrim Shaipi dhe Agon Maliqi, Qëndrimet e Partive kundrejt Politikave Sociale: Pensionet, Sigurimi Shëndetësor dhe Privatizimi, [Seria e Analizave të Politikave e FES-it – Raporti për Analizë të Politikave #1], Maj, 2008, Prishtinë; 3. Kushtrim Shaipi dhe Agon Maliqi, Qëndrimet e Partive Kundrejt Ekonomisë: Privatizimi, Politikat Fiskale dhe Zhvillimi, [Seria e Analizave të Politikave e FES-it – Raporti për Analizë të Politikave #2], Shtator, 2008, Prishtinë.

LDK	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
*L 2000	398,872	58.0%	Fitoi 20/27 komunave me mbi 50%
**P 2001	359,851	45.6%	47 ulëse në parlament; kryesia; koalicion konsensual me PDK-në dhe AAK-në; 3/10 ministrive
L 2002	321,239	45.9%	Fitoi 11/30 komunave me mbi 50%
P 2004	313,437	45.4%	47 ulëse në parlament; kryesia; koalicion me AAK-në; 8/15 ministrive
L 2007	118,084	22.8%	Zgjedhjet e para pas vdekjes së Ibrahim Rugovës , dhe formimi i LDD-së nga ndarja me LDK-në; fitoi 2/30 komunave me mbi 40% (Suharekë dhe Podujevë)
P 2007	129,410	22.6%	25 ulëse në parlament; kryesia; koalicion me PDK-në; 7/18 ministrive
L 2009	154,207	24.5%	Fitoi 3/30 komunave me mbi 40%
P 2010	172,552	24.7%	27 ulëse në parlament; në opozitë për herë të parë

***Zgjedhjet lokale **Zgjedhjet parlamentare**

LDD	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2007	45,259	8.75%	Formoi koalicion parazgjedhor me PSHDK-në; më e fortë se LDK-ja në katër komuna
P 2007	57,002	10.0%	Formoi koalicion parazgjedhor me PSHDK-në; 11 ulëse në parlament
L 2009	45,285	7.2%	Kishte rezultat më të mirë se LDK-ja në dy komuna
P 2010	14,924	2.1%	Nuk e kaloi pragun prej 5%

apë dorëheqje në shtator të vitit 2010, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese se ai nuk mund të jetë kryetar i LDK-së dhe president i shtetit në të njëjtën kohë. Sejdiu u zëvendësua nga Jakup Krasniqi, anëtar i PDK-së, i cili mori postin e ushtruesit të detyrës së presidentit deri në shkurt të vitit 2011.

LDD – Lidhja Demokratike e Dardanisë

[President: Nexhat Daci, ka 51 degë duke përfshirë ato të vendosura jashtë vendit].

LDD-ja u formua në vitin 2007 nga Nexhat Daci dhe ish-anëtarët e tjerë të LDK-së. Nexhat Daci u largua nga LDK-ja pasi që nuk u zgjodh në postin e kryetarit të ri të partisë, pas vdekjes së Ibrahim Rugovës. LDD-ja e sheh veten si parti konzervative dhe pasuese e politikave të zhvilluara nga Ibrahim Rugova; kjo parti përkrah taksa të ulëta, një ekonomi të lirë e të hapur të tregut pa pengesa e cila do ta zhvillonte sistemin kapitalist në Kosovë. LDD-ja po ashtu është në favor të ruajtjes së vlerave sociale dhe traditave. Hulumtimet e konsiderojnë LDD-në si një parti konzervative proevropiane e cila vendos interesin e grupit para atij individual.¹⁸⁷ Ajo vë theksin

¹⁸⁷ Shih: Publikimin e Friedrich-Ebert-Stiftung (FES), Prishtinë: Kushtrim Shaipi dhe Agon Maliqi.

në identitetin shqiptar dhe kërkon që minoritetet të premtojnë besnikërinë e tyre karshi shtetit të Kosovës. Së këndejmi, LDD-ja është kundër mekanizmit afirmativ. Pasiqë partia ka qëndrim të fuqishëm rreth sekularizmit shtetëror, ajo rrjedhimisht është kundër edukimit fetar në institucionet publike shkollore. LDD-ja është hapur kundër eutanazisë dhe martesës mes gjinisë së njëjtë, dhe poashtu është kundër legalizimit të prostitucionit dhe drogave të lehta. Kjo parti politike dëshiron ta amandantojë sistemin pensional me tri shtylla duke përfshirë në të edhe elementin e solidaritetit i cili do të financohej nga qeveria. LDD-ja beson në liberalizimin e tregut të kursimeve pensionale në mënyrë që niveli i kontributit të përcaktohet varësisht nga niveli i të ardhurave. Sigurimi shëndetësor duhet të garantohet për të gjithë qytetarët e Kosovës, dhe duhet të paguhet nga tri burime: punëdhënësi, punëtori dhe shteti. Shërbimet shëndetësore për qytetarët të cilët marrin asistencë sociale duhet të ofrohen falas. Sa i përket vetë asistencës sociale, ata besojnë se numri i atyre që marrin benefite duhet të zvogëlohet ndërsa shumica e asistencës duhet të rritet. Në kuadër të ekonomisë, LDD-ja propozon që pjesa më e madhe e ndërmarrjeve shoqërore të jepen me koncesion dhe është kundër privatizimit

LPK/PSK	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000			Mori pjesë si pjesë e koalicionit të AAK-së
P 2001	4404	0.6%	1 ulëse në parlament Garoi në 17 komuna
L 2002	2801	0.4%	Gjysma e votave u fituan në Suharekë
P 2004	4526	0.7%	1 ulëse në parlament
L 2007			Garoi në koalicion parazgjedhor me PDK-në
P 2007			Garoi në koalicion parazgjedhor me PDK-në
L 2009	3,085	0.5%	Garoi në 13 komuna Rishfaqet si PSK
P 2010			Nuk mori pjesë

	LKCK	LB	LIB	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
2000L				
2001P	8,725			
2002L	1,636			
2004P				
2007L	2,578			
2007P	2,702			
2009L	-	1,984	2,437	
2010P		-	-	LB-ja ishte në koalicion me VV-në deri në tetor të vitit 2011 – dy ulëse në parlament

të ndërmarrjeve të mëdha shtetërore. Së paku 51 përqind e ndërmarrjeve të mëdha shoqërore duhet të mbeten në pronësi të shtetit. Megjithatë, nëse procesi i privatizimit vazhdon si deri më tani, LDD-ja beson se fondet e mbledhura nga privatizimi në masë të madhe duhet tu ipen punëtorëve kurse pjesa tjetër duhet të shkojë në investime kapitale. LDD-ja nuk ka politikë të qartë sa i përket taskave. Disa nejrëz brenda partisë parapëlqejnë taksën fikse kurse të tjerët ate progresive. LDD-ja përkrah CEFTA-n dhe dëshiron që disa fusha si bujqësia, pylltaria, turizmi e disa sektorë tjerë ekonomikë të jenë të subvencionuara nga shteti.

LPK – Lëvizja Popullore e Kosovës, doli nga organizata e atëhershme ilegale *Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi* (LRSSHJ), e cila u formua ne vitin 1982 nga Xhafer Shatri, Sabri Novosella, Ibrahim Kelmendi, Fahredin Tafallari, Hasan Mala dhe Kadri Abdullahu. Organizata zyrtarisht u formua në vitin 1987 në Zvicërr dhe u emërtua *Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës* (LPRK), kurse në vitin 1991 iu ndërrua emrr në *Lëvizja Popullore e Kosovës* (LPK). Kjo parti nuk mori pjesë në zgjedhjet e vitit 1992 në Kosovë. Themeluesit e LPK-së në Zvicërr pohojnë ta kenë formuar UÇK-në në vitin 1993, në një takim në Drenicë. Ideologjikisht, LPK-ja është e vendosur

në të majtë të spektrit politik. Gjate zgjedhjeve lokale të vitit 2000, LPK-ja garoi si njëra prej gjashtë partive, në koalicion me AAK-në. LPK-ja poashtu garoi me kandidatët e saj në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 dhe 2004 si dhe në zgjedhjet lokale të vitit 2002. Në vitin 2007, kjo parti hyri në koalicion parazgjedhor me PDK-në në prag të zgjedhjeve parlamentare. Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2007, LPK-ja transformohet në PSK (Partia Socialiste e Kosovës).

PSK - Partia Socialiste e Kosovës, [President: Ilaz Kadollj]. PSK-ja në thelb nuk dallon nga LPK-ja. Ajo është parti e krahut të majtë, kurse arsyet për transformimin e saj qëndrojnë në faktin se rrethanat politike kishin ndryshuar, duke përfshirë këtu pavarësinë e Kosovës, dhe nevojën për të pasur një parti me një qëndrim të fuqishëm ideologjik në spektrin politik të Kosovës.

The LKÇK – Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës, u themelua nga Avni Klinaku, Raif Qela, Bahri Fazliu, Sabit Gashi dhe Mursel Sopi në vitin 1993. Për ndryshim nga LPK-ja, kjo parti ishte në favor të luftës çlirimtare. Në periudhën e pasluftës, LKÇK-ja iu bashkua AAK-së para se të reformohet për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001. Ajo fitoi 8,725 vota dhe

PDK	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000	187,821	27.33%	Fitoi 4/30 komunave me mbi 50% të votave
P 2001	202,622	25.70%	26 ulëse në parlament; koalicion konsensual me LDK-në e AAK-në. Bajram Rexhepi bëhet kryeministër; 2/10 ministrive
L 2002	207,012	29.60%	Fitoi 4/30 komunave me mbi 50% të votave
P 2004	199,112	28.85%	30 ulëse në parlament; në opozitë
L 2007	181,141	35.01%	Fitoi 8/30 komunave me mbi 40% të votave
P 2007	196,207	34.32%	Për herë të parë PDK-ja del e para në zgjedhje me 34 ulëse në parlament; formon koalicion me LDK-në; Hashim Thaçi merr postin e kryeministrit; 9/18 ministrive
L 2009	200,148	31.75%	Zgjedhjet e para që nga shpallja e pavarësisë. Fitoi 6/30 komunave me mbi 40% të votave
P 2010	224,339	32.11%	34 ulëse në parlament; Hashim Thaçi bëhet kryeministër; formon koalicion me KDTP-në, me koalicionin e AKR-së dhe listën "Ibrahim Rugova," 12/19 ministrive

një ulëse në parlament për Smajl Latifin. Në zgjedhjet lokale të vitit 2002, LKÇK-ja mori vetëm 1,636 vota në 17 komuna, dhe partia nuk mori pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2004. Në zgjedhjet lokale të vitit 2007, partia arriti ta rrisë numrin e votave në 2,578, në 11 komuna. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2007, LKCK-ja fitoi 2,702 vota. Pas kësaj, LKCK-ja u nda në dy parti të ndara të cilat në zgjedhjet e ardhshme garuan ndaras.

LB - Lëvizja për Bashkim, [President: Avni Klinaku]. LB-ja është njëra nga partitë e reja që doli nga shpërbërja e LKÇK-së. Kjo parti promovon bashkimin e Kosovës dhe Shqipërisë. Kjo parti e konsideron unitetin kombëtar si qëllimin kryesor të saj. Ajo poashtu fokusohet në problemet me të cilat qytetarët e Kosovës ballafaqohen për çdo ditë, mirëpo nuk ia arrin t'i adresojë çështjet specifike apo të dalë me propozime për zgjidhjen e tyre. Në zgjedhjet lokale të vitit 2009, LB-ja garoi vetëm në Vushtrri dhe Obiliq dhe fitoi 1,984 vota. Gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010, LB-ja iu bashkua lëvizjes Vetëvendosje! si pjesë e koalicionit parazgjedhor dhe fitoi dy ulëse në parlamentin e Kosovës, me deputetët Agim Kuleta dhe Aurora Bakalli. Në tetor të vitit 2011, LB-ja vendosi të largohet nga koalicioni me Vetëvendosje!-n.

LIB – Lëvizja për Integrim dhe Bashkim, [President: Fadil Fazliu] është partia e dyte që doli nga shpërbërja e LKÇK-së. Edhe kjo parti fokusohet kryesisht në promovimin e idesë së bashkimit të të gjithë shqiptarëve në një shtet të vetëm. Udhëheqësi i partisë, Smajl Latifi, i cili njihet si luftëtar i UÇK-së gjatë luftës në Kosovë, ka qenë deputet nga viti 2001 deri në vitin 2004. LIB-i mori pjesë në zgjedhjet lokale të vitit 2009 duke garuar në pesë komuna (Vushtrri,

Malishevë, Skenderaj, Klinë dhe Rahovec) dhe fitoi 2,436 vota, prej të cilave 2,009 i fitoi vetëm në Rahovec e Gjakovë. Që nga largimi i Latifit nga partia në gusht të vitit 2010, partia ka qenë pa udhëheqës dhe nuk ka marrë pjesë në zgjedhjet e vitin 2010. Në dhjetor të vitit 2010, Smajl Latifi pati garoi në zgjedhjet lokale si pjesë e AAK-së, dhe u zgjodh kryetar i komunës së Rahovecit.

PDK – Partia Demokratike e Kosovës,

[president: Hashim Thaçi], ka 32 degë në 28 komuna.

PDK-ja u themelua më 12 tetor të vitit 1999, fillimisht si Partia për Prosperitet Demokratik e Kosovës (PPDK) dhe e ndërroi emrin në vitin 2000, në Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Kjo parti doli nga UÇK-ja.

Sipas hulumtimit të FES-it, PDK-ja favorizon epërsinë e individit karshi grupit.¹⁸⁸ Për PDK-në, identiteti etnik është më i rëndësishëm sesa identifikimi i qytetarit me shtetin, prandaj PDK-ja mbështet vetëm çështjen e të drejtave të minoriteteve, që janë të regulluara me provizionet kushtetuese. Kjo parti beson se shteti duhet të jetë sekular dhe se feja nuk duhet të luajë rol në edukimin publik, apo të jetë pjesë e planprogrameve shkollore. Partia përkrah legalizimin e abortit por me disa rezerva. Në anën tjetër, partia nuk ka politika të qarta rreth eutanazisë, homoseksualitetit apo prostitucionit. Kjo parti është kundër legalizimit të drogave të lehta siç është marihuana.

Si pjesë e programit të politikave sociale, PDK-ja përkrah një sistem pensional i cili është i bazuar në kontribute dhe është pa ndërlidhje horizontale apo ndërmjet gjeneratave. PDK-ja përkrah liberalizimin e

¹⁸⁸ Shih: publikimin e Friedrich-Ebert-Stiftung (FES), Prishtinë: Kushtrim Shaiqi dhe Agon Maliqi.

AAK	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000	53,074	7.7%	Pa shumicë në të gjitha komunat
P 2001	61,688	7.8%	9 ulëse në parlament; koalicion me LDK-në dhe PDK-në; 2/10 ministrive
L 2002	61,732	8.8%	Fitoi komunën e parë, Deçanin me mbi 50% të votave
P 2004	57,931	8.4%	11 ulëse në parlament; koalicion me LDK-në. Ramush Haradinaj nga AAK bëhet kryeministër; 6/15 ministrive; pas tre muajve në këtë post, Haradinaj dërgohet në Hagë; zëvendësohet nga Bajram Kosumi e më vonë nga komandanti i përgjithshëm i TMK-së, Agim Çeku
L 2007	47,240	9.1%	Fitoi Deçanin me mbi 50% të votave
P 2007	54,611	9.6%	11 ulëse në parlament; në opozitë
L 2009	95,066	15.1%	Haradinaj kthehet nga Haga; AAK-ja mer mbi 50% të votave në Deçan dhe mbi 40% në Junik
P 2010	77,130	11.0%	12 ulëse në parlament. Haradinaj detyrohet të kthehet në Hagë. AAK-ja hyn në koalicion parazgjedhor me listën "Ibrahim Rugova"; në opozitë

ORA	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
P 2004	43,017	6.2%	7 ulëse në parlament
L 2007	19,092	3.7%	
P 2007	23,722	4.1%	Nuk e kaloi pragun prej 5%
L 2009	9,142	1.5%	Garoi në 9 komuna
P 2010			

tregut të kursimeve pensionale, por beson që niveli i kontributeve duhet të jetë i ulët dhe në linjë me nivelin e të ardhurave. Kjo parti do të dëshirojë që niveli i tanishëm i pagesave të asistencës sociale të rritet në mënyrë që të pasqyrojë nivelin e inflacionit. Të gjitha shërbimet tjera duhet të mbuloohen nga fondet për sigurim shëndetësor i cili do të financohet nga punëdhënësi dhe punëtori. Të papunët dhe personat në pamundësi për të kontribuar në pagesë, duhet të sigurohen nga shteti. Në aspektin ekonomik, PDK-ja fillimisht kshihte besuar se shteti duhet të mbajë në pronësi kompanitë, vetëm nëse ato janë të një rëndësie nacionale apo kanë një rëndësi të veçantë, siç është KEK-u dhe hekurudhat. Të gjitha ndërmarrjet tjera shoqërore duhet të privatizohen. Megjithatë, kah fundi i mandatit të parë të qeverisë së udhëhequr nga PDK-ja, qëndrimet e kësaj partie lëvizën në të djathtë. Tani kjo parti beson se të gjitha ndërmarrjet publike, përfshirë KEK-un dhe PTK-në duhet të privatizohen. Të ardhurat e mbledhura nga privatizimi duhet të investohen në infrastrukturën e vendit dhe në investime tjera kapitale. Në aspektin financiar, PDK-ja mbështet sistemin e taksave progresive, dhe beson se niveli i tanishëm i taksave është shumë i lartë. Kjo parti përkrah CEFTA-n dhe dëshiron që sektori i bujqësisë të subvencionohet. PDK-ja beson se kapitali

publik duhet të investohet në sektorin privat, në formë të partneritetit publiko-privat.

AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, [President: Ramush Haradinaj].

AAK-ja u themelua më 1999 nga një grup i ish-anëtarëve të UÇK-së nga rajoni i Dukagjinit. Forca shtytëse prapa krijimit të lëvizjes ishte Ramush Haradinaj. AAK-ja tërhoqi politikanë të ndryshëm duke përfshirë edhe ish-udhëheqësin komunist, Mahmut Bakalli.

Botëkuptimet kryesore të AAK-së përqëndrohen në rëndësinë e familjes dhe në respektimin e vlerave tradicionale para atyre individuale. Megjithatë, për AAK-në, individi është shumë i rëndësishëm pasi që përbën kushtin kryesor për një familje të shëndoshë. AAK-ja përkrah karakterin unik të Kosovës dhe diversitetin kulturor dhe etnik, duke besuar se identiteti shqiptar është poaq i rëndësishëm sa identiteti kosovar, identitete këto të cilat jo domosdoshmërisht përjashtojnë njëra tjetrën. Sa i përket minoriteteve, AAK-ja beson se ato duhet të jenë të mbrojtura, por jo përmes mekanizmave afirmativ. Ata besojnë se shteti duhet të jetë sekular dhe se feja nuk duhet të jetë pjesë e planprogrameve në shkollat publike. AAK-ja nuk ka qëndrim rreth eutanazisë, prostitucionit apo drogave

AKR	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2007	63039	12.2%	12 ulëse në parlament
P 2007	70165	12.3%	
L 2009	53,362	8.5%	
P 2010	50,951	7.3%	8 ulëse në parlament; koalicion me PDK-në, KDTP-në dhe listën "Ibrahim Rugova"; 3/19 ministrive; 2 zëvendëskryeministra

të lehta. Homoseksualiteti nuk shihet me sy të mirë pasi që nuk konsiderohet si element që forcon familjen. Kjo parti beson se tregu i kursimeve pensionale duhet të liberalizohet dhe është përkrahëse e flaktë e sistemit të tanishëm pensional. AAK-ja e konsideron shtyllën e parë të sistemit të tanishëm pensional si një formë të veçantë të asistencës sociale. Kjo parti është promovuese e idesë për sigurim universal shëndetësor për të gjithë qytetarët dhe se ata nën kufirin e varfërisë duhet të përjashtohen nga kontributi në pagesë. AAK-ja beson se niveli i papunësisë duhet të reduktohet dhe se shumica e përfitimeve të paguara duhet të rritet, por nuk propozon zgjidhje specifike për problemin përveç planit të përgjithshëm ekonomik. Sa i përket sektorit shtetëror, AAK-ja është në favor të privatizimit të të gjitha ndërmarrjeve shoqërore, me përjashtim të ndërmarrjeve strategjike nacionale siç është KEK-u. Kjo parti beson se ndërmarrjet shoqërore më të mëdha duhet të privatizohen pjesërisht dhe paratë e mbledhura të shfrytëzohen për përmirësimin e gjendjes së punëtorëve. Sipas AAK-së, pjesa më e madhe e mjeteve të mbledhura nga privatizimi duhet të shpenzohen për rritjen e rrogave të ekspertëve me aftësi të avancuara të punësuar nga ndërmarrje të ndryshme si dhe në investime kapitale. AAK-ja poashtu mbështet sistemin e taksës progresive dhe beson se qeveria duhet ti ulë ato. AAK-ja e mbështet CEFTA-n dhe beson se qeveria duhet t'i subvencionojë ata sektorë të ekonomisë që kanë potencial për t'u zhvilluar, sic janë bujqësia, energjia dhe turizmi. Në zgjedhjet lokale të vitit 2000, AAK-ja ishte pjesë e koalicioni të gjashtë partive të përbërë nga AQK-ja, LPK-ja, LKÇK-ja, UNIKOMB-i, PPK-ja dhe USHDK-ja. Në zgjedhjet e vitit 2010, AAK-ja krijoi koalicion me ish-anëtarët e LDK-së të cilët ishin ndarë nga partia për të formuar listën "Ibrahim Rugova." Pas zgjedhjeve, koalicioni u prish kur lista hyri në aleancë të re me PDK-në për të formuar qeverinë.

VV – Lëvizja Vetëvendosje!, [Udhëheqës: Albin Kurti].

VV-ja është kundër çfarëdo interferimi ndërkombëtar në politikën e Kosovës, e poashtu është kundër privatizimit ndërsa përkrah bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. VV-ja doli nga Rrjeti i

Aksionit Kosovar (KAN). KAN-i është themeluar në vitin 1997 nga një grup ndërkombëtar i aktivistëve nën udhëheqjen e shkrimtares amerikane Alice Mead. Qëllimi i KAN-it ka qenë ta promovojë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe ka qenë kryesisht i involvuar në çështje siç janë personat e zhdukur dhe të drejtat e njeriut. KAN-i ka operuar në Kosovë deri në vitin 2005. Udhëheqësit e lëvizjes, duke përfshirë Albin Kurtin dhe Glauk Konjufcën, vazhduan aktivitetet e organizatës si *Vetëvendosje!*. Ata u fokusuan në organizimin e protestave kundër negociatave me Serbinë, kundër decentralizimit dhe planeve të propozuara për Kosovën të cilat nuk parashihnin pavarësinë për Kosovën. Në protestën e organizuar nga VV-ja në vitin 2007, dy demonstrues u vranë nga policia e UNMIK-ut. Kjo e forcoi pozitën e VV-së dhe u dha një popullaritet në tërë Kosovës. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010, VV-ja fitoi 88,652 vota dhe mori 12 ulëse në parlament.

Partia Reformiste ORA u formua në vitin 2004, vetëm disa muaj para zgjedhjeve nacionale, nga një grup i intelektualëve të cilët u grupuan nga pronari dhe kryeredaktori i së përditshmës *Koha Ditore*, Veton Surroi. ORA ishte një lëvizje social-demokrate që përkrahte intervenimin e shtetit në ekonomi. Kjo parti ishte kundër privatizimit, avokonte subvencionimin e sektorëve strategjikë dhe krijimin e bankës agrare. ORA promovoi shtetit skular. ORA ishte në favor të abortit dhe mbante qëndrim liberal rreth martesës mes personave të gjinisë së njëjtë. Pas zgjedhjeve të vitit 2007, Surroi dha dorëheqje dhe pas zgjedhjeve të vitit 2009, ORA vendosi ti bashkohej LDK-së.

FER – Partia Fryma e Re, është themeluar një muaj para zgjedhjeve të vitit 2010 nga kryesuesi i një instituti të hulumtimeve (KIPRED) dhe Shpend Ahmeti (GAP). Kjo parti kishte politika ekonomike të qendrës dhe politika sociale liberale. Gjate fushatës, kjo parti shpeshë ishte parë si vazhdimësi e partisë ORA dhe sikurse partia e Surroit, anëtarët e FER-it vinin nga qendrat urbane. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010 partia nuk rriti ta kalojë pragun prej 5 përqind. Tre muaj pas zgjedhjeve, FER-i u bashkua VV-së, por dy ditë para këtij bashkimi, dy nga tre anëtarët kryesorë të FER-it, Ilir Deda dhe Qëndrim Gashi dhanë dorëheqje.

PSD	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000	2659	0.4%	Garoi në 17 komuna
P 2001	1785	0.2%	
L 2002	2239	0.32%	Garoi në 13 komuna
P 2004	2107	0.3%	Nuk e fitoi asnjë ulëse
L 2007			Garoi si pjesë e koalicionit të udhëhequr nga PDK-ja
P 2007			
L 2009	8,055	1.3%	Garoi në 18 komuna
P 2010			Pjesë e koalicionit parazgjedhor të AKR-së; Ministria e Mbrojtjes: Agim Çeku

PSHDK	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000	8533	1.2%	Garoi në 13 komuna
P 2001	7701	1.0%	1 ulëse në parlament; në koalicion me LDK-në, PDK-në dhe AAK-në Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
L 2002	10271	1.5%	Garoi në 12 komuna
P 2004	12427	1.8%	2 ulëse në parlament
L 2007	4123	0.8%	Garoi në 12 komuna
P 2007			lu bashkuan koalicionit parazgjedhor me LDD-në
L 2009	4,361	0.7%	Garoi në 4 komuna; Mark Krasniqi jep dorëheqje
P 2010			lu bashkuan koalicionit parazgjedhor me PDK-në

PDKI	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2007	3545	0.69%	Garoi në 4 komuna
P 2007			
L 2009	1858	0.29%	Garoi në 10 komuna
P 2010			lu bashkuan koalicioni parazgjedhor me LDK-në

PLK	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000	4,138	0.60%	Garoi në 19 komuna
P 2001	3,600	0.46%	
L 2002	4,519	0.65%	Garoi në 24 komuna
P 2004	3542	0.51%	1 ulëse në parlament
L 2007			lu bashkua koalicionit parazgjedhor me PDK-në
P 2007			lu bashkua koalicionit parazgjedhor me PDK-në. Gjergj Dedaj emërohet zëvendësministër i punës dhe mirëqenies sociale
L 2009	1,252	0.20%	Garoi në 10 komuna
P 2010			

Aktualisht, Deda është këshilltar i lartë dhe shef i kabinetit të presidentit të Kosovës. Pjesa më e madhe e anëtarëve të tjerë iu bashkuan *Vetëvendosjes!*. FER-i fitoi 15,156 vota kryesisht në zonat urbane (Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Ferizaj).

AKR – Aleanca Kosova e Re, [President: Behgjet

Pacolli].

U themelua në vitin 2006 nga Behgjet Pacolli, i vetmi manjat i vërtetë i Kosovës dhe pronar i kompanisë së ndërtimit *Mabetex*. AKR-ja promovon një përzierje të liberalizmit ekonomik dhe politikave konzervative sociale. Në vitin 2010, AKR-ja hyri në

koalicion parazgjedhor me PD-në, PSD-në, PGJK-në, PNDSh-në, Partinë e Pensionerëve, Partinë e Pensionerëve dhe Invalidëve dhe të ashtuquajturin grup i ekspertëve, E15. Pas zgjedhjeve, Behgjet Pacolli u zgjodh president i Kosovës nga parlamenti por Gjykata Kushtetuese vendosi që zgjedhja e tij ishte jokushtetuese pasi që nuk ishte arritur numri i caktuar i deputetëve të pranishëm gjatë procesit të votimit.

PPK – Partia Parlamentare e Kosovës, doli nga ish-Parlamenti Rinor (Socialist) i Kosovës i themeluar nga Shkëlzen Maliqi dhe Halil Matoshi. Gjatë vitete të 90-ta, PPK-ja ishte partia e dytë më e njohur dhe mori pjesë në zgjedhjet e vitit 1992 duke fituar 4,87 përqind të votave që u përkthye në 13 ulëse. PPK-ja nuk mori pjesë në zgjedhjet e vitit 1998, pasi që iu bashkua koalicionit të LBD-së, koalicion ky i cili u shpërbë tërësisht menjëherë pas luftës. Nga viti 1993 e deri në vitin 1996, PPK-ja u udhëhoq nga Bajram Kosumi pas të cilit kreun e partisë e mori Adem Demaçi deri në vitin 1998, para se të largohej për ta marrë pozitën e përfaqësuesit politik të UÇK-së në zyrën në Prishtinë. Me largimin e Demaçit, ne krye të partisë u rikthye Kosumi. Pas luftës, në maj të vitit 2000, PPK-ja i bashkohet AAK-së. Në vitin 2006, Bajram Kosumi mori postin e kryeministrit pas akuzës nga Tribunal i Hagës kundër Ramush Haradinajt. Pas një viti, Kosumi dha dorëheqje dhe u largua nga AAK-ja për t'iu bashkuar PDK-së si pjesë e *Lëvizjes Qytetare për Demokraci*, të themeluar vetëm disa ditë para antërësimit në PDK.

PSD – Partia Socialdemokrate e Kosovës (Social democratic party of Kosova) [President: Agim Çeku].

PSD-ja është themeluar nga Muhamedin Kullashi dhe Shkëlzen Maliqi në fillim të viteve të 90-ta. Udhëheqësi i parë i kësaj partie ishte Luljeta Pula, e cila u zëvendësua në vitin 1998 nga Kaqusha Jashari. PSD-ja mori pjesë në zgjedhjet e vitit 1992 ku Shkëlzen Maliqi dhe Behlul Beqaj siguruan dy ulëse në parlament. PSD-ja nuk mori pjesë në zgjedhjet e vitit 1998. Pas luftës, PSD-ja mori pjesë në të gjitha zgjedhjet. Në zgjedhjet e vitit 2007, kjo parti formoi koalicion parazgjedhor me PDK-në dhe Kaqusha Jashari fitoi një ulëse në parlament. Në vitin 2009, Agim Ceku u emërua kryetar i PSD-së dhe në vitin 2010 partia hyri në koalicion parazgjedhor me AKR-në.

Politikat themelore të PSD-së janë barazia, solidariteti, liria e lëvizjes dhe fjalës, si dhe të drejtat e njeriut më theks të veçantë në të drejtat e punëtorëve dhe bizneseve të vogla. PSD-ja e vendos komunitetin para inividit. Kjo parti konsideron se identiteti shqiptar në Kosovë është më me influencë se sa identiteti Kosovar, porse këto të dyja nuk duhet të jenë në

konflikt me njëra tjetrën. PSD-ja është në favor të mbështetjes së minoritetëve dhe është për mekanizma afirmativ. Partia beson në sekularizëm dhe rrjedhimisht në faktin që feja nuk duhet të jetë pjesë e planprogramit të shkollave publike. PSD-ja është në favor të abortit por është kundër eutanazisë. Kjo parti do të dëshironte që me anë të veprimeve më të ashpra të parandalohet prostitucioni të cilin ata e konsiderojnë si moralisht degraduese. Sa i përket asistencës sociale, kjo parti beson se shumica e përfitimeve të dhëna njerëzve të cilët nuk mund të punojnë duhet të rritet. PSD-ja është për privatizim të pjesshëm për aq sa interesi kombëtar nuk vihet në rrezik. Partia mendon se fondet e mbledhura nga privatizimi i pasurive nacionale duhet të shfrytëzohen për krijimin e fondit pensional të solidaritetit dhe për të luftuar disa dukuri negative në shoqëri siç janë varësia nga drogat dhe alkoholizimi. PSD-ja mbështet sistemin e tanishëm të taksave por mendon se niveli i tanishëm duhet të ulet. Kjo parti beson se si bujqësia ashtu edhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme duhet të subvencionohen.

PSHDK – Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, [President: Nikë Gjeloshi].

PSHDK-ja është themeluar në vitin 1990 nga Gjergj Rrapi, Lazër Krasniqi, Nikë Gjeloshi, Gjergj Dedaj dhe Umberto Bytyqi me qëllim të përfaqësimit të shqiptarëve të fesë katolike në Kosovë. Partia ka orientim konzervativ si ne politikat ekonomike ashtu edhe në ato sociale. Në vitin 1991, Gjergj Dedaj u nda nga PSHDK-ja dhe formoi PLK-në. PSHDK-ja mori pjesë në zgjedhjet e vitit 1992 dhe fitoi tre përqind të votave. Në vitin 1993 akademiku i mirënjohur Mark Krasniqi u bë kryetar i partisë, post ky të cilin e mbajti deri në vitin 2008. PSHDK-ja kishte dy përfaqësues në qeverinë në ekzil, dy nënkryetarë dhe në një moment kishte dy ministra. PSHDK-ja mori pjesë në zgjedhjet e vitit 1998 dhe dhe në të gjitha zgjedhjet tjera pas luftës. Mes viteve 2001 dhe 2004 ata iu bashkuan koalicionit LDK-PDK-AAK kurse Zef Morina u emërua ministër i transportit dhe telekomunikacionit. Megjithatë, në vitin 2007, pak kohë para zgjedhjeve, PDKI-ja (*Partia Demokristiane për Integrim*) u nda nga PSHDK-ja. Në vitin 2009, Mark Krasniqi dha dorëheqje nga pozita e kryetarit të partisë dhe u zëvendësua nga Marjan Demaj. Më pas PSHDK-ja hyri në koalicion parazgjedhor me PDK-në.

PDKI – Partia Demokristiane për Integrim, [President: Zef Morina].

PDKI-ja u nda nga PSHDK-ja në vitin 2007 dhe tani udhëhiqet nga Zef Morina. Politikat e kësaj partie janë shumë të ngjajshme me ato të PSHDK-së.

PLK – Partia Liberale e Kosovës, [President:

PD	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
P 2001	4,504	0.6%	1 ulëse në parlament
L 2002	5,679	0.8%	Garoi në 11 komuna Bazë të fuqishme në Prishtinë dhe Prizren
P 2004	7,013	1.0%	1 ulëse në parlament
L 2007	8,709	1.7%	Garoi në 22 komuna
P 2007	9,890	1.7%	Nuk e kaloi pragun prej 5%
L 2009	13,203	2.1%	Garoi në 19 komuna
P 2010			lu bashkua koalicionit parazgjedhor me AKR-në; anëtar i koalicionit qeverisës; Ministria e Shëndetësisë

ADK	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
P 2004	3,042	0.44%	
L 2007			lu bashkua koalicionit parazgjedhor me PDK-në
P 2007			lu bashkua koalicionit parazgjedhor me PDK-në; 1 ulëse në parlament
L 2009	797	0.13%	Garoi në 2 komuna (Prishtinë dhe Prizren)
P 2010			lu bashkua koalicionit parazgjedhor me PDK-në. Edita Tahiri u emërua zëvendës kryeministre përkundër faktit se nuk kishte fituar asnjë ulëse në parlament

POLK	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L2000	5329	0.78%	Garoi në 16 komuna. 1091 vota vetëm në Suharekë.
P 2001	2403	0.30%	Dështon të fitojë një ulëse në parlament
L 2002			Partia i bashkoi AAK-së (Maloku) dhe LDK-së (Kuçi)

BK	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
P 2001	2,881	0.37%	
L 2002	2,537	0.36%	Garoi në 9 komuna, prej të cilave 4 ishin të vendosura në Rajonin e Drenicës dhe më gjërë
P 2004	2,156	0.31%	
L 2007	921	0.18%	Garoi në 8 komuna
P 2007	1,199	0.21%	
L 2009	597	0.90%	Garoi në 7 komuna
P 2010			Nuk mori pjesë në zgjedhje

UNIKOMB	Votat	Percentage	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000			Garoi si pjesë e koalicionit të AAK-së
P 2001			Garoi si pjesë e koalicionit të AAK-së
L 2002	1,001	0.14%	Garoi në 9 komuna
P 2004	2,607	0.38%	Nuk merr asnjë ulëse; shpërndahet

Gjergj Dedaj]. PLK-ja u nda nga PSHDK-ja në vitin 1991 dhe qysh atëherë udhëhiqet nga Gjergj Dedaj. PLK-ja ka orientim liberal dhe anëtarët e saj janë poashtu anëtarë të Partisë së Reformuar Liberal-Demokrate të Evropës. PLK-ja mori pjesë në zgjedhjet e vitit 1992 por jo edhe në ato të vitit 1998. Pas luftës, PLK-ja vazhdoi të jetë faktor aktiv në skenën politike dhe mori pjesë në të gjitha zgjedhjet. Në vitin 2007, partia hyri në koalicionin parazgjedhor me PDK-në.

PD – Partia e Drejtësisë, [President: Ferid Agani]. PD-ja është themeluar në shtator të vitit 1999 nga Fuad Ramiqi, një ushtat i mirënjohur nga lufta e Bosnjes, i cili poashtu kishte luftuar në rradhët e UÇK-së dhe është aktiv në fushatën për mbështetjen e palestinezëve në Rripin e Gazës. Njeriu i dytë më i rëndësishëm në parti është neuropsikiatri Ferid agani nga Gjakova. Në sytë e publikut, partia shihet si parti muslimane për shkak të përkrahjes që ajo kishte shprehur për ndërtimin e një xhamie të madhe në qendër të Prishtinës, dhe për shkak se përkrah të drejtën e femrave për të mbajtur shami në shkolla. Poashtu partia është hapur në favor të futjes së edukimit fetar nëpër planprogramet e shkollave publike. Themeluesi i partisë, Ramiqi, është organizatori kryesor i protestave të shumta në përkrahje të këtyre çështjeve. Si pasojë e kësaj, PD-ja merr numrin më të madh të votave nga komuniteti musliman i Kosovës.

ADK – Alternativa Demokratike e Kosovës, [President: Edita Tahiri].

ADK-ja është themeluar në vitin 2004 disa muaj para formimit të ORA-s dhe e konsideron veten si “partia origjinale reformiste.” Partia është themeluar nga Edita Tahiri, një anëtare e vjetër e LDK-së, e cila ishte dëshpëruar me këtë parti. Tahiri ka qenë aktive qysh nga vitet e 90-ta duke qenë përgjegjëse për politikë të jashtë brenda LDK-së dhe po ashtu ka marrë pjesë në konferencën e Rambujesë dhe konferenca të tjera ndërkombëtare që merreshin me çështjen e Kosovës. Në zgjedhjet e vitit 2007, ADK-ja iu bashkua koalicionit parazgjedhor me PDK-në. Në vitin 2010, Edita Tahiri u emërua zëvendës kryeministre dhe gjithashtu udhëheqëse e ekipit negociator në bisedimet me Serbinë.

PQLK – Partia e Qendrës Liberale të Kosovës, është themeluar në vitin 1999 nga ish-ushtarë të UÇK-së, në mesin e të cilëve ishin edhe Naim Maloku e Blerim Kuçi. Maloku ishte i diplomuar në akademinë ushtarake dhe banonte në Slloveni. Ai poashtu ishte ish i burgosur politik. Maloku luftoi në Slloveni dhe Kroaci para se të bashkohej UÇK-së. Kuçi ka

qenë president i forumit rinor të LDK-së, para se të bashkohej UÇK-së. Ideja prapa formimit të PQLK-së ishte të formohej një parti e cila do të vendosej në mes dy ekstremeve të polarizuara, ata të cilët ishin për luftë dhe ata që promovonin paqen. Politikët e tyre ishin të qendrës liberale. Pas dështimit që të fitojnë një ulëse në parlament në vitin 2001, udhëheqësit e saj iu bashkuan AAK-së dhe LDK-së.

BK - Balli Kombëtar, [President: Ahmet Mulliqi].

BK-ja për herë të parë është formuar në vitin 1939 nga Ali Këlcyra and Mit'hat Frashëri si një parti mbarëkombëtare e cila do të ishte e pranishme kudo që jetojnë shqiptarët, koncept ky diametrikisht i kundërt me idetë komuniste e monarkiste. Gjatë luftës së dytë botërore, BK-ja formoi komitetin e përkohshëm kombëtar i cili shpalli pavarësinë e Shqipërisë dhe për më tepër zgjodhi një komitet ekzekutiv me qëllim të formimit të qeverisë së përkohshme. Në fund të luftës së dytë botërore, BK-ja u detyrua të shëndërrohej në lëvizje ilegale nga ana e komunistëve. Në vitin 1991, BK-ja u rishfaq si parti politike e krahut të djathtë në Kosovë e Shqipëri. Përderisa politika e saj sociale ishte bindshëm në anën e djathtë të spektrit politik, BK-ja kishtenjë numër të vogël të politikave ekonomike. BK-ja nuk mori pjesë në zgjedhjet lokale të vitit 2000.

UNIKOMB – Uniteti i Kombit, është themeluar më 5 maj të vitit 1991 nga Halil Alidemaj. Në vitin 1994, Ukshin Hoti u bë udhëheqës i UNIKOMB-it dhe më pastaj u burgos. Partia hyri në koalicion me LBD-në (*Lëvizja e Bashkuar Demokratike*) e Rexhep Qosjes në vitin 1998. Gjatë luftës, Ukshin Hoti u zhduk dhe besohet të jetë vrarë. Muhamet Kelmendi drejtoi partinë që nga viti 2000 e deri në vitin 2004. Në zgjedhjet lokale të vitit 2000 dhe ato parlamentare të vitit 2001, UNIKOMB-i garoi si pjesë e koalicionit parazgjedhor me AAK-në. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001, Muhamet Kelmendi fitoi një ulëse në parlament. Partia u shpërnda në vitin 2004.

LDSH - Lëvizja Demokratike Shqipëtare, është themeluar më 27 qershor të vitit 1998 dhe është udhëhequr nga Rexhep Qosja. Partia ka qenë kundër politikës së rezistencës pasive të udhëhequr nga LDK-ja, përderisa kishte marrdhënie të afërta ideologjike me UÇK-në. Në ditën e themelimit, LDSH-ja propozoi krijimin e një trupi politik të partive kryesore politike i cili do të koordinonte partitë politike dhe UÇK-në. Shumë shpejt pas kësaj, LDSH-ja iu bashkua koalicionit të gjërë LBSH, apo *Lëvizja e Bashkuar Shqiptare*.

LBD - Lëvizja e Bashkuar Demokratike, është

PNSDH	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000	1980	0.29%	Garoi në 9 komuna
P 2001	1066	0.14%	Nuk fitoi asnjë ulëse
L 2002	451	0.06%	Garoi në 4 komuna (Ferizaj, Prishtinë, Skënderaj, dhe Gjakovë)
P 2004	857	0.12%	Nuk fitoi asnjë ulëse
L 2007			Nuk mori pjesë në zgjedhje
P 2007			Nuk mori pjesë në zgjedhje
L 2009			Nuk mori pjesë në zgjedhje
P 2010			Hyri në koalicion parazgjedhor me AKR-në

UD	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2002	2881	0.41%	Garoi vetëm në Gjakovë
P 2004	2696	0.39%	Fitoi 768 vota në Gjakovë; pas zgjedhjeve partia pushoi së ekzistuari

themeluar në vitin 1998 si pjesë e koalicionit të shtatë partive politike: Partia Parlamentare e Kosovës (PPK) e drejtuar nga Bajram Kosumi, LDSH-ja e udhëhequr nga Rexhep Qosja, anëtarët e të cilës përfshinin ish të burgosur politik si dhe ish anëtarë të LDK-së si Hydajet Hyseni e Mehmet Hajrizi, UNIKOMB-i i udhëhequr nga Ukshin Hoti, PLK-ja e udhëhequr nga Gjergj Rrapi, Partia Nacionale Shqiptare e drejtuar nga Milaim Kadriu, Partia e të Gjellbërve e udhëhequr nga Daut Maloku dhe Partia Republikane Shqiptare e drejtuar nga Skënder Hoti. Koalicioni është udhëhequr nga Rexhep Qosja. Në vitin 1998, LBD-ja kërkonte rezistencë aktive dhe kundërshtone politikën e rezistencës pasive të promovuar nga LDK-ja. Ky koalicion nuk mori pjesë në zgjedhjet e vitit 1998. Ai u përfaqësua në konferencën e Rambujesë nga Qosja, dhe mori pjesë në qeverinë e përkohshme të pasluftës si dhe në Këshillin Tranzicional të SPPA-së (Strukturat e Përbashkëta të Përkohshme Administrative). Koalicioni pushoi së ekzistuari pas përfundimit të mandatit të SPPA-së, në prag të zgjedhjeve parlamentare në nëntor të vitit 2001.

PNSDH – Partia Nacionale Demokratike e Shqiptarëve, [President: Bujar Abdullahu].

PNSDH-ja është themeluar më 3 maj të vitit 1992 në Prishtinë dhe rrënjët e saj datojnë qysh nga koha e Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare (LNSDH) e cila ishte aktive gjatë viteve 1945-1947. PNSDH-ja përfaqëson vlerat prorepublicane dhe proliberale si dhe ka qëndrim të qartë kundër komunizmit, terrorizmit dhe racizmit. Megjithatë, kjo parti konsideron se ruajtja e vlerave të kulturës, traditës dhe familjes janë baza të një shoqërie liberal-demokrate, gjë që e vendos këtë parti në krahu të djathtë të

spektrit politik.

UD – Unioni Demokratik, është themeluar pak kohë para zgjedhjeve lokale të vitit 2002 me emrin Unioni Demokratik i Gjakovës (UDGJ). Kjo parti është formuar nga Mentor Kaçi, ish i burgosur politik. Në atë kohë, partia kishte vënë theks të veçantë në përfaqësimin e interesave lokale. Në vitin e saj të dytë, UDGJ-ja mori vendim të zgjeronte fushën e saj të veprimit në nivel të Kosovës. Kjo parti nuk kishte politikë të definuar rreth çështjeve ekonomike e sociale dhe pas pjesëmarrjes në zgjedhjet parlamentare të vitit 2004, partia pushoi së ekzistuari.

PARTITË TË CILAT GAROJNË PËR ULËSET E REZERVUARA NË PARLAMENTIN E KOSOVËS

PARTITË TURKE

KDTP – Kosova Demokratik Türk Partisi,

[President: Mahir Yağcılar].

KDTP-ja është parti e minoritetit turk. Në bazë të kushtetutës, pjesëtarët e komunitetit turk kanë dy ulëse të rezervuara në parlament. KDTP-ja është themeluar në vitin 1990, fillimisht si Unioni Demokratik Turk (*Türk Demokratik Birliği*) dhe ndërroi emrin në vitin 2001, kur filloi të veprojë si parti politike. KDTP-ja ka qenë pjesë e disa qeverive dhe ka fituar komunën e sapoformuar të Mamushës.

KTB - Kosova Turk Birliği (Unioni i Turqve të Kosovës), [President: Reshit Hanadan]. KTB-ja është parti e komunitetit turk e themeluar në vitin 2010. Kjo parti është e bazuar në komunën e sapoformuar të Mamushës. KTB-ja mori pjesë në zgjedhjet

KDTP	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000			
P 2001	7879	1.0%	3 ulëse të rezervuara në parlament
L 2002	7760	1.1%	Garoi në 4 komuna
P 2004	8353	1.2%	3 ulëse të rezervuara në parlament
L 2007	5184	1.0%	Garoi në 6 komuna
P 2007	4999	0.9%	3 ulëse të rezervuara në parlament; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
L 2009	7,497	1.2%	Garoi në 7 komuna dhe fitoi komunën e re të Mamushës
P 2010	8,548	1.2%	3 ulëse të rezervuara në parlament; Ministria e Administratës Publike

SDA	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000	3,653	0.5%	Garoi në 5 komuna
P 2001			Pre-election coalition with VAKAT; Numan Balić, leader of the SDA, becomes minister of health
L 2002			Koalicion parazgjedhor me VAKAT-in
P 2004	2,520	0.4%	1 ulëse në parlament
L 2007	2,468	0.5%	Garoi në 5 komuna
P 2007	3,661	0.6%	2 ulëse në parlament
L 2009	1,973	0.3%	Garoi në 5 komuna
P 2010	1,602	0.2%	Asnjë ulëse në parlament

parlamentare të vitit 2010 dhe fitoi 1,364 vota, por nuk mundi ta ndale dominimin e KDTP-së dhe nuk iu nda asnjë ulëse në parlament.

PARTITË BOSHNJAKE

SDA – Stanka Demokracija Akcije (Partia Demokratike për Aksion), [President: Numan Balić].

SDA-ja është themeluar më 14 tetor të vitit 1990 në Vitomiricë, afër Pejës. Në fillim të viteve të 90-ta, SDA-ja ka organizuar një numër tubimesh publike në të cilat partia dënonte regjimin e Millosheviqit, dhe si pasojë e kësaj, kryetari dhe disa bashkëpunëtor të tij, për shkak të prësionit u larguan nga vendi në mesin e vitit 1993. Pas vendosjes së trupave të NATO-s në Kosovë, SDA-ja luajti rol kyç në mbrojtjen e interesat dhe të drejtat jo vetëm të boshnjakëve por edhe të komuniteteve tjera.

BSDAK – Bosnjačka Stranka Demokratske Akcije Kosova (Partia Demokratike Boshnjake për Aksion në Kosovë) [President: Hilmo Kandić].

BSDAK-ja është parti e minoritetit boshnjak e cila garon për tri ulëse të rezervuara në parlamentin e Kosovës, përveç ulëseve të fituara përmes votës së drejtpërdrejtë. U themelua në vitin 1990, dhe në vitin 2000 partia e përvetësoi simbolin e shtetit të Bosnjës si logo të veten, me qëllim të joshjes së sentimentit

nacional boshnjak. Udhëheqësi i kësaj partie është Hilmo Kandić i cili ishte anëtar i Partisë Demokratike për Aksion (SDA) në vitet e 90-ta. Kandić ka qenë deputet në vitin 1992 dhe është rizgjedhur në vitin 1998.

VATAN (VATAN) [President: Džezair Murati].

VAKAT-i është parti e e komunitetit boshnjak/goran e themeluar në vitin 2001. Në vitin 2004, VATAN-i i'u bashkua dy partive tjera politike, Partisë Demokratike të Boshnjakëve (DSB) dhe Partisë Boshnjake të Kosovës (BSK), nga Prizreni, Dragashi dhe Peja, duke formuar kështu koalicionin e quajtur *Koalicija VAKAT*. Koalicioni përfaqëson intereset e boshnjakëve në Kosovë, por edhe të atyre që deklarohen si Goran.

NDS – Nova Demokratska Stranka (Partia e Re Demokratike) [President: Emilija Redžepi].

NDS-ja është themeluar në vitin 2009 nën udhëheqjen e Emilija Redžepit. Principet kryesore të partisë janë afirmimi i të drejtave dhe lirive të njeriut; demokratizimi i shoqërisë, barazia e popujve si dhe afirmimi i të drejtave të minoriteteve nacionale në përphtje me dokumentet ndërkombëtare dhe tregun e lirë.

PARTITË E GORANËVE

BSDAK	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000	4,068	0.6%	Garoi në 5 komuna
P 2001	2,906	0.4%	1 ulëse në parlament
L 2002	1,322	0.2%	Garoi në 5 komuna
P 2004	1,452	0.2%	Nuk fitoi asnjë ulëse
L 2007			Nuk mori pjesë në zgjedhje
P 2007			Nuk mori pjesë në zgjedhje
L 2009			Nuk mori pjesë në zgjedhje
P 2010	1,818	0.3%	1 ulëse në parlament

VAKAT	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet Remarks
L 2000			
P 2001	9,030	1.1%	4 ulëse në parlament; koalicion me PDK-në, AAK-në dhe LDK-në; Ministria e Shëndetësisë
L 2002	6,972	1.0%	Garoi në 8 komuna
P 2004	4,972	0.7%	3 ulëse në parlament; koalicion me LDK-në dhe AAK-në; Ministria e Shëndetësisë; SDA-ja largohet nga koalicioni
L 2007	5,269	1.0%	Garoi në 4 komuna
P 2007	5,428	0.9%	3 ulëse në parlament
L 2009	4,168	0.7%	Garoi në 5 komuna
P 2010	5,296	0.8%	2 ulëse në parlament

NDS	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2009	2,480	0.39%	Garoi në 2 komuna (Prizren dhe Istog)
P 2010	2,478	0.35%	1 ulëse në parlament

GIG	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000	1,789	0.26%	Garoi vetëm në Dragash Garoi si asociacion i qytetarëve
P 2001			1 ulëse në parlament Garoi në koalicion me VATAN-in
L 2002	1,505	0.22%	Garoi në 2 komuna (Dragash dhe Pejë)
P 2004	1,358	0.20%	1 ulëse të rezervuar. Vezira Emruš lëshon partinë.
L 2007	989	0.19%	Garoi vetëm në Dragash
P 2007	1,227	0.21%	1 ulëse të rezervuar
L 2009	454	0.07%	Garoi vetëm në Dragash
P 2010	787	0.11%	1 ulëse të rezervuar

GIG – Gradanska Inicijativa Gora (Iniciativa Qytetare e Gorës), [President: Mursel Haljilij].

Goranët kanë një ulëse të rezervuar në parlamentin e Kosovës. Fillimisht u themelua në vitin 2000 si asociacion i qytetarëve dhe si e tillë mori pjesë në zgjedhjet lokale të vitit 2000. Në vitin 2002, u shëndrrua në parti politike. Qendra e partisë

ndodhet në komunën e Dragashit. Qëllimi kryesor i programit të saj është avancimi i të drejtave dhe interesave të komunitetit Goran në Kosovë. Vezira Emruš, ish-anëtare e GIG-ut, që nga viti 2007 ka garuar si politikane e SDA-së dhe ka zënë një ulëse në parlamentin e Kosovës në vitin 2007.

PARTITË E ASHKALINJËVE

PDASHK	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000	1,552	0.23%	Garoi në 7 komuna
P 2001	3,411	0.43%	1 ulëse në parlament
L 2002	505	0.07%	Garoi në 3 komuna Konkurent i PDAK-së
P 2004	361	0.05%	Nuk fitoi asnjë ulëse

PDAK	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000			
P 2001			
L 2002	2,760	0.39%	Garoi në 9 komuna
P 2004	2,555	0.37%	1 ulëse në parlament
L 2007	2,718	0.53%	Garoi në 10 komuna
P 2007	3,443	0.60%	3 ulëse në parlament
L 2009	1,337	0.21%	Garoi në 9 komuna
P 2010	2,871	0.41%	1 ulëse në parlament

PDASHK – Partia Demokratike Ashkali Shqipëtare e Kosovës, është themeluar më 19 dhjetor të vitit 1999 në Ferizaj nga Beqir Bytyqi. PDASHK-ja i ka fokusuar politikën e sajë në rindërtimin e shtëpive të djegur të ashkalinjëve, kthimin e shtëpive të okupuara dhe pronave si dhe në përmirësimin e mundësive për punësim për anëtarët e komunitetit ashkali. PDASHK-ja u shua pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2004.

PDAK – Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës, [President: Danush Ademij].

PDAK-ja është parti e komunitetit ashkali e cila ka një ulëse të rezervuar në parlament dhe garon me partitë e romëve dhe egjiptasve për ulësen e dytë të rezervuar. Kjo parti është themeluar në vitin 2002. PDAK-ja ka për qëllim përmirësimin e respektimit të drejtave të njeriut në bazë të demokracisë e lirisë, të garantojë siguri e paqe për të gjithë popujt dhe të promovojë mirëkuptimin dhe dialogun mes të gjitha partive politike dhe mes pikëpamjeve të kundërta.

PARTITË E KOMUNITETIT EGJIPTAS

IRDK – Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, [President: Xhevdet Neziraj].

Komuniteti egjiptas ka një ulëse të rezervuar dhe garon me partitë rome dhe ashkali për ulësen e dytë të rezervuar. IRDK-ja është themeluar në prill të vitit 2011. Kjo parti mëton ta afirmojë dhe mbrojë identitetin nacional egjiptas, traditat, kulturën dhe çdo gjë tjetër që lidhet me këtë komunitet. IRDK-ja është parti e komunitetit egjiptas me bazë në rajonin perëndimor të Kosovës.

LEK - Lidhja e Egjiptianëve të Kosovës,

[President: Bislim Hoti].

LEK-u është themeluar në vitin 2010, pak para zgjedhjeve parlamentare. Qëllimet kryesore të kësaj partie janë përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave të këtij komuniteti. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010, LEK-u fitoi 1,010 vota që nuk ishin të mjaftueshme për të fituar një ulëse në parlament.

PARTITË E KOMUNITETIT ROM

PREBK – Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, [President: Haxhi Zylfi Merxha].

Komuniteti rom ka një ulëse të rezervuar në parlament dhe garon me egjiptasit dhe ashkalinjtë për ulësen e dytë të rezervuar. PREBK-u është themeluar në verë të vitit 2000 me zyren qendrore në Prizren. Kjo parti promovon sigurinë, të drejtat dhe mundësitë për punësim për komunitetin rom në Kosovë. PREBK-u është anëtar i Unionit të Romëve të Botës (RUW).

PARTITË E KOMUNITETIT MALAZEZ

CDS - Crnogorska Demokratska Stranka, [President: Predrag Despotović].

CDS-ja është themeluar në vitin 2009. Qëllimet kryesore të saj janë përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave të komunitetit malazias. Komuniteti malazias nuk ka ulëse të rezervuar në parlament dhe CDS-ja është e angazhuar që ta përmirësojë këtë gabim. Në zgjedhjet lokale të vitit 2009, kjo parti garoi në pesë komuna dhe fitoi 470 vota. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010, ajo fitoi 771 vota.

IRDK	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000			
P 2001	3,976	0.50%	2 ulëse në parlament
L 2002	3,136	0.45%	Garoi në 7 komuna; 6 prej tyre në Dukagjin
P 2004	2,658	0.39%	2 ulëse në parlament
L 2007	2,135	0.41%	Garoi në 7 komuna; 6 komuna në Dukagjin
P 2007	2,121	0.37%	2 ulëse në parlament
L 2009	2,306	0.37%	Garoi në 7 komuna; 6 komuna në Dukagjin
P 2010	1,690	0.24%	2 ulëse në parlament

PREBK	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
L 2000			
P 2001	2,717	0.34%	1 ulëse e rezervuar në parlament
L 2002			
P 2004	1,049	0.15%	1 ulëse e rezervuar në parlament
L 2007	442	0.09%	Garoi në 6 komuna
P 2007	600	0.10%	1 ulëse e rezervuar në parlament
L 2009	596	0.09%	Garoi në 4 komuna
P 2010	690	0.10%	1 ulëse e rezervuar në parlament

KP	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
P 2001	89,388	11.34%	22 ulëse në parlament
L 2002	13,238	1.89%	Garoi në 23 komuna

SLS	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet Remarks
L 2007	500	0.00%	Garoi në 8 komuna
P 2007	855	0.00%	5 ulëse në parlament, Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit
L 2009	4,331	0.01%	Garoi në 9 komuna
P 2010	14,352	0.02%	8 ulëse në parlament; zëvendës kryeministër; 2 ministri

SDSKiM	Votat	Përqindja	Situata paszgjedhore dhe vështrimet
P 2007	939	0.16%	2 ulëse në parlament
L 2009	303	0.05%	
P 2010	1,008	0.14%	1 ulëse në parlament

PARTITË E KOMUNITETIT SERB

The KP – Koalicija za Povratak (Koalicioni “Kthimi”) është themeluar në vitin 2001 si koalicioni i gjërë i serbëve të Kosovës. Disa prej udhëheqësve më në zë të komunitetit ishin: Rada Tajković, Oliver Ivanović, dhe Gojko Savić. Qëllimi i koalicionit ishte të unifikojë serbët dhe t’i mbrojtë drejtat dhe interesat

e komunitetit serb. Synim tjetër i partisë, siç mund të shihet edhe nga emri, ishte tu ndihmohet refugjatëve serbë të kthehen në shtëpitë e tyre. “Kthimi” pushoi së ekzistuari pas zgjedhjeve të vitit 2002.

SLS - Samostalna Liberalna Stranka, (Partia Liberale e Pavarur) [President: Slobodan Petrović].

SLS-ja është themeluar më 27 janar të vitit 2006 në komunën e Graçanicës kur një grup i njerëzve me ide të përbashkëta u bashkuan dhe vendosën të formojnë një parti politike të re liberale dhe proeuropiane. Momentalisht, SLS-ja është pjesë e koalicionit qeverisës me PDK-në dhe AKR-në. Kryetari i saj, Sllobodan Petrović është njëri nga gjashtë zëvendës kryeministrat dhe ministër i pushtetit lokal. Për më shumë, partia kryeson edhe dy ministri treja: Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale të udhëhequr nga Nenad Rašić dhe Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimit të udhëhequr nga Radojica Tomić.

JSL - Jedinstvena Srpska Lista (Lista e Bashkuar e Serbëve) është themeluar pak para zgjedhjeve të vitit 2010. Ajo përbëhet nga kandidatë të cilët përfaqësojnë partitë politike, kandidatë të pavarur nga OJQ-të si dhe një numër i madh i entiteteve politike të serbëve. Kjo përbërje ishte e bërë me qëllim të tërheqjes së një numri më të madh votuesish. Kjo listë udhëhiqet nga Rada Trajković, një ish përfaqësuese serbe në Strukturat e Përkoshshme të Përbashkëta Administrative (SPPA) dhe figurë udhëheqëse në koalicionin *Kthimi*. JSL-ja ka për qëllim të mbrojë dhe të përfaqësojë interesat e komunitetit serb dhe nuk është aq e qartë në orientimet e saja politike. JSL-ja përfaqëson një pikëpamje më radikale dhe me orientim kah Beogradi, për dallim nga shumica e partive tjera politike serbe. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010, JSL-ja fitoi 6,004 vota që i siguruan partisë katër ulëse në parlament.

SDSKiM - Srpska Demokratska Stranka Kosova i Metohije (Partia Demokratike Serbe e Kosovës e Metohisë) [President: Saša Đokić].

SDSKiM është themeluar në vitin 2004 nga udhëheqësi i tanishëm Saša Đokić dhe nga udhëheqësi i parë Slavisa Petković. Ky i fundit ka qenë ministër i kthimit në qeverinë e Kosovës (Koalicioni *Kthimi*), por është akuzuar për korrupsion dhe tanimë lënda e tij është në gjykatë. Qëllimi kryesor i programit të SDS-së është pajtimi mes serbëve dhe shqiptarëve, kurse ideologjikisht pozicionohet në kampin e partive social-demokrate.

SNSKiM - Savez Nezavisnih Socijaldemokrata Kosova i Metohije (Unioni i Social-demokratëve të Pavarur të Kosovës e Metohisë) është themeluar në vitin 2007 dhe garoi në zgjedhjet lokale e parlamentare të po të njëjtit vit. SNSKiM-ja kishte garuar në 6 komuna në zgjedhjet lokale, por fitoi vetëm 329 vota; kurse në zgjedhjet parlamentare, kjo parti fitoi 447 vota të cilat ishin të mjaftueshme për të marrë dy ulëse në parlament. Kjo ishte hera e parë dhe e fundit që SNSKiM-ja mori pjesë në zgjedhje.

SKMS - Srpska Kosovsko-Metohijska Stranka (Partia Serbe e Kosovës e Metohisë) është themeluar në vitin 2007 dhe garoi në zgjedhjet lokale dhe parlamentare të vitit 2007. SKMS-ja mori pjesë në zgjedhjet lokale në katër komuna por fitoi vetëm 57 vota, kurse në zgjedhjet parlamentare partia fitoi 317 vota, që mjaftuan për t'ia siguruar një ulëse në parlament. Kjo ishte hera e parë dhe e fundit që SKMS-ja mori pjesë në zgjedhje.

SLKM - Srpska lista za Kosovo i Metohiju (Lista Serbe për Kosovë e Metohi) është themeluar pas ndarjes së koalicionit *Kthimi*. SLKM-ja është udhëhequr nga Oliver Ivanović dhe kishte marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2004 ku kishte fituar 1,414 vota të cilat ia siguruan tetë nga dhjetë ulëset e rezervuara në parlament. Partia i bojkotoi institucionet e Kosovës dhe, edhe pse kishin fituar tetë ulëse, ato nuk u shfrytëzuan asnjëherë. Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2004, partia shpërbëhet.

GIS - Građanska Inicijativa Srbija (Iniciativa Qytetare Serbia) është themeluar nga Saša Đokić pas ndarjes së koalicionit *Kthimi*. Ata morën pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2004 dhe fituan 369 vota, që i garantonin GIS-së dy nga dhjetë ulëset e rezervuara në parlament. Pas zgjedhjeve, partia shuhet.

SNS - Srpska Narodna Stranka (Partia e Popullore Serbe) është themeluar në vitin 2007 dhe garoi në zgjedhjet lokale dhe parlamentare të po të njëjtit vit. Në zgjedhjet lokale, SNS-ja garoi vetëm në komunën e Rahovecit ku fitoi vetëm 23 vota. Në zgjedhjet parlamentare, kjo parti fitoi 224 vota, të mjaftueshme për ta fituar një ulëse në parlament. Kjo ishte hera e parë dhe e fundit që SNS-ja mori pjesë në zgjedhje.

ND - Nova Demokratija (Demokracia e Re) është themeluar në vitin 2007 dhe garoi në zgjedhjet lokale dhe parlamentare të vitit 2007. Në zgjedhjet lokale, ND-ja garoi në gjashtë komuna por fitoi vetëm 92 vota, kurse në zgjedhjet parlamentare, kjo parti fitoi 256 vota të cilat ishin të mjaftueshme për t'ua siguruar një ulëse në parlament. Kjo ishte hera e parë dhe e fundit që ND-ja mori pjesë në zgjedhje.

SHTOJCA I. REZULTATET E ZGJEDHJEVE 2000 DERI 2010

Tabela 1. Përshkrimi i elektoratit, dalja në zgjedhje, dhe votat e vlefshmes.

	2000 L*	2001 P**	2002 L	2004 P	2007 L	2007 P	2009 L	2010 P
Elektorati								
total	913,179	1,249,987	1,320,481	1,412,680	1,567,690	1,567,690	1,563,741	1,632,276
Votat e hedhura	721,260	803,796	711,205	699,519	628,630	628,630	697,212	739,258
Votat e Vlefshme	687,332	788,303	699,399	690,089	517,373	571,767	630,314	698,751

*- Zgjedhjet Lokale; **- Zgjedhjet Parlamentare

Tabela 2. Përshkrimi i shpërndarjes së votave ndër partitë kryesore Shqipëtare.

	2000L	2001P	2002L	2004P	2007L	2007P	2009L	2010P
LDK	398,872	359,851	321,239	313,437	118,084	129,410	154,207	172,552
LDD					45,259	57,002	45,285	14,924
PDK	187,821	202,622	207,012	199,112	181,141	196,207	200,148	224,339
AAK	53,074	61,688	61,732	57,931	47,240	54,611	95,066	77,130
LKCK		8,725	1,636		2,578	2,702		
LB							1,984	
VV								88,652
ORA				43,017	19,092	23,722	9,142	
FER								15,156
AKR					63,039	70,165	53,362	50,951
PD		4,504	5,679	7,013	8,709	9,890	13,203	
PSD	2,659	1,785	2,557	2,107			8,055	
LPK		4,404	2,801	4,526				
PSK							3,085	
PSHDK	8,533	7,701	10,271	12,427	4,123		4,361	
PDKI					3,545		1,858	
PLK		3,600	4,519	3,542			1,252	
PQLK		2,403						
PNDSh		1,066	451	857				
ADK				3,042			797	
BK		2,881	2,537	2,156	921	1,199	597	
UNIKOMB			1,001	2,607				
PGJK	1,187	2,325	680					

Tabela 3. Përshkrimi i shpërndarjes së votave ndër partitë e minoriteteve.

	2000L	2001P	2002L	2004P	2007L	2007P	2009L	2010P
KDTP		7879	7760	8353	5184	4999	7,497	8,548
KTB								1,364
BSDAK		2906	1322	1452				1,818
SDA	3653			2520	2468	3661	1,973	1,602
VAKAT		9030	6972	4972	5269	5428	4,168	5,296
NDS							2,480	2,478
GIG	1789		1505	1358	989	1227	454	787
CDS							470	
SDP							790	
PDASHK	1552	3411	505	361				
PDAK			2760	2555	2718	3443	1,337	2,871
BDA							1,205	
PAI								1,386
IRDK		3976	3136	2658	2135	2121	2,306	1,690
LEK								1,010
PREBK		2717		1049	442	600	596	690
KP		89388	13238					
GIS				369				
SLKM				1414				
SNS					26	224		
ND					92	256		
SLS					500	855	4,331	14,352
JSL								6,004
SDSKIM						939	303	1,008
SKMS					57	317		
SNSDKIM					329	447		

INDEKS

Simbole

1981 protests 21, 35

A

AAK 21, 29, 44, 45, 60, 65, 68, 71, 72, 73, 74, 76, 78, 82, 86

Adem Demaçi 18, 53

Adem Jashari 59

Adem Limani 28

ADK 30, 78, 86

Agim Çeku 19, 50, 74, 76

Ahmet Mulliqi 79

AKR 11, 41, 50, 51, 65, 68, 75, 76, 78, 80, 86

Albin Kurti 53

Aleksander Ranković 16

Alfred Moisiu 24

Alice Mead 75

Ali Këlcyra 15, 79

Ali Shukriu 23

Anamorava 61

Anton Çetta 25, 27

AQK 8, 43, 75

Ardian Gjini 45

Ashkali 66

Atifete Jahjaga 11

AUK 51

Avni Klinaku 36, 37, 72, 73

Azem Syla 36, 40

Azem Vllasi 19, 22

B

Bahri Fazliu 36, 72

Bajram Kosumi 19, 50, 74

Bajram Rexhepi 39, 51, 73

Balli Kombëtar 8, 14, 15, 59, 79

Bardhosh Gërvalla 36

Bardhyl Mahmuti 40

Baton Haxhiu 47

BDA 66, 68, 87

BE 8, 64

Behgjet Pacolli 41, 50, 51

Beograd 14, 17, 20, 21, 25, 29, 38, 40, 47

Beqir Bytyqi 83

Bill Clinton 38

Bislim Hoti 83

BK 78, 86

Blerim Shala 45

Boris Yeltsin 50

Bosnia e Hercegovina 50

BSDAK 66, 82, 87

BSPK 27

BTD 4, 8

Bujar Abdullahu 80

Bujar Bukoshi 29

Bujku 29

C

CDS 66, 68, 87

CEFTA 70, 72, 74, 75

Chris Hill 38

Christopher W. Dell 51

D

Danush Ademi 83

Daut Haradinaj 37

Daut Maloku 28, 80

Deçan 44, 74

Dick Marty 39

Dragash 68, 82

Drenas 41

Drenica 15, 41

Drenicë 36, 38, 72

Dukagjin 44, 47, 84

Dukagjin Gorani 47

Džezair Murati 81

E

E15 8, 62, 77

Edita Tahiri 30, 78

Egjiptas 9

Emilija Redžepi 81

Enver Hoxha 19

Enver Hoxhaj 42

Eqrem Basha 47

ESI 8, 32, 58, 92

EU 30

EULEX 39, 42, 53

F

Fadil Fazliu 73

Fadil Hoxha 16

FARK 29

Fatmir Limaj 33, 42

Fatmir Sejdiu 29, 31, 32, 33, 41,

70

Fehmi Agani 26

FER 48, 65, 86

Ferdinando Boattier de Mangeot 55

Ferid Agani 53, 79

Ferizaj 68, 80

Forum 18, 30

Forumi i Gruas 27

Fryma e Re 8, 48, 49, 75

Fuad Ramiqi 79

G

Gani Krasniqi 55

GAP 48

Gazmend Pula 27

GIG 66, 68, 82, 87

GIS 66, 87

Gjakova 11, 16, 21, 26, 44, 51, 68, 80

Gjakovë 52, 57, 58, 61, 62, 73, 76

Gjergj Dedaj 76

Gjilan 68

Gjykata Kushtetuese 10, 33, 34, 53, 77

Glauk Konjufca 55

Glogjan 44

Gojko Savić 84

Gorani 81, 82

Gorani 47, 66

Gospić 50

H

Hajredin Kuçi 42

Hajrullah Gorani 27, 28

Halil Alidemaj 79

Halil Matoshi 77

Halit Geci 37

Hamëz Jashari 26

Hashim Thaçi 35, 39, 73

Haxhi Zylfi Merxha 83

Hilmo Kandić 81

Hydajet Hyseni 27, 28, 38, 42, 80

Hysamedin Azemi 23

I

Ibrahim Makolli 52

Ibrahim Rugova 18, 21, 24, 26, 29, 32, 71, 73, 74, 75

ICG 8, 37, 38, 39, 40, 44

ICTY 8, 21, 42, 44

Idriz Ajeti 25, 27
Ilaz Kadolli 72
Ilir Deda 48
IPVQ 8, 67
IRDK 66, 68, 84, 87
Isa Mustafa 32, 33, 42
Istog 24, 68, 82

J

Jakup Krasniqi 41
JIAS 25, 39, 45
JNA 8, 21
JSL 66, 87
Junik 74
Jusuf Bajraktari 25
Jusuf Buxhovi 25, 26, 28

K

KACI 8, 49
Kadri Veseli 36, 38
Kadri Zeka 36
Kai Eide 54
Kamenica 19
KAN 53
Kaqusha Jashari 19
Kazakistan 52
KDTP 66, 68, 73, 75, 81, 87
KEK 8, 55, 70, 74, 75
Këshilli i Shpëtimit Kombëtar 38
Këshilli Koordinues 28, 30
KFOR 42
KIPRED 48
KKR 8
Kleçka 42
Klinë 61, 62, 73
KMLDNJ 8, 27, 28, 47
Koalicija VAKAT 81
Koha Ditore 47
Kosovë 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 25, 26, 27, 28, 31, 32, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 44, 45, 46, 48, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 63, 66, 67, 68, 70, 71, 72, 73, 75, 77, 79, 81, 82, 83, 85, 92
KP 66, 84, 87
Krajina 50
KTB 66, 87
KTV 47
KVM 8, 38

L

LB 68, 72, 86
LBD 25
LBSH 25, 79
LDD 31, 65, 68, 71, 76, 86
LDK 11, 16, 24, 25, 26, 29, 30, 31, 32, 33, 39, 41, 42, 44, 60, 65, 68, 71, 73, 74, 76, 78, 82, 86
LEK 66, 87
Leposaviq 68
LIB 68, 72
Lipjan 61
Lista Ibrahim Rugova 34
LKCK 72, 86
LKÇK 8, 36, 37, 44, 72, 73, 75
LKJ 8
LKK 8, 23, 24, 26, 27, 29
LPK 35, 44, 72, 86
LPRK 39
LRSSHJ 8, 36, 72
Luljeta Pula 27, 28, 77

M

Mabetex 50
Mahir Yağcılar 80
Mahmut Bakalli 19, 21
Malishevë 62, 73
Mark Krasniqi 76
Mehmet Hajrizi 27, 28, 80
Mehmet Kraja 23, 24, 25, 36
Mentor Kaçi 80
Milazim Krasniqi 25, 27
Mimoza Kusari-Lila 51
Mit-hat Frashëri 15
Mitrovica 58, 63, 64, 68
Montenegriins 15
Montenegro 15, 25, 66
Muhamedin Kullashi 27, 77
Muhamet Bicaj 28
Muhamet Kelmendi 79
Mujë Krasniqi 36, 37
Murselj Haljilji 82

N

Naim Maloku 79
NATO 26
ND 66, 87
NDS 9, 66, 67, 81, 82, 87
Nenad Rašić 85
Nexhat Daci 29, 31
Nikë Gjeloshi 28, 77
NP 9, 49
NSH 9, 58, 59

Numan Balić 81

O

Obiliq 58, 60, 73
OJQ 8, 28, 47, 48, 49, 85
Oliver Ivanović 84, 85
ORA 47, 65, 68, 74, 86
OSCE 9
OZNA 17

P

PAI 66, 87
Paris 24
Parlamenti Rinor 28, 77
Partia Parlamentare e Kosovës 9, 77, 80
PD 68, 78, 86
PDAK 66, 68, 83, 87
PDASHK 66, 83, 87
PDK 11, 29, 30, 32, 33, 35, 39, 41, 42, 44, 50, 60, 65, 68, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 78, 82, 86
PDKI 76, 86
Peja 24, 35, 50, 82
Peje 68
PGJK 86
PKJ 8, 15
Pleurat Sejdiu 40
PLK 68, 76, 86
PNDSH 52, 62, 77, 80, 86
Podujeva 71
Podujevë 32
Policia e Kosovës 9
PPDK 9, 40, 73
PPK 18, 47
PQLK 78, 86
PREBK 66, 84, 87
Predrag Despotović 83
PReK 29
Prishtina 11, 16, 18, 19, 21, 24, 25, 26, 30, 31, 32, 33, 35, 39, 41, 42, 44, 45, 47, 48, 50, 51, 53, 68, 78, 80
Privatizimi 70
Prizren 21, 30, 68, 78, 82
PSD 52, 53, 62, 68, 76, 77, 86
PSHDK 9, 28, 31, 68, 71, 76, 77, 79, 86
PSK 72, 86
PTK 9, 55, 74

Q

Qeveria e Përkohshme 9
QIK 28, 29
Qyshk 50

R

Rada Trajković 85
Radojica Tomić 85
Rahovec 58, 73
Raif Qela 36, 72
Rajoni i Drenicës dhe më gjërë 58
Ramush Haradinaj 44, 45, 74
Ramush Tahiri 28
Referendumi 28
Reshit Hanadan 80
Rexhep Qosja 24, 25
Rexhep Selimi 36, 37, 55
Richard Holbrooke 38
Rilindja 45, 47
Roma 66
Rahman Morina 23
RUW 83

S

Sabit Gashi 36, 72
Sabri Novosella 36, 72
Sali Gashi 31
SANU 9, 21
Saša Djokić 85
Saša Đokić 85
SDA 66, 68, 81, 82, 87
SDSKiM 66, 84, 87
Serb 16, 66
Serbia 15, 17, 19, 22, 24, 30, 31,
32, 45, 50, 58, 66
SFRJ 9
Shaban Polluzha 59
Shaban Shala 40
SHIK 9, 42
Shoqata e Shkrimtarëve 24
Shpend Ahmeti 48
Shqipëri 14, 15, 31, 38, 57, 79
Shtime 59, 61, 62
Skenderaj 39, 40, 58, 59, 61, 62,
73, 80
SKMS 66, 68, 87
SKOJ 9, 19
Slavisa Petković 85
SLKM 87
Slobodan Milošević 21
Slobodan Petrović 84

SLS 66, 68, 84, 87
Smajl Latifi 73
SNS 66, 87
SNSKiM 9, 85
SPPA 9, 32, 80, 85
Stalinist 17
Suhareka 29, 71, 72, 78
Suharekë 57, 59, 60
Switzerland 35, 39, 44, 50

T

Teuta Sahatqija 49
Tito 16, 17, 19
TMK 9, 43
Trepça 15, 58
Tribunali i Hagës 45

U

UÇK 16, 18, 24, 25, 35, 39, 41,
44, 50, 53
UD 80
UDBA 17, 24
UDGJ 80
UJDI 47
Ukë Rugova 29
Ukshin Hoti 79, 80
UNIKOMB 78, 86
Universiteti i Prishtinës 11, 20,
24, 26, 30, 31, 32, 33, 35, 39, 41,
44, 45, 51, 53, 85
UNMIK 53
UNSC 9
UPSUP 31, 53, 54
US 11
USAID 47, 51
USHDK 75

V

VATAN 82
Vendlindja Thërret 37, 40
Vetëvendosje! 5, 9, 37, 38, 48, 51,
53, 54, 55, 73, 75
Veton Surroi 47
Vezira Emruš 82
Vienna 24, 32, 50
Viti 27, 61
Vitomiricë 81
Vjenë 54
Vushtrri 68
VV 65, 72, 86

W

William Walker 38

X

Xhafer Shatri 28, 72
Xhavit Haliti 35
Xhevdet Neziraj 83

Y

Ylber Hysa 47

Z

Zadar 50
Zef Morina 77
Zëri 18, 29, 45
Zubin Potok 68
Zveçan 58, 69
Zvicër 36, 37, 40

PËR IKS-in

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) është think-tank i pavarur dhe jofitimprurës i cili përqëndrohet në hulumtime empirike dhe analiza të zhvillimeve socio-ekonomike në Kosovë. E themeluar në vitin 2004, IKS ofron hulumtime inovative dhe politika relevante me synim që të nxis debate për çështjet e rëndësishme për të ardhmen e Kosovës.

Ne besojmë që debatet publike të bazuara në dëshmi janë thelbi i vendimmarrjes demokratike.

Që nga vera e vitit 2004, IKS ka zgjeruar stafin dhe sot përfshin tetë analistë dhe hulumtues me orar të plotë, dhe rrjet në rritje e sipër të hulumtuesve dhe bashkëpunëtorëve. IKS përkrahet në

punën e saj nga Bordi i Drejtorëve i përbërë nga analistë dhe praktikantë Kosovarë dhe ndërkombëtarë.

Që nga zanafilla e saj, puna IKS është përqendruar në çështjet e qeverisjes, zhvillimit socio-ekonomik, planifikimit urban, korrupsionit në rindërtimin e pas-luftës, mbrojtjen e ambientit, arsimit, rinisë, problemit të imazhit të Kosovës si dhe strukturat qeverisëse ngatërruese të tanishme. IKS është poashtu pjesë e rrjetit të think-tanks në mbarë Evropën Juglindore të inspiruar nga ESI.

Të gjitha raportet mund ti gjeni në faqen tonë të internetit: www.iksweb.org.



Iniciativa Kosovare për Stabilitet — IKS
Telefoni: + 381 38 222 321
E-mail: info@iksweb.org; www.iksweb.org
Adresa: Rr. Garibaldi H11/6, Prishtinë, Kosovë

Dezajni: trembelat

Shkronjat: Në biografi: Trembelat Test; Në tekst: Garamond; Në fituj & ballinë: Kapital.

Kjo faqe është në formatin B5, kurse margjina e jashtme, e lartë & e brendshme është 1.6 cm. Margjina e poshtme 1.8 cm.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

329 (496.51)

Abetarja e Pushtetit: Libërth mbi politikën, njerëzit dhe partitë në Kosovë
/ [Iniciativa Kosova për Stabilitet]. – Prishtinë: IKS, 2011. – 96 f. : ilustr.
me ngjyra; 21 cm

Parafjala: f. 7

ISBN 978-9951-600-03-3



©Copyright IKS, dhjetor 2011

ISBN 978-9951-600-02-6



9 789951 600026